UNIVERSITETI BARLETI

KONFERENCË
NDËRUNIVERSITARE AKADEMIKE

SFIDAT E ARSIMIT TË LARTË DHE KËRKIMIT TË APLIKUAR NË SHQIPËRI

Tiranë

“Sfidat e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit të Aplikuar në Shqipëri”

Proceedings të Konferencës Ndëruniversitare Akademike

Tiranë, 2020

Barleti Press/ Universiteti “Barleti”

Adresa: Rruga e Kosovarëve, Nd.37, H.1 Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri

Cel:+355 69 20 62 086| E:info@umb.edu.al| W: www.umb.edu.al

Produktet e Konferencës së Parë Ndëruniversitare Akademike, me temë:

"Sfidat e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit të Aplikuar në Shqipëri",

organizuar nga Universiteti "Barleti" në bashkëpunim me IAL-të partnere: Universitetin "Aleksandër Moisiu" në Durrës, Universitetin "Fan Noli" në Korçë, Universitetin "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan, Universitetin "Ismail Qemali" në Vlorë dhe Universitetin "Eqerem Çabej" në Gjirokastër.

Tiranë, më 19.11.2020.

Konferenca bashkoi në një forum kombëtar akademikë, kërkues shkencorë, pedagogë, studentë dhe aktorë të tjerë në sektorin e arsimit të lartë në Shqipëri, për të ndarë njohuritë dhe përvojat e tyre në fushën e arsimit të lartë në Shqipëri.

Fushat kryesore që konferenca përfshiu:

1. Edukimi;
2. Ligji dhe Shkencat Politike;
3. Inovacioni dhe Ekonomia;
4. Shëndeti, Turizmi dhe Sporti.

Këshilli Shkencor

Kryetare: Prof. Dr. Suzana GUXHOLLI

Anëtarë: Prof. Dr. Artan SHYTI (Sekretar Shkencor), Prof. Dr. Lekë SOKOLI, Prof.Assoc. Dr. Zamira ÇAVO, Prof. Assoc. Dr. Arbi AGALLIU, Prof. Assoc. Dr. Valbona DURI, Dr. Robert GJEDIA, PhD. Kejda NUHU, Dr. Teuta NUNAJ(Kortoçi), PhD. Sokol Bana, Dr. Erinda Papa.

Gjuhët e Konferencës: Shqip dhe Anglisht

Tabela e Përmbajtjes

Fjala Pershëndetëse e Zv. Rektore për Kërkim dhe Novacion në Universitetin "Barleti"-Prof. Dr. Suzana Guxholli **5**

Punime në gjuhën shqipe

Të miturit devijant-Dr. Lejda Abazi **7**

Segmentimi i profilit të vizitorëve nëpërmjet përdorimit të analizës Klaster. Rast studimor: Zona rurale e Gjirokastrës-Dr. Irena Boboli Prof.Assoc. Dr. Valbona Duri 23

Institucionet edukuese në Shqipëri gjatë viteve 1963-1973 për fëmijët me aftësi të kufizuara-Dr.Orneda Gega (Hoxha) **37**

Mësimdhënia praktike në distancë në kohën e Covid-19-MSc.Manjola Bani **45**

Arsimi vs zhvillimit ekonomik në tranzicion. Rasti i Shqipërisë - Dr. Teuta Nunaj (Kortoçi), Kejda Nuhu PhD. **62**

Pasurimi i fjalorit të nxënësve të ciklit 9-vjeçar përmes tekstit të gjuhës shqipe- Suela Patoshi **84**

Përdorimi i teknologjisë në edukim për zhvillimin e provimeve me anë të kompjuterit krahas atyre që zhvillohen vetëm me test me shkrim- Dr.Alfons Harizaj, Dr.Robert Gjedia **103**

Procesi i të pyeturit në lëndën e historisë.Rast studimi: Shkollat 9-vjeçare, Bashkia Devoll -Dorisa Topi **114**

Stresi dhe performanca e studentëve-Msc. Valbona Çaushi, Msc. Anxhela Çaushi **149**

Kurrikula me bazë kompetenca në arsimin fillor-Msc. Armanda Xhani (Baça) **161**

Turizmi i aventurës:Trendi aktual i destinacioneve turistike në Shqipëri (Rast pilot: Via Dinarica – pjesa shqiptare)-Dr. Florina Pazari, Dr. Elda Mamoçi, M.Sc.Esmeralda Hasani **183**

Turizmi i aventurës në Shqipëri, Bosnjë & Hercegovinë dhe Serbi: Një vështrim i shkurtër- Gazmend Zeneli, Sabina Sirco, Thiery Joubert, Nemanja Neskovic, Ivan Nastic, Lorenc Konaj **200**

Turizmi kulturor, si mundësi për zhvillimin e qëndrueshëm në Qarkun e Gjirokastrës-Prof.Dr. Gëzim Sala, Prof. Asoc. Albina Sinani **228**

Turızmı ı aventurës në Shqıpërı: Mundësıtë dhe sfıdat(Rast pilot: Qarku i Dibrës)- Ardi Malaj **244**

Vlerat historike dhe arkitekturore të kalave në funksion të zhvillimit të turizmit kulturor në Shqipëri-Dr. Elda Mamoçı, Dr. Florina Pazari **259**

Turizmi në kurrikulat e arsimit të lartë shqiptar-Dr. Mariglen Sherifaj, Doc. Dr. Gentian Ruspi **280**

Punim në gjuhën angleze

The importance of cognitive reading strategies in comprehending literary-PhDc. Ardita Dylgjeri **300**

Fjala përshëndetëse e Zv. Rektore për Kërkim dhe Novacion në Universitetin “Barleti”

Prof. Dr. Suzana Guxholli

Me krenari dhe entusiazëm prezantohen punimet shkencore të Konferencës së Parë Ndëruniversitare Akademike, organizuar nga konsorciumi kombëtar i universiteteve shqiptare, ku bëjnë pjesë universiteti i Gjirokastrës, Korçës, Durrësit, Vlorës, Shkodrës dhe Barleti në Tiranë. Ky botim iveçantë kërkimor shkencor, kombëtar e më përtej, përfshin komunitetet akademike dhe jo vetëm, por edhe ato të biznesit, qeverisjes, sektorëve të ndryshëm të zhvillimit ekonomik e shoqëror, studentë dhe kërkuesit kudo që ndodhen. Duket si një klishe, por e dobishme do të thuhej. Ne jemi si një punë në progres, që në mënyrë aktive kërkon ide nga kampusi në kampus, nga komunitete, biznese e fusha të ndryshme zhvillimi, duke krijuar qëllime dhe vizione, sipas një strukture në ndërtim e sipër.

Ndërkohë ne jemi të hapur përsa u përket drejtimeve të rrugëtimit dhe mënyrës si arrijmë ku synojmë ndërsa kërkojmë. Kërkimi që ne zhvillojmë, përfaqëson një mendim dhe mënyrë të vepruari të një grupi individësh novatorë, që krijojnë vizione të reja, zbulojnë shtigje të reja drejt arritjeve në ndihmë të shoqërisë, individëve, biznesit, shkencës e teknologjisë.

Me këto botime synohet të përfaqësohet mendimin novator krijues i akademikëve, studentëve, kërkuesve, shkencëtarëve të mbarë vendit e më përtej, të rajonit gjithashtu. Është një përpjekje e parë për të krijuar sinergjinë e mendimit kërkimor shkencor të grupeve më të gjërase vetëm të një universiteti. Kjo iniciativë synon të krijojë një database të kërkimit shkencor, si themel i krijimit dhe zhvillimit të njohurive dhedijeve kolektive, të zgjerojë bazën e përpjekjeve për të rritur dijen e kapitalizuar ne vendin tonë e pse jo edhe në rajon më tej.

Synimi i këtij botimi shkencor është të jetë i pari i llojit të vet që angazhon kërkimin komunitar kombëtar e rajonal. Nëpërmjet web-it të

tij, ky botim shkencor dhe të tjerët që do pasojnë, si përfaqësues i rrjetit të kërkuesve kombëtarë e rajonalë, do të jetë dinamikë, si vetë realiteti që hulumton dhe si disiplinat shkencore e praktike që rriten e zhvillohen me shpejtësi, pra, do të jetë një përfaqësuese e veçantë e mendjeve dhe punës krijuese e novatore të universiteteve dhe komuniteteve. Synim tjetër i tij, është të kthehet në një instrument debati,bashkëbisedimi shkencor e përfshirje të komuniteteve akademike, të biznesit, shoqërisë, studenteve, sipëmarrësve shqiptarë e më përtej.

Botimi shkencor do të drejtojë e krijojë sinergji në punën kërkimore, idetë e risitë e saj në komunikimin dhe përhapjen e tyre në dobi të akademisë, qeverisjes, biznesit, shoqërisë, etj. Ai do të bëjë ndryshimin në përqasjen e kërkimit shkencor, si atij bazik dhe atij të aplikuar, jo izoluar vetëm në një universitet, por si ekonomi tërësore e dijes njerëzore në dispozicion të të gjithëve. Ky botim lehtëson diskutimet dhe debatin kërkimor, në një bazë të gjerë, transformuese, duke lidhur universitetet me komunitetet e ndryshme me një larmi pyetjesh, problemesh, gjetjesh që do të shprehen me zërin aktiv të asaj që ndodh e që pritet të ndodhë, që dot'ju përgjigjet pikëpyetjeve dhe nevojave të komuniteteve, që do të shtojë kontributet në njohuri teorike e të aplikuara.

Duke qenë novator në idetë e prezantuara, botimi shkencor bëhet një agorë e punës kërkimore akademike me bazë kombëtare e rajonale, integruese për mësimin, kërkimin, shërbimet për komunitete të ndryshme në fusha të ndryshme të tilla si fusha të ekonomisë, shoqërisë e qeverisjes duke përfshirë të gjithë ata që duan të hulumtojnë e që kanë intuitë e vizion të zbulojnë risi në ndihmë të zhvillimit të qëndrueshëm e novator. Le të nisim rrugëtimin së bashku drejt hulumtimit dhe zbulimit të ideve novatore që na transformojnë ne, akademikët dhe studentët si dhe komunitetet me te cilët jemi partnerë në sfidat që do të prezantojmë në seritë e botimeve në vazhdim.

TË MITURIT DEVIJANT

Dr. Lejda Abazi

Universiteti “Barleti”, Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit, Tiranë

bh.dep@umb.edu.al

Abstract

The idea of this article starts from a need that is strongly felt today, at the institutional, social and public level, in relation to a certain area of the more complex issue that of juveniles as the aspect of those youth groups that, although in ways various, have always received over time great visibility for violation of established laws and rules, with certain differences in the severityof crimes according to individual cases. Groups of teenagers who in their schools threaten or beat their weakest peers or even the professors themselves, juveniles who in groups commit acts of vandalism, theft of valuables, use or sale of drugs up to acts of murder.The phenomenon of juvenile delinquency has recently raised a strong social alarm and for which the national media have given more and more space for such news, labeling gangs with the term baby gang and pointing to this term, an extreme variety of deviant behavior created by groups of teens. The fact that the issue was not raised by researchers, but by the mass media, does not mean that the problem does not exist, the question that arises is whether this particular form ofjuvenile delinquency in the group is radically different from those detected and studied so far:such as the phenomenon of bullying or youth gangs involved in acts of vandalism. The episodes reported by the press hardly state, in fact, about the content of the phenomenon, but refer to its social perception. Our interest should be directed around the careful observation and study ofwhat are the special characteristics of groups of young people who tend to commit deviant actions and, in particular, to analyze the modalities by which juveniles manage to commit groupcrimes.

The study of juvenile delinquency in Albania, focusing mainly on psycho-social factors, is anattempt to analyze in several dimensions, the

current situation of juveniles in conflict with the law. This paper will focus not only on the treatment of some of the main theories on juvenile delinquency but also on the presentation of juvenile profiles in alternative penitentiary institutions, based on the processing and analysis of data through interviews, risk assessment system and Juveniles in Probation Service.The main purpose of this paper is to identify and analyze the factors that directly or indirectly affect the involvement of juveniles in committing criminal offenses, in order to create a clearpicture of juvenile delinquency in the country and suggest preventive measures.

Keywords: *deviant minor, criminality, juvenile defendants, teen groups, baby gang.*

Abstrakt

Ideja e këtij artikulli nis nga një nevojë që ndihet fuqishëm sot, në nivel institucional, shoqëror dhe publik, në lidhje me një fushë të caktuar të çështjes më komplekse ajo e "të miturve" si aspekti i atyre grupeve rinore që, megjithëse në mënyra të ndryshme, kanë marrë me kalimin e kohës gjithmonë shikueshmëri të madhe për shkeljen e ligjeve dhe rregullave të vendosura, me dallime të caktuara të gravitetit të krimeve sipas rasteve individuale.Grupet e adoleshentëve, të cilët në shkollat e tyre kërcënojnë ose rrahin bashkëmoshatarët më të dobët ose dhe vetë profesorët, të mitur që në grup kryejnë aktet e vandalizmit, vjedhje të sendeve me vlerë, përdorim apo shitje droge deri tek aktet vrasje. Fenomeni i delikuencës tek grupet e të miturve në kohët e fundit ka ngjallur një alarm të fortë social dhe për të cilën mediat kombëtare kanë dhënë gjithnjë e më shumë hapësirë për të tilla lajme, duke i etiketuar bandat me termin *baby gang* dhe duke treguar me këtë term, një shumëllojshmëri ekstreme të sjelljes devijante të krijuar nga grupet e adoleshentëve. Fakti që çeshtja nuk është ngritur nga studiuesit, por nga mass-mediat, nuk do të thotë se problemi nuk ekziston, pyetja që shtrohet është nëse kjo formë e veçantë e delikuencës së të miturve në grup është rrënjësisht e ndryshme nga ato të zbuluara dhe të studiuara deri tani: si për shembull fenomeni i bullizmit ose i bandave të të rinjve të përfshirë në aktet e vandalizmit. Episodet e raportuara nga shtypi thuajse nuk deklarojnë, në të vërtetë, rreth

përmbajtjessë fenomenit, por i referohen perceptimit të saj shoqëror. Interesimi ynë duhet të drejtohet rreth vëzhgimit dhe studimit me kujdes se cilat janë karakteristikat e veçanta të grumbullimeve të të rinjve që tentojnë të kryejnë veprime devijante dhe në veçanti, të analizojmë modalitetet me të cilat të miturit arrijnë të kryejnë krime në grup. Studimi i kriminalitetit të të miturve në Shqipëri i përqëndruar kyesisht në faktorët psiko-social, përbën një përpjekje për të analizuar në disa dimensione, situatën aktuale të të miturve në konflikt me ligjin. Ky punim do të fokusohet jo vetën në trajtimin e disa prej teorive kryesore mbi deviancën minorile por, edhe prezantimin e profileve e të miturve në institucionet e dënimeve alternative, bazuar në përpunimin dhe analizimin e të dhënave përmes intervistave, sistemit te vleresimit te rrezikshmerisee të miturve në Shërbim prove. Qëllimi kryesor i punimit është identifikimi dhe analizimi i faktorëve që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte, në përfshirjen e të miturve në kryerjen e veprave penale, me qëllim krijimin e një tabloje të qartë të kriminalitetit të të miturve në vend dhe sugjerimin e masave parandaluese.

Fjalët kyce:*minoren deviantë, kriminalitet, të pandehur të mitur, grupe adoleshent, baby gang.*

1. Përkufizimi dhe orientime teorike

Sjelljet devijuese të të miturve nuk konsiderohen më si rezultat i proçeseve të zhvillimit dhe rritjes në kontekste të vështira familjare, kulturore, ekonomike ose sociale, por si rezultat i një "zgjedhje adaptive", një nga përgjigjet e mundshme të zbatuara, në mënyrë të vetëdijshëm, për të prodhuar një ndryshim në vetë sistemin, i kuptuar si kontekst i jetës.

Përkufizimi i kriminalitetit të të miturve nuk është ndërmarje e lehtë pasi një nga vështirësitë ka të bëjë me mungesën e njësimit të terminologjisë në këtë fushë. Termi më i përhapur është kriminaliteti i fëmijëve ose e quajtur ndryshe delikuenca e të miturve por, disa autorë nuk janë dakort me këtë terminologji për shkak të përmbajtjes negative duke mbrojtur disa koncepte me të “butë dhe fleksibël”, për të përkufizuar të miturit autorë të veprave penale.

Koncepti i devijimit përfshin të gjitha ato sjellje që nënkuptojnë heqjen dhe / ose shkeljen e normave të pranuara shoqërore, por edhe të gjitha format e keqtrajtimit dhe shkeljes dhe i përgjigjet përvetësimit të një roli ose identiteti shoqëror, i cili mund të jetë individual ose grup, i cili arrihet përmes zbatimit të sjelljeve që shkelin një normë shoqërore të pranuar dhe të përbashkët. Në adoleshencë sjellje të tilla mund të manifestohen në mënyra që ndryshojnë në këmbëngulje dhe ashpërsi, nga qëndrimet më kundërshtuese, siç janë mosbindja ose gënjeshtra, shkelja e ligjeve, përdorimi dhe abuzimi i substancave narkotike, vandalizmi etj. dhuna ndaj personit (Manca dhe Mascia, 2006). Në këtë drejtim, Moffitt (1993) bën një dallim shumë të rëndësishëm, veçanërisht për sa i përket trajtimit dhe prognostikës, midis një sjelljeje: të rastësishëm antisocial, të përcaktuar si *adolescent-limited*, dhe një më serioz, tashmë kronik brenda strukturës së personalitetit, i quajtur *life-course persistent*.

Veprat penale për të mitur janë dukshëm në rritje, veçanërisht ato të dhunshme, ndaj personit dhe gjithashtu ato që lidhen me përdorimin e shtrembëruar të teknologjisë. Mosha e fëmijëve të përfshirë është gjithmonë më e ulët, djemtë nga të gjitha sferat e jetës janë të përfshirë dhe numri i vajzave të përfshira në veprime kriminale po rritet gjithashtu.

Eshtë e rëndësishme të nënvizohet se ekziston një marrëdhënie midis sjelljes antisociale, grup moshatarëve dhe pranisë së mbështetjes sociale, pasi delikuenca e të miturve në përgjithësi ka origjinë brenda një grupi dhe forcohet nga prania e bashkëmoshatarëve devijues dhe ndoshta edhe nga një mjedis që nuk censuron sjelljet e caktuara. Baby gang në përgjithësi kanë qëllime destruktive dhe të dhunshme, gjithashtu lehtësohen nga mungesa e përgjegjësisë midis anëtarëve të grupit sepse përmes këtij procesi nuk ka një vlerësim të qartë të pasojave të veprimeve të tyre.

Një nga emergjencat kryesore të delikuencës së të miturve ka të bëjë me përfshirjen e të miturve në forma të ndryshme të krimit të imët, siç janë trajtimi i drogës ose vjedhjet. Karriera delikuente e të miturve është e lidhur, madje edhe në mënyrë të konsiderueshme, me largimin e hershëm të shkollës. Mosha e fillimit të sjelljes delikuente paraqet një nga faktorët

kryesorë të rrezikut, kështu që sa më herët fillimi, aq më i madh rreziku i zhvillimit të një çrregullimi të sjelljes është i dukshëm në periudhat e mëvonshme ose të një personaliteti antisocial (Cerutti and Manca, 2008). Ndër shprehjet me të cilat sjellja e dhunshme në adoleshencë mund të manifestohet gjejmë: ajo e drejtuar kundër mallrave (vandalizmit), kundër njerëzve (nokaut), kafshëve, seksit dhe gjinisë e cila përfshin format e dhunës të pranishme brenda çifteve të adoleshentëve, të cilët mund të përfaqësojnë shenja të hershme të femicide.

Në përgjithësi, devijimi përcaktohet si një grup sjelljesh që prishin kompleksin e vlerave të cilat, në një moment të caktuar historik dhe në një kontekst të caktuar shoqëror, janë të vlefshme dhe themelore mbi bazën e kulturës së grupit mbizotërues shoqëror.Nuk ka asnjë vizion univokal të konceptit të devijimit, i cili ka supozuar kuptime dhe vlera të shumta me kalimin e kohës.

Pavarësisht orientimit teorik, sidoqoftë, mund të pohohet se devijimi lind në lidhje me delikuencën në raport me gjininë dhe speciet, në kuptimin që, nëse është e vërtetë që delikuenti është gjithashtu një devianant, një devianant nuk është domosdoshmërisht një delikuent. Devijimi dhe delikuenca nuk janë sjellje të përcaktueshme, por në funksion të kontrastit midis sjelljeve të caktuara dhe rregullave shoqërore (1).

Sjelljet devijuese ndahen në:

a) fakte e veprime me rëndësi penale si (dëmtime të objekteve, plagosje e vrasje)

b) sjellje të ligjshme (përdorimi i substancave narkotike, abuzim me alkoolin, prostitucion)

Për të kuptuar më mirë fenomenin në fjalë, dy faktorë të ngjashëm të konsideruara si sinonime të deviancës por që në praktik janë të ndryshme.

Bëhet fjalë për:

1. ***shqetësim shoqëror***: vështirësi vetjake që i riu adoleshent e ndjen brenda vetes si paaftësi për të pranuar veten. Nga kjo gjendje e brenshme

mund të krijohen forma akute si anoreksia, bulimia të lidhura me rritjen moshore (shprehet së brenshmi).

2. ***mungesë përshtatje:*** paaftësi për t'u raportuar paqësisht me ambjentin e jashtëm, për tëkrijuar marrëdhënie korrekte me personat e tjerë, me vlera e shoqërisë dhe botën e jashtme (shprehet së jashtmi).

Devijanza minorile shihet si alarm social jo sepse është fenomen i ri, por për rritjen e rasteve të rregjistruara dhe për ashpërsinë dhe rrezikshmërinë e shfaqur.

Po bëhet më e shpeshtë dhe e zakonshme prezenca e të miturve deviantë të cilët i përkasin klasës së mesme ndryshe nga çfarë ka qënë më parë si fenomen eskluziv i shtresave më të ulëta dhe të varfra sociale.

2. Shkaqet e deviancës minorile dhe zgjidhje të mundshme

Sipas disa studimeve 24% e deviancës minorile i përket faktorit patologjik (defiçit me karakter biologjik dhe neuropsikologjik) edhe pse jo çdo i mitur me çrregullime psikiatrike detyrimisht do të bëhet devijantë. Për këto raste ndihma vjen nga mjeksia.

- 76% i rasteve ka origjinë sociale dhe psikologjike ku:
- 44% të rasteve shkaktohen nga ambienti familjar i munguar ose tepër problematik i nënkulturave që lejojnë mungesën e vlerave dhe dhunën.
- 32% të rasteve lidhet me aspektet psikologjike dhe të marrëdhënieve ku hasen vështirësi reale i të miturit për të komunikuar me bashkëmoshatarë dhe të rritur.

Po t'i referohemi historikut të teorive që kanë trajtuar fenomenin e deviancës minorile duke u fokusuar tek shkaqet e formimit të kësaj sjellje të veçantë tek individi i mitur kemi:

1) Teoritë e Lombrozos (800) ku devijanca minorile e kishte prejardhjen nga defiçit biologjik.

2) Teoritë psikologjike dhe psikiatrike që shkaqet i lidhin me funksionimin e psikës.

3) Teoritë sociale që shohin si shkaktarë ambjentin e jashtëm konkretisht atë familjar si privues të afeksionit dhe përkujdesjes.

Përveç teorisë së parë, të gjitha të tjerat kanë elemente vërtetësie por ajo që duhet theksuar është fakti që sjellja devijante tek të miturit nuk shkaktohet nga një faktor i vetëm, cilido qoftë ai.

Devijimi i fëmijëve ka qenë gjithmonë një fenomen kompleks dhe i shumëanshëm, përkufizimet, leximet dhe interpretimet e të cilit mund të jenë të shumëfishta.

Devianca shpreh një problematikë që lind nga mungesa e një shkëmbimi të efektshëm të marrëdhënieve midis aktorëve të të njëjtit sistem shoqëror.

Në shoqërinë e sotme, pra, e karakterizuar nga ndryshimi i vlerave, nga ekuilibra tëbrishtë afektive dhe mbështetës, fenomeni i devijimit duket se merr një pozicion të veçantë brenda gjendjes së adoleshencës, në të cilin individi investohet nga pritshmëri të shumta sociale dhe evolucionit. Në të vërtetë, adoleshenca karakterizohet nga prania e ambivalencave të shumta siç është dëshira për autonomi dhe nevoja për mbrojtje, konformizëm dhe rebelim, refuzimi i së kaluarës së fëmijërisë dhe veprimi me sjellje të papjekur, dikotomia midis planifikimit dhe pasivitetit.

Në këtë drejtim, shqetësimi i adoleshentit mund të manifestohet edhe përmes kryerjes së një krimi, i cili bëhet një mjet komunikimi, shprehja e një çrregullimi në fazën e zhvillimit, rritja e adoleshencës dhe mangësitë në kontekstin e mikrosistemit të tij shoqëror, të botës së tij jetike.

Shpjegimi i fenomenit të devijimit të të miturve nuk duhet të kërkohet duke hulumtuar shkaqet që gjenerojnë sjellje antisociale ose antisociale.

Në fakt, një lloj përcaktori shkakor duket qartë i mohuar nga përvoja, sipas të cilit, për kushte të caktuara individuale ose shoqërore të subjektit, ai domosdoshmërisht duhet të korrespondojë një situatë devijimi. Sipas Bertolini "ajo që e çon një të mitur në zbatimin e formave të sjelljes antisociale nuk është një afinitet strukturor me këtë lloj veprimesh, ... por një afinitet i ndërtuar në mënyrë subjektive sipas atribuimit të një kuptimi të caktuar ndaj botës që e rrethon atë, me veprimet që ai bën ose lidhja e tij me një grup ose model të caktuar të jetës devijante ”.

Ndërgjegjësimi për të marrë më shumë në konsideratë subjektin devijues, individualitetin e tij, pavarësinë e tij përkatëse të pavarësisë, në lidhje me situatën ekzistenciale në të cilën e gjen veten, aftësinë e tij për të reaguar dhe bashkëvepruar me kushtet objektive të jeta.

Të ndryshme kanë qenë ndërhyrjet kundër devijimit për të miturme kalimin e kohës, të karakterizuara gjithashtu në bazë të teorive të ndryshme mbi devijimin.

Problemi i adoleshenti devijantë është jo vetëm një problem psikologjik dhe social por, kryesisht një problem pedagogjik. Nga ana tjetër, sot, ne jemi dëshmitarë të një rënie të vëmendjes nga kjo anë, faji i së cilës nuk qëndron vetëm tek shoqëria që favorizon arsimimin mbi edukimin dhe shkollimin mbi informacionin, por edhe me shkencën pedagogjike që është bërë më shumë teknikë komunikimi sesa reflektim i përmbajtjes që duhet komunikuar.

Manipulimi arsimor, mbivlerësimi i spontanizmit, i shoqëruar nga aktivizimi i tepërt i shërbimeve që shumëfishojnë bërjen e tyre, duke i ofruar të miturit vetëm një shumësi aktivitetesh, ka çuar në paaftësinë e tanishme për t’i ofruar adoleshentëve mjete të përshtatshme për të dalë nga situata e vështirë.

Eshtë thelbësore, pra, ndihma që nuk mbetet në sipërfaqe ose në periferi të personit, por që rrit pozitivitetin që mbart çdo qenie njerëzore dhe stimulon një punë personale të ndërtimit dhe rritjes personale, e cila aktivizon marrëdhënie pedagogjike të vlefshme me të rriturite tjerë duke

treguar se mund të ketë modele të integrimit shoqëror për tu ndjekur sepse ato janë të kënaqshme.

Si rezultat bëhet fjalë për nxitjen e një proçesi rehabilitimi që kalon në faza të ndryshme:

a) nga të kuptuarit e vizionit për botën që ka i mituri,

b) krijimin e një krize të vizionit të tij për botën dhe ristrukturimin e një vizioni të ri,

c) duke e ndihmuar subjektin të ndërtojë një "optimizëm ekzistencial"përmes propozimit të ndërhyrjeve të shumta dhe aktiviteteve që mund të zgjerojnë fushën e tij të përvojës, ta edukojnë atë drejt ndërsubjektivitetit.

3. Të miturit në Shërbimin e Provës – Zyra Vendore Fier

Trajtimi i tematikës së zgjedhur mbi të miturit devijantë e ka shtysën dhe nga profesioni im si psikologe pranë Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Fier gjatë periudhës (gusht 2018 - shtator 2019), ku përveç rasteve të adultëve kisha në ngarkim sidomos dosjet e të miturve me dënime alternative. Dënimet alternative siç është periudha e provëz, punë në interes publik etj parashikohen për veprat penale me rrezikshmëri të moderuar ose të ulët për të cilat parashikohet dënim heqje lirie nën 10 vjet.

Më poshtë pasqyrohen tre tabela të të dënuarve të mitur që e kanë kryer periudhën e provës pranë Zyrës Vendore Fier përgjatë viteve 2016, 2017 dhe 2018.

NR	LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE/ ZYRAT VENDORE	Numri i të denuarve te mitur te mbikeqyrur 31.12.2016										TOTALI
		Viti 2016/gjinia										
		Neni 59 i KP,		Neni 59/a i KP,		Neni 64 i KP,		Neni 63 i KP,		Neni 58 i KP,		
		Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	
1	Zyra Vendore Fier											
TOTALI MESHKUJ			8		0		0		2		0	10
TOTALI FEMRA		0		0		0		0		0		0
												10

Numri i të denuarve te mitur te mbikeqyrur 31.12.2016		
Vepra Penale e konsumuar NENI	Totali	
83	1	Vrasja e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme
130/a/1	2	Dhuna në familje
278	1	Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municioni
284	1	Kultivimi i bimëve narkotike
290	1	Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor
291	4	Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt
TOTALI	10	

NR	LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE/ ZYRAT VENDORE	Numri i të denuarve te mitur te mbikeqyrur 31.12.2017										TOTALI
		Viti 2017/gjinia										
		Neni 59 i KP,		Neni 59/a i KP,		Neni 64 i KP,		Neni 63 i KP,		Neni 58 i KP,		
		Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	
1	Zyra Vendore Fier											
TOTALI MESHKUJ			7		0		0		0		0	7
TOTALI FEMRA		0		0		0		0		0		0
												7

Numri i të denuarve te mitur te mbikeqyrur 31.12.2017		
Vepra Penale e konsumuar NENI	Totali	
130/a/1	1	Dhuna në familje
134/1	1	Vjedhja
279/2	1	Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta
291	3	Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt
293	1	Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit
TOTALI	7	

NR	LLOJI I DËNIMEVE ALTERNATIVE/ ZYRAT VENDORE	Numri i të denuarve te mitur te mbikeqyrur 31.12.2018										TOTALI
		Viti 2018/gjinia										
		Neni 59 i KP,		Neni 59/a i KP,		Neni 64 i KP,		Neni 63 i KP,		Neni 58 i KP,		
		Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	
1	Zyra Vendore Fier											
TOTALI MESHKUJ			9		0		0		2		0	11
TOTALI FEMRA		0		0		0		0		0		0
												11

Numri i të denuarve te mitur te mbikeqyrur 31.12.2018		
Vepra Penale e konsumuar **NENI**	**Totali**	
134/1/2	5	Vjedhja
279/1	1	Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta
283/1	1	Prodhimi dhe shitja e narkotikëve
291	4	Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt
TOTALI	**11**	

Si mund të vihet re edhe nga pasqyrimi i tabelave, kemi një rritje të rasteve të të miturve në shërbim prove ku mbizotron vepra penale N.291 “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” dhe N.134/1/2 “Vjedhja” e kryer në bashkëpunim.

Proçedura që ndiqet nga specialisti me marrjen e vendimit të ekzekutimit nga Prokuroria dhe Gjykata është krijimi i kontaktit të parë me të miturin dhe prindin e tij në ambjentet e Shërbimit të Provës. Në takimin e parë dhe në çdo takim pasues i mituri shoqërohet gjithmon nga njëri prej prindërve i cili asiston gjithë proçedurën e periudhës së provës dhe riabilitimin e tij. Takimi i mbikqyrës nr.1 fillon me prezantimin e të miturit dhe mbrojtësit të tij me specialistin që do ndjekë rastin, duke referuar vendimin mbi kohëzgjatjen e periudhës së provës ku gjatë kësaj kohe ndalohet çdo sjellje, veprimtari që përbën shkelje si dhe vendime të tjera plotësuese si frekuentimi i rregullt i shkollës, kryerja e një kursi profesional, vlerësim psiko-social, këshillim psikologjik apo punë në interes publik. Po në takimin nr.1 i cili zgjat mestarisht 60 min, realizohet

një intervistë e strukturuar njohje e të miturit, e kushteve familjare, sociale dhe ekonomike ku rritet, shkollimi, punësimi, nëse ka historik konsumi të alkoolit, drogave. Më pas i mituri i nënshtrohet një pyetësori të quajtur “Sistemi i vlerësimit të rrezikshmërisë” (SVR) ku merren informacione për veprën penale, rrethanat, dinamika e saj dhe nga specialisti bëhet pikëzimi dhe deklarohet niveli i rrezikshmërisë e ndarë në të ulët/të mesme/të lartë. Duke u bazuar nga gjithë këto të dhëna dhe qëndrimi i të miturit ndaj veprës penale të kryer, specialisti vendos mbi frekuencën e takimeve të të miturit për t’u paraqitur në Shërbimin e provës që shkon nga takime javore (1-2-3 herë/javë) deri në 1herë muaj nëse periudha e provës është e gjatënë kohë nga 1 vit e më tepër. Shpeshtësia e takimeve mbikëqyrëse lidhet edhe me sjelljen e vetë të miturit gjatë periudhës së provës, nëse vendos marrëdhënie besimi, bashkëpunimi dhe angazhimi për plotësimin e kushteve që i kërkohen ne referim të vendimeve të Gjykatës. Specialisti – psikolog i të miturve punon maksimalisht për të krijuar këtë raport besimi, ndihme, mbështetje, monitorimi, riabilitimi me adoleshentin në respekt të proçedurave institucionale por edhe duke qënë empatik, dëgjues aktiv i emocioneve, nevojave të shprehura dhe atyre të fshehura, orientues dhe këshillues i veprimeve, qëndrimeve dhe sjelljeve të të miturit në familje, shkollë e shoqërinë e bashkëmoshatarëve të tij.

Eksperienca ime me të miturit me dënime alternative, më ka mësuar që edhe agresiviteti, apatia, sfidimi, neglizhenca e tyre ndaj detyrimeve të programit individual të trajtimit (të përpiluar nga specialisti) janë mekanizma mbrojtës të adoleshentëve të vepruara përkundrejt specialistit përgjegjës pasi për të ai personifikon një adult tjetër (figurë autoritare prindërore, ligjore etj).

Në shumicën e rasteve të miturit shfaqen të friksuar, të hutuar, konfuz apo të orientuar nga prindërit dhe avokati sesi duhet të sillen dhe çfarë duhet të flasin përpara specialistit.

I bëhet e qartë mbrojtësit (prindit) të të miturit që, prania e tij gjatë takimeve mbikqyrëse të fëmijës së tij, nuk nënkupton që prindi duhet të flasi, të vendosi apo të pengojë proçesin e mbikqyerjes, riabilitimin dhe

riintegrimin e të miturit. Si specialisti ashtu dhe prindërit, mësuesit, operatorët e tjerë sociale duhet të jenë bashkë-udhëtarë të periudhës së provës që institucionet ligj-vënëse dhe ligj-zbatuese kanë vendosur për të miturin, provë e cila finalizohet me sukses nëse adoleshenti nuk lihet vetëm e pa përkrahje në këtë përvojë të re, jo të zakonshme.

Nuk është efikase dhe aspak produktive qasja e specialistit ndaj të miturit të dënuar si autoritet ligjor jo sepse i mungon por specialisti nuk mund dhe nuk duhet të jetë as zëvendës polic, prokuror apo gjykatës. Specialisti që ndjek rastet e të miturve është profesionist që përveç arsimit të lartë kryhen dhe shumë trajnime përgjatë ushtrimit të detyrës dhe funksionit të tij. Pra, specialisti nuk është ajo figurë profesionale që vetëm kontrollon, monitoron, vlerëson dhe raporton tek prokurori i çështjes ecurinë e të miturit por, adulti i aftë me kompetenca menaxhimi, ndërhyrje - asistim psikologjik, social dhe edukativ sidomos kur sistemet mikro dhe makro të fëmijës kanë dështuar në misionet e tyre apo janë të pafuqishme në rekuperimin e adoleshentit "problematik". Në disa raste është konstatuar që pengesa më e madhe e specialistit dhe detyrës së tij nuk është i mituri por prindërit, mësuesit e tij (evitues, që akuzojnë njëri-tjetrin për dështimet e tyre). Si rezultat, specialisti gjatë periudhës së provës me të miturit punon jo vetëm për rekuperimin e vlerave, normave, zgjedhjeve dhe zgjidhjeve etike dhe ligjore të adoleshentit por angazhohet dhe në krijimin e aleancave me rrethet sociale, adultët e tjerë që rrethojnë të miturin dhe ndikojnë direkt tek ai. Kjo veprimtari e krijimit të urave lidhëse dhe zgjerimit të rrjetit social bashkëveprues me të miturin, përbën objektivin kryesor, ai që jep dhe garanton rezultate afatgjata në jetën e të miturit edhe pas përfundimit të dënimit alternativ. Specialisti i Shërbimit të Provës ashtu si dhe psikologu me klientin e tij nuk mund të jetë përherë dhe përgjithmon në krah të të miturit ndryshe do të kishim të bënim me regres me të dënuar të mitur recidivistë.

Specialisti punon së bashku me të miturin që ky i fundit të mos krijojë vartësi por, pavarësi me zgjedhje inteligjente dhe konform moshës së fëmijës dhe prioriteteve të tij sidomos për të mos u kthyer kurrë më në Shërbim Prove apo ne IEVP nëse është 18 vjeç.

4. Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur ose ndryshe ligji numer 37, është miratuar nga Parlamenti Shqiptar më 30 Mars 2017. Ky Kod përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla proçedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

Gjithashtu Kodi përmban rregullime edhe për të rinjtë nga grupmosha 18 deri në 21 vjeç, sipas parashikimeve në nene të veçanta të tij.

Ai hyri në fyqi në 1 Janar 2018.

NENI 14: PËRPARËSIA E MASAVE ALTERNATIVE TË SHMANGIES

1. Për arritjen e qëllimeve të këtij Kodi dhe të ligjeve të tjera që kanë lidhje me drejtësinë për të mitur, në procedurën e drejtësisë penale për të mitur përparësi u jepet masave alternative të shmangies nga procedimi penal.

2.Masat alternative që synojnë shmangien e të miturit nga procedimi penal ose zbatimi i masave të drejtësisë restauruese vlerësohen si mundësia e parë. Kur bëhet ky vlerësim, nga çdo organ kompetent, në aktet respektive pasqyrohet mbajtja në vëmendje që masa alternative e shmangies i shërben më mirë qëllimeve të rishoqërizimit, rehabilitimit të të miturit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit përkundrejt vendosjes së tij nën përgjegjësinë penale dhe zbatimit të dënimit penal.

3. Sa herë është e përshtatshme, e mundshme dhe e nevojshme, shmanget vënia në lëvizje e procedurës penale për të miturit në konflikt me ligjin, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e të miturit dhe mbrojtja e tij.

4. Çdo masë që përdoret ndaj të miturit si alternativë për shmangien nga procedimi penal, duhet t’i shërbejë qëllimit të mbrojtjes së të drejtave dhe garancive ligjore të të miturit.

Përfundime

Pjesa më e madhe e të miturve që kanë kryer sjellje devijante dhe që janë në konflikt me ligjin kanë një vetvlerësim jo të shëndoshë. Prandaj me ta duhet punuar për rritjen e ndjenjës për vlerat e vetes e cila do të ndihmonte përmirësimin e komunikimit mes tyre, do të çonte në frenimin dhe në mosshkallëzimin e konflikteve. Kjo edhe për shkak se njerëzit në përgjithësi dhe adoleshentet me një sens të shëndoshë për vlerat e vetes së tyre kanë më pak gjasa të ushqejnë paragjykime kundër të tjerëve. Gjithashtu, njerëzit që kanë një sens të shëndoshë për vlerat e vetes kanë më pak gjasa të reagojnë ashpër ndaj të tjerëve si dhe janë më të aftë për të depërtuar në këndvështrimin e njeriut tjetër në konflikt. Duke patur një mendim pozitiv për veten, të miturit do të jenë më të aftë të ballafaqohen në mënyrë konstruktive me problemet me të cilat ndeshen, sidomos në kushtet e izolimit, por edhe pasi të dalin nga këto kushte.

Bibliografia

Cerutti R., Manca M. (2008). I comportamenti aggressivi. Percorsi evolutivi e rischio psicopatologico. Nuova edizione. Kappa, Roma.

De Piccoli N., Faretto AR, Zaltron F., Norme e agire quotidiano negli adolescenti, Bologna, Il Mulino, 2001.

LA GRECA, La devianza minorile: evoluzione delle interpretazioni e degli interventi, in CUOMO, LA GERCA, VIGGIANI, (a cura di), Giudici, psicologi e delinquenza minorile, Milano, 1982.

Manca M., Mascia I. (a cura di) (2006). Devianza e criminalità in adolescenza. Experta, Forlì.

Moffitt T.E. (1993). Adolescence-limited and life-course-persistent antisocial behavior: A developmental taxonomy. Psychological Review, 100(4):674-701.

Vezzani L., (2018). Le nuove forme di devianza minorile. Docsity.com

V. TOMEO, Dalla devianza al conflitto: verso una dissoluzione del concetto di devianza, in Soc. del diritto, 1979, n.1/2.

http://www.adir.unifi.it/rivista/2006/cimmino/cap1.htm ISSN 1827-0565

https://www.osfa.al/sites/default/files/kumtese_rasim_gjoka_brunilda_zenelaga.pdf

http://www.drejtesia.gov.al/ligje-2/

http://www.sherbimiproves.gov.al/images/pdf/Kodi_i_Drejtesise_Penale_per_te_Miturit.pdf

SEGMENTIMI I PROFILIT TË VIZITORËVE NËPËRMJET PËRDORIMIT TË ANALIZËS KLASTER.

Rast studimor: Zona rurale e Gjirokastrës

Dr. Irena Boboli

Universiteti “Eqrem Çabej”, Fakulteti Ekonomik, Gjirokastër

irena_boboli@yahoo.com

Prof.Assoc. Dr. Valbona Duri,

Universiteti “Eqrem Çabej”, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Gjirokastër

bongjeo@yahoo.com

Abstract

Tourism is a sector or group of sectors, which offers a group of products, whose customers are visitors. Considering the different type(s) of visitors, marketers hope to classify the latter as market segments giving them the opportunity to identify common reasons for buying a product in each market segment, the same consumer behavior and the same reactions in marketing activities. Furthermore we have a specific economic interest in tourism segmentation, as different types of visitors (market segments) operate under different economic constraints and have different economic impacts as a result of their tourism activity. Gjirokastra area is one of the most favourite destinations in Albania which attracts a significant number of domestic and foreign visitors and where visitors can find a diversity of tourist offer. As consumer behavior patterns are increasingly being specified, creating a visitor-consumer profile and determining their preferences and tourist demand is an important factor. Information about the profile of tourists and focusing on certain markets will ensure the success and development of the destination. Cluster analysis is a multivariate statistical technique that can be used to identify market segments. This market segmentation approach offer some advantages to researchers, such as, in market definition,

centers based on similarities between tourists, classification of tourist groups, creation of hypotheses on these groups of tourists. The purpose of this paper is to identify segments of visitors in the rural area of Gjirokastra, through the use of cluster analysis. In this paper, we will describe the socio-demographic profile of visitors in the study area. Also, the clusters are defined according to the purpose of the trip, as well as the characteristics of each cluster based on the socio-demographic variables. At the end of the paper are given some conclusions.

Keywords: segmentation, cluster analysis, rural areas

Abstrakt

Turizmi është një degë ose një grup degësh, që ofron një bashkësi produktesh, klientët e të cilave janë vizitorët. Nisur nga tipi (llojet) i ndryshëm i vizitorëve, marketuesit shpresojnë ti klasifikojnë këta të fundit si segmente tregu duke ju dhënë mundësinë atyre të përcaktojnë arsye të përbashkëta blerjeje të një produkti në çdo segment të tregut, sjellje të njëjta konsumatore dhe reagime të njëjta në aktivitetet e marketingut. Për më tepër kemi një interes ekonomik specifik për segmentimin e turizmit, meqënëse lloje të ndryshme të vizitorëve (segmente tregu) funksionojnë nën kufizime të ndryshme ekonomike dhe kanë ndikime të ndryshme ekonomike si rrjedhojë e veprimtarisë së tyre turistike. Zona e Gjirokastrës është një nga destinacionet më të preferuara në Shqipëri e cila tërheq një numër të konsiderueshëm vizitorësh vendas dhe të huaj dhe ku oferta turistike është e shumllojshme. Ndërkohë që modelet e sjelljes së konsumatorëve po specifikohen gjithnjë e më shumë, krijimi i profilit të vizitorit-konsumator dhe përcaktimi i preferencave dhe kërkeses turistike të tij përbën faktor të rëndësishëm. Informacioni në lidhje me profilin e turistëve dhe fokusimi në tregje të caktuara do të sigurojë sukses dhe zhvillim të destinacionit. Analiza klaster është një teknikë statistikore multivariate që mund të përdoret për të identifikuar segmentet e tregut. Kjo qasje e segmentimit të tregut ofron disa avantazhe studjuesve, të tilla si, dobishmëri në përcaktimin e tregut, qëndra të bazuara në ngjashmëritë midis turistëve, klasifikim të grupeve turistike, krijim hipotezash mbi këto grupe turistësh. Qëllimi i ketij

punimi është identifikimi i segmenteve të vizitorëve në zonën rurale të Gjirokastrës, nëpërmjet përdorimit të analizës klaster. Në këtë punim, fillimisht bëhet një përshkrim i profilit socio-demografik të vizitorëve të zonës së studimit. Në vazhdim, përcaktohen klasterat sipas qëllimit të udhëtimit, si dhe jepen karakteristikat e secilit klaster mbështetur në variablat socio-demografike. Në fund të punimit jepen disa konkluzione dhe rekomandime.

***Fjalë kyç**: segmentim, analiza klaster, zona rurale*

Hyrje

Turizmi është një fenomen kompleks ekonomik dhe social, ndaj dhe studimi i aspekteve të sjelljes së aktorëve kryesorë të tij (turistëve), ka një dimension të gjerë për të kuptuar nevojat e tyre, motivet, motivimin dhe qëndrimet gjatë fazave të para-vendimit dhe vendimit para se të udhëtojnë (Marujo *et al,* 2012).

Nisur nga tipi (llojet) i ndryshëm i turistëve, marketuesit shpresojnë ti klasifikojnë këta të fundit si segmente tregu duke ju dhënë mundësinë atyre të përcaktojnë arsye të përbashkëta blerjeje të një produkti në çdo segment të tregut, sjellje të njëjta konsumatore dhe reagime të njëjta në aktivitetet e marketingut. Në vazhdim bëhet i mundur synimi i segmenteve të tregut me produkte specifike dhe dalja e tyre në treg me metoda të ndryshme (Bull, 2002). Tregu është i përbërë nga nëngrupe të personave me nevoja dhe dëshira të ndryshme dhe të veçanta. Një strategji efektive marketingu mund të rezultojë në një përdorim më efikas dhe efektiv të marketingut dhe promovimit për çdo segment të tregut (Kotler & McDougall, 1983).

Disa lloje turistësh janë më të vlefshëm për një zonë krahasuar me të tjerët dhe si pasojë operatorët duhet të maksimizojnë përpjekjet për tërheqjen e tyre. Organizmat turistikë dhe në veçanti qeveritë munden gjithashtu të zhvillojnë politika ekonomike ose jo ekonomike, të cilat nuk ndikojnë njësoj tek të gjithë turistët. Rrjedhimisht, metoda e segmentimit

luan një rol të rëndësishëm. Grupet e turistëve duhet të disponojnë jo vetëm një homogjenitet të brendshëm relativ ndaj faktorëve ekonomikë, por edhe duhet të ekzistojë një diversifikim i ndjeshëm midis kategorive. Metoda të dobishme segmentimi mund të jenë: segmentimi duke u bazuar te qëllimi i udhëtimit, segmentimi psikografik, segmentimi duke u bazuar tek bashkëveprimi (Bull, 2002).

Përfitimi i segmentimit të tregut shtrihet në një destinacion turistik që specializohet në nevojat e një grupi të veçantë dhe arrin të jetë më i miri në ofrimin e shërbimeve ndaj këtij grupi. Duke vepruar në këtë mënyrë, destinacioni fiton një avantazh konkurrues (Dolnicar, 2008).

Analiza klaster

Analiza klaster, është një teknikë ose grup teknikash që përdoren për të grupuar objekte të ndryshme (mallra, individë, biznese, ferma etj) në grupe sipas ndonjë kriteri ngjashmërie (apo mosngjashmërie) të specifikuar qartë (Osmani, 2006). Një bashkësi vrojtimesh (ose objektesh) për të cilat ekziston nje numër variablash, klasifikohet në mënyrë të tillë që vrojtime me karakteristika të ngjashme të bëjnë pjesë në një grup (Everitt *et al*, 2011). Analiza klaster është një teknikë statistikore që mund të përdoret për të identifikuar segmentet e tregut (Lonial *et al*, 2000).Analiza klaster është një metodë multivariate që synon identifikimin e segmentimit të tregut. Kjo qasje e segmentimit të tregut ofron disa avantazhe studjuesve, të tilla si, dobishmëri në përcaktimin e tregut, qëndra të bazuara në ngjashmëritë midis turistëve, klasifikim të grupeve turistike, krijim hipotezash mbi këto grupe turistësh dhe testimi i një koncepti për të vërtetuar nëse lloje të caktuara konsumatoresh janë prezente në bashkësinë e të dhënave, dhe është e mundur të analizohet me efektivitet një numër shumë i madh të intervistuarish (Jurowski & Reich, 2000). Qëllimi i analizës klaster është të grupojë vëzhgime në klaster në mënyrë të tillë që çdo klaster, të jetë sa më shumë homogjen në lidhje me variablat e grupimit. Një analizë e suksesshme është ajo që do të krijojë grupe të cilat përmbajnë vëzhgime mundësisht sa më homogjene, por dhe që ndryshojnë me njëri-tjetrin për sa i përket karakteristikave që analizojmë. Pra, studjuesi synon të zbulojë

një sistem të ndarjes të vëzhgimeve në grupe, pjesët e të cilave të kenë karakteristikë të përbashkët, dmth të karakterizohen nga homogjeniteti brenda në grup, por grupet të jenë të ndryshme midis tyre, të karakterizohen nga heterogjeniteti midis grupeve.

Rëndësia e përdorimit të analizës klaster është kërkimi për një kuptim më të mirë të sjelljes blerëse, duke identifikuar grupe homogjene blerësish. (Hamilton *et al,* 2000)".

Sipas (Tuma *et al,* 2009) nga rishikimi i literaturës në lidhje me aplikimin e analizës klaster në marketing, rezulton se baza e segmentimit bëhet sipas variablave të ndryshëm, ku variabla kryesorë jane ata demografikë, socioekonomikë dhe psikografikë. Ekzistojnë disa teknika për segmentimin e tregut. Teknika më e rëndësishme për identifikimin e segmenteve është klasterizimi. K-means dhe klasterizmi Hierarkik janë më të përdorurat në segmentimin e tregut (Srivihok & Yotsawat, 2014).

(Sangpikul, 2008) dhe (Slabbert & Laurens, 2011) kanë përdorur analizën klaster për të përcaktuar motivimin e turistëve. (Brida *et al,* 2010) ka përdorur analizën klaster për segmentimin e popullsisë pritëse në lidhje me pikpamjet mbi strategjitë e politikave të turizmit. Për zonën e Gjirokastrës dhe Shqipërinë jugore është kryer një studim nga (Axhami, 2010) duke përdorur praktikat klaster në zhvillimin e turizmit të trashëgimisë.

Metoda e studimit

Në këtë punim do të përcaktojmë profilin e vizitorëve-konsumatorë në zonën rurale të Gjirokastrës. Në funksion të këtij studimi është zhvilluar një anketim që konsistoi në mbledhjen e informacionit të nevojshëm. Nëpërmjet pyetjeve të strukturuara drejtuar vizitorëve të zonës së studimit, u mblodhën të dhënat socio-demografike të vizitorëve si dhe qëllimi i vizitës së tyre në zonën e studimit. Periudha e anketimit ishte periudha maj-shtator 2015, për arsye se kjo periudhë përkon me fluksin më të madh turistik në zonë. Gjatë kësaj periudhe u plotësuan rreth 300 pyetësorë që lejoi një marzh gabimi 5,67%. Zgjedhja e mostrës ishte probabilitare dhe u përdor zgjedhja klaster në dy faza. Në fazën e parë u

përcaktuan disa nga pikat e lëvizjes së vizitorëve dhe në fazën e dytë, u bë një zgjedhje e rastësishme e vizitorëve në këto pika. Rezultatet e pyetesorëve u analizuan me statistikë përshkruese dhe analizë klaster. U përdor Excel për statistikën përshkruese dhe në vazhdim për përpunimin e të dhënave u përdor software Weka. U aplikua analiza klaster e data mining, me përdorimin e algoritmit K-means.

Rezulatet e studimit

Karakateristikat socio-demografike të vizitorëve të zonës

Nga vizitorët e intervistuar në studim, 86.67% rezultojnë shtetas të huaj, kryesisht evropianë, si dhe shtetas amerikanë. Pjesa më e madhe vjen nga vendet fqinjë, Italia dhe Greqia, si dhe një numër i konsiderueshëm nga Franca dhe Gjermania. 13.33% rezultuan shtetas shqiptarë me banim në Shqipëri por dhe jashtë vendit (grafiku 1). 55.56% e vizitorëve ishin femra dhe 44,44% meshkuj (grafiku 2).

Grafiku 1: Shtetësia



Burimi: Anketa 2015

Grafiku 2: Gjinia



Burimi: Anketa 2015

Nga të dhënat rezulton se vizitorët i përkasin të gjitha grupmoshave ku pjesa më e madhe 26.7% i përket grupmoshës 45 -54 vjeç (grafiku 3). 49.60% ishin me status civil të martuar (grafiku 4).

Grafiku 3: Grupmosha



Burimi: Anketa 2015

Grafiku 4: Statusi civil



Burimi: Anketa 2015

Niveli i shkollimit të vizitorëve rezulton i lartë ku pjesa më e madhe e tyre, (68.20% kanë arsim universitar), 4.40% e vizitorëve kanë arsim pasuniversitar (grafiku 5).

Grafiku 5: Niveli i shkollimit



Burimi: Anketa 2015

Pjesa më e madhe e vizitorëve rezulton të jetë e punësuar në sektorin privat 33.70 %, kanë biznes privat 19% dhe të punësuar në sektorin publik 16% (grafiku 6).

Grafiku 6: Puna aktuale



Burimi: Anketa 2015

Ndërkohë që përqindja më e madhe 26.70% deklarojnë të ardhura familjare vjetore 10001 – 25000 Euro, 20% kanë të ardhura vjetore 25001-50000 Euro dhe një pjesë e konsiderueshme e tyre 15.9 % kanë të ardhura vjetore mbi 50000 Euro. 4.45% kanë të ardhura vjetore 5000 Euro (grafiku 7).

Grafiku 6: Të ardhurat familjare vjetore



Burimi: Anketa 2015

Përcaktimi i klasterave

Pas përcaktimit të profilit të vizitorëve të zonës rurale të Gjirokastrës, në vazhdim u përcaktua mënyra e segmentimit të vizitorëve. Variabli i varur ishte qëllimi i udhëtimit, ndërsa si variabla të pavarur u përcaktuan variablat socio-demografikë si gjinia, mosha, arsimi, puna aktuale, shtetësia, të ardhurat. Në vazhdim u përcaktua numri *k* i klasterave, konkretisht gjashtë grupe vizitorësh sipas qëllimit të udhëtimit, të cilat u etiketuan: “tranzit”, “kureshtje”, “argëtim”, “vizita te miqtë-të afërmit”, “të rastësishëm”, “edukativ” (grafiku 8).

Grafiku 8: Qëllimi i udhëtimit



Burimi: Anketa 2015

Profili i klasterave

Klasteri “Tranzit”

Klasteri i parë “tranzit” konsiston në 6.66% të të anketuarve. Përqindja më e lartë janë femra 61%, të të gjitha grupmoshave përveç asaj 65+, me arsim të mesëm 50%. Kanë në pronësi biznes privat 55% dhe të ardhura familjare vjetore mbi 50000€ 44%. Kanë shtetësi gjermane 44%.

Klasteri “Kureshtje”

Klasteri i dytë “kureshtje” konsiston në 18.88 % të të anketuarve. Përqindja më e lartë janë femra 72%, të të gjitha grupmoshave, me arsim universitar 78%. Janë të punësuara në sektorin publik 56%, ndërkohë që nuk përgjigjen pyetjes për të ardhurat familjare vjetore 37%. Kanë shtetësi italiane 54%.

Klasteri “Argëtim”

Klasteri i tretë “argëtim” konsiston në 25.55 % të të anketuarve. Përqindja më e lartë janë meshkuj 76%, të të gjitha grupmoshave, me arsim universitar 88%. Janë të punësuara në sektorin privat 39% dhe kanë biznes privat 28%, ndërkohë që kanë të ardhura familjare vjetore nga 25000-50000 € 37%. Kanë shtetësi të ndryshme kryesisht gjermane 21%.

Klasteri “Vizita te miqtë / të afërmit”

Klasteri i katërt “vizita te miqtë-te afërmit” konsiston në 19.62 % të të anketuarve. Nuk kanë ndryshim përsa i përket gjinisë dhe grupmoshave, me arsim universitar 64%. Janë të punësuar në sektorin privat 35% dhe në sektorin publik 22%, ndërkohë që kanë të ardhura familjare vjetore nga 5000-10000 € 56%. Kanë shtetesi shqiptare 64%.

Klasteri “Të rastësishëm”

Klasteri i pestë “të rastësishëm” konsiston në 12.59 % të të anketuarve. Përqindja më e lartë janë femra 61% të të gjitha grupmoshave, me arsim të mesëm 58%. Janë të punësuar në bujqësi 26% dhe në sektorin privat

17%, ndërkohë që kanë të ardhura familjare vjetore nga 10000-25000 € 55%. Kanë shtetësi greke 73%.

Klasteri "Edukativ"

Klasteri i gjashtë "edukativ" konsiston në 16.66 % të të anketuarve. Përqindja më e lartë janë femra 84% të të gjitha grupmoshave, me arsim universitar 82%. Janë kryesisht pensioniste 42% dhe të punësuar në sektorin privat 17%, ndërkohë që kanë të ardhura familjare vjetore nga 10000-25000 € 44%. Kanë shtetësi franceze 64%.

Konkluzione

Turizmi është përkufizuar si një industri dhe për shumë rajone një faktor i rëndësishëm për zhvillim ekonomik, i cili ka impakt mbi prodhimin, konsumin e punësimin e zonave rurale dhe urbane. Matja e këtyre ndikimeve është e rëndësishme për ekonomitë lokale, ndërkohë që njohja e nevojave turistike të konsumatorëve përbënnjë domosdoshmëri. Studimi i profilit të aktorëve kryesorë të tij (turistëve), ka një dimension të gjerë për të kuptuar nevojat e tyre, motivet dhe sjelljen e tyre në destinacion. Klasifikimi i tyre në segmente tregu mundëson përcaktimin e sjelljeve të njëjta konsumatore, arsye të përbashkëta blerjeje të një produkti në çdo segment të tregut si dhe reagime të njëjta në aktivitetet e marketingut.

Nisur nga qëllimi i studimit për të përcaktuar profilin e vizitorëve në zonë u përdor teknika e klasterizimit dhe algoritmi k-means. Për këtë u përcaktuan grupet në varësi të qëllimit të udhëtimit dhe si variabla të pavarur u morën disa variabla socio-demografikë.

Vizitorët e zonës rurale të Gjirokastrës janë kryesisht të huaj, femra dhe meshkuj, të grupmoshave të ndryshme, me status civil të martuar, kanë nivel të lartë shkollimi dhe përsa i përket punësimit kanë ose janë të punësuar në biznes privat.

Kontrolli i segmenteve është shumë i rëndësishëm sepse segmentet e studjuara sigurojnë informacion specifik në lidhje me modelet blerëse të turistëve, për menaxherët dhe administratorët e turizmit. Nga analiza e të

dhënave rezultuan gjashtë grupe - klastera vizitorësh sipas qëllimit të udhëtimit konkretisht: “tranzit”, “kureshtje”, “argëtim”, “vizita te miqtë-të afërmit”, “të rastësishëm”, “edukativ”.

Nëpërmjet segmentimit të tregut turistik dhe njohjes së profilit të vizitorëve përfitojnë:

- Bizneset turistike, bizneset mbeshtetese të turizmit: mund të mbështesin strategjitë e tyre në mënyrë që të rritin avantazhin konkurrues duke përzgjedhur nëngrupin më të përshtatshëm të turistëve.

- Komuniteti lokal: në rritjen e pjesmarrjes duke investuar në infrastrukturë pritëse, e prodhim të produkteve të zonës në funksion të plotesimit të nevojave tëvizitorëve.

- Qeverisja vendore: vlerësimi i çdo grupi në veçanti dhe përcaktimi i sjelljes konsumatore e preferencave të tij do të ndihmojë në hartimin e strategjive të zhvillimit të turizmit në nivel lokal e rajonal, në investimin e duhur në infrastrukturë rrugore, turistike e shërbime me qëllim plotësimin e nevojave të vizitorëve.

Bibliografia

Axhami, M. (2010). Cluster practices in heritage tourism development-case study in southern Albania. *revista de tourism, nr 9* , fq. 56-61.

Boboli, I. (2017). *Ndikimi I turizmit ne zhvillimin e zonave rurale te rrethit te Gjirokastres, Punim Doktorature*. Tirane.

Brida, J., Osti, L., & Barquet, A. (2010). Segmenting resident perceptions towards tourism-a cluster analysis with a multinominal logit model of a mountain community. *International Journal of Tourism Research, Vol 12, Issue 5* , fq. 591-602

Bull, A. (2002). *Touristiki oikonomia, 2th Edition.* Athina: Kleidarithmos.

Dolnicar, S. (2008). Market segmentation in tourism. University of Wollongong, Research Online.

Everitt, B., Landau, S., Leese, M., & Stahl, D. (2011). *Cluster Analysis, 5th Edition.* Wiley.

Hamilton, R., Hewer, P., & Howcroft, B. (2000). *An Application of Cluster Analysis to the Understanding of Consumers' Financial Services Behaviour.*
https://people.kth.se/~lang/arkiv/finans/exjobb/kim/cluster.doc.

Jurowski, C., & Reich, A. (2000). An Explanation and Ilustration of Cluster Analysis for Identifying Hospitality Market Segments. *Journal of Hospitality and Tourism Research 24(1)* , fq. 67-91.

Kotler, P., & McDougall, G. (1983). *Principles of marketing. Englewood Cliffs, NY: Prentice-Hall.*

Koupa, E. (2008). *Statistikes methodoi se psixometrika dedomena.*Athina: Oikonomiko Panepistimio Athinwn.

Lonial, L., Menezes, D., & Zaim, S. (2000). Identifying Purchase Driving Attributes and Market Segments For PCs Using Conjoint and Cluster Analysis. *Journal of Economic and Social Research 2 (2) 2000* , fq. 19-37.

Marujo, N., Serra, J. M., & Borges, M. d. (2012). VISITORS TO THE CITY OF ÉVORA: WHO ARE THEY? *European Journal of Tourism, Hospitality and Recreation, Vol. 3, Issue 2* , fq. 91-108.

Osmani, M. (2006). *Metodat Statistikore Multivariate.*Tiranë: Blendi.

Sangpikul, A. (2008). A factor-cluster analysis of tourist motivations: A case of U.S. senior travelers. *Original Scientific Paper, Vol.56 No/1/2008* , fq. 23-40.

Slabbert, E., & Laurens, M. (2011). Motivation-Based Clustering:An Empirical Study of Vizitors to Kruger National Park in South Afrika.

Book of Proceedings Vol.II- International Conference on Tourism & Management Studies-Algarve 2011 , fq. 1122-1126.

Srivihok, A., & Yotsawat, W. (2014). Market Segmentation of Inbound Business Tourists to Thailand by Binding of Unsupervised and Supervised Learning Techniques. *JOURNAL OF SOFTWARE, VOL. 9, NO. 5* , fq. 1334-1341.

Tuma, M., Scholz, S., & Decker, R. (2009). *The Application of Cluster Analysis in Marketing Research:A Literature Analysis.* http://www.westga.edu/~bquest/2009/cluster09.pdf.

INSTITUCIONET EDUKUESE NË SHQIPËRI GJATË VITEVE 1963-1973 PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Dr.Orneda Gega (Hoxha)

Fakulteti i Edukimit, Universiteti "Aleksandër Moisiu"

Durrës, Shqipëri

ornedagega@gmail.com

ABSTRACT

This paper presents historical events about the construction of educational institutions for children with disabilities in Albania during the years 1963-1973.The purpose of this paper is to analyze through archival documents, study reports the history of the development of education of students with disabilities in Albania over 10-years, during the years 1963-1973.Thus, special education in our country has its history of development. In 1963, with the opening of the Institute for Deaf and Dumb Students, the institutionalized treatment of children with disabilities began.

After the opening of the Institute for the teaching and education of deaf-mute and blind children on 29.04.1963 and after sending the telegram throughout the city of Albania, children with disabilities were sent to this Institution. Following this decision, the internal regulations of the Institute of Deaf and Dumb Children were established. This regulation defines the purpose of opening this institution as well as special curricula approved by the Ministry of Education and Culture. In these schools, in addition to general education, the emphasis was also on vocational training, to be able to live in the future with their work and feel themselves an active participant in building society. The conditions of admission, the daily regime of work with children, the duties of the educational staff as well as the duties of the administrative staff are defined.In the plans and programs of the school for the deaf-mute and the blind, it is determined that the curricula extend to five years, for the blind

children are provided as special subjects lessons in individual groups for spatial orientation, while for those deaf-mutes the special place is occupied by specialty subjects and then the working ones.With the opening of the school, the first Braille primer and the arithmetic text were ready. The number of students who could not see or hear increased from 22 children in 1963 to 90 students in 1970.The Ministry of Education and Culture with a letter addressed to the Executive Committee requests that in Tirana for the academic year 1973-1974 request to open a first-class with 10-14 children for the education of children with mild mental retardation. The class was dependent on the Education section and near an 8-year school.

Keywords: *educational institutions, children with disabilities, education, integration*

ABSTRAKT

Në këtë punim paraqiten ngjarje historike rreth ndërtimit të Institucioneve edukuese për fëmijët me aftësi të kufizuar në Shqipëri gjatë viteve 1963-1973. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë nëpërmjet dokumentave arkivorë, raporteve studimore historikun e zhvillimit të arsimimit të nxënësve me aftësi të kufizuar në Shqipëri gjatë një perjudhe 10 vjeçare, gjatë viteve 1963-1973.Kështu, arsimi special në vendin tonë ka historikun e tij të zhvillimit. Në vitin 1963 me hapjen e Institutit të nxënësve që nuk shikojnë dhe të nxënësve që nuk dëgjojnë nisi trajtimi i institucionalizuar i fëmijëve me aftësi të kufizuara.Pas çeljes së *Institutit për mësimin dhe edukimin e fëmijëve shurdhë-memecë dhe të verbër* më datë 29.04.1963 dhe pas dërgimit të telegramit në të gjithë qytet e Shqipërisë, fëmijët me paaftësi u dërguan në këtë Institucion. Pas këtij vendimi u përcaktua dhe rregulloria e brëndshme e Institutit të fëmijëve shurdh memecë dhe të verbër.Në këtë rregullore përcaktohet qëllimi i hapjes së këtij institucioni si dhe dhe planeve dhe programeve mësimore speciale të aprovuara nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës. Në këto shkolla krahas arsimimit të përgjithshëm theksi i vihej edhe pregatitjes profesionale, me qëllim që të bëhen të aftë që të jetojnë në të ardhmen me punën e tyre dhe të ndjejnë veten pjesmarrës aktiv në ndërtimin e

shoqërisë. Përcaktohen kushtet e pranimit, regjimi ditor i punës me fëmijët, detyrat e personelit edukativ si dhe detyrat e personelit administrativ.Tek planet dhe programet e shkollës së shurdhë-memecëve dhe të verbërve përcakohet se programet mësimore shtrihen në pesë vite, për fëmijët e verbër parashikohen si lëndë speciale mësime në grupe individuale për orientimin në hapsirë ndërsa për ata shurdh memecë vënd të rëndësishëm zënë lëndët e specialitetit dhe më pas ato të punës.Me hapjen e shkollës ishte bërë gati dhe abetarja e parë në brail dhe teksti i aritmetikës. Numri i nxënësve të cilët nuk shikonin dhe nuk dëgjonin pësoi rritje nga 22 fëmijë në vitin 1963 në 90 nxënës në vitin 1970.Ministria e Arsimit dhe Kulturës me një shkresë drejtuar Komitetit Ekzekutiv kërkon që në Tiranë për vitin akademik 1973-1974 të hapet një klasë e parë me 10-14 fëmijë për edukimin e fëmijëve me prapambetje të lehtë mendore. Klasa ishte në varësi të seksionit të Arsimit dhe pranë një shkolle 8 vjeçare.

Fjalët kyçe:*institucione edukuese**,**nxënës me aftësi të kufizuar, edukim, integrim.*

HYRJA

Trajtimi i institucionalizuar i fëmijëve me aftësi të kufizuara ka filluar që në vitin 1963, me hapjen e Institutit të nxënësve që nuk shikojnë dhe të nxënësve që nuk dëgjojnë. Më vonë, pas viteve 1970 nër qytetet që kishin spitale psikiatrike u hapën shkollat e para të nxënësve me prapambetje të lehtë mendore.

Përpjekjet e para lidhen me hapjen e disa klasave të veçanta për fëmijë të verbër dhe fëmijë që nuk dëgjojnë. Zgjerimi i tyre çoi në krijimin në Tiranë në vitin 1963 të një Instituti Kombëtar, të nxënësve që nuk shikojnë dhe të nxënësve që nuk dëgjojnë, i cili pas shumë vitesh (në vitin 1992) arriti të ndahej në 2 institucione më vete, një për nxënës që nuk dëgjojnë dhe një tjetër për nxënës që nuk shikojnë. Vlen të theksohet se disa institucione të arsimit special në atë kohë u ngritën pranë shkollave të zakonshme.

METODOLOGJIA

Metoda e përdorur në këtë studim është shqyrtimi-interpretimit i literaturës. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë nëpërmjet dokumentave arkivorë, raporteve studimore, historikun e zhvillimit të arsimimit të nxënësve me aftësi të kufizuar në Shqipëri gjatë një perjudhe 10 vjeçare, gjatë viteve 1963-1973.

REZULATET

Fillimisht në mbledhjen e zhvilluar më datë 15.12.1962 nëpërmjet VKM-së Nr. 46 më 15/XII/1962 "Mbi hapjen e shtëpisë së fëmijëve me të meta mendore" Këshilli i Ministrave vendosisenë tremujorin e parë të vitit 1963, të hapet në Tiranë Shtëpia e Fëmijëve me të meta mendore, me një afrësi prej 100 shtretër ku do të shtrohen të fëmijët me të meta mendore prej 3-14 vjeç.

Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës nëpërmjet Projekt-Vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për hapjen e Institucioneve për Edukimin e të Verbërve dhe Shurdhëmemecëve mori disa vendime: Të hapë në tremujorin e parë të vitit 1963 në Tiranë Institucionin për Edukimin e të Verbërve dhe shurdhëmemecëve. Në këtë institucion të pranohen fëmijët 7-10 vjeç kryesisht të verbër dhe shurdhëmemecë jepet me bursën e shtetit dhe të tjerët me pagesë. Afatiimësimit do tëjetë :

a. për të verbërit programi i shkollës 8 vjeçare do të zgjasë 9 vjet
b. për shurdhëmemecët programi i shkollës do të zgjasë 9 vjet. Viti i fundit do të jetë vetëm për mësime profesionale. Në mbarim të 9-vjeçarit fëmijët e këtij institucioni krahas kulturës së përgjithshme do të mësojnë të flasin dhe të marin një porfesion duke fituar kategorinë minimale të punëtorit të prodhimit.

Gjithashtu, u mor vendim se në vitin e katërt të jetës së tij ky institucion do të ndahet:

a. N'institucionin për të verbërit
b. N'institucionin për shurdhëmemecët

Më pas, Ministria e Arsimit dhe Kulturës i dërgoi Drejtorisë së Botimeve Shkollore Tiranë protokollin "Mbi çeljen e shollave speciale të shurdhëmemecëve e të verbërve" për të marë masat për zbatimin në afatet e caktuara.

Në këtë protokoll shkruhej se '*Kolegiumi i Ministrisë dhe Kulturës në mbledhjen e dt 19.12.1962 diskutoi problemin e çeljes së shkollave speciale për shurdhëmemecëve dhe të verbërve dhe konstatoi se në vendin tonë janë krijuar mundësitë për çeljen e shkollave speciale për shurdhëmemecët dhe të verbërit. Në këto shkolla krahas arësimimit të përgjithshëm duhet të jetë dhe pregatitje profesionale , me qëllim që të bëhen të aftë që të jetojnë në të ardhmen me punën e tyre dhe të ndjejnë veten pjesmarrës aktiv në ndërtimin e shoqërisë socialiste*.'

Gjithashtu në këtë protokoll për ngritjen e këtyre shkollave në 1 shtator 1963 u vendos ti paraqitet projekt vendimi qeverisë për ngritjen e shkollave speciale për shurdhëmemecë dhe të verbër si dhe projekt-organika e tyre.

Gjithashtu u bëhen telegrame rretheve: Korçë, Durrës, Shkodër për 24 fëmijët e verbër të dërgohen urgjentisht dokumentat.

Telegrame rretheve: Lushnje, Sarandë, Elbasan, Vlorë për 10 fëmijët e verbër të dërgohen urgjentisht dokumentat

Telegram në Peshkopi për 1 fëmijë të verbër të dërgohen urgjentisht dokumentat

Telegramet u dërgohen të gjithë qyteteve, e pas kësaj meret Vendimi i Këshillit të Ministrave, për secilin rast për pranimin ose jo në Institucion.

Nëpërmjet VKM, Nr 160, dt 29 prill 1963, shteti shqiptar vendosi hapjen e Institutit të parë për edukimin special të dy kategorive të personave me aftësi të kufizuar, të nxënësve që nuk shikonin dhe nxënësve që nuk dëgjonin.Më datë 30-X-1963 fëmijët nga të gjithë rrethet (gjithsej 30 fëmijë) do të rregullohen në këtë Institut. Për të pëcaktuar definitivisht pranimin e tyre në institucion është nevoja që fëmijët të ekzaminohen nga një komision mjeksor i përbërë nga mjekë pediatër, psikiatër, neuropatolog dhe okulist.

Vetëm 7 muaj pas daljes së vendimit u mundësua hapja e këtij Instituti. Në 5 nëntor 1963 hapi dyert për herë të parë në historinë e arsimit special shqiptar Instituti i nxënësve që nuk dëgjojnë dhe nxënësve që nuk shikojnë, i cili në atë kohe u emërtua si Instituti i Shurdhmemecëve dhe të Verbërve. Nga ana e Ministrisë së Arsimit të asaj kohe u importua një makinë shkrimi brail e markës Perkins e cila iu vu në dispozicion “Institutit të Shurdhememecëve dhe të Verbërve”. (Mësuesja e parë për nxënësit me aftësi të kufizuara vizuale në Shqipëri ishte arsimuar pjesërisht në degën e defektologjinë në Leningrad në 1958). Me hapjen e shkollës në 5 nëntor të vitit 1963 ishte bërë gati dhe abetarja e parë në brail dhe teksti i aritmetikës. Këto libra ishin të ilustruara dhe me figura. Mësuesit e parë që punuan në këtë institut sollën një eksperiencë nga Leningradi që do të shërbente më pas dhe si bërthama rreth së cilës do të vërtitej edukimi i kësaj kategorie nxënësish. Tekstet e para në brail filluan të shtypeshin dhe nga vetë mësuesit që realizonin shpërndarjen e tyre te nxënësit me tema apo kapituj të veçantë. Jeta e këtij Instituti filloi me hapjen e dy klasave një për nxënës që nuk shikonin (12 nxënës) dhe një tjetër për nxënës që nuk dëgjonin (10 nxënës). Kriteret administrative të pranimit ishin: nxënësit që nuk shikonin, duhet të ishin të verbër dhe të mos shoqëroheshin me probleme të tjera zhvillimi. I njëjti kriter u aplikua dhe për nxënësit që nuk dëgjonin. Ndër objektivat më të rëndësishme që gjetën zbatim në atë kohë për arsimimin e fëmijëve që nuk shikojnë ka qenë pajisja e nxënësve me vëllimin e plotë të njohurive për arsimin 8 vjeçar të tyre, ndërsa për nxënësit me probleme dëgjimi do të aplikohej programi i ciklit fillor, por i shtrirë në 8 - 9 vite shkollë.

Qendra e Zhvillimit Berat Qëndra rezidenciale ka filluar aktivitetin e saj në vitin 1963. Kjo qëndër ka trajtuar në fillimet e veta fëmijë të braktisur distrofike dhe me çrregullime mendore dhe fizike të moshës nga 3-15 vjeç. Ky institucion funksionoi si i tillë deri në vitin 1991.

Ministria e Kulturës nëpërmjet një shkrese me numër 2979 Prot. drejtuar Komiteti Ekzekutiv K.P. të Rrethit, Tiranë kërkoi që për edukimin e fëmijëve me prapambetje të lehtë mendore në vitin shkollor 1973-1974 të hapet në Tiranë një klasë e parë me 10-14 fëmijë të moshës 7-10 vjeçare. Kjo klasë do të jetë pranë një shkolle 8 vjeçare në varësi të seksionit të arsimit. Për punët mësimore edukative të caktohen dy mësues efektivë të cilët të jenë nga më të mirët dhe me stazh jo më pak se pesë vjet. Mësuesit të meren edhe para edhe mbasdite me zhvillimin dhe organizimin e punës mësimore edukative.

Ministria e Arsimit, duke filluar nga viti shkollor 1973-1974 pranë shkollave 8-vjeçare ”Luigj Gurakuqi” Tiranë dhe `Maliq Muço´ Durrës hapi disa klasa eksperimentale për edukimin e fëmijëve me prapambetje mendore të shkollës së depilitetit.

BIBLIOGRAFIA

- F.490 Këshilli I Ministrave V. 1962 D. 479, fq 6
- F.511 Ministria e ArsimitdheKulturës V. 1962 D.18, fq7
- F.511 Ministria e ArsimitdheKulturës V. 1963 D.21, fq1
- F.511 Ministria e ArsimitdheKulturës V. 1963 D.21, fq2
- F.511 Ministria e ArsimitdheKulturës V. 1963 D.21, fq25
- F.511 Ministria e ArsimitdheKulturës V. 1963 D.21, fq26
- F.511 Ministria e ArsimitdheKulturës V. 1963 D.21, fq27
- F.511 Ministria e ArsimitdheKulturës V. 1973 D.91, fq01

- World Vision, E Drejta e fëmijëvemeaftësitëkufizuarapërarsimingjithëpërfshirës (Analizë e historikuttëzhvillimittëarsimimittëfëmijëvemeaftësitëkufizuaranë Shqipërigjatëperiudhës 1945 - 2011), Mars 2012

MËSIMDHËNIA PRAKTIKE NË DISTANCË NË KOHËN E COVID-19

MSc.Manjola Bani

Studiuese Kërkimore

manjola.bani15@gmail.com

ABSTRACT

With the complexity of the world, the dangers we face increase. One of these dangers is the COVID-19 pandemic, a great challenge for the whole society, spread across national borders, affecting people regardless of nationality, educational level, gender, or economic income.The impact of this pandemic has been felt day after day, both in our country and around the world. In this challenge of the global explosion of COVID-19, the education system is no exception, as a highly affected sector. It was initially thought that the pandemic would last a while but unfortunately this pandemic still persists. Most countries in Europe and beyond, as well as in our country, as part of measures to limit contact between people and prevent the spread of the virus, closed educational institutions. Coherent with the growing number of cases affected by the virus and the suggestions of specialists in the field regarding the pandemic, the educational activity was decided to take place "at a distance" (online). In the period before the pandemic, traditional teaching was considered as a major form of education, now education through technology is becoming more and more necessary for the exchange of knowledge and practical skills of students. *The fundamental question arises:* how to effectively combine the required characteristics of teaching the subject in an authentic distance laboratory educational experience ? as a very important element in scientific education and especially in completing the subject of chemistry. Through the development of laboratory sessions, creativity, activity and interest in the subject of chemistry is stimulated, which has proven to be difficult for some students to learn. In addition to the advantages presenting by traditional practical applications, they have

some limitations as some experiments can not be done due to lack of: chemical reagents, apparatus, protective measures, hazardous chemicals and insufficient time available. Limitations in traditional environments allow teachers to look for different alternatives to realize in a fully way and in the best possible way the course program as well as to realize the acquisition and acquisition of information on different subject topics by students. In this paper, through an overview of online teaching, integration of education in modern methods and researchs, the impact of changes on students, integration of technology and programs in the development of distance learning (online), a presentation is made through simulations and animations that these programs offer and not only, to bring a digital teaching practice as well as the degree of applicability and efficiency. Virtual methods helped students to better understand the theoretical information obtained by arranging the lesson in their individual way, repeating it whenever they saw fit, paying special attention to the whole methodology. The program used could realized the successive stages of work development, modifications could be made as well as processing the data until the display of the final result. The program system also allowed the lecturer to ask questions in the form of a written test to evaluate student performance in relation to the topic addressed.From the detailed evaluation of the fulfillment of the objectives, this way has proved effective.

Keywords:*Distance Teaching (online),Chemistry,VirtualLab, Simulation, COVID-19*

ABSTRAKT

Me ndërlikimin e botës shtohen dhe rreziqet me të cilat përballemi.Një ndër këto rreziqe është dhe pandemia e COVID-19, një sfidë e madhe për të gjithë shoqërinë, e përhapur në kufijtë mbarë-kombëtarë, duke prekur njerëz pavarësisht kombësisë, nivelit arsimor, gjinisë, apo të ardhurave ekonomike.Ndikimi i kësaj pandemie është ndjerë ditë pas dite,si në vendin tonë ashtu dhe në të gjithë botën. Në këtë sfidë të shpërthimit global të COVID-19, nuk bën përjashtim dhe sistemi arsimor, si një sektor mëse i prekur. Fillimisht u mendua se pandemia do të zgjaste pak

por për fat të keq kjo pandemi vazhdon ende.Shumica e vendeve në Evropë dhe më gjerë, ashtu dhe në vendin tonë, si pjesë e masave për të kufizuar kontaktin midis njerëzve dhe për të parandaluar përhapjen e virusit, mbyllën institucionet arsimore. Duke qënë në koherencë me numrin në rritje të rasteve të prekura me virus dhe sugjerimet e specialistëve të fushës lidhur me pandeminë, aktiviteti arsimor u vendos të zhvillohej në "distancë" (online).Në periudhën përpara pandemisë mësimdhënia tradicionale konsiderohej si një formë kryesore e edukimit, tashmë edukimi përmes teknologjisë po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm për shkëmbimin e dijeve dhe shkathtësive praktike të studentëve. *Lind pyetja themelore :* si të ndërthuren në mënyrë efektive karakteristikat e kërkuara të mësimit të lëndës në një përvojë autentike arsimore të laboratorit nga distanca ?, si një element shumë i rëndësishëm në edukimin shkencor dhe vecanërisht në plotësimin e lëndës së kimisë.Nëpërmjet zhvillimit të seancave laboratorike nxitet kreativiteti, aktiviteti dhe interesi për lëndën e kimisë e cila ka rezultuar se është e vështirë për t'u mësuar nga një pjesë e studentëve. Përpos avantazheve që paraqesin aplikimet tradicionale praktike,ato kanë disa kufizime pasi disa eksperimente nuk mund të bëhen për shkak të mungesës së: reagentëve kimikë, aparaturave,masave mbrojtëse, rrezikshmërisë së kimikateve si dhe kohës jo të mjaftueshme në dispozicion. Kufizimet në mjediset tradicionale lejojnë mësimdhënësit të kërkojnë alternativa të ndryshme për të realizuar plotësisht dhe në mënyrën më të mirë të mundshme programin e lëndës si dhe për të realizuar marrjen dhe përvetësimin e informacioneve për temat e ndryshme të lëndës nga studentët. Në këtë punim nëpërmjet një pasqyre të mësimdhënies online, integrimit të edukimit në metodat e kërkimet moderne,impakti i ndryshimeve tek studentët,integrimit të teknologjisë dhe programeve në zhvillimin e mësimit në distancë (online), është bërë një paraqitje me anë të simulimve dhe animacioneve që ofrojnë këto programe dhe jo vetëm, për të sjellë një praktikë të mësimdhënies dixhitale,si dhe shkalla e zbatueshmërisë dhe efikasiteti. Metodat virtuale i ndihmuan studentët për të kuptuar më mirë informacionin teorik të marrë duke e rregulluar mësimin sipas mënyrës individuale të tyre, t'i përsërisnin sa herë që e shihnin të arsyeshme, t'i kushtonin vëmendje më të vecantë të gjithë

metodikës.Programi i përdorur mund të realizonte etapat e njëpasnjëshme të zhvillimit të punës, të mund të bëheshin modifikime si dhe të përpunonte të dhënat deri në shfaqjen e rezultatit përfundimtar.Sistemi i programit gjithashtu lejonte pedagogun që të bënte pyetje në formëtesti me shkrim për të vlerësuar performancën e studentëve në lidhje me temën e trajtuar.Nga vlerësimi i hollësishëm i përmbushjes së objektivave, kjo mënyrë ka rezultuar efektive.

Fjalët Kyçe: *Mësimdhënie në distancë(online), Kimi, VirtualLab, Simulime, COVID-19*

1. HYRJE

Me ndërlikimin e botës shtohen dhe rreziqet me të cilat përballemi.Një ndër këto rreziqe është dhe pandemia e COVID-19, një sfidë e madhe për të gjithë shoqërinë, e përhapur në kufijtë mbarë-kombëtarë, duke prekur njerëz pavarësisht kombësisë, nivelit arsimor, gjinisë, apo të ardhurave ekonomike.Ndikimi i kësaj pandemie është ndjerë ditë pas dite,si në vendin tonë ashtu dhe në të gjithë botën. Në këtë sfidë të shpërthimit global të COVID-19, nuk bën përjashtim dhe sistemi arsimor, si një sektor mëse i prekur. Fillimisht u mendua se pandemia do të zgjaste pak por për fat të keq kjo pandemi vazhdon ende.Shumica e vendeve në Evropë dhe më gjerë, ashtu dhe në vendin tonë, si pjesë e masave për të kufizuar kontaktin midis njerëzve dhe për të parandaluar përhapjen e virusit, mbyllën institucionet arsimore. Duke qënë në koherencë me numrin në rritje të rasteve të prekura me virus dhe sugjerimet e specialistëve të fushës lidhur me pandeminë, aktiviteti arsimor u vendos të zhvillohej në “distancë” (online).Në periudhën përpara pandemisë mësimdhënia tradicionale konsiderohej si një formë kryesore e edukimit, tashmë edukimi përmes teknologjisë po bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm për shkëmbimin e dijeve dhe shkathtësive praktike të studentëve.Duke u bazuar më sipër, ky punim paraqet një pasqyrë të mësimdhënies online, integrimin e edukimit në metodat e kërkimet moderne, impakti i ndryshimeve tek mësimdhënësit dhe mësimnxënësit, arsyet e mënyrat e përdorimit të metodave inovative, integrimi i

teknologjisë në zhvillimin e mësimit në distancë (online), në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, praktika dhe shembuj të zhvillimit të mësimdhënies dixhitale.

2. MËSIMDHËNIA NË DISTANCË (ONLINE)

Historikisht, arsimi në distancë ishte përcaktuar si të gjitha nivelet e studimit nga studentët jo nën drejtimin e drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshëm të mbikëqyrjes së pedagogut ,dhe aktualisht i referohet arsimit ku studenti dhe pedagogu ndahen fizikisht nga një distancë gjeografike. Së bashku me këtë mënyrë ndarjeje është përcaktuar se arsimi i vërtetë në distancë duhet të ofrohet nga institucioni arsimor, duhet të ketë komunikim interaktiv midis studentit dhe pedagogut dhe duhet të ndajë rezultatet e përvojave të të nxënit me studentin. Përparimet në teknologji kanë lejuar që arsimi në distancë të evoluojë nga një model i metodës tradicionale në atë që përfshin të mësuarit në internet në vetë kursin.

Të mësuarit në internet konsiderohet të jetë forma më e re e të mësuarit në distancë që u rrit nga përparimet e jashtëzakonshme në teknologji dhe situatës pandemike që u krijua.Mësimi online është një qasje ndaj mësimdhënies dhe të nxënit, që përfaqëson të gjithë ose një pjesë të modelit arsimor të aplikuar, që bazohet në përdorimin e mediave elektronike dhe pajisjeve si mjete për përmirësimin e aksesit në trajnim, komunikim dhe ndërveprim dhe që lehtëson adoptimin e mënyrat e të kuptuarit dhe zhvillimit të të mësuarit.

Lind pyetja themelore : si të ndërthuren në mënyrë efektive karakteristikat e kërkuara të mësimit të lëndës në një përvojë autentike arsimore të laboratorit nga distanca ? Në mënyrën tradicionale të mësimit teorik, ekziston një ndërveprim kyç që ekziston midis pedagogut dhe studentit. Në praktikë, ne argumentojmë se përparësia kryesore e përvojës "ballë për ballë" është mundësia për të pasur ndërveprim real, të drejtpërdrejtë me kimikatet, aparaturat dhe instrumentet e një eksperimenti real. Ky ndërveprim i drejtpërdrejtë "student-eksperiment"

është i gjithë objektivi i përvojës së të mësuarit laboratorik. Përvojat laboratorike që përmbajnë pajisje reale të nevojshme për të kryer eksperimentin e vendosur fizikisht në të njëjtin vend fizik si eksperimentuesi karakterizohen si laboratorë praktikë. Atributi kryesor i të pasurit studentë fizikisht të pranishëm me pajisjet reale të laboratorit në një proces të vërtetë eksperimental dallon laboratorë praktikë nga llojet e tjera të praktikave laboratorike, të tilla si laboratorë të simuluar (virtual) ose laboratorë në distancë.

2.1 PËRSE ËSHTË E NEVOJËSHME MËSIMDHËNIA PRAKTIKE?

Në të gjitha shkencat ekzakte laboratorët janë shumë të nevojshëm dhe të rëndësishëm. Kryesisht në fushën e kimisë, si një lëndë praktike, cilido kurs ka një përmbajtje të caktuar laboratori pavarësisht prezences së tyre. Nëpërmjet zhvillimit të seancave laboratorike nxitet kreativiteti, aktiviteti dhe interesi për lëndën e kimisë e cila ka rezultuar se është e vështirë për t'u mësuar nga një pjesë e mirë e nxënësve apo studentëve. Në laborator studentët kanë mundësi që të realizojnë apo të aplikojnë njohuritë teorike që kanë marrë lidhur me një temë të caktuar në kimi. Janë të shumta arsyet që ngrenë pikëpyetje për mësimdhënien në laborator si psh: mungesa e materialeve, aparaturave ose koha jo e mjaftueshme që i është lënë në dispozicion laboratorit.Pra studentet mund të ngrenë pikëpyetje nëse ka një mungesë qëllimi të zhvillimit të laboratorit. Shtrohet pyetja: a mund të arrihen qëllimet e rëndësishme në kimi nëse puna praktike nuk ka nje rol të përfillshëm? Po nëse laboratorit nuk do i jepej asnjë vend në programin e kimisë, cfarë do të humbiste kimia? A do të kishin studentët kuriozitetin dhe dëshirën për të studiuar kiminë vetëm duke u bazuar tek mësimet teorike të leksioneve në auditor?Mungesa e përvojës laboratorike, kryesisht në lëndët të cilat e kanë shumë të domosdoshëm zhvillimin e laboratorit mund të ndikojë tek studentët duke krijuar mangësi në perceptimet abstrakte të teorisë së kimisë. Pavarësisht nëse të gjithë studentët do të kenë të domosdoshëm të zhvillojnë praktikën e kimisë apo jo në të ardhmen në punën që ata do të kryejnë, është shumë e

rëndësishme të dihet pesha dhe vendi që zë praktika.Sigurisht që nuk bëhet fjalë për një tepri të punës praktike por ndërthurja e saj me teorinë në mënyrë që kjo e fundit të bëhet më e thjeshtë dhe më e përvetësueshme nga studentët. Sigurisht që jo të gjithë do të duhet ta përdorin praktikën laboratorike me kalimin e kohës, por kanë te arsyetuara dhe të analizuara qartë njohuritë teorike të marra duke i dhënë një kuptim të vecantë kimisë. Jo të gjithë studentët shfaqin entuziazëm për praktikën laboratorike, duke u mjaftuar kështu vetëm me informacionin teorik. Ata që shfaqin interes të vërtetë janë me mendimin se plotësimi i informacionit teorik pasohet nga puna praktike në laborator.

Për vetë rëndësinë e madhe që ka në degën e kimisë, puna laboratorike nuk mund të shihet si sekondare dhe koha që i lihet në dispozicion duhet të arsyetohet, kjo në varësi të lëndëve në degën e kimisë. Pra është shumë e nevojshme që praktika laboratorike të bëhet pjesë më e gjerë e mësimit të kimisë duke kontribuar kështu në rritjen e efektivitetit në mësimnxënien për një mësim të mirë dhe të përhershëm.

2.2 MËSIMDHËNIA NËPËRMJET PRAKTIKËS VIRTUALE

Në fushën e arsimit, teknologjitë në zhvillim ofrojnë mundësi për të bërë më efektiv procesin mësimor si dhe për të përmirësuar metodat e mësimit e të komunikimit.Mjedisi arsimor artificial përdor metoda të ndryshme për të simuluar realitetin, kryesisht në ato drejtime të shkencës që paraqesin terma komplekse. Përpos avantazheve që paraqesin aplikimet tradicionale laboratorike kanë disa kufizime, pasi disa eksperimente nuk mund të bëhen për shkak të mungesës së: reagentëve kimikë, aparaturave , masave mbrojtëse, rrezikshmërisë së kimikateve dhe së fundmi gjatë periudhës së mbylljes së shkollave për semestrin pranverë 2020 si rezultat i pandemisë së krijuar nga COVID-19. Gjithashtu koha jo e mjaftueshme përbën një problem që studentët hasin në laborator.Jo të gjithë studentët mund të kryejnë një eksperimet në të njejtën gjatësi kohore apo në të njejtën mënyrë për të konkluduar në të njëjtin rezultat përfundimtar.Përsëritja e eksperimentit apo orët shtesë në laboratore nuk

mund të jenë gjithnjë të mundura dhe kjo përbën një shqetësim kryesisht për ata studentë të cilët kanë aftësi të dobëta në praktikën laboratorike.Kufizimet në laboratorët tradicionalë të kimisë lejojnë mësimdhënësit të kërkojnë alternativa të ndryshme për të realizuar plotësisht dhe në mënyrën më të mirë të mundshme programin e lëndës së kimisë si dhe për të realizuar marrjen dhe përvetësimin e informacioneve për temat e ndryshme të lëndës nga studentët. Një aplikim i vlefshëm është realizimi i seancave laboratorike nëpërmjet kompjuterit dhe programeve të caktuara si ChemCollective, ChemReax, Chemagic, Labster,ChemMixLab, Chem1 Virtual Textbook, Nanome,PraxiLabs,Molecular Workbench, ChemSims, ChemDoodle etj.Zhvillimi i një eksperimenti në kimi nëpërmjet kompjuterit, në pamundësi për t'u zhvilluar fizikisht në laborator është një mënyrë e mirë dhe efikase për t'i ndihmuar studentët të qartesojnë dhe përvetësojnë njohuritë teorike të marra në klasë. Nëpërmjet eksperimenteve kimike të zhvilluar realisht në laborator pedagoget dhe studentët mund të arrijnë qëllimin e tyre dhe të mund të marrin rezultatet e dëshiruara. Ndërsa eksperimenti virtual i vjen në ndihmë studentëve për të kuptuar më mirë informacionin teorik të marrë duke e rregulluar mësimin sipas mënyrës individuale të tyre. Ata mund ti kushtojnë vëmëndje më të vecantë pajisjeve të përdorura, përdorimit dhe funksionit të tyre, reagentët kimikë, sasitë e përdorura të tyre si dhe rradhën e përdorimit të tyre. Nëpermjet eksperimenteve të simulimit është e mundur që të zhvillohen dhe ato eksperimente të cilat janë të kufizuara të zhvillohen realisht në laborator për shkak të shkallës së dëmtimit apo rrezikshmerisë së reagentëve, ose mungesës së pajisjeve filtruese të avujve të dëmshëm në ambjentet e laboratorit. Gjithashtu nëpërmjet simulimeve virtuale studentët mund të përsërisin eksperimentet sa herë që ata e shohin të arsyeshme deri në momentin që e kanë kuptuar plotësisht temën e mësimit të orës laboratorike, pa u kufizuar kështu nga kufizimet e reagenteve të pranishëm, aparaturave shumë të shtrenjta, ose orët jo të gjata në laborator.

3. METODIKA E PUNËS

Në këtë punim është paraqitur mësimdhënia praktike online (virtuale) e zhvilluar gjatë semestrit pranverë 2020 me studentët e vitit të fundit në Kimi në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë. Për të ndjekur zhvillimin e të gjitha eksperimenteve dhe përftimin e rezultateve janë përdorur disa programe në Virtual Lab por për temën e marrë në trajtim është përdorur programi ChemCollective dhe ChemReax të zhvilluar në paketën VirtualLabs, të përbëra nga animacione dhe simulime lidhur me përcaktimin e oksigjenit të tretur në ujëra. Ky përcaktim mund të kryhej edhe në mjedisin laboratorik por në këtë rast nuk ishte e mundur pasi si rezultat i gjëndjes së pandemisë së krijuar nga COVID-19, mësimi për laboratorin e kimisë u zhvillua në mënyrë virtuale.Edhe pse në këto kushte, eksperimenti u përgatit duke përdorur simulime për t’u dhënë studentëve mundësinë të përsërisin dhe të kontrollojnë hapat e eksperimentit sipas ecurisë individuale dhe kohës në dispozicion të tyre.Përcaktimi i kërkesës kimike për oksigjen në ujëra, si treguesi kryesor i cilësisë së ujërave, është një temë e rëndësishme në kursin e kimisë së mjedisit dhe përvojë praktike e rëndësishme për studentët në laborator.Simulimi i paraqitur është përgatitur duke marrë parasysh kushtet dhe kohën e pamjaftueshme në laborator në rast të ndodhjes në një situatë normale në të cilën mësimi do të zhvillohej në mënyrë fizike në mjdiset e laboratorit.Kohët e fundit, nëpërmjet zhvillimit të programeve kompjuterike, eksperimentet e simulimit dhe aplikacione të tjera që ndihmojnë në realizimin e eksperimentit dhe marrjen e të dhënave, janë bërë të afërta në fushën e edukimit të kimisë.Programi i përdorur mund të realizonte etapat e kryerjes së eksperimentit, të mund të bëheshin modifikime në reagentet e përdorur dhe pajisjet e përdorura si dhe të përpunonte të dhënat deri në shfaqjen e rezultatit përfundimtar.Sistemi i programit gjithashtu lejonte pedagogun që të bënte pyetje në formë testi me shkrim për të vlerësuar performancën e studentëve në lidhje me temën e trajtuar.

4. PROCEDURA EKSPERIMENTALE

Si shembull është marrë tema: Përcaktimi i oksigjenit të tretur në ujëra.

4.1 Hapat e zhvillimit të eksperimentit në Virtual Labs:



Hapi 1:*Mbushet shishja BOD me mostrën e ujit. Me pas mbushet bureta me tretesirë tiosulfat natriumi* $Na_2S_2O_3$



Hapi 2:*Shtohen 2 ml sulfat mangani në shishen e BOD me anë të një pipette*

Hapi 3:*Shtohen 2 ml tretesirë e reaktivit alkalin i përzierjes jodur dhe azid*

Hapi 4: *Përzihet mostra disa herë dhe lihet pak kohë në qetësi.*

Hapi 5:*Merret 2 ml acid sulfurik i përqëndruar nëpërmjet një pipete duke treguar kujdes të mos formohen flluska ajri.*



Hapi 6:*Merren 200 ml moster me anë të një pipete dhe hidhen në balonin konik*



Hapi 7:*Titullohet mostra me tretesirën e tiosulfatit të natriumit. Shtohen 2 ml tretesirë amidoni kur tretësira merr ngjyrë të lehtë të verdhë. Me pas vazhdohet titullimi derisa tretësira merr ngjyrë blu dhe kjo ngjyrë zhduket.*



Leximi fillestar i buretes = 0 ml





Vellimi final = 9.8 ml

4.2 Eksperimenti në ChemCollective



Rezultatet e eksperimentit:

Vëllimi fillestar i mostrës	*Vëllimi përfundimtar i mostrës*	*Vëllimi i harxhuar i $Na_2S_2O_3$*	*Përqendri-mi i DO mg/L*	*Përqëndrimi i DO në mostër*	*Përqe-ndrimi fillestar i $Na_2S_2O_3$ mol/L*	*Përqend-rimi fillestar i mostrës mol/L*
200ml	217.8 ml	9.8	9.8	1.96	0.025	0.001

5. KONKLUZIONE

Në përfundim të praktikës u realizua një bisedë në formë pyetësori me studentët të cilët ishin protagonistë në këtë lëndë, lidhur me sa ata kishin arritur të kuptonin qëllimin e temës së mësimit dhe hapat e zhvillimit të eksperimentit në mënyrë virtuale. U bë një vlerësim i hollësishëm i përgjigjeve të tyre për të parë nëse simulimi përmbushte objektivat për të ndihmuar studentët të përqëndrohen në parimet e kimisë, kryesisht kimisë së mjedist si lënda e marrë në shqyrtim, mënyra si ata e përdoren programin dhe nëse ishin të kënaqur me këtë mënyrë simulimi.Sigurisht që argumentimet e tyre ishin të ndryshme për faktin se për të zhvilluar vitualisht punën e laboratorit një pjesë kishin përdorur laptopë dhe disa smartphonë, por në thelb ata shprehën qëndrime pozitive për realizimin e mësimit duke u ndodhur në kushtet e izolimit në shtëpi për shkak të pandemisë së krijuar nga COVID-19 si dhe duke qënë në dijeni të kohës së pakët që praktika laboratorike kishte për këtë rast, nëse do të ishte zhvilluar fizikisht në mjediset e laboratorit.Gjithashtu shprehën dëshirën e tyre që ta praktikonin këtë mënyrë edhe në rast të kthimit në normalitet të gjëndjes së përgjithshme në arsim, për të kryer seancat laboratorike kur reagentët janë në sasi të limituara ose kur mungojnë, në mënyrë që të kenë një përfrytyrim të plotë dhe të plotësojnë informacionin e marrë në teori për lëndën.Gjithashtu të mund t'i praktikojnë edhe në rastin e kryerjes plotësisht të eksperimentit fizik në laborator, me qëllim përsëritjen e tij sipas ecurisë individuale të tyre, si dhe mundësisë për të menduar ndryshim të përafërt të reagentëve apo materialeve të përdorura, për t'i testuar më pas në laboratorin real të kimisë.Pra metoda që u mor si rast studimi rezultoi pozitive për këtë kurs.

6. REKOMANDIME

- ✔ Në mënyrë që mësimi të jetë efikas nuk nevojitet vetëm që studentët të lexojnë tekstin apo vetëm pedagogët të ligjërojnë.Efikasiteti i mësimit tek studentët rritet me faktin se ata mësojnë më mirë duke menduar, duke pyetur dhe duke praktikuar informacionin teorik që ata kanë marrë.
- ✔ Në mungesë të zhvillimit të laboratorit real,për të mbushur boshllëqet dhe për të adresuar kufizimet, mund të përdoren në mënyrë inovative programet apo sistemet e teknologjisë, pra simulimet kanë kontribuar pozitivisht në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- ✔ Laboratori virtual paraqet një alternativë për shkencat duke përmirësuar procesin e mësimit në to.

Mësimi dhe zhvillimi i tij nëpërmjet simulimeve:

- ✔ u jep studenteve mundësinë të kuptojnë më qartë temën në mënyrë vizuale,efektive dhe interesante.
- ✔ në këtë mënyrë nxitet dhe kurioziteti i studentëve si dhe aftësia për të bërë modifikime të lejueshme e të nevojshme gjatë zhvillimit të eksperimentit.
- ✔ nëpërmjet simulimeve studentët kanë mundësi të shohin përdorimin praktik të njohurive teorike të marra, si dhe pedagogët mund të shpjegojnë eksperimentin sa herë të jetë e nevojshme nga ana e studentëve.
- ✔ nëpërmjet simulimeve ulet shkalla e vështirësisë së mësimit në mungesë të zhvillimit të mësimit praktik real në laborator.
- ✔ konceptet bëhen vizive dhe konkrete.
- ✔ studentet mund të ndjekin procedurën dhe etapat e zhvillimit të eksperimentit sipas aftësive të tyre të përshtatjes në laborator, pra shpejtësisë me të cilën ata ndjekin mësimin.
- ✔ mund të bëjnë gabime dhe të mësojnë nga gabimet e tyre gjatë procedurës së zhvillimit të punës eksperimentale.
- ✔ në këtë mënyrë do të rriten iniciativat dhe rezultatet e studentëve, ata do të kenë mundësi që të bëjnë të realizueshme cdo temë që

lidhet dhe shpjegon dukuritë e jetës së përditshme duke kontribuar kështu në mësim efektiv dhe me domethënie.

- ✔ duke përdorur simulimet në edukimn e kimisë do të jepej një kontribut duke parandaluar efektet e rrezikshme të kimikateve dhe mbrojtjen e mjedisit prej tyre.

Pra laboratorët virtuale janë një lloj teknologjie që duhet të bëhet prezent në klasat e mësimit për të përmirësuar metodat aktuale të të mësuarit,në mungesë të zhvillimit të laboratorit fizik si rezultat i kufizimeve të reagentëve apo aparaturave por edhe si rezultat i shmangjes për demtimin e mjedisit përreth.

- ✔ Gjithashtu dhe një ndërthurje e zhvillimit të laboratorit virtual me atë real në rastet e kohës së paktë që i është vënë në dispozicion laboratorit në program, apo numrit të madh të studentëve në grup duke cuar në pamundësinë e tyre për të ndjekur procedurën eksperimentale me detaje deri në finalizimin e rezultateve.
- ✔ Shumë efikas përdorimi i laboratorëve virtualë do të jetë dhe në fushën e kimisë organike,kristalografi,kimi e përgjithshme, kimi analitike, kimi fizike etj për disa tema të caktuara duke marrë parasysh efektet e rrezikshme të kimikateve në shëndetin e studentëve dhe kryesisht në laboratorët të cilët nuk kanë një sistem të mirë ajrimi ose nuk janë të pajisur me kapë.
- ✔ Krahas zhvillimit të eksperimenteve, laboratorët virtualë nëpërmjet përdorimit të programeve kompjuterike përbëjnë efikasitet dhe në ndërtimin e strukturave të molekulave të thjeshta e atyre dy dhe tre dimensionale (2D & 3D), konformacioneve, gjeometrisë së molekulave, strukturat e Lewisit, celulave elektrokimike, strukura atomike, shpërndarjes elektronike në atome etj.

BIBLOGRAFIA

[1].Bani.M ,Përmirësimi i procesit të mësimdhënies në kiminë organike nëpërmjet aplikimit të mjeteve teknologjike. “NETWB19” 2018-2020”, IUS,Macedonia.

[2].https://www.researchgate.net/publication/26872620_A_simulation_on_teaching_volhard_method
[3]. Khulood Aljuhani, Marwa Sonbul,Mashail Althabiti,Maram Meccawy Creating a Virtual Science Lab (VSL): the adoption of virtual labs in Saudi schools, pg 1.
[4].https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S1877042810023682/pdf?md5=2b9af7ba3bf6ba400ee6e97470dca002&pid=1-s2.0-S1877042810023682-main.pdf
[5].https://www.researchgate.net/publication/327572325_VIRTUAL_CHEMISTRY_LABORATORIES_FOR_THE_UNDERGRADUATE_STUDENTS_OF_KAZAKHSTAN
[6]. https://cnx.org/contents/YMCN43kV@1/Virtual-Labs-in-a-Chemistry-Classroom
[7].https://www.acs.org/content/acs/en/education/students/highschool/chemistryclubs/activities/simulations.html
[8]. Avaa A., Improving performance in the sciences. A support paper presented at a workshop held at Federal Government Girls' College Zaria, 2007.

[9]. Adesoji F.A., Olatunbosun S., Student, Teacher and School Environmental factors as Determinants of Achievement in Senior Secondary School Chemistry in Oyo State, Nigeria. Uluslararası Sosyal Ara_tırmalar Dergisi. The Journal of International Social Research, 2008, 1/2.

[10]. Usman I.A., Relationship between Students performance in practical Activities and their Academic Achievement in Integrated Science using NISTEP mode of teaching, Unpublished and Ph.D Thesis Dept. of Education A.B.U. Zaria, 2000.

[11]. Ojo M.O., The differential Effectiveness cooperative competitive and individual's Goal structures on students' performance in chemistry. Unpublished PhD Thesis, University of Ibadan, Ibadan, 1989.

[12]. Adesokan C.O., Students Attitude and gender as Determinants of Performance in JSS Integrated Science. Unpublished B.Ed Project Department of Chemistry, University of Nigeria, Nsukka, 2002.

[13]. Raimi S.M., Problem-solving Techniques and Laboratory skills as supplements to Laboratory Teaching in Senior Secondary School Students'Learning of Volumetric Analysis.

[14].**Abdulahi A** 1982. Science Teaching in Nigeria. Ilorin. Nigeria: Atoto Press Limited. Abdullah NM 2009. Blame Government for Mass Failure – Mataimaki TonMaiyashi. Daily Trust: The Online Edition. From (Retrieved on 29 October 2014).

[15].https://www.researchgate.net/publication/First Year Chemistry Laboratory Courses for Distance Learners Development and Transfer Credit Acceptance

ARSIMI VS ZHVILLIMIT EKONOMIK NË TRANZICION
Rasti i Shqipërisë

Dr. Teuta Nunaj(Kortoçi)

Universiteti "Barleti", Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë, Tiranë

teuta.nunaj@gmail.com

Kejda Nuhu, PhD.

Universiteti "Barleti", Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative, Tiranë

co.research@umb.edu.al

Abstract

Common problems faced by higher education and the economy in Albania are related to the reduction of the number of individuals pursuing university studies, the emigration of skilled workers, the low public budget for research and education, as well as the low level of collaborations between higher education institutions and business as a whole. On the other hand, the treatment of investment in education as an indicator that would bring growth in the economy is increasingly taking place in the studies of economists and policymakers, which will have to be addressed in Albania as well. In addition to the increase in professionalism, education also brings an increase in individual income, it also affects the acceleration of the development of a country's economy. This paper aims to analyze the current development of higher education in Albania and its impact on the economy. The research question that is intended to be answered is: *What is the impact of education on the economic development of a country?*

The results of the study highlighted the independent development of educational reforms by other sectors, the lack of a unifying strategy for the development of higher education based on economic development priorities, the low level of public funding in education and, the need for cooperation between institutions. Education and the public and private sector.

Keywords:*higher education, economic development, educational policy, Albania.*

Abstrakt

Problemet e përbashkëta me të cilat përballet arsimi i lartë dhe ekonomia në Shqipëri kanë të bëjnë me uljen e numrit të individëve që vazhdojnë studimet universitare, emigrimin e punonjësit të kualifikuar, buxhetin e ulët publik për kërkim shkencor dhe arsim, si dhe nivelin e ulët të bashkëpunimeve mes institucioneve të arsimit të lartë dhe biznesit në tërësi. Nga ana tjetër, trajtimi i investimit në arsim, si një tregues që do të sillte rritje në ekonomi, gjithnjë e më shumë po zë vend në studimet e ekonomistëve dhe politikëbërësve, gjë e cila do të duhet të trajtohet edhe në Shqipëri. Arsimi krahas rritjes në profesionalizëm, sjell dhe rritje të të ardhurave individule, ndikon edhe në përshpejtimin e zhvillimit të ekonomisë së një vendi.

Ky punim ka si qëllim të analizojë zhvillimin aktual të arsimit të lartë në Shqipëri dhe ndikimin e tij në ekonomi. Pyetja kërkimore që synohet t'i jepet përgjigje është: *Cili është ndikimi i arsimit në zhvillimin ekonomik të një vendi?*

Rezultatet e studimit nxorrën në pah zhvillimin e pavarur të reformave arsimore nga sektorët e tjerë, mungesën e një strategjie unifikuese për zhvillimin e arsimit të lartë mbi bazën e prioriteteve të zhvillimit ekonomik, nivelin e ulët të financimit publik në arsim dhe nevojën për bashkëpunim mes institucioneve arsimore dhe sektorit publik e privat.

Fjalë kyçe: *arsim i lartë, zhvillim ekonomik, politika arsimore, Shqipëri.*

Hyrje

Arsimi për çdo njeri, është një e drejtë universale që duhet t'i realizohet nga qeveritë; është një mundësi që i jepet çdo njeriu për të përmirësuar ekonominë e tij; është një shans për të ndryshuar jetën e tij; është tërësia e dijeve që çdo individ merr përgjatë viteve të studimit, të cilat nëse i vë në punë, e ndihmojnë të rritet profesionalisht dhe të rrisë të ardhurat e tij. Por arsimi edhe pse merret individualisht, është një e mirë publike dhe nuk vepron i shkëputur nga ekonomia, duke qenë një nga variablat ndikues më të rëndësishëm në rritjen e saj.

Kapitali human[1] mbetet burimi kryesor i zhvillimit ekonomik dhe një zhvillim i qëndrueshëm dhe profesional i cilësisë së tyre ndikon drejtpërdrejtë në ekonomi. Të zhvilluarit e arsimit dhe ekonomisë në dy rrugë paralele, jo vetëm nuk e ndihmojnë njëra-tjetrën, por zgjasin në kohë dhe ngadalësojnë ritmet e zhvillimit të secilës. Problemet e përbashkëta me të cilat përballet arsimi i lartë dhe ekonomia në Shqipëri kanë të bëjnë me: (i) uljen e numrit të individëve që vazhdojnë studimet universitare, ku në periudhën mes viteve akademike 2013-2014 dhe 2017-2018 kemi 23,501 indidivë që studiojnë më pak në universitete; (ii) emigrimin e punonjësit të kualifikuar: mjekë, infermierë, specialistë IT, etj.; (iii) buxhetin e ulët publik për kërkim shkencor dhe arsim, mbi 3% në vitin 2020 (Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 2020:12); si dhe (iv) niveli i ulët i bashkëpunimeve mes institucioneve të arsimit të lartë dhe biznesit në tërësi.

Punimi është organizuar në pesë pjesë. Në pjesën e parë është rishikimi i literaturës; në pjesën e dytë përshkruhet metodologjia dhe burimet e të dhënave; në pjesën e tretë paraqiten rezultatet e studimeve të ndryshme mbi ndikimin që ka arsimi në zhvillimin ekonomik të një vendi; në pjesën e katërt bëhet një analizë cilësore dhe krahasimore mbi gjendjen e arsimit dhe ekonomisë në Shqipëri; në pjesën e pestë prezatohen përfundimet dhe rekomandimet.

[1] Kapitali human në kuptimin e kësaj eseje është individi i arsimuar.

Literatura

Një ekonomi e zhvilluar investon në arsim për ta rritur në nivel dhe një arsim i zhvilluar rrit risitë dhe ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e ekonomisë së një vendi dhe standardin e jetës së qytetarëve të saj. Sipas Dickens et al. (2006), investimi në kapitalin human është vendimtar për të ardhmen, sepse ekonomia është duke u kthyer nga njohuritë bazë, pas një ekonomie post industriale (Cituar nga Bashir, Herath dhe Gebremedhin, 2012:5).Për të matur dhe përcaktuar nivelin e zhvillimit të një vendi, studiuesit përdorin si variabël bazë Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) dhe për të identifikuar mirëqënien e popullatës përdorin Prodhimin e Brendshëm Bruto për frymë. Pasi synimi bazë i zhvillimit të një vendi, është pikërisht përmirësimi i cilësisë së jetës të qytetarëve të tij. Sipas një studimi të kryer nga UNESCO: "Çdo vit shtesë shkollimi rrit mesataren vjetore të PBB me 0.37%" (UNESCO, 2010:6), njëkohësisht "një vit shtesë shkollimi rrit të ardhurat vjetore [individuale] 10%" (Po aty, fq. 7).

Studimime të ndryshme kanë vërtetuar se arsimi është një nga faktorët kryesorë që çon në rritje të ekonomisë, pasi arsimi rrit profesionalisht burimin njerëzor që është kapitali më i rëndësishëm në rritjen e produktitvitetit dhe lindjen e risive në fusha të ndryshme, përfshirë këtu edhe teknologjinë. Ndaj, të investosh në arsim, do të thotë njëkohësisht të investosh në burime njerëzore. Nga ana tjetër, edhe në nivel mikro, investimi në arsim i mundëson individit që dijet e marra ta ndihmojnë në rritjen profesionale, në rritje në karrierë, në rritjen e aftësisë në punë, në rritjen e të ardhurave personale, që sjell rritje të konsumit, që sjell rritjen e parasë në qarkullim, që sjell më shumë të ardhura për biznesin, që sjell më shumë investime, që sjell më shumë vende të reja pune, por edhe më shumë të ardhura për buxhetin e shtetit, se paguahen më shumë taksa, që sjellë edhe më shumë investime publike. Pra kemi të bëjmë me efekte zinxhir. Në këtë mënyrë të mirat janë individuale dhe publike dhe sistemi ekonomik dhe ai arsimor përfitojnë nga njëri-tjetri në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe indirekt njëkohësisht, duke i kthyer arsimin dhe ekonominë në të mira publike.

Robert J. Barro është autori i dytë më i cituar që ka trajtuar lidhjen mes arsimit dhe zhvillimit ekonomik të një vendi. Ai mbërrin në rezultatin se lidhja ekonomike lidhet pozitivisht me nivelin fillestar të mesatares të viteve të shkollimit të meshkujve të rritur në nivelin [arsimor] të mesëm dhe të lartë (Barro, 2001:17).Sipas Krueger dhe Lingahl (2001), politikëbërësit dhe ekonomistët, vendet ose shtetet duhet të shpenzojnë një shumë të konsiderueshme për arsimin për popullatën e tyre, e cila do të rriste të ardhurat në mënyrë të konsiderueshme dhe do të çonte në rritjen e ekonomisë (Cituar nga Bashir, Herath dhe Gebremedhin, 2012:3).

Sipas të dhënave nga OECD (2007), në periudhën 1996-1998, për individët nga mosha 25 – 64 vjeç, vendet me mesatare më të lartë të shkollimit për banorë janë: SHBA me 13.5 vite shkollimi, Zvicra me 12.6 vite shkollimi, Britania e Madhe dhe Suedia me 12.1 vite shkollimi. Ndërkohë në Shqipëri mesatarja e shkollimit për banorë është 9 vite, aq sa është edhe arsimi i detyrueshëm. Këto ndryshime shpjegohet edhe me nivelin e ndryshëm ekonomik të këtyre vendeve.

Metodologjia

Metodologjia e zbatuar është narrative dhe analizuese. Në aspektin narrativ punimi paraqet rezultatet e studimeve të ndryshme për ndikimin e arsimit në zhvillimin ekonomik të një vendi dhe në aspektin analizues shtjellohet gjendja aktuale e arsimit të lartë në Shqipëri. Metodat e zbatuara janë cilësore dhe krahasimore. Janë përdorur burime dytësore të marra nga raportet e insitucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, që trajtojnë arsimin dhe ndikimin e tij në zhvillimin ekononik të një vendi.

Arsimit dhe zhvillimi ekonomik, si modele të ofruara nga vende të ndyshme në botë

Pas viteve ’80-të të shekullit të kaluar, studiuesit gjithnjë e më shumë po përballin në analizat e tyre dy variabla: arsimin dhe zhvillimin ekonomik, të cilat kanë një rëndësi të veçantë në ardhmërinë e një vendi. Përfundimet kanë një përbashkësi, pasi është identifikuar ndikimi që këto dy variabla kanë te njëri-tjetri dhe te shtetasit.

Nga të dhënat e Bankës Botërore, në vitin 2017, qeveria shqiptare shpenzon për arsimin 3.6 % të PBB, ndërkohë, po në të njëjtin vit, në vendet e OECD (Organizata Evropiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim) ky shpenzim është 5% e PBB, në vendet e BE-së është 4.7%, në vendet e Amerikës së Veriut është 5% dhe mesatarja botërore është 4.5% (Word Bank, 2020), pra ne jemi nën mesataren botërore. Ndërsa në vitin 2019, shpenzimet publike për arsimin kanë zënë 11.3% të shpenzimeve publike ose 3.3% të PBB (INSTAT, 2020:37), ndërkohë në vitin 1991, buxheti për arsimin ka qenë 5% e PBB.Dowvrick në studimin e tij evidenton se në vendet e OECD rritja e një viti arsimim ka ndikim në rritjen e të ardhurave personale. Njëkohësisht ai mbërrin në përfundimin se: "... ka prova që evidentojnë kthimin e [investimit] në arsim në përputhje me evidencat mikroekonomike mbi fitimet individuale. ... Një rritje e menjëhershme [në nivelin arsimor] do të prodhojë një rritje [po] të menjëhershme të nivelit të PBB për frymë. ... Ka prova që efektet dinamike të rritjes lidhen edhe me aftësinë e vendit për të zbatuar teknologjitë e reja." (2002:20).

Bashir, Herath dhe Gebremedhin zhvilluan një analizë empirike mbi arsimin e lartë dhe rritjen ekonomike në Virxhinian Perëndimore, SHBA dhe mbërritën në përfundimin: "… si rritja e arsimit dhe rritja e të ardhurave ndikojnë pozitivisht njëra-tjetrën. Ndaj, do të ishte e dobishme të bëheshin më shumë përpjekje për të rritur punën ose të ardhurat, për të gjeneruar më shumë mundësi. … Arritjet në arsim rrisin produktivitetin, rrisin të ardhurat dhe fitimet, ulin rriskun e varfërisë dhe përmirësojnë standardin e jetesës së popullatës. …" (2012:11).

Rezultatet e studimit të ndërmarrë nga OECD më 2011 nxorrën në pah një problem të rëndësishëm për arsimin e lartë në rajonin e Lombardisë në Itali. Kështu: "Shumë universitete kanë një ndjekje të dobët të zhvillimit dhe arritjeve të studentëve, si dhe të rezultateve të punësimit të të diplomuarve. Pavarësisht disa përjashtimeve të dukshme, shpesh të drejtuara nga sektori aktiv privat ose shoqatat industriale në Lombardi, tradicionalisht, përshkrimi i programeve të studimit në shumë universitete në Lombardi janë bazuar në anën mbështetëse (të dëshirave dhe kapaciteteve të akademikëve), sesa nga ana e kërkesës (së nevojave të

tregut të punës apo të studentëve). Si rezultat, kultura arsimore mbetet (e qendërzuar te mësuesi) dhe dështon në përfshirjen e të mësuarit eksperimental, interaktivë, të metodologjisë së punës dhe të mësuarit të bazuar në problem…" (OECD, 2011:124).

Por, zhvillimi ekonomik i një vendi përcakton edhe nevojën për nivelin arsimor që i duhet. Sipas Grant: "Vetëm arsimi i mesëm me bazë të gjerë dhe arsimi fillor universal ka të ngjarë t'u japë vendeve të varfra mundësinë që të nxisin kapitalin njerëzor të nevojshëm për të nxjerrë nga varfëria segmente të mëdha popullsie" (2017:2). Sipas Ilasa (2008) për vendet më të zhvilluara, edukimi terciar [arsimi i lartë] i të rinjve luan një rol themelor në rritjen ekonomike (Cituar nga Grant, 2017:2).

Hanushek dhe Woßmann mbërritën në përfundimin se "Cilësia e edukimit, e matur nga ajo çfarë njerëzit dinë, ka një efekt të fuqishëm në fitimet individuale, në shpërndarjen e të ardhurave dhe në rritjen ekonomike. ... fitimet individuale janë të lidhura sistematikisht me njohuritë konjitive. Shpërndarja e njohurive në shoqëri shfaqet e lidhur ngushtë me shpërndarjen e të ardhurave. Dhe, ndoshta më e rëndësishmja, rritja ekonomike është e influencuar fort nga aftësitë e punëtorëve" (2007:76).Në marrëdhënien mes rritjes së viteve të shkollimit të lartë dhe rritjes së të ardhurave personale dhe rritjes ekonomike të një vendi, shumë studiuesit theksojnë rëndësinë që mbart niveli i zhvillimit teknologjik dhe ekonomik të një vendi, si edhe cilësia e arsimit. Pasi nuk mjafton vetëm të rritësh numerikisht vitet e shkollimit, pasi duhet edhe cilësia e tij. Ndaj, kjo marrëdhënie nuk është e njëjtë si në vendet e zhvilluara dhe në vendet në zhvillim apo të varfëra, arsye që i ka çuar studiuesit që në analizat e tyre vendet e OECD-së t'i ndajnë nga vendet e tjera të botës.

Hanushek argmenton se "... rritja [ekonomike] është shumë e lidhur me kapitalin e njohurive të një vendi..." (2016:550). Ai evidenton se ky kapital matet nga testet ndërkombëtare të matematikës dhe shkencës dhe rritjet në arsimin e lartë lidhen me nivelin e shkollimit të viteve të mëparshme. Ndaj "… rezultatet e arsimit të lartë duhet të mendohen si

endogjene, sesa nga pikëpamja e zakonshme që është ekzogjene për pranimet" (Po aty, fq. 550).

Në studimin "Arsimi dhe rritja ekonomike" Barro analizoi një panel me rreth 100 vende me të dhëna të vëzhguara në periudhën 1960-1995 dhe mbërriti në përfundimin: "Të dhënat e rezultateve të studentëve në provimet e krahasueshme ndërkombëtarisht në shkencë, matematikë dhe lexim u përdorën për të matur cilësinë e shkollimit. Rezultatet në testet e shkencës kanë një lidhje veçanërisht të fortë pozitive me rritjen ekonomike…." (2013:31), duke specifikuar në këtë mënyrë lidhjen e zhvillimit të ekonomisë përmes arsimit në shkencat ekzakte.

Nga të dhënat e INSTAT, Tabela 3, Shtojca, në Shqipëri, numri i studentëve që studiojnë "Shkenca Natyrore, Matematikë dhe Statistikë" në vitin akademik 2014-2015 është 10,473 studentë ose 6.5% e totalit të studentëve. Ndërsa 6 vite më vonë, në vitin akademik 2020-2021 ky numër është 4.924 studentë ose 4% e totalit të studentëve. Të dhënat paraqesin se në këtë periudhë kemi një rënie të ndjeshme të studentëve që studiojnë "Shkenca Natyrore, Matematikë dhe Statistikë" me 5,549 studentë ose 53% më pak. Por ndryshimet në fushat e studimet lidhen pak me fushat prioritare ekonomike që vendos qeveria, siç është rritja e numrit të studentëve të regjistruar në fushën "Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim" që lidhet drejtpërdrejtë me rritjen dhe zhvillimin e industrisë së ndërtimit në vitet e fundit.

Figura 1: Studentë në arsimin e lartë sipas fushave të studimit



Gyimah-Brempong, Paddison dhe Mitiku analizuan marrëdhënien mes arsimit të lartë dhe rritjes ekonomike në 33 vende Afrikane dhe rezultuan

se “Të gjitha nivelet e edukimit të kapitalit human, përfshirë arsimin e lartë të kapitalit human kanë efekt pozitiv dhe janë statistikisht të rëndësishëm në normën e rritjes së të ardhurave për frymë në [33] vendet afrikane [të marra në analizë]” (2006:509).Hoareau, Ritzen dhe Marconi (2013) krahasuan politikat arsimore në 32 vende evropiane (përfshirë edhe Turqinë) dhe prespektivat e arsimit të lartë, me qëllim adresimin e diferencave në nivelin e inovacionit ekonomik mes tyre. Studimi nxorri në pah se shkalla e fuqizimit [të vendit] lidhet me performancën e arsimit të lartë dhe me kapacitet inovative të vendeve. Të dhënat treguan se vende si Turqia me një popullsi të re, kanë një numër më të madh studentësh në krahasim me popullatën. Por madhësia e madhe e studentëve në arsimin e lartë nuk ka një marrëdhënie pozitive me inovacionin ekonomik, gjë e cila tregon se ndikimi i arsimit nuk realizohet vetëm përmes viteve të studimit, por rëndësi themelore ka cilësia e tij.

Monsaláz, Peralta, Serrano, and Soler vlerësuan kontributin e institucioneve të arsimit të lartë në rritjen ekonomike dhe në PBB për frymë në vendet e Bashkimit Evropian (BE) përgjatë periudhës 2000-2015. Variablat që u morrën në analizë ishin ndikimi i universiteteve në ekonomitë kombëtare, veçanërisht efekti i kërkim-zhvillimit të universiteteve në kapitalin teknologjik. Ata mbërritën në përfundimin se “… këto efekte [të universiteteve] janë një burim i rëndësishëm i rritjes [ekonomike] në vendet e BE-së, duke kontribuar në zbutjen e efekteve anësore në periudhat e krizave… Rezultatet e arritura treguan gjithashtu ndryshime të konsiderueshme në PBB për frymë mes vendeve të BE-së të lidhura me aktivitetin e institucioneve të arsimit të lartë” (2018:1).

Sipas studimeve të kryera nga UNESCO shembujt real vijnë nga Azia, ku vendet e quajtura “Tigrat e Azisë” [Koreja e Jugut, Singapori, Hong Kongu dhe Taivani] janë shembulli i zhvillimit të njëkohshëm të arsimit dhe ekonomive së tyre. Ndërsa sugjerohet se rritja e qëndrueshme në Afrikën Sub-Sahariane do të varet nga politikat e shëndosha ekonomike të koordinuara me investime qeveritare në arsim dhe njohuritë për trajnim në aftësimin e nevojave për tregun e punës (UNESCO 2012).Sipas një vlerësimi të pavarur të Bankës Botërore: “Në përputhje me gjetjet e një

vlerësimi të fundit të Independent Evalutation Group, rritja e regjistrimeve [në arsimin e lartë] duhet të përputhet me rritjen e kërkesave për një fuqi punëtore të arsimuar (World Bank 2016). Të dy këta faktorë do të vendosin nën presion qeveritë për të zgjeruar mbështetjen e tyre për nivelin e arsimit të lartë, duke vendosur një ngarkesë të pashmangshme në burimet e kufizuara fiskale. Rritja e regjistrimeve mund të shtojë presionin mbi cilësinë e arsimit të lartë, të dyja për shkak të zvogëlimit të mundshëm të financimit publik për studentët dhe për shkak të rritjes së numrit të ofruesve privatë të parregulluar" (World Bank, 2017:55).

Arsimi dhe ekonomia në tranzicionin shqiptar

Prej 3 dekadash në Shqipëri ekonomia e tregut vijon të jenë në tranzicion duke lënë ende gjurmë të thella. Gjatë kësaj periudhe, ekonomia shqiptare u dallua për (i) paqëndrueshmëri ekonomike; (ii) zhvillim individual të kapitalit njerëzor; (iii) investime të ulta; (iv) krah pune të pakualifikuar, që solli paga të ulta; (v) nivele të larta të remitancave, shumica e të cilave shpenzohen për konsum ditor; (vi) infrastrukturë pjesërisht të zhvilluar; dhe (vii) mungesë të politikave afatgjata disavjeçare, duke i kufizuar startegjitë e zhvillimit ekonomik dhe arsimor vetëm për periudha mandatuese elektorale. Sipas Bankës Botërore, Shqipëria përfshihet në ekonomitë me të ardhura të mesme 4,036$ - 12,475$ në vit për person (World Bank, 2021).

Karakteristika dominuese e shoqërisë shqiptare është nisja gjithnjë nga zero, e cila tashmë është kthyer në traditë. Në çdo rotacion politik kemi një plan të ri ekonomik, një model të ri zhvillimi, një riformatim marrëdhëniesh me investitorët shqiptarë dhe të huaj, një rishikim të koncesioneve dhe shitjeve të ish – ndërmarrjeve publike. Ndërkohë, që janë të paktat raste kur puna fillon aty ku është lënë nga qeveria paraardhëse. Prezenca profesionale dhe shkencore e specialistëve dhe ekspertëve ka ndjeshëm mungesë … (Nunaj, 2015, parag. 5).Tranzicioni gjeti shtrirje edhe në arsimin e lartë. Dy janë ngjarjet me gjurmët më të mëdha në arsimin e lartë: (i) mbyllja e një pjese të institucionave të arsimit të lartë; (ii) rritja në mënyrë të vazhdueshme e numrit të të rinjve

që studiojnë jashtë shtetit dhe nuk kthehen në Shqipëri, për shkak të paqëndrueshmërisë dhe mungesës së sigurisë.

Në vitin 2002 u themelua universiteti i parë privat në vend. Liberalizimi i tregut solli mundësi në nivel makro për rritjen e arsimit dhe në nivel mikro për zgjedhjen e programeve të preferuara të studimit nga ana e studentëve. Licensimi dhe hapja pa kriter e institucioneve të arsimit të lartë dëmtoi arsimin duke krijuar një sistem fiktiv studentësh dhe me nivel të ulët përgatitje (Nunaj, 2016). Një pjesë e këtyre institucioneve u përfshinë në afera abuzive dhe devijuan nga misioni i tyre, duke ushtruar aktivitet pa miratimet përkatëse ligjore, duke ofruar diploma fiktive dhe duke vënë si prioritet fitimin në kurriz të standardit dhe cilësisë arsimore. Por vetëm pas një dekade, Reforma e Arsimit e vitit 2015 mbylli 26 institucione të arsimit të lartë (Agjensia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë [ASCAL], 2021), që nuk plotësonin kriteret ligjore dhe kishin cënuar dhe degraduar arsimin e lartë shqiptar. Aktualisht në Shqipëri ushtrojnë aktivitetin e tyre 41 institucione të arsimit të lartë (ASCAL 2021).

Problematikat me të cilat ende ndeshet arsimi i lartë në Shqipëri lidhen me:

1. Fluksin e lartë të largimit të studentëve jashtë shtetit dhe kthimin e ulët të tyre pas studimeve në vend. Kështu, sipas të dhënave nga UNESCO, në vitin 2016, janë larguar për studime jashtë shtetit 17,397 studentë shqiptarë.

2. Ulja e numrit të studentëve ndër vite, si pasojë e numrit të ulët të nxënësve në të gjitha ciklet e studimit. Në të dhënat e INSTAT të paraqitura në Tabelën 1 Shtojca, shohim se në periudhën e marrë në analizë, nga viti akademik 2014-2015 deri në vitin 2020-2021 kemi një rënie të ndjeshme të regjistrimeve në të gjitha nivelet e shkollimit. Në arsimin e lartë përgjatë kësaj periudhe kemi një rënie prej 38,747 studentësh ose 24% më pak.

3. Përfshirjen më shumë të teknologjisë së informacionin në procesin e mësimdhënies.

4. Përgatitjen e kapitalit njerëzor gjithnjë e më tepër me zhvillimet kombëtare, rajonale e botërore.

5. Orientimin në karrierë të studentit, që të mund të jenë më të përgatitur dhe më të përfshirë në tregun publik e privat.

6. Rritjen e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të sektorit të arsimit në tërësi me sektorin publik dhe privat.

Krahas sa më sipër, në Shqipëri, në shumë raste, ndërtimi i programeve mësimore në institucionet e arsimit të lartë është realizuar mbi fushat e studimit të hartuesve, duke u lidhur tangencialisht me kërkesat e tregut, duke u mbështetur në kurikulat e universiteteve ndërkombëtare, por pa u përshtatur me kushtet e Shqipërisë dhe në mungesë të vazhdueshme të literaturës në gjuhën shqipe. Ndërsa bashkëpunimet me sektorin publik dhe privat, ende janë në stade të ulta dhe pa ndikim në përmirësimin e programeve mësimore.Në dezertacionin e punuar nga Ditjona Kule që ka analizuar ndikimin e arsimit të lartë në Shqipëri në periudhën 1996-2013, ajo ka analizuar PBB si variabël të varur dhe si variabla të pavarura ka marrë numrin e studentëve të regjistruar në arsimin e lartë, shpenzimet për arsimin e lartë dhe nivelin e punësimit. Ajo mbërrin në rezultatin se "Shkalla e regjistrimit të studentëve, shpenzimet për arsimin e lartë dhe punëzënia kanë ndikim pozitiv në rritje në PBBB..." (2015:129). Por, siç e ka theksuar edhe Kule, në Shqipëri si vend tranzicioni, ka ende mungesa në nxjerrjen e të dhënave të plota, që do të mundësonin një analizë të thelluar empirike mbi marrëdhënien që ekziston mes variablave zhvillim ekonomik dhe arsimor.

Figura 1: Popullsia në moshën 20-34 vjeç, numri i studentëve dhe i të diplomuarve



Nga të dhënat e pasqyruara te Shtojca, konkretisht në Tabelën 1 për studentët e diplomuar, në Tabelën 2 për studentët e regjistruar, në Tabelën 4 për punëkërkuesit sipas niveleve arsimore dhe në Tabelën 5 për popullsinë, për periudhën e marrë në analizë 2015 - 2020, kemi këto të dhëna: popullsia nga mosha 20 – 34 vjeç ka një rënie prej 4,501 banorë ose 0.67%; numri i studentëve në arsimin e lartë ka një rënie me 24,480 studentë ose 16%; numri i të diplomuarve është ulur me 1,567 të diplomuar ose 8%; numri i punëkërkuesve në total është ulur 78,214 punëkërkues ose 48%; dhe numri i punëkërkuesve me arsim të lartë është ulur 6,461 punëkërkues ose 55%. Kjo rënie e ndjeshme e numrit të studentëve të regjistruar në arsimin e lartë ka si faktorë: (i) rënien e numrit të popullatës; (ii) emigrimin e studentëve shqiptarë për studime jashtë vendit; (iii) mbyljen e arsimit të lartë me kohë të pjesshme me reformën e arsimit të lartë 2015; (iv) rritja e notës mesatare për hyrjen në programet e ciklit të parë Bachelor; (v) mungesa e kërkesave të tregut për teknikë të lartë 2-vjecare, gjë e cila mban në ritme të ulta regjistrimet në këtë cikël studimesh.

Fillimisht reforma e arsimit të lartë 2015 për shkak të trajtimit të gjerë me grupet e intersit dhe me aktorë të ndryshëm, krijoi shumë pritshmëri për përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë, por rezultatet e saj ishin të ndryshme. Kështu, krahas autonomisë universitare, një parim tjetër i rëndësishëm ishte: “Disa nga programet e studimit duhet të gëzojnë “status të veçantë” si përparësi kombëtare….” (Komisioni për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, 2014:10), gjë e cila nuk u realizua asnjëherë. Kjo solli moskrijimin e lidhjes mes fushave të studimit të arsimit të lartë dhe fushave prioritare të zvillimit ekonomik të vendit.

Në studimin e kryer nga Çani dhe Olldashi pas 5 viteve reform në arsimin e lartë gjetjet më kryesore që mbështesin përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë janë: (i) autonomia financiare nuk solli rritjen e financimit për kërkim shkencor për pedagogët; (ii) nuk u realizua kontrolli antiplagjaturë për titujt dhe gradat shkencore, siç u parashikua në VKM nr. 777, dt. 26.12.2018; (iii) pati vonesa në miratimit e akteve nënligjore duke krijuar problematike në funksionin e institucioneve të arsimit të lartë (2020:29). Këto mosrealizime, e lanë arsimin në status quo dhe nuk

ndihmuan në përmirësimin e cilësisë së tij. Ndaj një reform e dytë për arsimin e lartë për përmirësimin real të cilësisë së tij është domosdoshmëri si për arsimin e lartë dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. Pa arsim cilësor, nuk mund të ketë zhvillim. Paralelisht kjo reformë duhet të lidhet me strategjinë e zhvillimit ekonomik të vendit, duke identifikuar fushat prioritare dhe me rëndësi strategjike, me programet e posaçme që do të çojnë në përgatitjen e individëve të kualifikuar, të aftë për t'u përballur me kërkesat dhe sfidat e një tregu gjithnjë e më dinamik.

Përfundime dhe rekomandime

Zhvillimi i arsimit të lartë dhe zhvillimi ekonomik në Shqipëri janë dy fusha veprimi me rëndësi kombëtare për të tashmen dhe të ardhmen e vendit, por që deri më tani janë zhvilluar si dy paralele që nuk u bashkuan. Gjë e cila ka bërë që ecuria e tyre të jetë e pavarur nga njëra-tjetra, ndërkohë që duhet të ndodhte tërësisht e kundërta. Arsimi dhe ekonomia duhet të kishin një platformë të përbashkët zhvillimi. Pa arsim nuk ka ekonomi të zhvilluar dhe pa ekonomi nuk ka arsim të zhvilluar. Për sa kohë që në Shqipëri secila fushë zhvillimi do të eci dhe veprojë më vetë, pa bashkëpunim, rezultatet do të shfaqen të segmentuara, të pakta dhe shumë larg realizimit të një produkti dobiprurës për vendin dhe popullatën.

Në një analizë cilësore të gjendjes së arsimit të lartë dhe krahasimore me ndikimin që arsimi ka në ekonomitë në vende të ndryshme të botës, mbërrijmë në përfundimin se arsimi i lartë ka një ndikim si në ekonominë e një vendi edhe në ekonominë personale: (i) një individ i arsimuar dhe i kualifikuar profesionalisht është një kapital i rëndësishëm për organizatën dhe shoqërinë në tërësi, pasi ka predispozitën të sjellë përmirësim, risi, zhvillim dhe rritje të produktivitetit; (ii) çdo vit shtesë në arsim ndikon në rritjen e të ardhurave personale, njëkohësisht në rritjen e PBB dhe të PBB për frymë; (iii) rritja në arsim krahas ndikimit pozitiv në rritjen e ekonomisë dhe anasjelltas, ushtron ndikim edhe në rritjen e kapitalit të njohurive të vendit.Ndaj, ritmi i zhvillimit të arsimit është i domosdoshëm të jetë në të njëjtën linjë me ritmin e zhvillimit të

ekonomisë; prioritetet në arsim duhet të njehtësohen me prioritetet në ekonomi; avantazhet në ekonomi, duhet të mbështeten me zhvillimet në arsim; nevojat që ka ekonomia duhet të mbështeten me politika arsimore; strukturimi dhe prioritetet e ekonomisë duhet të ngrihen mbi bazën e bashkërendimit të prioriteteve dhe strukturimit të politikave publike arsimore. Arsimi duhet të kthehet në prioritete kombëtar për qeverinë kryesisht dhe për të gjithë aktorët pjesëmarrës.

Në përfundim rekomandohet: (i) qeveria të rrisi buxhetin publik për arsimin; (ii) qeveria të bashkërendojë politikat arsimore me ato ekonomike, që arsimi të jetë një mbështetje e fuqishme për fushat prioritare dhe me rëndësi strategjike për zhvillimin e vendit; (iii) qeveria të kontribuojë në forcimin e institucioneve të arsimit të lartë publik dhe privat; dhe (iv) institucionet arsimore, publike dhe private të punojnë për rritjen e bashkëpunimit mes tyre që të kontribuojnë edhe më shumë në përgatitjen e punonjësve të aftë për tregun e punës.

BIBLIOGRAFIA

Agjensia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (2021). *Lista e IAL*.https://www.ascal.al/sq/lista-e-ial

Barro, R. J. (2001). "Human capital: growth, history and policy – a session to honor Stanley engerman." *The American Economic Review*, vol. 91, No. 2, pp. 12-17.

Barro, R. J. (2013). *Education and the economic growth.* https://www.oecd.org/education/innovation-education/1825455.pdf

Bashir, S., Herath, J and Gebremedhin, T. (2012). *An empirical analysis of higher education and economic growth in West Virginia*. Selected paper for presentation at Agricultural and Applied Economics Association Annual Meeting, August 12-14, Seattle, WA, USA.

Breton, Th. R. (2013). "The role of education in economic growth: theory, history and current returns". *Educational Research*, Vol. 55, no. 2, pp. 121-138.

Çani, E. M. Dhe Olldashi, E. (2020). *5 vjet nga reforma nw arsimin e lartw*. http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/16981.pdf

Dowrick, S. (2002). *The contribution of innovation and education to economic growth.* Presented in Melburne Institute Economic and Social Outlook Conference, April 4-5. http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.196.7596&rep=rep1&type=pdf

Hanushek, E. A. and Woßmann, (2007). *The role of education quality for economic growth.*

Hanushek, E. A. (2016). "Will more higher education improve economic growth". *Oxford Economic Review of Economic Policy*, Vol. 32, No. 4, pp. 538-552. http://hanushek.stanford.edu/sites/default/files/publications/Hanushek%202016%20Oxf%20Rev%20Econ%20Policy%2032%284%29.pdf

Hoareau, C. Ritzen, J. and Marconi, G. (2013). "Higher education and economic innovation, a comparison of European counties". *IZA Journal of European Labor Studies* 2, 24

Instituti i Statistikës. *Arsimi. http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/#tab2*

Instituti i Statistikës. *Shqipëria në shifra 2019.* http://instat.gov.al/media/6964/shqiperia_ne_shifra_2019_.pdf

Instituti i Statistikës. *Popullsia.* http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2

Instituti i Statistikës. *Punësimi dhe papunësia*. http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pun%C3%ABsimi-dhe-papun%C3%ABsia/#tab2

Këshilli i Ministrave. (2018). *Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore,* Vendim nr. 777, 26 dhjetor. https://www.fhf.edu.al/wp-

content/uploads/2019/01/P%C3%8BR-KONTROLLIN-ANTIPLAGJIATUR%C3%8B.pdf

Komisioni për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. (2014). *Raporti përfundimtar për reformën e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor*, korrik.

Kule, D. (2015). *Ndikimi i arsimit të lartë në rritjen ekonomike: Rasti i Shqipërisë*. Tezë Doktorature.

Grant, C. (2017). *The contribution of education to economic growth.* K4D Helpdesk Report. Brighton, UK: Institute of Development Studies.*https://assets.publishing.service.gov.uk/media/5b9b87f340f0b67896977bae/K4D_HDR_The_Contribution_of_Education_to_Economic_Growth_Final.pdf*

Gyimah-Brempong, K., Paddison, O. and Mitiku, W. (2006). "Higher education and economic growth in Africa". *The Journal of Development Studies*, Vol. 42, No. 3, pp. 509-529.

Ministria e Financa dhe dhe Ekonomisë dhe UN Women. (2020). *Buxheti 2020 për qytetarin.* https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/Buxheti-i-Qytetarit-2020.pdf

Monsaláz, J. M. P., Peralta, C., Serrano, L. & Soler, Á. (2018). "Higher education institutions, economic growth and GDP per capita in European Union countries". *European Planning Studies*, 26 (5):1-22.

Nunaj, T. (2016). *A kemi një model të ri ekonomik në Shqipëri?* 12 janar, http://gazetamapo.al/a-kemi-nje-model-te-ri-ekonomik-ne-shqiperi/

Nunaj, T. (2015). *Shqipëria dhe sindroma e vendit të vogël*, 26 prill. http://shekulli.com.al/shqiperia-dhe-sindroma-e-vendit-te-vogel/

Organisation for Economic Cooperation and Development [OECD]. (2007). *Education at a Glance 2007: OECD indicators*. https://www.oecd.org/education/skills-beyond-school/40701218.pdf

OECD (2011). *Higher education in regional and city development, Lombardy, Italy*.https://www.oecd.org/education/imhe/49001152.pdf

UNESCO (2012) UNESCO Global Monitoring Report. http://unesdoc.unesco.org/images/0021/002180/218003e.pdf

United National Educational, Scientific and Cultural Organisation [UNESCO]. (2010). *Education counts: Towards the Millennium Development Goals.* https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000190214.

The World Bank. (2017). *Higher Education for Development: An evaluation of the Word Bank Group's Support*. https://ieg.worldbankgroup.org/sites/default/files/Data/Evaluation/files/highereducation.pdf

The World Bank. (2020). *Government expenditure on education, total (% of GDP)*. September. https://data.worldbank.org/indicator/SE.XPD.TOTL.GD.ZS?most_recent_value_desc=false

The World Bank. (2021). *World Bank Country and Lending Groups: Country Classification.* https://datahelpdesk.worldbank.org/knowledgebase/articles/906519-world-bank-country-andlending-groups

Shtojcë

Tabela 1: Të regjistruar në arsim[2]

Nr.	Të regjistruarit në arsim	Vite shkollorë/akademikë (në numër)						
		2014-15	**2015-16**	**2016-17**	**2017-18**	**2018-19**	**2019-20**	**2020-21**
TOTAL		**748,488**	**704,779**	**677,818**	**652,592**	**641,161**	**612,534**	**584,616**
1	Në Kopshte	82,494	82,623	81,194	81,026	78,942	77,858	71,332
2	Në arsimin 9 vjeçar:							
	Në fillore	188,371	179,564	174,836	170,861	167,104	162,170	158,528
	Në ciklin e lartë të arsimit bazë	175,037	163,935	153,264	148,810	139,426	132,709	127,958
3	Në arsimin e mesëm:	140,042	130,380	127,114	120,062	116,646	109,533	103,001
	Gjimnaz dhe Social-Kulturor	117,241	108,956	106,133	99,457	95,359	89,869	83,977
	Profesional	22,801	21,424	20,981	20,605	21,289	19,664	19,024
4	**Në arsimin e lartë**	**162,544**	**148,277**	**141,410**	**131,833**	**139,043**	**130,264**	**123,797**

[2] http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/#tab2

Tabela 2: Të Diplomuar sipas niveleve arsimore

Nr.	Të Diplomuar në arsimin	Vite shkollorë/akademikë						
		2013-14	**2014-15**	**2015-16**	**2016-17**	**2017-18**	**2018-19**	**2019-20**
1	9 vjeçar	44,139	44,001	43,084	36,546	37,795	34,982	33,618
2	E mesëm:	35,254	39,629	38,583	36,436	35,278	34,021	31,662
3	vetëm Profesional	3,136	4,702	4,507	4,281	4,189	3,807	4,862
4	Arsimin e lartë gjithsej	29,301	33,654	31,865	35,388	34,331	34,891	32,889
5	vetëm Bachelor	17,469	19,152	18,652	20,423	20,108	18,696	17,585
Total të diplomuar		**108,694**	**117,284**	**113,532**	**108,370**	**107,404**	**103,894**	**98,169**

Tabela 3: Studentë në arsimin e lartë sipas fushave të studimit

Nr.	Fushat e studimit	Vite shkollorë/akademikë (në numër)[3]						
		2014-15	2015-16	2016-17	2017-18	2018-19	2019-20	2020-21
1	Shkenca arsimi	13,654	11,236	11,779	10,689	10,062	9,062	8,367
2	Arte dhe shkenca humane	17,588	17,095	17,278	15,441	14,348	12,537	10,972
3	Shkenca sociale, gazetari dhe informacion	10,462	13,073	10,004	12,259	14,086	11,397	10,277
4	Biznes, administrim dhe ligj	42,089	41,523	36,471	30,233	33,447	32,732	31,173
5	Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	10,473	6,719	7,816	6,325	7,060	5,962	4,924
6	Teknologji e Informacionit dhe komunikimit	9,560	8,260	7,487	8,228	10,016	8,883	8,341
7	Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	18,728	18,005	18,480	18,730	20,019	20,775	20,537
8	Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari	10,171	8,383	7,086	4,564	4,999	4,158	3,458
9	Shëndet dhe mirëqenie	22,780	21,550	20,900	19,837	20,727	20,199	21,195
10	Shërbime	5,022	2,433	2,306	3,088	4,279	4,559	4,553
11	Fushë e panjohur	2,017	0	0	0	0	0	0
TOTAL		**162,544**	**148,277**	**141,410**	**131,833**	**139,043**	**130,264**	**123,797**

[3] http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/#tab2

Tabela 4: Punëkërkues sipas nivelit arsimor[4]

Nr.	Punëkërkues të papunë të regjistruar	2015	2016	2017	2018	2019
1	Me arsim 8/9-vjeç	78,400	63,900	50,250	42,676	39,582
2	Me arsim të mesëm	59,001	47,187	34,260	27,102	26,062
3	Me arsim të lartë	11,747	8,623	5,270	4,908	5,286
TOTAL		**151163**	**121726**	**91797**	**76704**	**72949**

Tabela 5: Popullsia më 1 janar sipas grup-moshës dhe gjinisë[5]

Nr.	Grupmosha	Gjithsej 2016	Gjithsej 2017	Gjithsej 2018	Gjithsej 2019	Gjithsej 2020	Gjithsej 2021
1	**20-24**	256,899	254,172	247,137	236,982	226,425	218,787
2	**25-29**	224,705	230,218	234,063	237,378	237,607	235,197
3	**30-34**	184,936	189,712	194,459	197,702	200,941	208,052
Gjithsej		**666,540**	**674,102**	**675,659**	**672,062**	**664,973**	**662,036**

[4] http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/pun%C3%ABsimi-dhe-papun%C3%ABsia/#tab2
[5] http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/#tab2

PASURIMI IFJALORIT TË NXËNËSVE TË CIKLIT 9-VJEÇAR PËRMES TEKSTIT TË GJUHËS SHQIPE

Suela PATOSHI
Shkolla 9-vjeçare "Fiqiri Kurti"
suelapatoshi@yahoo.com

Abstract

Textbooks are filled with a variety of programs, which in addition to others bring unclean training by students both from the lexical as well as didactical.Understanding the information they convey is vague.To talk about old concepts seem unmotivating to us because today we need to know as much about vocabulary.

Our main goal has to do with the identification of the role and importance of the formulation of the habit of speaking and the first writing in the vocabulary of the text of the “Gjuha amtare” (homework, class work, writing etc), in accordance with the recognition, deepening and awareness also in accordance with the features of mental development, psychological for the linguistic part of this age group.

Keywords **-** *textbooks, lexicon, vocabulary enrichment, student, mental development*

Abstrakt

Tekstet shkollore janë të mbushura me një mori programesh, ku përveç te tjerave sjellin formim jo të pastër nga ana e nxënësve si nga ana leksikore ashtu dhe didaktike.

Kuptimi i informacionit që ato përcjellin është i vakët. Të flasësh për koncepte të vjetra na duket e pamotivueshme sepse sot ne na duhet të njohim sa më shumë për pasurimin e fjalorit.

Qëllimi ynë kryesor ka të bëjë me evidentimin e rolit dhe rëndësinë e formulimit të shprehisë së të folurit e të shkruarit e parë në pjesën e leksikut në tekstin e “Gjuha amtare”, (detyra shtëpie,klase, punë me

shkrim dhe ese etj) në përputhje me njohjen, thellimin dhe ndërgjegjësimin për pasurimin e fjalorit të nxënësve, gjithashtu dhe në përputhje me veçoritë e zhvillimit mendor,psikologjik për pjesën gjuhësore të kësaj grupmoshe.

Fjalët kyçe *–tekste shkollore, leksik, pasurim i fjalorit,nxënës, zhvillim mendor*

Qëllimi i studimit dhe metodologjia e përdorur

Mbështetur në përvojën e deritanishme me të drejtë shtrohet pyetja: Sa e përgatitur është shkolla jonë për të ecur më tej në proceset integruese, cilat janë problemet, nevojat dhe mundësitë në këtë fushë? Cili është formimi gjuhësor i gjuhës së nxënësve;po roli i leksikut në tekstet e gjuhës amtare?Jo vetëm specifikimi i saktë i objektit të studimit por edhe inkuadrimi i tij në një kontekst më të gjerë është i domosdoshëm të marrë natyrën e inkuadrimit në nje kontekst episteologjik funksional.Në mendimin tonë gjuhësor dhe psikologjik rreth këtij objekti të specifikuar sipas parametrave aktual të psikolinguistikës janë në fillimet e tyre.Edhe në rrafsh evropian, problemi i formimit gjuhësor të fëmijëve,deri në vitet `60 të shekullit XX,përgjithësisht,është trajtuar në punimet të natyrës përshkruese.Pranohen që janë pikërisht teorit e Çomskit dhe gramatika gjenerative që kanë filluar më drejt përdrejt të përligjin për gjuhëtarët studimin teorik të përvetsimit dhe zhvillimit të gjuhës,megjithëse edhe vetë modeli çomskian ishte një model përshktimi dhe jo një model përvetësimi.

*Noam Chomsky,psikolinguistnga Instituti i Teknologjisë në Masaçuset,më 1957 zhvilloi dhe përpunoi një teori të quajtur``teoria transformuese e gjuhës``.Në këtë teori ai e konsideron semantikën e gjuhës më të rëndësishme se gramatika.Çomski e rishikoi teorinë e tijmë 1965 dhe arriti në përfundimin se vetëm njerëzit janë të aftë të mësojnë gjuhën gjuhën,majmunët jo.****Gjuha,thoshte ai,është pasqyra e mendjes.***[1]

---

[1].Musai.B.``*Psikologji edukimi,zhvillimi,të nxënët,mësimdhënia*``PEGI,TIRANË 1999,fq 57.

Studimet në fushën e psikolinguistikës përformimin gjuhësor të fëmijëve në grupmosha të caktuara karakterizohen nga dy prirje të përvijuara tashmë:

- *Studimet ku përparsi marrin dukuritë dhe treguesit psikologjik(p.sh.studimet e C.George,J.F.Richard,etj.).*
- *Studimet ku peshën kryesore e mban aspekti gjuhësor.*

Këto tipe të ndryshme këndvështrimesh kanë mundësuar shumë hulumtime me lidhje me zhvillimin ndërgjegjes gjuhësore tek fëmijët.

Ideja e përbashkët në çdo rast është:

- Të mësosh të flasësh dhe të kuptosh.
- Të mësosh mirë leksikun dhe strukurën gramatikore.
- Të mësosh tipet e ndryshme të lidhjes së thënies,shprehjes në dialog apo monolog.
- Të dish të përgjigjesh,të tregosh,të argumentosh,të krahasosh.[2]

Në këndështrimet e sotme të psikolinguistikës objekti i gjuhësisë është të studiojë ndryshimet.Studime psikolingustike që kanë të bëjnë me ligjërimin e fëmijës,**një vend qëndror i lënë problematikës që kanë të bëjnë me aspektet leksikore,kuptimore,semantike.**Në lidhje me këtë prirje thekson François thekson :*të analizosh gjuhën ,do të thotë të analizosh,sipas terminologjis së Hollidej,një potencialitet të kuptimit. Të analizosh aktet gjuhësore,ligjërimin,do të thotë të studiosh kuptimin aktual të mesazheve në funksion të lidhjeve të tyre jashtë gjuhësore,me atë çka është thënë apo me atë çka synohet të thuhet ,në një kontekst të ngushtë apo në një kontekst më të gjerë*.[3]

Në përcaktimin e konceptit me të cilin po operojnë,ne marrim në konsideratë,mes të tjerash këto përkufizime:**``Leksiku,*në kuptimin e tij të përgjithsëm mud të përcaktohetsi tërësia e fjalëve nëpërdorimin e njëgjuhe*.**

---

[2].F.François ``Conduites linguistique chez le jeune enfant``PUF,

[3].F.François,vep.e cit.,47

Në një kuptim më të ngshtë,ai është i përbërë i vetë leksemave.[4]Për disa gjuhtarë kompetenca e subjektit folës përfshin përbërës leksikor,të cilat përshkruhen nga disa psikolinguistë me termin e leksikut mental.

Leksiku mental do të përkufizohej:``*një kujtesë në kuptimin e gjërë të termit,në të cilën është vendosur tërësia e informacioneve që një folë zotëron mbi fjalët e gjuhës së tij.Në çdo fjalë (ose morfermë) janë të bashkëshoqëruar një kod fonologjik dhe një kod grafemik,si dhe të gjitha informacionet mbi pasuritë semantike e sintaksore që i përkasin përdorimin e kësaj fjale.Mënya me të cilën janë organizuar elementet e leksikut mental,nxjerr në pah treguesit mbi kujtesën semantike.*``[5]

Veçoritë e zhvillimit gjuhësor e psikik të fëmijëve psikologjike te të menduarit të kësaj moshe,mjedisi me cilin jeton e formohet gjuhësisht fëmija,parapëlqimet,interesat,etj,duke u nisur me këto tregues,mendojmë se,në përcaktimin e leksikut të disa teksteve ,është e nevojshme të mbahen parasysh:

1. *Sasia e përgjithshme e fjalëve të secilit tekst.*
2. *Pasuria kuptimore e këtyre fjalëve.*
3. *Lidhjet kuptimore të tyre(sinonimet,antonimet etj)*
4. *Marrëdhëniet që krijohen midis fjalëve të së njejtës klasë a grup leksiko-gramat*
5. *Tipet fjalëformues.*
6. *Denduria e përdorimit të fjalëve në tekste.*
7. *Vendi i fjalës me ngjyrim emocionues*

 Ç`probleme dhe ç'të dhëna dalin nga ky shqyrtim?

Së pari numri i përgjithshëm i fjalëve të çdo teksti shkon nga 1400 në 2600 njësi leksikore,pa përfshirë mjetet fjalëformuese i,e ,të,së,dhe pjesëza do.të,u,po,etj…por duke numëruar dhe tingullimitimet.

4.Zogar,Dictionnaire de Psychologie,PUF 1991,fq.402;dhe Larausse ``Dictionnaire de la psycologie``´,N.Sillamy,1995.

5.Zogar,vep.e cituar,fq 403 dhe N-sillamy,vep.e cit.

- Kriteri se cilat fjalë do të përfshijë teksti,nuk është as i vetmi, madje as i pari.Gjatë përzgjedhjes së materialit,kujdesi për përmbajtjen gjuhësore dhe larminë leksikore të tekstit duhet të mbahet gjithnjë parasysh.Edhe ky kriter duhet të orientojë zgjedhjen e materialit.

- **Së dyti,në këto tekste fjalët përdoren kryesisht me kuptimin leksikor kryesor dhe herë herë me kuptime të tjera.**Prirja,që një pjesë e mirë e fjalëve,dhe sidomos ato të fundit aktiv,të paraqiten në mënyrë sa më të plotë kuptimisht,duhet të spikatë,sidomos në tekstet e leximit dhe të gjuhës shqipe.

- **Së treti,me rëndësi është veçanërisht përdorimi i sinonimeve, që dallojnë nga nuance kuptimore dhe njyrimi stilistik-emocionues**.Për të pasqyruar lidhjet kuptimore të fjalëve, në këto tekste duhet punuar më mirë.

- **Së katërti,vërehet vendosja e një përpjestimi të caktuar në përdorimin e emrave konkret,abstrakt,përmbledhës e të lendëse të lëndës të mbiemrave cilësues drejtpërdrejt e të ndërmjetuar.**

- **Së pesti,në këto tekste pjesën më të madhe të leksikut e zënë fjalët e parme dhe të prejardhurat me prapashtesim,**por ka dhe mjaft fjalë të përngjitura, të përbëra ose të krijuara me parashtesa.Kjo gjendje është e motivueshme.

- **Së gjashti,**duke shqyrtuar dendurinë e përdorimit të fjalëve,në këtë tekste del se në tekste e ``Gjuha shqipe 8,9``**njësitë e kuptimshme ,**kanë denduri më të madhe përdorimi se në tekstet e tjera.

- **Së shtati,ngjyrimi emocionues nuk mund të ndahet nga kuptimi leksikor.Këta tregues leksikor krijojnë një hierarki të caktuar vlerash gjuhësore.**

Gjithsesi,kujdesi dhe përpunimi i tekstet shkollore jo vetëm në rrafshin leksikor,përbën domosdoshmëri,pasi në këto tekste nxënësi,më mirë se në çdo realitet tjetër gjuhësor,me të cilin është në kontakt mund të gjejë vlerat e mirëfillta positive dhe gjedhet funksionale leksikore, stilistike,ligjërimore dhe komunikative

Pasurimi i fjalorit të nxënësve,fjalori aktiv dhe pasiv

Pasurimi i fjalorit të nxënësve dhe njohja e tyre me semantikën e fjalëve që ai duhet t'i bëjë pronë të fjalorit aktiv,varet nga disa kushte të caktuara gjuhësore të cilat lidhen ngushtë edhe me disa kushte të tjera të natyrës psikopedagogjike.

Përvetësimi i fjalëve të reja dhe njohja me kuptimet e sakta të tyre është një nga rrugët më të rëndësishme të zhvillimit të të folurit të fëmijëve dhe të zotërimit të gjuhës amtare si mjet i marrëveshjes shoqërore.Prandaj pasurimi i fjalorit të nxënësve është një veprimtari mësimore,e cila shtrihet në këtë proçesin mësimor që përbën dhe kërkon që t'i kushtohet vëmendje e madhe ,ndërkoh që përfshin tërë veprimtarinë në shkollë e jashtëshkolle (leximi i librave i gazetave,shikimi i filmave ,i televizorit dëgjimi i radios etj)dhe shtrihet deri në orët e çdo lënde mësimore.

Kur themi që ``nxënësi mëson në shkollë gjuhën amtare ``,nuk kemi parasysh një nxënës të huaj por nxënësin shqiptar,i cili e di gjuhën amtare në një nivel të caktuar dhe në mënyrë praktike,njeh 3-4mijë fjalë,strukturat kryesore,ndërtimin gramatikor e shumë elemente të tjera,që i ka fituar deri në moshën 6-7 vjeç. Mbi këtë bazë shkolla bën normalizimin e këtij bagazhi (shmang elemente dialektore,të gabuara etj),i mëson nxënësit nocionet themelore për gjuhën si system dhe ia pasuron ligjërimin me mjete leksikore,frazeologjike,semantike,sintaksore stilistike ende të panjohura për të.Përsa i përket pasurimit të fjalorit të nxënësit duhet thënë se deri tani ka qenë ana më e dobët e punës së

shkollës në mësimin e gjuhës amtare. Prandaj puna pë pasurimin e fjalorit të nxënësve në shkollë duhet të trajtohet si drejtim i veçantë e shumë i rëndësishëm.Kjo punë nuk duhet parë vetëm si përvetësim i një shume mekanike fjalësh të rastit.Fjalët e reja duhen mësuar në tekste e kontekste ligjërimore,më pas mund të punohet me semantikën e tyre(për njohjen e kuptimeve të parme a të prejardhura)dhe për ngjyresat e veçanta.[6]

Në shkollë proçesi i pasurimit të fjalorit të nxënësve realizohet në mënyrë të programuar.Çdo lëndë u jep fëmijëve mundësi të zotërojnë leksikun dhe frazeologjinë aktive në tërë stilet e gjuhës (letrar,shoqëror,politik,shkencor)sipas lëndëve.Por rol të veçantë në pasurimin e fjalorit të nxënësve luan vetë mësimi i gjuhës shqipe si lëndë mësimore,përmes së cilës kalon tërë puna për njohjen e përdorimin e fjalëve;një punë që përqendrohet në grupet e ndryshme leksiko-semantike.

1)*Njohja e fëmijëve lidhet me semantikën e fjalës.*

2)*Zhvillimi gjuhësorë i fëmijëve për tì përdorur fjalët në varësi nga tipat dhe stilet e të folurit.*

3*)Dallimi dhe veçimi shkallë-shkallë (nga fondi i fjalorit të nxënësve)i fjalëve dialektore nga fjalët e thjeshtëligjërimit,duke i vënë në barazvlerë me fjalët e gjuhës standarde,për të rritur te nxënësit kultureën e të folurit.*

Përvoja tregon që sot theksi duhet vënë më shumë në tri drejtime kryesore që janë: Rëndësi të veçantë merr përmbajtja e punës për pasurimin e fjalorit të nxënësve në mësimin e gjuhës shqipe.Sistemi i leksikut të gjuhës ndryshon nga sistemet e tjera(fonetik,gramatikor),*së pari*,ngapafundësia e njësive të tij;*së dyti*,nga ndryshimet e mëdha në lidhje me semantikën,fjalëformimin e përdorimin stilistik të fjalëve.

Të dhënat e kohëve të fundit[7]e quajnë si të domosdoshme që për të realizuar të folurit normal,nxënësi duhet të zotërojë afërsisht 3000(për

---

[6.]J:Thomai,M.Samara,A.Sinani;``*Gjuha dhe letërsia në shkollë*``,1988.

[7.]Psikologjia moshore,1987.vep.e cit....``Didaktika e gjuhës shqipe``..fq,109

moshat e vogla shkollore) njësi leksikore emërtuese. Por kjo e dhënë nuk do të thotë që fëmijët të aftësohen për të zotëruar vetëm një fond të tillë fjalori. Është detyrë e shkollës që këtë fond ta zgjerojnë sa më shumë .Zotërimi i një leksiku të tillë realizohet edhe gjatë rrjedhës së jetës së njeriut.

Vendi që zë fjalori në programet mësimore të klasës së nëntë, kushtet gjuhësore dhe psikopedagogjike

Pasurimi i fjalorit të nxënësve dhe njohja e tyre me semantikën e fjalëve që ai duhet t'i bëjë pronë të fjalorit aktiv,varet nga disa kushte të caktuara gjuhësore të cilat lidhen ngushtë edhe me disa kushte të tjera të natyrës psikopedagogjike.Kur flasim për njohjen e nxënësve me semantikën e fjalës, kemi parasysh njohjen me kuptimet e fjalës, me fjalët shumëkuptimore,me ngjyresat emocionuese dhe shprehëse që përmban fjala në vetvete, me vlerat stilistike,me sinonimet dhe antonimet e saj,me vetitë e fjalës, me gjininë ose llojin ku bën pjesë. Gjithashtu është e domosdoshme që nxënësit të njihen me strukturën e fjalës,me temën fjalëformuese e ndajshtesat, me sferën e përdorimit, me rolin e saj në fjali etj...Sot kjo realizohet në programe dhe në tekste nëpërmjet njohurive që janë futur në leksikologjinë, fjalëformimin, stilistikën, sintaksën, etj..dhe që janë njohuri të domosdoshme për pasurimin e fjalorit të nxënësve dhe zhvillimin e të folurit.

Një rol të veçantë në përvetësimin e kuptimit të fjalëve luan konteksti në të cilin përdoret ajo.Konteksti e bën më të kapshëm kuptimin e fjalës, pasi ajo shfaqet aty sipas një stili të caktuar shkallë-shkallë,sipas moshës e klasave, grupohen edhe lidhjet leksiko-sintaksore të fjalëve të fjalëve(leksematika),kur realizohen kuptimet e ngjyrimet e ndryshme.

Këto ndihmojnë për të kapur më lehtë çdo kuptim,psh:a*)gryka e njeriut;më dhemb gryka;më mbeti në grykë;b)gryka e pushkës;gryka e shishes;e mbushi deri në grykë;etj...c)gryka e malit;hymë në një grykë etj.*

Zbulimi i leksematikës së plotë për çdo kuptim e njeh nxënësin edhe me lidhjet më të drejta sintaksore, me gjërësinë e përdorimit të fjalës të kuptimeve të ndryshme.

Për këtë në program duhet të qartësohen ato njohuri të domosdoshme,të cilat ndihmojnë për motivimin e kuptimit të fjalëve,për konkretizimin e tyre,për zbulimin e lidhjeve logjike dhe përdorimin e saktë në fjali.

Duhet thënë se në këto klasa mund të jepen njohuri në një nivel më të lartë për nxënësin.Krahas këtyre,dhënia e kuptimeve të fjalës duhet të mbështetet në pasurinë e koncepteve e të përfytyrimeve të nxënësve,pas të cilave fshihen njohuri për botën.Kjo njohje lidhet me korrelacionet që vendos fjala më realen.

Gjithashtu për pasurimin e fjalorit të nxënësve dhe njohjen e tyre me kuptimet e fjalëve,kanë rëndësi të veçantë edhe lidhjet ndërlëndore,si dhe zhvillimi i vetëveprimit për të fituar njohuri të ndryshme.Për t‘ì zhvilluar këto aftësi është e rëndësishme që të njihen e të vlerësohen disa kushte si:

-zgjerimi i njohurive për botën;

-njëhsimi i kërkesave për punën me fjalorin nga mësuesit nga të gjitha lëndët mësimore;

-tërheqja e vëmendjes për fjalët e panjohura;

-aftësimi i nxënësve për të përdorur fjalorin etj.

Realizimi i këtyre kërkesave në mësimin e gjuhës shqipe,por edhe në lëndët e tjera,kërkon që të tërhiqet vëmendja e nxënësve në fjalët e panjohura,si dhe të punohet për shpjegimin e fjalëve të panjohura.

Njësimi i kërkesave për punën me fjalorin siguron një të folur të njejtë në shkollë.Zgjerimi i njohurive për botën, sipas disa temave,i nevojitet jo rradhë edhe mësuesit,sidomos kur kjo punë lidhet me shpjegimin e grupeve të mëdha leksiko-semantike të fjalëve. Për këtë mësuesi mund të përdorë formë të ndryshme pune si:shfrytëzim literature, fjalorësh enciklopedikë, fjalorësh tematikë; ekskursione më nxënësit(kjo formë pune mund të shfrytzohet kryesisht në klasat e ulëta të shkollës nëntë vjeçare). Këto forma sigurojnë mundësi për tù ngulitur nxënësve në mendje fjalën me vlerat e saj. Një rol vendimtar në këtë mes luan krahas lëndëve të tjera mësimi i gjuhës amtare. Puna për përdorimin e fjalorit në

tërësi ka rëndësi për përvetësimin e fjalës si njësi leksikore.Në shkollën tonë puna me fjalorin nuk është kthyer ende në një formë efikase;kjo lidhet me punën e pamjaftueshme që bëhet nga mësuesit e ndryshëm .Në kushtet e sotme është detyrë e shkollës që nxënësit të pajisen me fjalor shkollor të domosdoshëm për punën e tyre të përditshme mësimore dhe për të gjitha lëndët.Ky mjet ka të njejtën vlerë që ka çdo tekst mësimor.

Puna me fjalorin është e domosdoshme,veçanërisht gjatë mësimdhënies në orët e leximit /letërsisë,pasi vihet re që gjatë punës me tekste të veçanta duket sikur nxënësit i njohin kuptimet e fjalëve që lexojnë,por,në të vërtetë po t'ì pyesësh se çfarë kuptimi ka kjo apo ajo fjalë ,si dhe ç`kuptojnë me atë shprehje,ata nuk përgjigjen dot;u mungon aftësia për të vënë në punë mjetet e shprehjes prandaj në rast se nuk do të punohet në veçanti me kuptimin e fjalës shkolla jonë gjithmonë do të vuajë nga kjo mungesë si në mësimin e gjuhës shqipe ashtu dhe në të gjitha lëndët e tjera.

Metodat e pasurimit të fjalorit të nxënësve dhe organizimi i punës për pasurimin e fjalorit të tyre.

Përmbajtja e punës për pasurimin e fjalorit të nxënësve në shkollë në kohën e sotme mbështetet në forma,në forma,të tilla si:

- Diskutime me tematikë të caktuar,përmes.të cilave nxënësi,në mënyrë sa më origjinale,e përvetëson fjalorin e një fushe të caktuar që lidhet me veprintarinë dhe përjetimet e tij të përditshme.Ky kriter është zbatuar në tekstin e ri të gjuhës shqipe për klasën e dytë.Mbi këtë bazë,nxënësit zhvillojnë të folurit e pasurojnë fjalorin e tyre.
- Paraqitja e tekstit është një tjetër moment,në të cilin mund të mbështetet puna për pasurimin e fjalorit të nxënësit.Duke i njohur nxënësit me një tekst të caktuar ,i cili përmban subjekte të zgjedhura,nxënësit njihen me një fjalor të caktuar, të cilin u kërkohet ta riprodhojnë nëpërmjet tregimit të tekstit të dhënë.Kjo formë pune mund të praktikohet më shumë në orët e leximit letrar,por pa përjashtuar edhe orët e gjuhës shqipe.

- Ushtrimet leksikore janë formë e rëndësishme për pasurimin e fjalorit të nxënësve.Këto ushtrime realizohen nëpërmjet njohjes dhe të ushtruarit të nxënësve me dukuritë- bazë leksikore,siç janë kuptimet e fjalëve, sinonimia, antonimia, semantika e fjalëve, frazeologjia etj.Ka rëndësi të kuptohet drejt që ushtrimet leksikore për nxënësit nuk duhen trajtuar si ushtrime që do të zhvillohen në kohë të caktuara të orës së mësimit.Krahas kërkesave që mund të kenë tekstet,është e rëndësishme që mësuesit dhe nxënësit të punojnë me to në çdo moment,kur janë të mundshme dhe kur shfaqen.

Duke u mbështetur në këto drejtime mund të punohet për përsosjen e punës për përvetësimin e semantikës së fjalës dhe përdorimin e saj në të folur.Por kjo punë varet nga zgjedhja dhe larmia tematike,si dhe nga mënyra e të shkruarit pavarësisht nga stili i zgjedhur në to(letrar,publiçist,apo shkencor).

Për zgjedhjen e fjalëve mund të përdoren dy kritere:

Kriteri gramatikor-drejtshkrimor: sipas këtij kriteri,në fillim fjalët analizohen nga pikpamja gramatikore e drejtshkrimore,pastaj zgjidhen dhe u paraqiten nxënësve për të përvetësuar,bashkë me kutimin dhe formën e tyre,sipas mundësive dhe aftësive perceptuese të secilit.

Kriteri semantik*:*ky kriter zbulon afritë tematike që duhet të kemi parasysh për zgjedhjen e fjalëve.Të dy kriteret e mësipërme lidhen me formën dhe përmbajtjen e fjalëve.Të këtij kriteri janë një sërë përfaqësuesish të shkollës rusesi:Ribnikova,Barxun,Dobromisllov,Betrov etj....të cilët mbrojnë mendimin e grupimeve leksiko-semantike.Këtë drejtim e ndjekin dhe zbatojnë në tekstet e gjuhës amtare edhe shkolla të tjera,si shkolla austriake,franceze,italiane,rumune etj...[10]Minimumi i fjalëve për çdo grup kuptimor a tematik mund të jetë një kufi i domosdoshëm për fjalët që duhet të zotërojnë nxënësit në një fushë të caktuar tematike.Zgjedhja dhe përcaktimi i grupeve leksiko-tematike të fjalëve duhet të kalojë përmes kritereve të ndryshme.Ky kriter mund të realizohet psh.në këtë grup leksiko-semantik të mbiemrave:

- Mbiemra që tregojnë cilësi,ndjenja,shenja të veçanta:i shkathët,i shpejtë,i duruar,besnik,i guximshëm,i dashur etj.
- Mbiemra që tregojnë kohë,vend,hapësirë:i përjavshëm,i përkohshëm,i përvitshëm;
- Mbiemra që tregojnë formën e përmasën e sendeve:i madh,i vogël,i gjatë,i shkurtër..etj...

Kriteri i mësipërm mund të përcaktohet edhe për klasifikimin e foljeve në grupe leksiko-semantike,të tilla si:foljet e mendimit,të lëvizjes, të veprimit, të qendrimit etj
(mendoj,hartoj,gjykoj,arsyetoj,godas,çoj,lexoj,ulem,qëndroj,pres,etj.)
Grupime tematike leksiko semantike mund të përbëhen edhe prej *mikrosistemesh* të ndryshme njësish leksikore.kështu;

-këto *mikrosisteme mund të jenë të mbyllura*,psh;emërtimi i muajve të vitit i ditëve të javës,ngjyrat e ylberit etj....(janar ,shkurt,.....dhjetor; e hënë , e martë ;...)

-mund të jenë edhe *mikrosisteme të hapura* në grupimet leksiko semantike të fjalëve si:foljet e lëvizjes,emrat e banorëve sipas emrit të banimit,emrat e vepruesit.

Përcaktimi i fjalëve në lidhje të njëjta leksiko-semantike duhet bërë shkallë-shkallë dhe kjo shtrihet në tërë punën që bëhet në shkollë për pasuriminfjalorit te nxënësve dhe zhvillimin e të folurit.Gjithashtu duhet trajtuar në përshtatje me tematikën e tërë punës që bëhet në shkollë përmësimin e gjuhës shqipe sipas aftësive përvetësuese të moshës së nxënësve.Është e domosdoshme që në program të thellohet puna me këto grupe ,kurse në tekst të pasqyrohen nëpërmjet ushtrimesh që nxënësit i kryejnë në mënyrë të pavarur.

---

[10].K.Safir,``*Gjuha,hyrje në shkencën e ligjërimit*``,1984

- ***Mbi organizimin e punës për pasurimin e fjalorit të nxënësve.***

Fëmijët janë në gjendje të bëjnë lidhjen e fjalës me botën e jashtme,lidhjen e fjalës me grupin e fjalëve të afërta nga kuptimi e nga formimi etj.Këto aftësi të nxënësve duhen shfrytëzuar mirë.

Lidhur me veçoritë e fjalës do të dallojmë disa kritere a kushte ,të cilat ndihmojnë në punën për pasurimin e fjalorit të nxënësve.

- ***Së pari,*** *përcaktimi i korrelacionit të fjalës me realen(me sendin ose vizatimin e tij).*Ky kusht ka të bëjë me zbatimin e parimit të konkretizimit siç quhet në didaktikë ,dhe është karakteristikë për punën me fjalorin në klasat e ulëta.Ky kriter mund të quhet ndryshe edhe kriteri jashtëgjuhësorë.
- ***Së dyti,***të vëzhguarit e fjalës në gjininë e llojin e vet(në familjen e fjalëve ku hyn ajo).Këtu do të përfshimë:gjëndjen e vetë fjalës,lidhjen e saj sinonimike e antonimike,si dhe strukturën fjalëformuese e semantike në lidhje me fjalën mëmë.Këtë kriter gjuhësia bashkohore e quan ndryshe edhe *kriteri paradigmatik*[11].
- ***Së treti,****paraqitja e fjalës në mes të grupit të fjalëve të tjera dhe përcaktimi i lidhjeve lineare në mes tyre.*Vetëm duke e kapur fjalën në kontekstet ku ajo mund të përdoret lehtësohet mjaft puna për përvetësimin e kuptimit të saj.Futja e njohurive nga lënda e sintaksës që në klasët e ulëta mundëson sot realizimin e zbatimit praktik të këtij buxheti.
- Marrja e njohurive në këtë fushë për tekstin e fjalinë,për grupin e fjalëve etj;që në klasën e dytë,do të ndihmojë për punën me fjalorin dhe përvetësimin e kuptimeve të fjalëve brënda grupeve ku ato hyjnë.Ky kriter mund të quhet ndryshe *edhe kriteri sintagmatik.*

- ***Së katërti****,përdorimi i fjalëve në stilet e ligjërime të veçanta.*Puna në këtë drejtim mund të fillojë pasi nxënësit të jenë njohur e të jenë ushtruar me lidhjet që krijon fjala,si ato sinonimike,antonimike,etj;Pra nga klasa e katërt e lart.

---

[11].*Petro,R;Çerpja A;Metani,I;``Gjuha Shqipe 9``*Albas,Tiranë 2010,fq.10

Së pesti *përfshirja e fjalës në kontekste fjalish e tekste të lidhura.*Kjo punë është specifike gjatë realizimit të ritregimeve a të përmbledhjeve gjatë hartimeve etj.

Për ta realizuar këtë punë me sukses është mirë që nxënësit ta kenë bërë më parë fjalën pronë të fjalorit të tyre aktiv,më pas të vendosin në struktura të ndryshme togfjalëshash a fjalish.

Vështrim teorik bazuar në teoritë gjuhësore

- ***Pasurimi I fjalorit të nxënësve me sinonime e antonime të ndryshme***

Sinonimet,fjalë të ndryshme me kuptim të njejtë a të afërt,përbëjnë një klasë të pasur në gjuhën shqipe.Sikurse dhe polisemia,sinonimia është shprehje e thellimit të njohjes njerëuore,që synon të zbulojë gjithnjë anë të reja të sendeve,të dukurive etj…

Kur studiohen sinonimet, duhen vështruar jo vetëm kuptimi leksikor por edhe *ngjyrimi stilistik emocional shtrirja e gjërësia e përdorimit të fjalëve aftësia e tyre për të formuar fjalë të reja ose për t'u lidhur me fjalë të tjera etj pra duhet parë jo vetëm çka i afron fjalët por edhe çka i dallon ato.*Sinonimet ndërmjet tyre mund të dallohen :

a) ***Nga nuanca kuptimore;*** *psh ; shikoj- vështroj-vërej etj,kallzoj-tregoj-them;mendim-opinion;ndëshkoj-gjuaj-shtyj;vajtoj-qaj;iki-shkoj-largohem;fus-ngarkoj-mbledh*[12]
b) ***Nga ngjyrimi stilistik-emocional*** *psh mësues-dhaskal,fëmijë-kalama;fytyrë-surrat;tregti-pazarllëk;*[14] *shënojnë të njëjtën vetë,*
c) ***Nga aftësia për të krijuar fjalë të reja*** *dhe për t'u lidhur me fjalë të reja ose në njësi frazeologjike;*psh të tjera fjalë formon fjala kokë dhe me të tjera fjalë lidhet ajo psh: (kokëderr, kokëmish).

Gjithashtu, sinonimet dallohen edhe se *nuk kanë të njejtën gjërësi e denduri përdorimi* në masën e folësve;në shtresat shoqërore,në ligjërimet e stilet,një fjalë përdoret më shumë,sinonimi i saj më pak,ose një sinonim mund të përdoret në një stil kurse tjetri në njëstil

tjetër.*psh.koshiencë-ndërgjegje-vetëdije;dele-dhi, ku më shumë përdoret fjala ndërgjegje*[13]

Njohja dhe studimi i sinonimeve në gjuhën shqipe kanë rëndësi për dy arsye:

- ***Së pari,*** sinonimet janë një mjet shumë i fuqishëm,sidomos në letërsinë artistike,për të tipizuar më mirë vetat,rrethanat dhe mjediset.
- ***Së dyti,***sinonimet përdoren si një nga mjetet më të mira për pasurimin e fjalorit të nxënësve gjatë punës me gjuhën në shkollë.

Vëzhgime në tekstet e gjuhës amtare në lidhje me problemin e fjalorit,sa e sjellin tekstet pasurimin e tij

Ngjyrimi emocional i jep fjalës aftësinë që të shpreh qëndrimin e folësit për çka flitet,si e vlerëson ai këtë(me dashuri,me përkëdhelje,me admirim,me tallje,me përbuzje,etj.)

Dallojmë dy lloj ngjyrimesh:

- *Ngjyrim emocional pozitiv* (dashuri,admirim,gëzim,entusiazëm,kënaqësi,miratim,përkëdhelje,mahnitje etj.)
- *ngjyrim emocional negativ* (urrejtje,përbuzje,zemërim,neveri,tallje,ironi,hidhërim,dëshpërim,pikëllim,etj.)

Duke e ndarë në dy pjesë leksikun e shqipes arrijmë të shquajmë edhe një kundërvënie ndërmjet fjalëvë asnjanëse dhe fjalëve me ngjyrim emocional.Mund të themi se dallimi i këtyre shtresave të fjalëve duhet bërë gjatë studimit të përmbajtjes së fjalëve.

---

[12].shih:Thomai.J;``*Leksikologjia e Gjuhës shqipe*``Tiranë,1984;*vep.e cit.…fq.84.*

[13]Ballhysa.A;Jashari.A,``*Formim gjuhësor*``,Tiranë.2002.cit...fq.102.

[14].R.Petro,N.Pepivani,Sh.Vreto,A.Çerpja,``***Gjuha shqipe 9``,***Botimet Albas ,Tiranë 2013

Duke e ndarë në dy pjesë leksikun e shqipes arrijmë të shquajmë edhe një kundërvënie ndërmjet fjalëvë asnjanëse dhe fjalëve me ngjyrim emocional.Mund të themi se dallimi i këtyre shtresave të fjalëve duhet bërë gjatë studimit të përmbajtjes së fjalëve.

Llojet e fjalorëve gjuhësorë

Fjalori është njëvepër shkencore që përmban një numër fjalësh me shpjegime për kuptimet e tyre.Ai është një mjet i pazëvendësueshëm pune që na ndihmon për të njohur e për të përdorur leksikun e gjuhës.

Fjalorët gjuhësorë janë të tipave të ndryshëm. Nga mënyra se si jepet përmbajtja e fjalëve,fjalori mund të jetë shpjegues, dygjuhësh ose shumëgjuhësh.Nga shkalla e pasqyrimit të shtresave të leksikut fjalori mund të jetë **i vogël,i mesëm ose i madh.**

Nga lënda që përmban mund të jetë **i përgjithshëm,kombëtar,dialektor,frazeologjik,terminologjik,sinonimik,drejtshkrimor,i një shkrimtari të veçantë**etj.

Në fjalorët shpjegues fjalët e një gjuhe jepen me fjalë të po asaj gjuhe,me shpjegime pak a shumë të gjëra e me sinonimi.

Fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe

a)Vepra e parë e madhe në fushën e fjalorëve shpjegues kombetarëështë ``**Fjalori i gjuhës shqipe**´´i vitit 1954.Fjalori është i tipit të vogël dhe ka rreth 25000 fjalë.

b)Ndërsa i pari fjalor shpejgues kombeëtar i tipit të mesëm është``**Fjalori I gjuhës së sotme shqipe´´(1980)**me rreth 41000 fjalë,afro 7000 njësi frazeologjike e me mbi 180000 kuptime

c)´´**Fjalori i shqipes së sotme´´(1984)** me rreth 34000 fjalë u hartua i mbështetur kryesisht te ´´Fjalori i gjuhës së sotme shqipe´´.Ky fjalor u ripunua dhe u ribotua në vitin 2002 me të njëjtin titull,duke sjellë fjalë dhe shrehje të reja

ç)``**Fjalori i gjuhës shqipe``(2006),**ka rreth 48000 fjalë**.**Ky fjalor ruan dhe pasuron vlerat e gjithë fjalorëve të mëparshëm dhe ka një numër më të madh fjalësh se ata.

Rezultatet e studimit.

Në trajtimin e teorive dhe koncepteve bazë është pasur si qëllim realizimi i tri synimeve kryesore:

*Së pari,*trajtimi i të gjitha çështjeve të bëhet në një këndvështrim të thellë psikologjik,duke pasur parasysh që një qëndrim i tillë i koncepteve të mësimdhënies dhe të nxënit ka munguar deri tani dhe të krijohet kështu një bazë e qëndrueshme për zhvillimin në të ardhmen të një metodologjie të përgjithshme të mësimdhënies dhe të të nxënit,gjithashtu duke sjelle një pasurim të mëtejshëm në fjalorin e nxënësve.

*Së dyti,*të ruhet një raport i arsyeshëm,në lëndën e gjuhës amtare,bazuar kjo në rezultatet e kërkimeve të fundit në fushën e leksikologjisë e cila sot është një tendencë e fundit e fjalorit të sotëm.

*Së treti,*të bëhet i përvetësueshëm për një rreth të gjerë lexuesish,në të vërtetë libri është i domosdoshëm dhe jep informacion të mjaftueshëm për ata lexues që nuk kanë informacion të plotë dhe për ta sjellë atë sa më të qartë tek nxënësit.

Përfundime dhe propozime.

Nga studimi i këtij punimi rezultuam në këto përfundime se :

1. statistikat e kryera e të rishikuara në bazë të orëve mësimore janë të pamjaftueshme për pasurimin e fjalorit të nxënësve.

2. Teksti Gjuha shqipe 8,9 të botimit ALBAS nuk ishin të qarta për nivelin bazë në përmbajtjen e lëndës përsa i përket leksikologjisë,psikolinguistikës e degëzime të tjera të saj të cilat janë për një nivel më të lartë të nxënësve,nga ku hasin vështirësi në të kuptuar.Pasurimi i fjalorit të nxënësve kërkon shumë teori leksikologjike.

3. Në klasën e 6-të i jepet rëndësi nivelit të të kuptuarit,kurse në klasën e 7-të nivelit të zbatuarit,të analizës së personazheve e të pjesës.

4. Informacionet e sjella nga mësuesi në klasë janë të shkurtra,të thjeshta dhe të sakta.

5. Përgjigjet e dhëna nga nxënësi janë të sakta por jo të formuluara mirë gjë që ndikon në fjalorin e secilit nxënës,të cilit informacioni i sjellë është i pamjaftueshëm.

***Propozime*:Ne propozojmë** që tekstet e Gjuhës shqipe të sotme të ndahen,të jenë të trajtuara veçmas,sepse përmbajtja nuk do të jetë e ngarkuar dhe ngarkesa pikologjike do të jetë më e lehtë.

Ne propozojmë që tek klasa e 8-të njohuritë gjuhësore të leksikologjisë e leksikografisë të jenë më të zgjeruara e jo vetëm 4 orë,sepse niveli i tyre të të menduarit është i ndryshëm nga klasa në klasë.

Ne propozojmë që me zgjerimin e temave mësimorë për pasurimin e fjalorit si nga ana e mësuesit ashtu dhe të programeve mësimore përgatitja e nxënësit do të vijë në rritje

Bibliografi

1. Ballhysa,A., Jashari, A .“Formim gjuhësor**“,**Silver,2007….cit...fq.72

2. Ballhysa.A;Jashari.A,``Formim gjuhësor``,Tiranë.2002.cit...fq.102.

3. François.F ``Conduites linguistique chez le jeune enfant``PUF, ,vep.e cit.,47

4. Gjoci,P.``Metodologji e mësimdhënies``Rama, Graf. botimi I dytë,Elbasan,2014…cit..fq219

5. Thomai J,M.Samara,A.Sinani;``Gjuha dhe letërsia në shkollë``,1988.

6. Musai.B**.**``Psikologji edukimi,zhvillimi,të nxënët,mësimdhënia``PEGI,TIRANË 1999,fq 57.

7. M.Gjokutaj,Psikologjia moshore,1987.vep.e cit....``Didaktika e gjuhës shqipe``..fq,109

8. K.Safir,``Gjuha,hyrje në shkencën e ligjërimit``,1984.

9. Petro,R;Çerpja A;Metani,I;``Gjuha Shqipe 9``Albas,Tiranë 2010,fq.10

10. Petro,R;Çerpja A;Metani,I;``Gjuha Shqipe 9``Albas,Tiranë 2010;fq 33-34;63,79.

11. Petro,R.Pepivani,Sh.Vreto,A.Çerpja,``Gjuha shqipe 9``,Botimet Albas ,Tiranë 2013...

12. Petro,R .N.Pepivani,Sh.Vreto,A.Çerpja,``Gjuha shqipe 9``,Botimet Albas ,Tiranë 2013...

13. Thomai.J;``Leksikologjia e Gjuhës shqipe``Tiranë,1984;vep.e cit…fq.84.

14. Thomai.J;``Leksikologjia e Gjuhës shqipe``Tiranë,1984;vep.e cit…fq.90.

15. Zogar,Dictionnaire de Psychologie,PUF 1991,fq.402;dhe Larausse ``Dictionnaire de la psycologie`´,N.Sillamy,1995.

16. Zogar,vep.e cituar,fq 403 dhe N-sillamy,vep.e cit.

PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË NË EDUKIM PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE ME ANË TË KOMPJUTERIT KRAHAS ATYRE QË ZHVILLOHEN VETËM ME TEST ME SHKRIM

Dr.Alfons Harizaj, Dr.Robert Gjedia
Universiteti "Barleti", Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit,Tiranë
alfons.harizaj@gmail.com;robgjed@yahoo.com

ABSTRACT

The development and popularization of technology and the Internet has influenced important developments in many areas and in particular has influenced developments in education. The potentials of using technology have been discovered not only for new learning environments and methods, but also for entirely new instruments in designing and administering tests of student achievement in learning. Computerized testing (TC), which helps to improve assessment effectiveness and further increase the reliability of results, will gradually replace the traditional paper-based exam in many ways. The main purpose of writing this paper is to evaluate how TK tests can be integrated with written test (TSH) based exams in our education system.

In pre-university education, the weight of assessment has increased through the summative test in the overall annual assessment of the student. In each school year the student is required to take three written test exams for summative assessment, one for each semester. In the 9-year system, in addition to the release exam given at the end of 9th grade, an exam for students at the end of 5th grade has been added, the Assessment of Student Achievement in Primary Education (VANAF). Both of these exams are conducted by means of a written test only. State Matura exams in high school are conducted only with a written test.

In our educational system, TK technology for test development has a very low level of use. It started with an intermediate form applied by universities for admissions of candidates in higher education by competition through the test in the years 1990-2005. In 2013, the state exam for regulated professions in the Republic of Albania started. Graduates in the field of medicine and teaching in a period of about two years after graduation must pass a final exam. This exam is conducted with a computer test. The infrastructure that enables the exam is a local network of computers, which communicate with a central server. Albania also participates in the international PISA assessment that takes place with students aged 15 years. This assessment was first conducted in 2000 in written test format and from 2018 began to be fully implemented on the computer.

In the next 10-20 years there is no doubt that the number of computer exams inside or outside the education system will increase. This will also be a challenge for the education system in our country. Through this article we aim to highlight some of the challenges of this expansion and the opportunities for implementation in our university and pre-university system.

Keywords *- exams, computer test, written test, university education, pre-university education*

ABSTRAKT

Zhvillimi dhe popullarizimi i teknologjisë dhe internetit ka ndikuar zhvillime të rëndësishme në shumë fusha dhe posaçërisht ka ndikuar zhvillimet në arsim. Janë zbuluar potencialet e përdorimit të teknologjisë jo vetëm për mjediset dhe metodat e reja të të mësuarit, por edhe për instrumente tërësisht të reja në hartimin dhe administrimin e testeve të arritjeve të sudentëve në të nxënë. Testimi i kompjuterizuar (TK), që ndihmon për të përmirësuar efektshmërinë e vlerësimit dhe më tej për të rritur besueshmërinë e rezultateve, do të zëvendësojë gradualisht provimin tradicional të bazuar në letër në shumë mënyra. Qëllimi kryesor i shkrimit të këtij punimi është të vlerësohet se si testimet

TK mund të integrohen me provimet e bazuara në test me shkrim (TSH) në sistemin tonë arsimor.

Në arsimin parauniversitar është rritur rritur pesha e vlerësimit me anë të testit përmbledhës në vlerësimin e përgjithshëm vjetor të nxënësit. Në çdo vit shkollor nxënësi është i detyruar të bëjë tre provimeme test me shkrim për vlerësim përmbledhës, nga një për çdo semestër. Në sistemin 9 vjeçar, përveç provimit të lirimit që jepet në fund të klasës së 9-të, është shtuar edhe një provim për nxënësit në fund të klasës së 5-të, Vlerësimi i Arritjeve të Nxënësve në Arsimin Fillor (VANAF). Të dyja këto provime zhvillohen vetëm anë të testit me shkrim. Provimet e maturës shtetërore në shkollën e mesme zhvillohen vetëm me test me shkrim.

Në sistemin tonë arsimor teknologjia TK për zhvillimin e testeve ka nivel përdorimi mjaft të ulët. Ai ka nisur me një formë të ndërmjetme e aplikuar nga universitetet për pranimet e kandidatëve në arsimin e lartë me konkurs nëpërmjet testit në vitet 1990-2005. Në vitin 2013 nisi rrugën provimi i shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë. Të diplomuarit në fushën e mjekësisë dhe mësuesisë në një periudhë afro dyvjeçare pas diplomimit duhet të japin një provim përmbledhës. Ky provim zhvillohet me test në kompjuter. Infrastruktura që e mundëson provimin është një rrjet lokal me kompjutera, që komunikojnë me një server qëndror. Shqipëria merr pjesë gjithashtu në vlerësimin ndërkombëtar PISA që zhvillohet me nxënësit e moshës 15 vjeç. Ky vlerësim u zhvillua për herë të parë në vitin 2000 në formatin test me shkrim dhe nga viti 2018 nisi të zbatohet tërësisht në kompjuter.

Në 10-20 vitet e ardhshme nuk ka dyshim se numri i provimeve në kompjuter brenda sistemit arsimor apo jashtë tij do të vijë duke u rritur. Kjo do të jetë edhe sfidë për sistemin e edukimit në vendin tonë. Nëpërmjet këtij artikulli ne synojmë të evidentojmë disa nga sfidat e këtij zgjerimi dhe mundësitë për zbatim në sistemin tonëuniversitar dhe parauniversitar.

Fjalët kyçe *–provime,test në kompjuter,test me shkrim, arsim universitar,arsimparauniversitar*

DY LLOJE KRYESORE TË TESTIMIT TË BAZUAR NË KOMPJUTER

Testi i bazuar në kompjuter TK nuk është vetëm një metodë alternative për kryerjen e provimeve, por përfaqëson një ndryshim të rëndësishëm cilësor kundrejt metodave tradicionale siç janë testet në letër.

Ekzistojnë dy lloje kryesore të testimit të bazuar në kompjuter. Lloji më i njohur është kur kandidatët plotësojnë përgjigjet e tyre në letrër (answer sheet), e cila kalon më pas në një lexues optik (optical mark reader). Kjo lexon formularin, vlerëson sa pikë janë fituar dhe madje mund të raportojë për besueshmërinë e testit. Lloji i dytë i testimit të bazuar në kompjuter është kur kompjuterët ofrojnë një ndërfaqe vlerësimi për nxënësit ose studentët: ata japin përgjigjet e tyre dhe marrin vlerësim përmes një kompjuteri (Jimoh, AbdulJaleel, & Kawu, 2012). Mjaft studime kanë zbuluar se formati i testimit nuk ndikon në rezultatet e provimit dhe si i tillë TK mund të konsiderohet një mënyrë e vlefshme dhe e pranueshme e testimit. Ndërsa TK filloi të përdoret për vlerësimin përmbledhës, përcaktimi nëse performanca e testimit të bazuar në kompjuter ishte e krahasueshme me atë të vlerësimit të bazuar në letër është bërë rëndësishme.

PËRDORIMI I TK NË SHQIPËRI

Në Shqipëri përdorimi iTK ka nisur me një formë të ndërmjetme. Ajo eshtë aplikuar nga universitetet për pranimet e kandidatëve në arsimin e lartë me konkurs nëpërmjet testit në vitet 1993-2005. Testi printohej i personalizuar në letër për çdo kandidat. Përgjigjet që jepeshin nga nxënësi transferoheshin nga ai në një fletë më vete që quhej fleta e përgjigjeve. Në mbyllje të provimit për të gjithë kandidatët kjo fletë lexohej anë të një lexuesi optik (optical mark reader). Pajisja prodhonte njëherazi edhe raportin e pikëve të fituara nga kandidatët pjesmarrës në test.

Në vitin 2013 nisi rrugën testimi provimi i shtetit me kompjuter për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë. Kjo u mundësua nëpërmjet ndërtimit të një rrjeti lokal LAN me 54 kompjutera që komunikojnë të gjithë me një server qëndror. Në këtë mënyrë mund të testohen njëherazi 54 kandidatë. Në përfundim të testit gjenerohej fleta e përgjigjeve për secilin nga kandidatët pjesmarrës.

Shqipëria merr pjesë gjithashtu në vlerësimin ndërkombëtar PISA që zhvillohet me nxënësit e moshës 15 vjeç në lëndët matematikë,lexim dhe shkenca. Mosha 15 vjeç i gjen shumicën kryesore të nxënësve në klasën e nëntë të arsimit bazë. Ky vlerësim u zhvillua për herë të parë në vitin 2000 në formatin test me shkrim dhe mbahet rregullisht çdo 3 vjet. Nga viti 2018 vlerësimi ndërkombëtar PISA bëhet me kompjuter. Edhe cikli PISA 2015 u zhvillua pjesërishtme anë të kompjuterit.

Në Shqipëri bëhen disa testime që përfshijnë gjithë popullatën dhe të dhënat e vlerësimit humbasin ose merren afro 1% të të dhënave për interpretim. Nëse forma e testimit do ishte me anë të kompjuterit të gjitha të dhënat do të ishin në dispozicion të analizave dhe interpretimit të rezultateve. Testimi me TKështë një tendencë që po vjen duke u zgjeruar.

Historia e testimit të bazuar në kompjuter filloi në fillim të viteve 1970 me futjen e kompjuterave të hershëm. Prej 20 vitesh ajo u maturua dhe filloi zgjerimin e përdorimit të saj në vitet 1990. Me këtë rast u zbuluan potencialet e përdorimit të teknologjisë jo vetëm për mjediset e reja të të mësuarit, por edhe për instrumente tërësisht të reja në hartimin dhe administrimin e testeve.

Disa universitete në Evropë në 1996 zhvilluan bashkërisht sistemin e vlerësimit diagnostikues të gjuhëve Evropiane – DIALANG, i cili mbulonte 14 gjuhë evropiane. TOEFL_TK 1998 u zhvillua në TOEFL_IBT në 2005. GMAT dhe GRE në 1998 dhe 1999 filluan të zbatojnë një provim të kompjuterizuar.

Përdorimi i TK ndodh në një kontekst që e ndihmon dhe e kufizon përdorimin e tij.

PROVIMET TK TRANSFORMOJNË SISTEMIN E VLERËSIMIT

Një provim duhet të matë aspekte të ndryshme të performancës. Kashumë mënyra përmes të cilave kjo mund të bëhet në një sistem kompjuterik duke përdorur gamën e pajisjeve, softuerë-ve, rrjeteve kompjuterike dhe opsioneve në dispozicion qëato kanë. Për shembull, një provim në kompjuter mund të shpërndahet në kompjutera personalë në mënyrë të pavarur, brenda një rrjeti të mbyllur lokal (LAN) ose të përdorë teknologji online, siç janë faqet elektronike përmes internetit. Metodat teknike dhe administrative mund të përdoren për të garantuar siguri dhe trajtim të barabartë (McNachel et al., 2011). Gama gjithnjë e më e sofistikuar e pajisjeve shtesë kompjuterike mund të sigurojë mbështetje audio-vizuale dhe kinestetike për të mundësuar një hapësirë të madhe të llojeve të përgjigjeve të nxënësve dhe të performancës së tyre.Provimet tradicionale bazohen në përgjigjet e pyetjeve, por një provim mund të përfshijë edhe detyra shtesa për vlerësuar performancën. Përgjigjet e pyetjeve të testit të bazuar në kompjuter mund të ofrojnë stimuj duke përdorur një demonstrim të plotë për të gjitha shqisat tona dhe mund të lejojnë përgjigje të ndryshme si: tekst, grafik, audio dhe forma kinestetike.

Provimet e bazuara në kompjuter janë një pjesë e vlerësimit elektronik që Ripley (2009) përcakton si "përdorimin e teknologjisë për të digjitalizuar, për të bërë më efikase, për të riformatuar ose transformuar sistemin e vlerësimeve dhe testimeve" që përfshin: provime profesionale, kualifikime, çertifikime dhe teste shkollore, vlerësim në klasë dhe vlerësime të tjera të të nxënit dhe për të nxënë . Ai propozon që ka dy "nxitës" të vlerësimit elektronik, që janë "efiçenca e biznesit" dhe "transformimi arsimor". Vlerësimi elektronik i nxitur nga efikasiteti i biznesit do të priret të përdorë teknologji digjitale për të mbështetur të njëjtat forma të vlerësimit të bëra tradicionalisht në letër, siç janë pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë dhe pyetjet me përgjigje të shkurtër. Kur

nxitësi është transformim arsimor, ka të ngjarë që vlerësimi elektronik të marrë forma dhe modele të ndryshme për t'iu përshtatur rezultatit të pritur ose performancave që do të vlerësohen.

TEKNOLOGJIA I'U PËRGJIGJET SFIDAVE PEDAGOGJIKE TË TË MËSUARIT

Historia e testimit të bazuar në kompjuter filloi në fillim të viteve 1970 me futjen e kompjuterave të hershëm. Me këtë rast u zbuluan potencialet e përdorimit të teknologjisë jo vetëm për mjediset e reja të të mësuarit, por edhe për instrumente tërësisht të reja në hartimin dhe administrimin e testeve. Zhvillimi i teknologjise ne dekadën e fundit ka formatuar të gjitha industritë dhe me këtë rast edhe atë të edukimit.

Pandemia globale COVID-19 është një sfidë edhe për zhvillimet në edukim nëpërmjet teknologjisë.Me dhjetëra miliona studentë në të gjithë botën janë të detyruar të qëndrojnë në shtëpi dhe të ndjekin shkollat online. Mbylljet në disa zona mund të vazhdojnë gjatë. Si mund të arrihet që ata të marrin arsimin më të mirë të mundshëm?

Mësuesit dhe pedagogët po ndërmarrin disa qasje për të sjellë vazhdimësi në programet e tyre mësimore dhe sesionet arsimore. Ndërsa disa kanë anuluar provimet e tyre të mbetura, një shumicë e universiteteve po mendojnë të kalojnë në testime të bazuara në kompjuter. Teknologjia po bëhet më e lehtë për t'u integruar me atë që mësuesit e pedagogët po përpiqen të përmbushin. Të mësuarit me anë të teknologjisë, posaçërisht përpunimi në gjuhën natyrale, do të sigurojë qasje pedagogjike Sokratike dhe mundësi më të koordinuara për të mësuar.

ÇFARË DUHET TË GARANTOJË PLATFORMA TK

Është e rëndësishme të planifikohet TK-të, në mënyrë që rezultatet të provojnë se është përdorur njëTK e përshtatshme. Planifikimet mund të jenë në nivele të ndryshme, nga ato që qëndrojnë në themel të ndërtimit

të të gjithë sistemit te ato që drejtojnë mënyrat në të cilat studentët ndërveprojnë me TK në mënyrë individuale.

TK KONSIDEROHET SI SISTEM I PËRBËRË NGA INFRASTRUKTURA KOMPJUTERIKE DHE SHËRBIMET PËR FUNKSIONIMIN E TIJ

TK ndodh brenda kontekstit më të gjerë arsimor, i cili përfshin infrastrukturën e ndërtesës dhe klasës, si dhe vetë platformën kompjuterike. Ndodh gjithashtu brenda një konteksti në të cilin mësuesit dhe studentët kanë pasur përvoja të ndryshme në përdormin e kompjuterit. Këta dhe faktorë të tjerë, duhet të analizohen me kujdes si pjesë e marrjes së vendimeve në lidhje me TK. Analiza e faktorëve dhe vendimmarrja nëse dhe si duhet të përdoret TK duhet të respektojë profilet e të gjithë studentëve, përfshirë ata me aftësi të kufizuara.Nëse studentët nuk janë të familjarizuar me përdorimin e PC është e vështirë që përdorimi i TK të ketë sukses si metodë.

PLANIFIKIMI I TK TË MARRË PARASYSH STUDENTËT ME AFTËSI NDRYSHE

Platforma për TK mund të ndërtohet për PC locale ose në rrjet. Në të dy rastet platforma duhet të japë mundësi që ato të ndërveprojnë potencialisht sipas niveleve të parashikuara të aksesit si dhe me teknologji të ndryshme ndihmëse që studentët mund të përdorin.Në këtë raste nevojitet ekspertizë për të realizuar teknikisht përdorimin e platformës nga studentët me aftësi ndryshe. Vëmendje duhet tu kushtohet veçorive të aksesit që nuk që nuk janë të përfshira në TK dhe kanë nevojë për akomodime të jashtme.

MËSUESIT DHE STUDENTËT DUHET TË PËRGATITEN PARAPRAKISHT PËR PËRDORIMIN E PLATFORMËS TK SIPAS NEVOJËS.

Mësuesit dhe studentët duhet të trajnohen për veçoritë e përdorimit të platformës. Përfshirja e mësuesve lidhet me rolin e tyre si administrator me nivele të caktuara ose për shkak të udhëzimeve dhe instruksioneve që duhet të përcjellin te studentët. Këta nga ana e tyre duhet të kuptojnë qartësisht mënyrën e të përgjigjurit me anë të sistemit duke qënë të sigurt në përdormin e kapaciteteve teknike të tij.

REFERENCA

[1]. Daniel, S.J. Education and the COVID-19 pandemic. *Prospects* 49**,** 91–96 (2020). https://doi.org/10.1007/s11125-020-09464-3

[2]. Bartell, T., Floden, R., Richmond, G. (2018). What data and measures should inform teacher preparation. Journal of Teacher Education, 69(5), 426-428

[3]. Bell, C. A., Jones, N. D., Qi, Y., Lewis, J. M. (2018). Strategies for assessing classroom teaching: Examining administrator thinking as validity evidence. Educational Assessment, 23(4), 229-249.

[4]. American Psychological Association Committee on Professional standards and committee on psychological tests and assessment (1986). Guidelines for computer-based tests and interpretations. Washington, DC.

[5]. Braun, H.I. & Wainer, H. (1988). Test Validity. New Jersey: Lawrence Erlbaum.

[6]. Bugbee, A.C Jr. (1996). The equivalence of paper-and-pencil and Computer-based testing. Journal of Research on Computing in Education, 28(3) 282-299.

[7]. Bunderson, C.V, Inouye, D.K, & Olsen, J.B. (1989). The four Generations of computerized educational measurement in RL

[8]. Coniam, D. (1999). Subjects' Reaction to Computer-Based Tests, Journal of Educational Technology Systems. 27(3).

[9]. John, C.K., Cynthia, G.P., Judith, A.S., & Tim, D. (2002). Practical Considerations in Computer-Based Testing. Sheridan Books. New Jersey: Lawrence Erlbaum Associates.

[10]. Darrell, L.B. (2003). The Impact of of Computer-Based Testing on Student Attitudes and Behaviour. The Technology Source. [7]. Erle, L., Benjamin, O., Einar, W.S., & Raymond, S. (2006). Computer-based versus Pen-and-paper Testing: Students' Perception. Ann Acad Med Singapore 35, 599-603.

[11]. Fyfe, G., Meyer, J., Fyfe, S., Ziman, M., Sanders, K., & Hill, J. (n.d). Self-evaluation of assessment performance can enhance student's perception of feedback on computer-generated tests.

[9]. Harmes, C.J. (1999). Computer-Based Testing: Toward the design and use of innovative items. University of Florida.

[10]. Johnson, M. & Green, S. (2004). On-line assessment: the impact of mode on students' strategies, perceptions and behaviours. University of Cambridge.

[12]. Binkley, M., Erstad, O., Herman, J., Raizen, S., Ripley, M., Rumble, M.: Defining 21st Century Skills. In: Griffin, P., McGaw, B., Care, E. (eds.) Assessment and Teaching of 21st Century Skills, pp. 17–66. Springer, Heidelberg (2012)29

[13]. Weigle, S.C.: Validation of automated scores of TOEFL iBT tasks against non-test indicators of writing ability. Language Testing 27, 335–353 (2010)

[14]. Hardré, P.L., Crowson, H.M., Xie, K., Ly, C.: Testing differential effects of computer-based, web-based and paper-based administration of

questionnaire research instruments. British Journal of Educational Technology 38, 5–22 (2007)

[15]. Ben-Simon, A., Bennett, R.E.: Toward a more substantively meaningful automated essay scoring. Journal of of Technology, Learning and Assessment 6 (2007)

[16]. Looney, J.: Making it Happen: Formative Assessment and Educational Technologies. Promethean Thinking Deeper Research Papers 1 (2010)

[17]. Means, B., Rochelle, J.: An Overview of Technology and Learning. In: Peterson, P., Baker, E., McGaw, B. (eds.) International Encyclopedia of Education, vol. 8, pp. 1–10. Elsevier, Oxford (2010)

PROCESI I TË PYETURIT NË LËNDËN E HISTORISË

Rast Studimi: Shkollat 9-Vjeçare, Bashkia Devoll

Dorisa Topi

dorisatopi@yahoo.com

Abstract

One of the most influential elements in the effective teaching of history along with other elements is the questioning process, due to the nature and objectivity of this subject. Over theyears, although questioning in theory has been accepted as an integral and important part ofteaching for classroom interaction, effective questioning does not occur often, it occurs veryrarely, even among teachers with considerable teaching experience, there is a lack of knowledge on questioning process, lack in theoretical and practical aspects. So the respondents still do not function at adequate levels. Today, despite the efforts of various actors in the field of education that have increased over the years, the improvements are very small, in the way teachers use respondents, not as multifunctional and multidimensional, but with the main purpose of assessment. Low-level, reproducible questions still predominate in the classroom. The didactic criterion most possessed by teachers for designing questions was the criterion of length, then clarity and taxonomy. The phase in which teachers direct more questions is that of evocation and reflection and less in the second phase. The tendency of teachers is to direct questions individually and less in groups. An element that affects the respondents is also the time that teachers give to the students to answer, or the reaction of the teachers or the class to the students'answers. Another aspect of the problem is students perception and knowledge about respondents as an important component in this process, they need to direct more questions. So, the actors that affect the proper functioning of the questioning process in the classroom are: teachers, students and textbook compilers.

The purpose of this study is to investigate the functioning of the questioning technique in thesubject of history, and why not to become helpful for all actors as a manual for the properfunctioning of this process. A descriptive and analytical methodology was used to carry out this

work. The methods used are: that of research, interview, survey and comparison. Teachers arethe most important actors, so they must be careful in the way they design, direct and use thequestions. Since text exercises are widely used as ready-made question models by teachers,textbook compilers need to establish a proportion in relation to the question levels. While thetrainers, to establish a proper proportion during the treatment between the theoretical andpractical framework, attention should be paid to the practical aspect. The result of the study aims to help teachers to understand even more the importance of asking, to minimize any weaknesses and so that they can improve their questioning practice in the classroom. Another goal is to help the trainers, the compilers of teaching and didactic materials by seeing the problems of the questioning that emerged from this study.

Keywords: *questioning process, effective teaching, teachers, students, history subject.*

Abstrakt

Një nga elementët me mjaft ndikim në mësimdhënien efektive të historisë krahas elementëve të tjerë është procesi i të pyeturit, për shkak të natyrës e objektivit që ka kjo lëndë. Gjatë viteve, edhe pse marrja në pyetje në teori është pranuar si pjesë e pandashme dhe e rëndësishme e mësimdhënies për ndërveprim në klasë, pyetja efektive nuk ndodh shpesh, ndodh shumë rrallë, edhe tek mësuesit me përvojë të konsiderueshme në mësimdhënie, ka mungesë njohurish mbi të pyeturin, mungesë në aspektet teorike dhe ato praktike. Pra, të pyeturit ende nuk funksionon në nivele adekuate. Sot, pavarësisht se përpjekjet e aktorëve

të ndryshëm në fushën e arsimit janë shtuar gjatë viteve, përmirësimet janë shumë të vogla, në mënyrën se si mësuesit përdorin të pyeturit, jo si multifunksional e multidimesional, por me qëllim kryesor vlerësimin. Në klasë ende mbizotërojnë pyetjet e nivelit të ulët, rriprodhues. Kriteri didaktik që zotërohet më shumë nga mësuesit për hartimin e pyetjeve, ishte kriteri i gjatësisë, më pas qartësia e taksonomia. Faza në të cilën mësuesit drejtojnë më shumë pyetje është ajo e evokimit dhe reflektimit dhe më pak në fazën e dytë. Tendenca e mësuesve është që të drejtojnë pyetje individuale dhe më pak në grup. Një element që ndikon tek të pyeturit është edhe koha që mësuesit i japin nxënësve për t'u përgjigjur, apo dhe reagimi i mësuesve apo klasës ndaj përgjigjeve të nxënësit. Aspekt tjetër i problemit është perceptimi dhe njohuritë e nxënësve në lidhje me të pyeturit si komponent i rëndësishëm në këtë proces, ata duhet të drejtojnë më shumë pyetje. Pra, aktorët që ndikojnë në mirëfunksionimin e procesit të të pyeturit në klasë janë: mësuesit, nxënësit e hartuesit e teksteve.

Ky studim ka si qëllimi të hetojë funksionimin e teknikës së të pyeturit në lëndën e historisë, dhe pse jo t'ju vijë në ndihmë të gjithë aktorëve si një manual për mirëfunksionimin e këtij procesi. Për realizimin e këtij punimi është përdorur një metodologji e karakterit përshkrues e analizues. Metodat e përdorura janë: ajo e hulumitimit, intervistimit, anketimit e krahasimit. Mësuesit janë aktorët më të rëndësishëm, prandaj ata duhet të jenë të kujdesshëm në mënyrën si i hartojnë, drejtojnë e përdorin pyetejet. Duke qënë se ushtrimet e tekstit përdoren shumë si modele të gatshme pyetjesh nga ana e mësuesve, hartuesit e teksteve duhet të vendosin një proporcion në lidhje me nivelet e pyetjeve. Ndërsa trajnuesit, të vendosin një proporcion të duhur gjatë trajtimit mes kuadrit teorik dhe praktik, vëmendja duhet t'i kushtohet aspektit praktik. Rezultati i studimit synon të ndihmojë mësuesit për të kuptuar edhe më shumë rëndësinë e të pyeturit, për të minimizuar çdo dobësi dhe kështu që të mund të përmirësojnë praktikën e tyre të të pyeturit në klasë. Synim tjetër është të ndihmojë trajnuesit, e hartuesit e materialeve mësimore e didaktike duke parë problematikat e të pyeturit të dala nga ky studim.

Fjalë kyç: procesi i të pyeturit, mësimdhënie efektive, mësuesit, nxënësit, lënda e historisë.

TË PYETURIT NË LËNDËN E HISTORISË

Pjesa më e madhe e orës së mësimit kalon nëpërmjet mardhënies pyetje-përgjigje, dhe ajo nuk është e rastësishme. Kështu ndodh në vazhdimësi, nga ora në orë që do të thotë se të pyeturit është një nga teknikat kryesore në mësimdhënie.Ja si është shprehur një ndër themeluesit e filozofisë së sotme Xhon Djui:'' Të dish të bësh pyetje siç duhet do të thotë të dish të japësh mësim''(Musai, 2014, f.231) Më shumë se çdo gjë tjetër, arti i bukur i mësimdhënies varet nga mjeshtëria e përdorimit të pyetjeve, pasi ajo shërben si drejtim për ide të gjalla e të qarta, nxit me shpejtësi imagjinatën dhe mendimin, gjë që të shtyn për veprim''(Musai, 2014, f.231). Të pyeturit në klasë ndodh për shumë qëllimenga ana e mësuesit, por jo gjithmonë qëllimet që ne parashikojmë për drejtimin e pyetjeve narezultojnë të sakta, më poshtë po japim disa qëllime të marrjes së pyetjeve në klasë sipas studimittë Fondacionit SOROS:

- Për të përqëndruar vëmendjen e tyre rreth çështjes që do trajtojmë
- Për të kontrolluar të kuptuarit, njohuritë e shprehitë
- Për të siguruar vëmendjen te detyra e dhënë
- Për të nxitur mendimin kritik të nxënësve
- Për të lehtësuar procesin e të nxënit etj. (Fondacioni i shoqërisë së hapur SOROS, AEDP 2005, f.14)

Zakonisht mësuesit u bëjnë pyetje nxënësve kryesisht për tre qëllime kryesore: qëllime vlerësuses (75%), qëllime motivuese (12%) dhe qëllimi i përgatitjes së terrenit për të krijuar atmosferë pune (13%). Qëllimi i krijimit të një atmosfere pune, sipas vëzhgimit u realizua nga ana e mësuesve duke drejtuar një ose disa pyetje në fillim të çdo mësimi, të cilat mund të kenë lidhje ose jo me mësimin. Mësuesit mendonin se këto pyetje i ndihmonin nxënësit të viheshin në pozitë pune. Aktivitetet e

krijimit të atmosferës së punës përfshijnë kryesisht: vlerësimin e njohurive paraprake të nxënësve në lidhje me temën që do të trajtohet. Këto pyetje i ndihmojnë nxënësit të përgatiten për të kuptuar se çfar do të trajtohet në mësim. Në praktikë mësuesit nuk zbatonin këtë rradhë pune ata qysh në fillim i drejtonin nxënësve pyetje me qëllime vlerësuese, pra për t'i vënë notë. Sipas anketimit të nxënësve, pyetjet që mësuesit drejtonin për krijimin e një atmosfere pune ishin rreth 5%. Një qëllim tjetër i të pyeturit është qëllimi motivues. Disa pyetje që mund të drejtohen nga mësuesit, janë kryesisht pyetjet që i nxitin nxënësit për mësimin dhe i inkurajojnë për të provuar një përpjekje tjetër drejt përgjigjes së saktë. Këto ishin pyetje motivuese. Nxënësit duhet të ndihen të motivuar, sepse mund të dinë diçka rreth pyetjes që ne mund të drejtojmë, por kanë nevojë për nxitje. Sipas anketimit të nxënësve pyetjet që ata i motivonin zinin rreth 3%. Një nxënës u shpreh se*:''nëse ne nuk përgjigjemi mësuesi ngre dikë tjetër''.*

Qëllim tjetër për marrjen në pyetje është, qëllimi i vlerësimit. Trajtimi në fund i këtij qëllimi është për arësye se ky qëllim nuk është qëllimi kryesor i pyetjeve në kontekstin si e trajtojnë mësuesit, për t'i vënë nxënësit një notë. Mësuesit e përdorin pyetjen me qëllim vlerësues në masë të madhe, kjo duket edhe nga vëzhgimi, anketimi e intervistimi. Pothuajse, çdo mësues raportoi se ata mund të kuptonin nëse mësimet e tyre po shkonin mirë ose jo duke i bërë pyetje nxënësve gjatë mësimit, pra se ku nxënësit kishin paqartësi, sa ata po kuptonin. Kur nxënësit mund të përgjigjeshin saktë mësuesi kuptonte se ata ishin të vëmendshëm dhe atë që po u shpjegoje ata e kishin kuptuar. Në rast të kundërt kur ata nuk kuptonin diçka atëherë ne kuptonim se diçka nuk shkonte. Por, aspekt tjetër pse i përdorim pyetjet në këtë kontekst është të vlerësojmë nxënësin me notë, por ky nuk është qëllimi kryesor i vlerësimit. Sipas vëzhgimit pyetjet u përdorën më shumë me qëllime vlerësuese, pra për t'i vënë notë nxënësit, të cilët u pyetën nga mësimi i kaluar, aktual dhe nga punimet ose detyrat e shtëpisë.

Për çdo mësim mësuesi përcaktonte rezulatatet e të nxënit me kompetenca. Ideja e të mësuarit me kompetenca qëndron në atë që nxënësi konstrukton vetë dijet e tij, duke u mbështetur në dijet e

mëparshme dhe përvojën e tij (Mësimdhënia dhe të nxënit bazuar në kompetenca, (http://ëëë.portalishkollor.al/dokumenta/M%C3%ABsimdh%C3%ABnia%20dhe%20t%C3%AB%20nx%C3%ABnit%20bazuar%20n%C3%AB%20kompetenca%20.pdf). Në shumë pak mësime, mësuesit i paraqitën për nxënësit këto. Pjesa më e madhe e rezultatateve të të nxënit me kompetenca sipas temës mësimore ishin të njohura nga ana e mësuesve. Po, mësuesit nuk kishin tendencë që në pyetjet, të cilat drejtonin të mbanin parasysh rezultatet e të nxënit me kompetenca. Nga intervistimi rezultoi se të pyeturit ishe i bazuar kryesisht në kompetencat temës mësimore e të lëndës.



Grafiku 1: Drejtimi i pyetjeve bazuar në rezultatet e të nxënit

Nga grafiku shohim që shumica e pyetjeve që mësuesit drejtonin bazoheshin në rezultatet e të nxënit me kompetenca, pra kjo tregon se mësuesit duket sikur janë në zbatim të kuadrit teorik dhe bazohen në këto standarde, pavarësisht të nxënit që mund të ndodhë tek nxënësi. Ndërsa, sipas vëzhgimit vura re se, mësuesit pyetjet që drejtonin nuk lidheshin me rezultatet e të nxënit të parashikuara në temën mësimore apo në tërësi të lëndës, kjo mbase ata nuk i planifikonin pyetjet paraprakisht.

Sipas niveleve pyetjet mund të klasifikohen në: a) pyetje të nivelit të ulët (të sferës njohëse, të kuptuarit, të informacionit, të zbatuarit e njohurive të fituara) dhe, b) pyetje të nivelit të lartë (analizë, sintezë, vlerësim)

(Instituti i studimeve pedagogjike, 2002, f.80). Këto gjashtë nivele janë përshtatur në formulimin e qëllimeve të shkollës, vlerësimin e përparimit të nxënësve dhe zhvillimin e pyetjeve. Sipas përmbajtjes, shumë dijetarë u përpoqën t'i klasifikojnë pyetjet në mënyra të ndryshme. Hargreaves (1984) përmendi tre lloje pyetjesh që janë pyetje të hapura, të mbyllura pyetje dhe pyetje gjysmë të hapura (Teachers' questioning techniques in mathematics at grade 11 level: the case of four selected secondary schools in Petaukedistrict:http://dspace.unza.zm:8080/xmlui/bitstream/handle/123456789/3155/Chidongo%20M..pdfs quence 1&isAlloëed).

Sipas vëzhgimit paraprak u konstatua se nxënësit nuk dinin pyetje sipas niveleve apo sipas përmbajtjes, pyetjet e anketimit të tyre i grupuam në pyetje të thjeshta e të vështira dhe pyetje interesante. Nga të dhënat e nxjerra nga intervistimi i mësuesve, u konstatua se ata përdornin taksonominë e Bloomit për hartimin e pyetjeve. Megjithatë, sipas vëzhgimit u konstatua, se shumica e pyetjeve që mësuesit i kërkuan në klasë ishin pyetje të nivelit të ulët pra, pyetje që përfshin njohje, kuptim. Nga aketimi i nxënësve, pothuajse 90% e pyetjeve të bëra nga mësuesit ishin pyetje të thjeshta, pasi përgjigjet e tyre ishin në libër në mënyrë të drejpërdrejtë. Ata kishin shkruar se nuk duhej të mendonin shumë për t'iu përgjigjur pyetjeve të mësuesve, se ishin drejtpërdrejt në libër dhe përgjigjet e tyre ishin të shkurta. Pra, duket se pyetjet e bazuara në nivelet e ulëta zinin përqindje të lartë. Dominimi i këtyre pyetjeve do të thotë ‘’humbjen e një klase kritike e krijuese’’. Sipas intervistimit të mësuesve ata u shprehën se përdorin pyetje nga të gjitha nivelet, por janë një sërë faktorësh që ndikojnë në shpeshtësinë e përdorimit të njërës apo tjetrës.

Njohje	20%
Kuptim	40%
Zbatim	10%
Analizë	10%
Sintezë	10%
Vlerësimit	10%

Tabela 1: *Llojet e pyetjeve sipas Taksonomisë së Bloomit*

Ata u shprehën se pyetjet e nivelit njohjes përdoreshin zakonisht për ndonjë përkufizim termi, ndonjë datë historike. Pyetjet e nivelit të dytë (kuptim), mësimdhënësit bëjnë shumë pyetje nga ky nivel krahasuar me nivelin e parë të taksonomisë së Bloom-it. Përqindja e pyetjeve të tilla ishte 40%. Nëpërmjet këtyre pyetjeve, mësuesit pyetën nxënësit për të parë nëse ata kishin kuptuar atë që e kishin lexuar. Niveli i zbatimit zinte reth 10%, mësuesit u shprehën se i përdorin këto pyetje në zbatimin e njohurive teorike në hartat historike. Pyetjet e nivelit të analizës ishte niveli më i lartë i përdorur në klasat kur mësuesit i pyesnin nxënësit. Ky nivel zuri vetëm 10% të numrit të përgjithshëm të pyetjeve. Nga ana e mësuesve u konstatua se shumica e pyetjeve të nivelit të analizës nga shumë nxënës nuk marrin përgjigjen e duhur. Mësuesit me idenë se këto pyetje nuk mund të përdoren për gjithë nivelet e nxënësve i përdorin shumë pak.Nga vëzhgimi vura re se me rritjen e nivelit të pyetjeve, zvogëlohej përdorimi i tyre, por edhe përgjigjet nga ana e nxënësve. Në të njëjtën kohë, aftësia dhe cilësia e përgjigjes së nxënësve u ulën kur u rrit niveli i pyetjeve. Në pyetjet të nivelit të njohjes shumica e nxënësve mund të përgjigjen mirë; ndërsa në rast të pyetjeve të nivelit të analizës, shumica e nxënënsve nuk u përgjigjën plotësisht. Për një nxënës që e ka mësuar mësimin në mënyrë mekanike një pyetje të nivelit të lartë që do t'i drejtojmë ka shumë gjasa që mos përgjigjet, dhe këtij nxënësi kjo pyetje do t'i duket e vështirë.Nga intervistimi i mësuesve u konstatua se, nxënësit në pjesën më të madhe të kohës përgjigjen, pasi ata e kanë kuptuar shumë mirë mësimin. Por, ishte normale që nxënësit të përgjigjeshin sepse pyetjet ishin thjesht rriprodhim i asaj që shkruhej në libër. Pyetjet që kërkonin analizë nxënësit përgjigjeshin mirë një pjesë shumë shumë e vogël, shumë shkurt, ose aspak.

Në klasifikimin sipas përmbajtjes, kemi pyetje të hapura, të mbyllura dhe pyetje me përgjigje po/jo. Nga intervistimi mësuesit u shprehën se u parashtrojnë nxënësve, pyetje të mbyllura rreth (65%), (5%) e pyetjeve ishin po/jo dhe vetëm (30%) e pyetjeve ishin pyetje të hapura. Pyetje të hapura janë ato pyetje që nuk kanë një përgjigje fikse me një ose dy fjalë. Ata mund të prodhonin dy apo tre fjalë që nuk plotësonin përgjigjen. Gjithashtu mësuesit u shprehën në intervistë se nuk prisnin përgjigje për pyetjet e hapura nga të gjithë nivelet e nxënësve dhe ata i

bënë pyetje të hapura disa nxënësve selektivë. Kjo gjë nuk është plotësisht e vërtetë sepse secili nga nxënësit ka një përgjigje pavarsisht se sa e plotë mund të jetë kjo përgjigje. Pyetjet të mbyllura zënë një përqindje më të madhe të të pyeturit në lëndën e historisë rreth 65%. Nxënësit i'u përgjigjën këtyre pyetjeve duke përdorur një ose disa fjalë. Përgjigjet e këtyre pyetjeve ishin të fiksuara dhe nxënësit u shprehën me një entuziazëm maksimal për t'iu përgjigjur këtyre lloj pyetjesh. Pjesën më të madhe të kohës mësuesit pyesnin përkufizime të koncepteve, si veproi, cila ishte taktika, etj, pyetje përgjigjet e të cilave ishin në libër. Përveç llojeve të tilla të pyetjeve të mbyllura, mësuesit gjithashtu kërkuan disa pyetje me zgjedhje të shumëfishta, pasi në disa raste ata kërkuan të plotësojnë edhe boshllëqet. Nxënësit i quajtën ‘’pyetjet ndihmëse’’. Si mësuesit dhe nxënësit treguan për disa përfitime nga llojet e tilla të pyetjeve të lehta. Nxënësit u shprehën: Se kur mësuesit filluan të bëjnë pyetje të tilla, atëherë ata ndiejnë më shumëbesim për t'u përgjigjur dhe gradualisht mund të vazhdonin t'i përgjigjeshin edhe pyetjeve të vështira.

Shumica e mësuesve besonin se ishte më mirë të bëje pyetje të thjeshta për nxënësit sesa për pyetje të hapura ose krijuese; megjithëse ata i vlerësonin këto pyetje si të rëndësishme për mësimdhënien. Mësuesit mendonin se kur ata kërkuan pyetje të shkurtra dhe të mbyllura, atëherë ata mund të bënin shumë më tepër pyetje dhe mund të kontrollonin përgjigjet e nxënësve, të kuptuarit më shumë nga ana e nxënënsve, nxënësit ndiheshin më të inkurajuar, ndiheshin më të qetë dhe përmirsonin të folurit. Në këtë mënyrë, mësuesit gjithashtu mund të vlerësojnë mësimdhënien e tyre dhe të nxënët nga ana e nxënësve në të njëjtën kohë. Pyetjet me përgjigje po/ jo ishin të pranishme në mësimdhënien e historisë. Pra, mësuesit bënin një pyetje shumë të zgjeruar dhe nxënësit u përgjigjën duke thënë po ose jo, kjo sipas vëzhgimit. Këto pyetje mësuesi i përdorte edhe për tërhequr vëmendjen në disa raste. Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se pjesa më e madhe e pyetjeve ose afërsisht 2/3 e pyetjeve nuk preknin pyetjet e nivelit të lartë.

Aspekt tjetër jo pak më i rëndësishëm që do trajtojmë në këtë çështje janë edhe burimet e pyetjeve. Të dy aktorët si mësuesit dhe nxënësit raportuan

se pyetjet në klasë i përkisnin përmbajtjes së teksteve shkollore. Të dhënat gjatë intervistimit treguan se mësuesit u bëjnë pyetje nxënësve nga tre burime:

- Ushtrimet e teksteve shkollore,
- Përmbajtja e teksteve shkollore
- Nga lidhja midis përmbajtjes dhe jetës reale

Të njëjtën gjë pohuan edhe nxënësit. Sasia e pyetjeve të tilla ishte 70% e totalit të pyetjeve. Në intervistë me mësuesit mësuam se, *ata kërkuan pyetje të tilla lidhur me përmbajtjen e temës sepse nxënësit atë kanë burimin kryesor të të mësuarit dhe nëse mund t'I pyesësh jashtë tij ata thonë se nuk e kanë lexuar atë gjë.* Natyrish pyetjet që mësuesit drejtojnë duhet të lidhen me përmbajtjten e temës mësimore, me përjashtim të rasteve.Pyetjet e drejtuara nga ushtrimet e tekstit shkollor zinin një përqindje të konsiderueshme, ato mund të drejtoheshin me gojë nga ana e mësuesit për një nxënës ose për gjithë klasën, por mund të plotësoheshin edhe në tekst dhe më pas të lexoheshin. Nxënësit pohuan se pyetjet e drejtuara nga ushtrimet e tekstit ishin më të pëlqyera nga ana e tyre. Pyetje që bënin analogji me jetën reale ishin vetëm 5% të numrit të përgjithshëm të pyetjeve të bëra në klasë. Mësuesit mendonin se nxënësit mund t'i përgjigjeshin mirë pyetjeve të tilla dhe gjithashtu i pëlqenin këto lloj pyetjesh. Nxënësit gjithashtu shpreheshin se i pëlqenin të gjitha pyetjet e zgjedhura nga libri ose nga jeta e përditshme. Ata mendonin se pyetjet nga libri ndonjëherë i ndihmonin ata të kuptonin më mirë mësimin. Por, këto pyetje shpesh në klasë ngjallnin diskutime e debate që mund të ishin shumë produktive nëse mësuesi e përdor si duhet teknikën e të pyeturit që ky debat të jetë në funksion të mësimit.

Element tjetër që ndikon në të pyeturin është dhe respektimi i kritereve didaktike për hartimin e tyre. Pyetja e mirë ka një numër karakteristikash, si: ajo duhet të jetë e përshtatshme në lidhje me taksonominë e objektivave arsimore (Bloom, 1956), gjatësia, formulimi dhe qartësia. (Instituti për zhvillimin e arsimit, *Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës së në AMU(klasat VI-IX)*, 2017). Sipas, vëzhgimit mësuesit në pyetjet që drejtonin kishin mangësi didaktike. Mangësia e parë, qëndron në faktin se

mësuesit nuk përdornin taksonominë në pyetjet që ata drejtonin. Siç e përmendëm më lart ata nuk përdornin pyetje të të gjitha niveleve të taksonomisë së Bloomit. Komponent i rëndësishëm është edhe gjatësia e pyetjes, një pyetje shumë e gjatë mund ta konfuzojë nxënësin, ndërsa një pyetje e shukurtër që do të thotë shumë mund ta ndihmojë nxënësin të kuptojë se çfarë kërkon mësuesi. Një pyetje e formuluar qartë dhe saktë do të thotë më shumë produktivitet. Nga anketimi i nxënësve u konstatua se mësuesit, një nga kriteret që zotëronin më shumë ishte gjatësia, pasi pyetjet që ata drejtonin nuk ishin shumë të gjata, më pas vinte, fomulimi, qartësia ndërsa taksonomia shumë shumë pak.



Grafiku 2: Kriteret didaktike të hartimit të pyetjeve

Duke parë grafikun shohim se kriterin didaktik që mësuesit e e zotëronin më mirë është gjatësia, kjo ndoshta lidhet me nivelin e pyetjeve që mësuesit përdorin që kanë një përgjigje me pak fjalë. Nxënësit, konstatuan se mësuesit në pjesën më të madhe të kohës bëjnë pyetje të shkurta. Formulimi, pra mënyra se si mësuesit e formojnë pyetjen zë një përqindje më të vogël, pasi nga anketimet e nxënësve u rezultua se formulimi ishte jo gjithmonë i drejtë nga ana e mësuesve. Qartësia dhe

formulimi qëndrojnë në nivele pak a shumë të barabarta sepse lidhen mjaft me njëra tjetrën, një pyetje e keqformuluar nuk mund të jetë e qartë.

3.2. ROLI I MËSËUESIT NË PROCESIN E TË PYETURIT

Mësuesi është aktori kryesor në mire funksionimin e teknikës së të pyeturit. Ai luan rol ky] në drejtimin e pyetjeve, strategjitë e taktikat që ai përdor për të realizuar të pyeturin si proces dhe dhe si teknikë, po rol luan edhe në krijimin e një atmosfere bashkëpunimi në të pyetur. Disa aspekte i trajtuam lart dhe kjo tregon më së miri sesa i rëndësishëm është mësuesi në drejtimin e funksionimin e të pyeturit. Funksionimi i teknikës së të pyeturit në lëndën e historisë varet nga shumë elementë, strategji e dhe taktikat që përdor mësuesi, këtu mund të përmendim: mënyra e ofrimit të pyetjeve nga ana e mësuesit, mënyra e drejtimit të pyetjeve, dhënia e kohës për t'u përgjigjur dhe koha për të drejtuar pyetje, reagimi etj. Parashtrimi i pyetjeve nga ana e mësuesit ka një rëndësi të madhe në mirëfunksionimin e të pyeturit në klasë. Elementët që mund të jenë ndikues në ofrimin e pyetjeve mund të jenë: cilësia dhe qasja e zërit të mësuesit gjatë ofrimit të pyetjeve, kjo ndikohet nga timbri i zërit të mësuesit sa i qartë është, por a është edhe i kuptueshëm për të gjithë, një element tjetër është mënyra e parashtrimit të pyetjeve, pra pyetje të drejtuara individualish apo për gjithë klasën ku rreth kësaj mënyre ka perceptime të ndryshme nga ana e nxënësve krahasuar me mësuesit.

Nga anketimi i nxënësve, por edhe nga vëzhgimi mësuesit u drejtonin nxënësve pyetje me zë të lartë dhe të qartë në masën e rreth 98%. Pyetjet që mësuesit drejtonin arrinin të dëgjoheshin edhe nga nxënësit në bankat e fundit sipas vëzhgimit të klasave. Së bashku me gjetjet me cilësinë e zërit, nxënësit shprehën mendimin e tyre rreth qasjes së pyetjeve nga mësuesit. Nxënësit janë shprehur pozitivisht për qasjen e pyetjeve. Dhe duha ta citoj një thënie të një grup nxënësish të një shkolle në klasën: "....*Mësuesi ynë është shumë miqësor me ne, ai na bënë pyetje në mënyrë shumë miqësore dhe nëse ne nuk e kuptojmë zërin e tij apo pyetjen, e përsërit dhe nuk na bërtet. Nëse ne dështojmë në përgjigjen e pyetjes, ai na ka ndihmuar që ne të përgjigjemi, na fyer*". Është e qartë se citimi i

mësipërm paraqet kënaqësinë e këtyre nxënësve për qasjen e mësuesve për të drejtuar pyetje. Shumica e nxënësve u shprehën se mësuesit drejtojnë pyetje në mënyrë miqësore, me përjashtim të disa rasteve kur mësuesit fyejnë, apo ndëshkojnë, një grup jo shum i madh nxënësish u shprehën se: mësuesi ynë nuk na përsërit pyetjet, madje kur i kemi thënë a mund të na i thuash prap se nuk e dëgjuam, thotë:'' a t'ju vë të gjithëve nga një notë katër, ose kur pyetja drejtohet individualisht sidomos tek nxënësit e dobët mësuesi ynë i vë direkt katër''. Kjo tregon një qasje të ulët të mësuesve ndaj të pyeturit.

Por, një aspekt tjetër është mënyra e drejtimit të pyetjeve, që mund të jetë, pra individuale, ose për gjithë klasën. Sipas intervistimit të mësuesve në këtë aspekt ndikojnë natyra dhe përmbajtja e pyetjes. Nga intervistimi u pa se mësuesit parapëlqenin për t'i bërë pyetje nxënësve në mënyrë individuale në vend që t'i drejtonin pyetje të gjithë klasës. Në 18% të mësimeve u drejtuan pyetje të gjithë klasës dhe në masën 70% të mësimeve, pyetjet parapëlqeheshin të drejtoheshin në mënyrë individuale, dhe në masën 2% drejtoheshin në grup, kjo ndoshta se puna në grup përdorej shumë pak. Sipas mësuesve pyetjet për gjithë klasën ishin në masën 50%, individuale 40% dhe në grup 10%. Por, në rastet kur mësuesit drejtonin pyetje për gjithë klasën, ata shpreheshin se gjithmonë tendenca ishte të përgjigjeshin nxënësit që mësonin. Por, pati raste se kur mësuesi drejton një pyetje për gjith klasën, pra që gjithësecili të mendohet e të përgjigjet, shpesh ndodh që nxënësit ta keqinterpretojnë dhe të përgjigjen të gjthë së bashku. Ndërsa, drejtimi i pyetjeve në mënyrë individuale shpesh përputhet me nivelin e nxënësit, u drejtohet nxënësve që janë për vlerësim, por edhe në rastet kur një nxënës nuk përgjigjet i drejtohet një nxënësi më të mirë, sipas mësuesve të intervistuar.

Duke qënë se mësuesit pjesën më e madhe të kohës drejtojnë pyetje në mënyrë individuale, lind nevoja që ata shpesh të drejtojnë pyetjen duke i'u drejtuar me emër nxënësit që do të japë përgjigjen. Por, ndodh që mësuesit të drejtojnë pyetje për gjithë klasën dhe më pas të drejt një nxënësi, sepse pyetjet me përgjgije në kor janë shumë të ralla ose aspak, ose për pyetjet individuale mësuesit mund të mos i drejtohen me emër

dhe mund ti thuan ju atje etj. Gjatë intervistimit ata janë shprehur se:’’të pyeturit duke i’u drejtuar me emër nxënësit vendos më shumë kontakt midis mësuesit dhe nxënësit e vë atë më shumë në pozitë pune, mendonin se mësuesit u jepnin prioritet, rrit vëmendjen e nxit, por mund të ketë edhe efekt të kundërt mund të krijojë tek nxënësi ankth, emocione nëse i drejtohemi në mënyrë të drejpërdrejtë.

Kohën si faktor ndikues në procesin e të pyeturit studiuesit e shikojnë në dy këndvështrime: koha kur drejtohen pyetjet dhe këtë e lidhin me etapat mësimore dhe sasia e kohës që mësuesi lejon të kalojë pasi ka parashtruar pyetjet (Mësimdhënia dhe të nxënit bazuar në kompetenca,

http://ëëë.portalishkollor.al/dokumenta/M%C3%ABsimdh%C3%ABnia%20dhe%20t%C3%AB%20nx%C3%ABnit%20bazuar%20n%C3%AB%20kompetenca%20.pdf). Sasia e pyetjeve që mësuesit drejtojnë gjatë mësimdhënies ndryshon nga një fazë mësimore në tjetrën. Mësimi sipas përkufizimeve teorike zhvillohet në tre faza: evokim, realizimi kuptimi dhe reflektim (Instituti për zhvillimin e arsimit, Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës së në AMU(klasat VI-IX),(Tiranë: 2017).

Në fazën e parë, mësuesit përdorin zakonisht një sasi të vogël pyetjesh ndoshta për shkak se kjo periudhë zgjat pak në kohë. Të dhënat e intervistës së mësuesve treguan se në këtë fazë mësuesit përdorën disa pyetje që nxitnin mendimin e nxënësve, rrisjelljen e njohurive apo përgatitjen paraprake për njohuritë. Qëllimi i këtyre pyetjeve ishte për të nxitur situatën për përparim të mëtejshëm të mësimit. Ndërsa në fazën e dytë, e cila zgjat relativisht shumë në kohë, mësuesit në thelb i prezantojnë mësimin dhe përpiqen t'i ndihmojnë nxënësit të marrin mesazhin e mësimit. Paraqitim temën dhe njëkohësisht, u bëjmë nxënësve pyetje të shkurtra, për të kontorlluar vëmendjen. Sipas mendimit të mësuesve, përmes pyetjeve në këtë fazë ata mund të kuptonin nëse nxënësit po kuptonin mësimin ose jo. Por, dhe në reflektim mësimit mësuesit i drejtuan pyetje nxënësve me qëllim vlerësimin e tyre. Pyetjet e kësaj faze filluan pas mbarimit të shpjegimit nga ana e mësuesve. Shumica e pyetjeve ju drejtuan nxënësve në këtë fazë,

afërsisht 40% e pyetjeve. Pyetjet që mësuesit drejtonin në këtë fazë ishin kryesisht ushtrimet nga teksti.

Një faktor që mund të ketë efekte të fuqishëm në pjesëmarrjen e nxënësve është sasia e kohës që një mësues jep midis pyetjes dhe pritja e përgjigjes. Hulumtimet për pyetjet në klasë dhe për përpunimin e informacionit tregojnë se nxënësit kanë nevojë për të paktën tre sekonda për të kuptuar një pyetje, për të shqyrtuar informacionin në dispozicion, për të formuluar një përgjigje dhe për të filluar përgjigjen, i njëjti hulumtim ka vërtetuar se, mesatarisht, një mësues në klasë lejon më pak se një sekondë kohë pritëse

Asking useful questions: goals, engagement and differentiation in technology-enhanced language learning:http://yadda.icm.edu.pl/yadda/element/bëmeta1.element.desklight-bacf0615-cf92-4b6b-b51f 87bcc52c8138/c/2._Asking_Useful_Questions_Goals_and_Guides_for_Technology Enhanced_Language_Learning__by_Joy_Egbert__2007-1_.pdf

Koha e pritjes është një faktor i rëndësishëm për praktikën e duhur të pyetjeve. Koha e pritjes është koha që mësuesi i ofron një nxënësi pas një pyetjeje për të menduar përgjigjen e pyetjes. Mësuesit gjatë intervistimit janë shprehur se ata i japin kohën e mjaftueshme nxënësve për t'u përgjigjur,po ashtu mendonin dhe nxënësit. Gjithashtu nga vëzhgimi i klasës, vetëm në disa shkolla u pa se mësuesit u dhanë kohë nxënësve për përgjigje në 80% të rasteve, por kishte raste kur mësuesi drejtonte një pyetje dhe nuk i linte nxënësit shumë kohë aq sa dhe nxënësi ndihej në presionin e kohës ‘’për t'u menduar dhe dhënë përgjigje, sepse ai i thoshte:’’nëse nuk e di ulu’’ ose ngrinte një nxënës tjetër, pa i dhënë kohë nxënësit të mendohej ose përgjigjej vetë. Llogaritja e kohës tregoi se mësuesit për rreth 60% të pyetjeve, ofruan afërsisht 2” për t'u menduar e përgjigjur nxënësit, pra për të menduar rreth pyetjeve. Vetëm 1” është dhënë për 16% të pyetjeve. Nga ana tjetër, për 17% të pyetjeve, mësimdhënësi dha një kohë të pritjes prej më shumë se tre sekonda, dhe rreth 1', 7%. Pritja rreth një minutë ishte në ato rastet kur mësuesi vërente

se nxënësi nuk kishte ‘’nivel’’ ose për nxënësit që ata mendonin se mund të jepnin një përgjigje.



Grafiku 3:Koha e përgjigjes

Siç e shohim koha e pritjes së përgjigjes ishte e kufizuar brenda 1-3 sekondave. Në intervistë mësuesit e menduan atë në varësi të niveleve të vështirësisë së pyetjeve, por edhe nivelit të nxënësve koha e pritjes ndryshonte. *Mësuesit argumentuan se ishte humbje kohe për të pritur përgjigjen nga ata nxënës të cilët nuk mund të përgjigjen ose që mbanin poshtë kokën e tyre pas pyetjeve.* Sipas vëzhgimit mësuesit shpesh nuk i jepnin kohë nxënësve, ata çonin një nxënës tjetër ose përgjigjej vetë. Për pyetje të vështira nevojitet kohë për t’u menduar. Megjithatë, mësuesit menduan se duhet të japin më shumë kohë për nxënësit të mendojnë, por pasi ata kishin kufizim kohor, ata nuk mund ta bënin këtë. Shumica e mësuesve menduan se nxënësit mund të përgjigjen në mënyrë të qetë dhe në mënyrë të qartë nëse ata i ofrojnë disa herë për të menduar për këto pyetje. Mësuesit shtuan se nëse nxënësve ‘’u ushtrohet’’ presioni i kohës ata nuk mund t'i përgjigjen pyetjes megjithëse ata e dinë përgjigjen. Kjo është arsyeja pse mësuesi duhet të presë për disa kohë pasi ka bërë pyetje.

Reagimi në procesin e pyetje-përgjigjes është një faktor ndikues në krijimin e një klime bashkëpunimi në klasë. Ky reagim mund të vijë nga mësuesit ose shokët e klasës. Reagimi është një komponent i rëndësishëm

i praktikës së marrjes në pyetje. Gjithmonë mësuesit reagojnë pas përgjigjes së nxënësve në mënyrë ‘’pozitive’’ ose ‘’negative’’. Por, shpesh pas përgjigjes së pyetjeve reagimi është edhe nga ana e shokëve të klasës. Janë këto komponente që e frenojnë shpesh të pyeturin nga ana e nxënësve. Pjesën më të madhe të kohës, mësuesit dhanë reagime drejtuar nxënësve në mënyrë individuale, duke qënë se shumica e pyetjeve që drejtoheshin ishin individuale. Nga vëzhgimi i disa klasave, vura re se mësuesit në të gjitha rastet reagonin ndaj përgjigjeve të nxënësve. Sipas intervistimit, mësuesit regonin në mënyrë “pozitive" edhe kur përgjigjet e nxënësve nuk ishin të plota apo të pasakta, ku sipas tyre me anë të reagimeve të tyre ata donin t’i ndihmonin nxënësit ndërsa përballeshin me vështirësi. Ndonjëherë nxënësit përgjigjegjen pjesërisht për pyetjet dhe në këto raste ne i ofrojmë pyetje frymëzuese ose nxitëse. Mësuesit shprehen se ata përdornin fjalë të ndryshme lavdëruese si faleminderit, shumë të mirë, shkëlqyer, vazhdoni se keni shumë të drejtë etj. Reagimi i mësuesit është shumë i rëndësishëm sepse mund t’i motivojë ose demotivojë nxënësit. Këtë e shprehnin edhe mësuesit: ‘’reagimi në mënyrë positive ndaj përgjigjes së tyre i entuziazmon nxënësit’’. Nga ana tjetër nxënësit raportuan se mësuesit e tyre shpesh reagojnë në mënyër jo nxitëse në rast se nxënësit japin përgjigje të pasakta ose të paplota ata ngrenë menjëherë një nxënës tjetër, përgjigjen vetë, ose thonë ‘’po këtë përgjigjen e një pyetjet kaq të thjeshtë nuk e di’’, pra nuk na nxitin ose stimulojnë raste shumë të rralla mund të na nxisin, ndërsa kur përgjigjet janë të sakta në fund na thonë ‘’shumë mirë, të lumtë, bravo.

3.3. Pjesëmarrja e nxënësve në procesin e të pyeturit dhe perceptimet e tyre rreth këtij procesi.

Pjesëmarrja e nxënësve në procesin e të pyeturit është jetike. Ajo tregon se sa të gatshëm janë nxënësit për të marrë pjesë procesin e të pyeturit, pyetjet që ata mund t’i drejtojnë mësuesit, sa të gatshëm janë ata për t’u përgjigjur pyetjeve që mësuesi drejton. Një nga fokusimet kryesore të studimit ishte për të hetuar pjesmarrjen e nxënësve në procesin e të pyeturit, jo vetëm në kontekstin për të dhënë përgjigje, por edhe për të

pyetur. Aspekti i dytë shumë i rëndësishëm për të pyeturin janë perceptimet e nxënësve rreth këtij procesi etj.

Nxënësit raportuan se ata janë aktivë në procesin e marrjes në pyetje, të kundërtën raportuan mësuesit ata u shprehën se nxënësit nuk ishin shumë të gatshëm të merrnin pjesë në këtë proces. Nga ana tjetër, nxënësit ju përgjigjën pyetjeve të mësuesve, por nuk treguan interes ose entuziazëm për t'ju përgjigjur pyetjeve të mësuesve, menjëherë pasi t'i dëgjojnë pyetjet nga mësuesit; mësuesve i'u desh t'i thërriste në emër për t'iu përgjigjur pyetjeve, për shumicën e nxënësve, jo për të gjithë nxënësit dhe shumë nga këta nxënës i'u përgjigjën pyetjes së mësueses pavarsisht se nuk e kishin ngritur dorën. Nga intervistimi i mësuesve, nga anketimi i nxënësve, por edhe nga vëzhgimi i disa klasave rezultoi, por edhe vura re se nxënësit në shumicën e rasteve nuk u përgjigjën me vullnet. Rezultoi se 70% e nxënësve nuk përgjigjeshin me shumë vullnet dhe rreth 30% përgjigjeshin me vullnet. Sipas vëzhgimit të klasave vura re se mësuesit nuk bënin një përzierje të nxënësve që përgjigjeshin me dëshirë dhe ata që mund t'i ngrinte mësuesi, pasi ata synonin të pyesnin më shumë nxënësit që ishin për t'u vlerësuar. Si rezultat, shumica e nxënësve nuk mund të ishin pjesëmarrëse në praktikën e marrjes në pyetje dhe në fund të fundit ata humbnin interesin e tyre për të qënë aktivë. Mësimdhënësit kanë shprehur se të gjithë nxënësit nuk marrin pjesë në praktikën pyetje-përgjigje në mënyrë të barabartë.

Sot gjithnjë e më shumë po tentohet që nxënësi të vihet në rolin e atij që heton, vëzhgon, pyet. Nga vëzhgimi, u pa se nxënësit nuk u parashtruan shumë pyetje mësuesve. Ata mund të pyesnin për ndonjë koncept historik për procedurë apo për kuriozitet, por shumë pak. Sipas intervistimit të mësuesve, shumica u shprehën se nxënësit në shumicën e orëve maksimumi i pyetjeve ishte dy në masën 80%, një zinte masën e 15% dhe më shumë se dy në masën e 5%. Shpesh pyetjet që nxënësit drejtonin ishin pyetje të nivelit të ulët, për të marrë një informacion, për të saktësuar diçka, për të verifikuar një informacion të marrë më parë, për të thelluar një informacion, për të kontrolluar veten, por përqindje të konsiderueshme zinin edhe pyetjet udhëzuese apo sqaruese. Të pyeturit për të kuptuar një koncept ka një % shumë të madhe, madje mund të

themi se me të pyeturin nga ana e nxënësve ndodh e kundërta e asaj që duhet të ndodhë në të vërtetë, kjo është një tregues që të pyeturit nuk funksionon siç duhet. Në qoftëse të pyeturit nga ana e nxënësve në shumicën e rasteve duhet të shërbejë si një burim informacioni për të thelluar informacionet, saktësuar idetë etj, shohim se përqindjen më të madhe e zënë pyetjet thjesht për të kuptuar ndonjë koncept historik apo udhëzuese se si duhet të veprojnë për të kryer një detyrë apo një punim, këto të dytat janë pyetje jo mësimore jo produktive në të nxënë. Në qoftë se nxënësit duhet që të pyesin dhe ata e dinin se kjo ishte edhe e drejta e tyre, por ata tërhiqeshin ose nuk kishin kuriozitet të pyesnin, pra ndikojnë disa faktorë të cilat të cilat i trajtuam në çështjet më lart, por edhe përceptimet e nxënësve. Sipas mësuesve ata pyesin pak se nuk i kushtojnë vëmendje mësimeve, kështu që ata nuk mund ta kuptonin dhe si rezultat nuk i lind ndonjë pyetje.

Shumica e nxënësve kanë raportuar se mund t'u përgjigjen shumicës së pyetjeve të mësuesve. E njëjta gjë u raportua edhe nga ana e mësuesve. Nga anketimi rezultoi se nxënësit u përgjigjeshin mësuesve në masën e 85% të pyetjeve, pavarsisht nivelit të saktësisë. *Nxënësit raportuan se ndonjëherë ata përballeshin me vështirësi për t'iu përgjigjur disa pyetjeve ose nuk mundën mbani mend përgjigjen.* Kjo ndodh zakonisht kur janë pyetje me përgjigje fikse. Mësuesit raportuan se shumicën e kohës ata janë të kënaqur me përgjigjet nga nxënësit.

Të pyeturit nga ana e nxënësve shihet si një praktikë e preferuar për vlerësim sidomos nga mësuesit sipas tyre, këndvështrime të tjera, si pëlqimi dhe mospëlqimi për pyetjet, llojet e pyetjeve që pëlqejnë, mendimet ose besimet e nxënësve për pyetjet dhe rolin e tyre në mësimdhënien e tyre, por edhe në rezultatet mësimore. Nga intervistat e mësuesve por edhe nga anketimi me nxënësit, të pyeturin e identifikuan më së shumti si praktikën e preferuar për vlerësim, sidomos nga ana e mësuesve të cilën e trajtuam.Ndër të gjitha praktikat e vlerësimit me aanë të të pyeturit, nxënësit pëlqyen më së shumti kur mësuesit i vlerësuan ata përmes pyetjeve nga analogjia me jetën reale. Rreth 80% e nxënësve e shënuan si prakitkën më të parapëlqyer për vlerësim nga ana e mësuesve.

Nxënësve u pëlqen kjo teknikë për një numër arsyesh të ndryshme të shpjeguara më poshtë. Një nga arsyet më kryesore është se kjo teknikë i zhvilloi disa aftësi, si të folurit edhe të vëzhguarit apo edhe të përshkruarit. Një nxënës u shpreh se *"mua më pëlqen më së shumti kur mësuesi na vlerëson përmes pyetjeve, sepse pyetjet më ndihmojnë për të mësuar shumë gjëra në një kohë''*. Nxënësit u shprehën:*‘’kur mësuesi na tregon pyet rreth ndonjë fotoje dhe bën pyetje ne mund të mësojmë për të përshkruar dhe për të vëzhguar pamjen, por njëkohësisht na ndihmon të mësojmë më shpejt dhe na nguliten më mirë në mendje.''*Një pjesë e nxënësve pëlqenin vlerësimet me shkrim, edhe pse zinin afërsisht 40% të nxënësve. Ata renditën disa arsye, pse e pëlqenin këtë mënyrë. Ata besonin se përmes shkrimit ata mund të shprehnin njohuritë dhe shkathtësi e tyre më shumë, por gjithashtu ndiheshin më të qetë emocionalisht. Ata u shprehën, *‘’se mësuesit tanë na vlerësojnë edhe me shkrim, si edhe duke na drejtuar pyetje, mes këtyre dyjave na pëlqen më shumë praktika e vlerësimit me shkrim''*. Praktika e vlerësimit me shkrim pëlqehej nga ana e nxënësve sepse në rradhë të parë ata ishin më të qetë emocionalisht, nuk ishin nën komentin e mësuesit dhe nxënësve dhe mund të jepnin një përgjigje më të mirë se sa me gojë.

Një aspekt tjetër i perceptimit të tyre ishte edhe për kohën që mësuesi u jep për të pyetur nxënësit dhe për t’u përgjigjur. Ata u shprehën se një faktor ndikues ishte mungesa shpesh e hapësirës që mund të krijonte mësuesi për të pyeturit nga ana e nxënësve. Ata shpesh shpreheshin se nuk kishte kohë ose hapësirë gjatë orës mësimore kur ata të mund të drejtonin pyetjet për paqartësitë që mund të kishin, kjo e mbështetur në masën e 40%. Mësuesit drejtonin pyetje në shumicën e kohës së orës mësimore. Por nga shumica e nxënësve rreth 70% e tyre nuk pëlqenin që mësuesit në çdo fazë të mësimit të pyesnin dhe ky fakt i shqetësonte. Vetëm 30% e nxënësve raportuan se pëlqenin kur mësuesit drejtonin shumë pyetje. Sipas nxënësve, mësuesit u drejtonin atyre lloje të ndryshme pyetjesh, të lehta e të vështira. Ata raoportuan se disa pyetje ishin të lehta dhe ata mund të përgjigjeshin menjëherë, por disa pyetje ishin të vështira dhe ata nuk mund të përgjigjeshin menjëherë, por u duhet të mendoheshin. Por, siç e pamë edhe më lart mbizotëruese në orën mësimore të historisë ishin pyetjet e nivelit të ulët, të cilat ishin pyetje që

nuk kërkonin shumë kohë për t'u menduar. Por, rreth 30% e nxënësve kërkonin pyetje në të cilat ata të shprehnin mendimin e tyre.

Nxënësit ndanin percpetime të ndryshme edhe në lidhje me vlerësimin ose komentin e mësuesve për përgjigjet që ata jepnin. Ata u shprehën se kur ata jepnin përgjigje të sakta dhe mësuesit i lavdëronin ata nxiteshin më shumë për të punuar më shumë kështu mendonin rreth 98% e nxënësve, ndërsa vetëm 2% e nxënësve u shprehën se *''vlerësimi me fjalë motivuese nga ana e tyre nuk kishte ndonjë stimul pasi ne nuk kemi nevojë për nxitje që të mësojmë, ne na pëlqen, e bëjmë me kënaqësi''*. Ndërsa, kur nxënësit nuk përgjigjeshin saktë ose përgjigje jo të plota ndiheshin keq dhe kur mësuesit i qortonin ata demotivoheshin dhe madje nuk mund të thoshin as ato që mund të dinin, këtë e shohim më së miri tek një nxënës i cili kishte shkruar *"kur mësuesja më ngre për t'ju përgjigjur pyetjes dhe unë nuk jam shumë i sigurt në përgjigje nga frika e reagimit të mësuesit dhe të shokëve unë hutohem fare dhe nuk mund të përgjigjem, demotivohem fare''*. Rreth 90% e nxënësve ndihen të demotivuar kur mësuesit reagojnë jo në mënyrë pozitive ndaj përgjigjeve të gabuara. Ndërsa, 10 % u shprehën se nuk demotivohen nga reagimi negativ'' i mësuesit. Reagimi nga shokët ndikon jo vetëm në përgjigjen e pyetjeve që mund të drejtojë nxënësi, por edhe në pyetjet që ai mund të drejtojë për diçka të paqartë dhe kjo sjell që shpesh nxënësit të heshtin dhe nuk marrin ose japin atë që duan, pasi druhen nga reagimi i klasës. Pavarësisht se mësuesit mundohen t'i shmangin regimet negative të kolegëve ato janë të pranishme dhe madje janë të menjëhershme nga ana e nxënësve.

Besimi është një aspekt i rëndësishëm i perceptimit. Për të kuptuar perceptimin e nxënësve në drejtim të pyetjeve, mendimet e nxënësve u morën në konsideratë si një element me rëndësi. Anketimi tregoi se nxënësit kishin mendime të ndryshme rreth praktikës së pyetjeve. Pjesa e mëposhtme do të shqyrtojë mendimet e nxënësve lidhur me praktikën e pyetjeve. Nxënësit besonin se kishte një marrëdhënie pozitive mes pyetjeve të pyetura nga mësuesi dhe mësimin e tyre. Pasi që pothuajse 80% e nxënësve mendonin se nëse mësuesit bënin më shumë pyetje, ata do të mësonin më shumë. Në, histori nxënësit mendonin se kur mësuesit

u bënin pyetje, ata mund të kuptonin se sa kishin mësuar dhe në cilën pikë duhet ta përqëndojnë më shumë vëmendje. Ata gjithashtu raportuan se idetë e tyre u bënë të qarta kur mësuesit i drejtuan atyre pyetjet.

Një nga rolet kryesore të një pyetje është të nxisë mendimin kritik të nxënësve. Rreth 30% e të anketuarve nuk e kuptonin se si të pyeturit ndikonte në mendimin kritik të tyre, madje nga këta 10 % nuk e njihnin mendimin kritik. Ndërsa, 70% e të anketuarve mendonin se pyetjet e pyetura në klasë i ndihmuan ata të zhvillonin të menduarit kritik. Kjo mbase vjen për arsye se pyetjet që mësuesit drejtojnë janë të niveleve të ulëta, dhe duke qënë kështu nxënësit edhe nuk mund ta njohin.

Përsa i përket perceptimit se duhet të ngiheshin për t'u përgjigjur vetëm nxënësit me dëshirë apo edhe nxënësit e tjerë, perceptimi qëndronte pothuajse në raporte të barabarta. Rreth 50% e nxënësve besonin se pyetjet duhet t'u kërkohen atyre nxënësve që ishin të gatshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve. Po, 50% e nxënësve besonin se pyetjet duhet t'u bëhen edhe atyre nxënësve që nuk kanë marrë pjesë në pyetje-përgjigje me dëshirë. Në të vërtetë duhet të sigurohet njëkohësisht pjesëmarrja e ekuilibruar ndërmjet vullnetarizmit dhe nxënësve jo-vullnetarë. Një nxënës kishte shkruar për këtë, "*të pyeturit krijojnë një lloj nxitje që duhet ta mësojmë mësimin, ka ndodhur që kur kemi orët e shkurta ne e dimë që mësuesit nuk na pyesin dhe unë nuk kam mësuar.''* Pra, këtu shohim se sa nxitëse janë pyetjet për nxënësit. Por, pyetjet nga ana e nxënësve nuk shihen vetëm si nxitëse, por edhe produktive në mësimnxënien e historisë, se janë pyetjet ato që sjellin tek nxënësit të kuptuarit e mësimit për gjërat e paqarta, pra nxënësit drejtojnë pyetje, por janë pyetjet nga ana e mësuesit të cilat ngulitin, organizojnë edhe më mirë njohuritë e marra. Shumica mendonin se mund ta kuptojnë mësimin mirë nëse mësuesi bën pyetje.

Të pyeturit shërbente si një promovues i aftësive të të menduarit të nxënësve. Kjo u mbështet nga rreth 70% e nxënësve. Por, ne e pamë se pyetjet që mbizotëronin në mësimdhënien e historisë ishin të nivelit të ulët, pyetje të cilat nuk promovonin shumë mendimin e nxënësve, pra nxënësit mund të shprehnin mendimin e tyre por shumë pak. Janë pyetjet

e nivelit të lartë të cilat i ndihmojnë ata të zhvillonin aftësitë e të menduarit. Këto pyetje i angazhojnë ata në një mendim më të thellë. Në anën tjeter, 30% e të anketuarve mendonin në mënyrë të kundërt. Ata menduan se pyetjet të cilat mësuesit drejtonin nuk ndikoni në promiovimin e aftësive të të menduarit për arsye se mësuesit e tyre drejtonin pyetje me përgjigje të cilat ishin në libër dhe shumë pak herë në pyetjet që drejtonte mësuesi kërkohej mendimi i nxënësve.

Vëmendja e nxënësve gjatë porcesit të mësimdhënies ka një rol të rëndësishëm, sipas perceptimit të nxënësve mardhënia pyetje-përgjigje bënte që ata të ishin të vëmendshëm.Të vëmendshëm për të dëgjuar pyetjen, të vëmendshëm për të dëgjuar përgjigjen e shokëve. Rreth 90% e nxënësve u shprehën se procesi i pyetje-përgjigjes i mban ata të përqëndruar në mësim. Ata mund ta përqëndrojnë vëmendjen për të dëgjuar pyetjen më shumë se sa përgjigjen që mund të japë shoku, kjo ndoshta lidhet me reagimin që jepte mësuesi nëse nxënësi nuk kishte dëgjuar pyetjen.

Grafiku 4: Arsyet pse pyesin nxënësit



Kalimi i testimit, perceptimi i nxënësve shkon shumë larg rreth të pyeturit ata mendojnë së të pyeturit luan një rol të rëndësishëm në rezultate e testeve që mësuesit ose instancat e tjera u bëjnë atyre. Ky perceptim ekzistonte në masën e 95% të nxënësve. Ata u pajtuan me pohimin se mësuesit vënë në test pyetjet që ata pyesin gjatë mësimit. Disa nxënës ishin shprehur se:*''mësuesi i tyre u thotë, mos e keni vëmendjen këtu, por kur t'ja u vë në test këtë'' dhene menjëherë dëgjojmë me vëmendje përgjigjet që japin shokët pyetjes së mësuesve"*. Por, ishte edhe thënia e një nxënësi të vetëm, i cili ishte shprehur se: *unë nuk mësoj shumë në shtëpi, thjesht jam i vëmendshëm gjatë shpjegimit, por sidomos në pyetje-përgjigjet që bën mësuesi dhe kam vënë re se mësuesi gjithmonë vë në test pak a shumë pyetjet që drejton në klasë, dhe nga ky dëgjim unë kam arritur rezultatet shumë të mira në teste''*. Pra, nëse mund t'i mësojmë ata nga klasat tona ne mund të shkruajmë saktë provimi. Sipas anketimit mësuesi bën pyetje që do të jenë edhe në teste mbështetet në masën 80% dhe vetëm 20% mendonin të kundërtën. Kjo shihet si një aspekt mjaft ndikues që nxënësit të jenë të vëmendshëm gjatë gjithë kohës.

3.4. Faktorët që ndikojnë tek të pyeturit sipas gjetjeve të kërkimit

Të pyeturit nuk funksionon ashtu siç duhet gjatë orës mësimore së historisë dhe këtë e treguan më së miri rezultatet e anketimit të nxënësve, intervistimi i mësuesve dhe vëzhgimi i klasave se si funksiononte realisht të pyeturit në praktikë nga ajo që duhet të jetë sipas kuadrit teorik, në disa aspekte ato duken sikur janë shumë larg njëra-tjetrës e në disa aspekte ka vend për përmirsime. Faktorët që do t'i trajtojmë do t'i shohim të ndarë në disa grupe si mësuesit të cilët do t'i shohim në kontekstin e aktorëve kryesorë dhe do t'i trajtojmë më gjatë, nxënësit të cilët janë aktorë të rëndësishëm në procesin e mësimdhënies, por jo ndikuesit kryesorë, faktorë të tjerë janë hartuesit e teksteve të cilët duhet të bëjnë kujdes me formulimin e pyetjeve që ata përfshijnë në temat mësimore sepse mësuesit i përdorin këto pyetje si burim për mësuesit dhe trajnuesit e

mësuesve që mund të luajnë rol duke i përditsuar njohuritë e mësuesve në përputhje me kërkesat e kohës. Sipas vëzhgimeve të takimeve të rrjetit professional të mësuesve vura re se ata nuk bënin shkëmbim përvojash, por trajtonin aspekte teorike, aspekti teorik është shumë i rëndësishëm, por mësuesit aspektin teorik mund ta studiojnë vetë dhe atje të bëjnë shkëmbim përvojash.

Faktorët që ndikojnë nga ana e mësuesit për mosfunksionimin e duhur të teknikës së të pyeturit si proces dhe si teknikë janë: *së pari*, mospërgatitja paraprake e pyetjeve në planin ditar, mësuesi ashtu siç parashikon në planin ditar atë që do të trajtojë me nxënësit të njëjtën gjë duhet të bëjë edhe me pyetjet, kjo nuk do të thotë se ai duhet që me patjetër duhet të zbatojë mepërpikmëri pyetjet që do të planifikojë se rrjedha mësimore nuk është gjithmonë eparashikueshme, mund të lindin situata që ne nuk i kemi planifikuar, por kur kemi disa pyetje në mendje mund të na ndihmojnë për të krijuar një situatë të suksesshme e produktive në mësimdhënie. Por, edhe pyetjet e formuluara në moment mund të jenë produktive ose të formuara mbi bazën e kriterve didaktike. Ne duhet t'i kemi disa pyetje të planifikuara për të mos u menduar gjatë mësimit dhe të humbim kohë.

Së dyti, pyetjet e formuluara nga ana e mësuesit duhet të zbatojnë me përpikmëri kriteret didaktike për hartimin e pyetjeve atao duhet të ndërtohen sipas niveleve të taksonomisë, pra në gjashtë nivelet e saj dhe jo të bazohemi tek pyetjet e nivelit njohës, është shumë e drejtë që këto pyetje luajnë një rol të rëndësishëm të njohurive, se pa faktë nuk mund të kalojmë në analizë, kalimi bëhet i dalëngadalshëm, në fillim nxënësi duhet ta njohë më pas të krijojë konceptimin e vet rreth fenomenit, ngjarjes që mëson, më pas e zbaton dhe pastaj kalon tek pyetjet e nivelit të lartë që janë analizë, sintezë e vlerësim. Duhet që midis këtyre llojeve të bëhet një miksimim i niveleve në përdorim dhe jo vetëm të drejtojmë pyetje të nivelit të njohjes, se këto pyetje nuk ngjallin diskutime, debate, nuk nxitin mendimin tek nxënësi. Kriteri tjetër didaktik që duhet të merret në konsideratë nga an e mësuesve është gjatësia e pyetjes. Një pyetje e formuluar gjatë mund të shkaktojë te nxënësi konfuzion pasi ai mund të mos e kuptojë se çfar mësuesi kërkon të dijë nga ana e tyre dhe

mund të japë një përgjigje të gabuar, pyetja në vetvete duhet të përmbajë thelbin e lëndës substanciale. Dy kriteret e tjera janë mënyra e formulimit të pyetjes dhe qartësia e saj, të cilat duhet të respektohen nga ana e mësuesve për të marrë atë që ata duan të kuptojnë nga nxënësi.

Së treti, pyetjet që mësuesit drejtojnë duhet të jenë në përputhje me rezultatet e të nxënit me kompetenca të përgjithshme të lëndës dhe kompetencat spesifike të temës, sepse këto janë standard të cilat janë të përcaktuara nga studiuesit e fushës dhe janë kompetencat që nxënësi duhet të zotërojë në atë lendë dhe më pas në temën mësimore specifike. Gjithashtu, kompetencat janë të hartuara në bazë të niveleve të ndryshme të taksonomisë dhe të bazuarit tek ato për të ndërtuar më pas pyetjet do të thotë se mësuesi do të përdorë një shumllojshmëri nivele pyetjesh.

Së katërti, qëlimi pse mësuesit pyesin, ndoshta në teori mësuesit e dinë se të pyeturit ka shumë qëllime, në praktikë rezulton e kundërta, ata në shumicën e rasteve e përdorin si praktikën e preferuar për vlerësim, por për të vlerësuar sa nxënësi di. Kjo, është një praktikë e gabuar,mësuesi duhet ta përdorë pyetjen me qëllim vlerësimin për të përmirësuar më tej punën e tij, duke kuptuar ku nxënësit kanë paqartësi dhe si mund të veprojnë ata për të ndihmuar nxënësit.

Dy qëllimet e tjera pse mësuesit duhet të përdorin pyetjet janë qëllimi motivues dhe qëllimi për të krijuar një atmosferë pune në klasë. Qëllimi motivues është një qëllim që duhet të përdoret nga ana e mësuesit, sepse shpesh nxënësit kanë nevojë për motivim, shtytje, kjo nuk do të thotë se ne duhet t'i tregojmë përgjigjen, por duke i drejtuar pyetje të tjera nga ku ne mendojmë se ato mund ta çojnë nxënësin në përgjigjen e pyetjese që ne drejtojmë. Qëllimi motivues, mund të jetë edhe nëpërmjet motivimit që ne mudn t'i bëjmë nxënësit duke e përgëzuar për rezultatet. Qëllimi i krijimit të një atmosphere pune është një komponent i rëndësishëm, madje mund të themi se është kryesori, sepse në një klasë ku ka atmosferë pune, ku nxënësit e mësuesi janë në bashkëpunim të vazhdueshëm me njëri tjetrin përfitimet do të jenë të mëdha tek nxënësit dhe ora nuk do të jetë një orë e bezdisshme.

Së pesti, llojet e burimeve që mësuesit përdorin për hartimin e drejtimin e pyetjeve, mësuesit zakonisht përdorin si burim për pyetjet tekstin, ushtrimiet që ai përmban dhe pyetje të nivelit të njohjes nga tema mësimore dhe shumë pak përdor pyetjet që mund të bëjnë analogjinë e jetës së përditshme me përmbajtjen e temës mësimore kjo analogji bën që nxënësit të jenë më të vëmendshëm, të jenë më aktivë dh eta ruajnë më gjatë në kujtesën e tyre. Ndërsa, pyetjet e drejtuara nga ushtrimet e tekstit mund të shërbejnë si burim pyetjesh por jo vetëm pyetjet e rubrikës së parë kontrollo njohuritë, por edhe rubrikat që kërkojnë arsyetim e vlerësim.

Së gjashti, rol të rëndësishëm në funksionimin e të pyeturit luan edhe mënyra e qasjes ose ofrimit të pyetjeve dhe mënyra e drejtimit të pyetjeve. Mënyra e qasjese së pyetjes nga ana e mësuesi mund të ketë efekt te nxënësi, por ka edhe raste kur ajo nuk mund të ketë, nëse pyetjet ofrohen në mënyrë miqësore, jo t'ia bësh të qartë se po i drejtoheni për ta vlerësuar, atëherë nxënësi do të mund të ndihet më i qetë emocionalisht dhe në këtë kontekst ai mund të shfaqë më lirë mendimin e tij. Mënyra e drejtimit të pyetjeve që zakonisht më shumë përdorin mënyrën e drejtimit individual, pra në fiilim mësuesi mund t'i thotë dikujt ngrihu dhe më pas t'i drejtojë pyetjen, ose këtë pyetje do e thotë x që ndodh rëndom në shkollë kjo mënyrë e drejtimit të pyetjeve. Nëse ne e drejtojmë pyetjen në këtë mënyrë, atëherë nxënësit e tjerë mund të bjenë në pasitivitet duke menduar se mësuesi e ngriti dikë tjetër e nuk do na ngrerë ne ai mund të humbë vëmendjen. Ndërsa, kur mësuesi ia drejton pyetjen gjithë klsaës atëherë të gjithë nxënësit do tëndihen të angazhuar se askush nuk e di se kush do të ngrihet të gjithë do të fillojnë të mendojnë një përgjigje, për pyetjen që mësuesi drejtoi. Mënyra e drejtimit të pyetjes në grup është një mënyrë efktive nëse nxënësit krijojnë bashkëpunim e bashkëveprim, pasi në këtë mënyrë në përjekje për të dhënë përgjigje ata marrin e japin nga njëri-tjetri.

Së shtati, sasia e pyetjeve që mësuesi drejton në raport me cilësinë. Një mësues gjatë një ore mësimore drejton shumë pyetje. Por, këto pyetje që ai drejton duhet të jenë në përputhje me kriteret didaktike

Së teti, koha që mësuesi drejton pyetjet, koha që mësuesi u lë nxënësve në dispozicionpër t'u përgjigjur dhe koha që mësuesi u lë nxënësve për të pyetur. Mësuesi duhet të drejtojëpyetje në të treja fazat e mësimit, jo vetëm në evokim dhe reflektim, por edhe në realizim kuptimi me qëllim që nxënësit të jenë aktivë për të kuptuar dhe forcuar njohuritë, për të qënë të vëmendshëm, për të parë nëse ata mund të dinë diçka rreth asaj që mësuesi flet dhe për të shpjeguar ndonjë paqartësi. Koha që mësuesi u jep nxënësve për t'u përgjigjur është shumë e vlefshme sidomos për ato pyetje të cilat kërkojnë analizë, vlerësim apo sintezë, ndërsa për tre pyetjet e nivellit të ulët mësuesit duhet të japin më pak kohë sepse ato kërkojnë vetëm rriprodhim njohurish. Ndërsa, koha që mësuesi u jep nxënësve për të pyetur është një element tjetër që ndikon, por kjo duket se funksionon mirë nga ana e mësuesve ata në të shumtën e rasteve u japin kohë, por ndodh edhe që kur nxënës kërkon të bëjë një pyetje ata thonë pritë në fund të orës.

Së nënti, strategjitë dhe taktikat e tjera që mësuesi ndjek për të realizuar procesin e të pyeturit. Mënyra se si mësuesi reagon qoftë kur nxënësi pyet dhe qoftë kur nxënësi përgjigjet, ndikojnë shumë në procesin e të pyeturit. Nëse mësuesi kur nxënësit pyesin i përgëzon pavarsisht pyetjes që ai drejton pavarsisht se në pamje të parë mund të duket e thjeshtë, nuk duhet t'i themi nxënësit po këtë pyetje kaq të thjeshtë nuk e di por duhet t'i japë një përgjigje dhe ta vlerësojë nxënësin që pyet dhe kështu nxënësit do të ndihen të vlerësuar dhe jo të paragjykuar dhe tek ata mund të lindë dëshira më e madhe për të pyetur. Mënyra se si i trajtojmë përgjigjet e nxënësve ndikon shumë tek nxënësit për të qënë pjesëmarrës aktivë ose jo në mësimdhënie. Nëse, ata për përgjigjet që japin marrin një vlerësim dhe jo një paragjykim ata do të ndihen se mjedisi në klasë është bashkëpunues dhe nuk do qëndreojnë inferior, trajtimi i përgjigjeve të gabuara, kërkon profesionalizëm nga ana e mësuesit, i cili duhet nuk duhet ta pargjykojë por duhet të bëjë përpjekje nëse nxënësi di diçka rreth kësaj pyetje duke i drejtuar pyetje të tjera për ta çuar tek përgjigja dhe nëse nxënësi nuk përgjigjet përsëri atëherë ne duhet ta këshillojmë atë për të mësuar më shumë. Në rastet se nxënësi jep një përgjigje pjesërisht të saktë ose pjesërisht të plotë atëherë ne duhet ta vlerësojmë për përgjigjen që jep në mënyrë që ai të ndihet i vlerësuar dhe imotivuar që herën tjetër

të përpiqet më shumë. Por edhe kur nxënësi përgjigjet saktë edhe atij duhet t'i japim një përgëzim jo vetëm ulu dhe kaq. Sepse vlerësimi tek nxënësit ndikon në motivimin e tyre. Të dëgjuarit me vëmendje pyetjet e përgjigjet e nxënësve, sepse ata janë burimi kryesor i dhënies së informacionit, sa puna juaj është realizuar, sa nxënësi ka arritur të kuptojë ku qëndrojnë vështirësitë apo problematikat. Vëmendja ndikon edhe në një drejtim tjetër, kur nxënësit kuptojnë se mësuesi i dëgjon me vëmendje atëherë ata mund të ndihen se mësuesi i tyre i vlerëson. Të dëgjuarit me vëmendje edhe kur nxënësit pyesin se nga pyetjet e tyre mësuesi mund të grumbullojë shumë informacion rreth punës që ai duhet të bëjë në klasë, në kontekstin se ku nxënësit nuk arrijnë të kuptojnë dhe çfarë mund të bëjë ai.

Së dhjeti, njohuritë substanciale që zotëron mësuesi, në lidhje me lëndën e historisë. Në qoftë se mësimdhënia është edhe art edhe shkencë ato të parat që trajtuam ishin më shumë art në pjesën më të madhe dhe shkencore në kriteret metodologjike. Njohuritë e lëndës janë shkencë të cilat mësuesi duhet t'i zotërojë. Mësuesi nuk duhet ta trajtojë lëndën e historisë thjesht nëkuadrin e marrjes së informacioneve historike, por duhet ta lidhë të shkuarën me të tashmen. Por tek të pyeturit ndikojnë edhe nxënësit. Mënyra se si ata e perceptojnë të pyeturinndikon shumë që ata të mos pyesin shumë apo dhe të mos ndihen të lirshëm e bashkëpunues. Ata e shohin si një praktikë të preferuar për vlerësim nga ana e mësuesit dhe duke e parë kështu ata nuk ndihen bashkëpunues në këtë proces dhe mendojnë nëse në pyesim ose përgjigjemi ‘’keq’’ ose gabim do të paragjykohemi dhe do të vlerësohemi negativisht nga ana e mësuesit. Kjo ndërpret bashkëpunimin dhe nxënësi nuk përfiton asgjë nga ky proces. Perceptimi i nxënësve rreth reagimeve ndaj pyetjeve që ata mund të drejtojnë, por edhe ndjenja e përgjigjeve që mund të japin, i mban ata në nivele ‘’frike’’, hezituese dhe jo bashkëpunuese. Nxënësi mban paqartësitë në vetvete dhe mëson thjesht në mënyrë mekanike, pra lexon mësimin e thotë edhe pse mund të mos e kuptojë. Reagimi nga shokët dhe nga mësuesi mund të ndikojë negativsht te nxënësi kur ai është demotivues dhe pozitivisht kur ai është motivues. Tek të pyeturit nga an e nxënësve ndikojnë edhe njohuritë që ai zotëron.

PËRFUNDIME

- Të pyeturit në mësimdhënien e historisë është një element shumë i rëndësishëm, përshkak të natyrës dhe objektivit që ka kjo lëndë. Të pyeturit qëndron në themel të komunikimitmasiv mësues nxënës, është një pyetje me shkrim ose me gojë që sqaron një çështje tëcaktuar, drejton e gjallëron idetë, nxit me shpejtësi imagjinatën dhe mendimin gjë që eshtyn për veprim, është art për të kërkuar informacion dhe mënyra që sqaron një çështjetë caktuar.

- Pyetjet dhe procesi i të pyeturit nuk funksionojnë në nivele adekute, si nga ana e mësuesve dhe nga ana e nxënësve. Mësuesi është aktori kryesornë këtë drejtim.

- Drejtimi i pyetjeve e marrja e përgjigjeve përmbushin disa përparësi në procesin e tëmësuarit të historisë. Drejtimi i pyetjeve ngre nivelin e orës së mësimit. Mënyra sesibëhën pyetjet është një nga treguesit e cilësisë dhe efektivitetit të mësimdhënies.Tëpyeturit është element aktiv që përdoret gjatë gjithë orës së mësimit.

- Qëllimet e pyetjeve që mësuesit drejtojnë konsitojnë në qëllimin vlerësëues, motivues dhe për të krijuar një atmosferë pune.

- Pyetjet e bazuara në rezultatet e të nxënit me kompetenca që mësuesit drejtonin gjatë mësimdhënies ishin shumë të pakëta.

- Pyetjet mbizotëruese që përdoreshin nga ana e mësuesve ishin pyetje të nivelit të ulët njohës, ndërsa pyetjet ë nivelit të lartë që kërkonin analizë, sintezë e vlerësim përdoreshin shumë pak, gjë kjo që humb qëllimin e krijimit të një klase kritike e krijuese.

- Burimi kryesor që mësuesit përdorin për të drejtuar pyetje është përmbajtja e temës mësimore dhe më pak përdorin ushtrimet e tekstit dhe pyetjet që kanë lidhje me jetën e përditshme.

- Kriterin didaktik për hartimin e pyetjeve që mësuesit e zotërojnë më shumë është kriteri i gjatësisë, më pas kriteri i qartësisë dhe shumë më pak kriteri i taksonomisë.

- Mënyra e ofrimit të pyetjeve nga ana e mësueve ishte me një qasje pozitive në më të shumtën e rasteve.

- Pyetjet nga ana e mësuesit drejtoheshin më shumë në mënyrë individuale, dhe më pak për gjith klasën dhe shumë pak në grup.

- Mësuesit më shumë pyetje drejtonin në fazën e evokimit e reflektimit dhe më pak në fazën e realizimit të kuptimit.

- Krahsa konceptit të kohës kur drejtojnë pyetje këtë koncept e përdorëm edhe nëkontekstin e kohës që mësuesi i jep nxënësit për përgjigje. Koha më e madhe duhet të jetëpër përgjigjet e pyetjeve të nivelit të lartë me qëllim që nxënësi të formulojë përgjigjen në mendjen e tij, ndërsa për pyetjet rriprodhuese koha duhet më e pakët sepse përgjigja është pak a shumë e ditur. Sasia e kohës që mësuesit jepnin ishte brenda 1-3". Mësuesit u shprehën se kufizimi kohor vjen edhe për arsye se koha është e kufizuar.

- Reagimi i mësuesve dhe i shokëve të klasës ndaj pyetjeve apo përgjigjeve që mund të japin apo drejtojnë nxënësit ndikon pozitivisht ose negativisht në procesin e të pyeturit.

- Pjesmarrja e nxënësve në procesin e të pyeturit është një komponent i rëndësishëm në procesin e të pyeturit. Ai ndikon e ndikohet drejtpërsëdrejti në këtë proces. Nxënësit pyesin shumë pak gjatë një ore mësimore dhe pyetjet që ata drejtojnë janë kryesisht pyetje të nivelit njohës. Nxënësit mendonin se kishte një marrëdhënie pozitive mes të pyeturit dhe të mësuarit, ata u shprehën se të pyeturit i ndihmonte ata të kontrollonin njohuritë e tyre, të qartësonin idetë, i ndihmonte në forcimin e njohurive dhe promovimin e aftësive të tyre dhe ndikonin në rezultatet e tyre mësimore.

- Realisht të pyeturit në praktikë nga ajo që duhet të jetë sipas kuadrit teorik, në disa aspekte ato duken sikur janë shumë larg njëra-tjetrës e në disa aspekte ka vend për përmirsime. Faktorët që i trajtuam i ndamë në disa grupe si mësuesit të cilët, i pamë në kontekstin e aktorëve kryesorë dhe i trajtuam më gjatë, nxënësit të cilët janë aktorë të rëndësishëm në procesin e mësimdhënies, por jo ndikuesit kryesorë, faktorë të tjerë janë hartuesit e teksteve të cilët duhet të bëjnë kujdes me formulimin e pyetjeve që ata përfshijnë në temat mësimore sepse mësuesit i përdorin këto pyetje si burim për mësim dhe trajnuesit e mësuesve që mund të luajnë rol duke i përditsuar njohuritë e mësuesve në përputhje me kërkesat e kohës, duke eleminuar kuadrin teorik dhe të vënë më shumë në përdorim kuadrin praktik.

REKOMANDIME

1. Mësuesve

- Planifikoni pyetjet paraprakisht për të përmbushur kriteret didaktike të hartimit të tyre dhe mirëfunksionimin e teknikës së të pyeturit.

- Përdorni pyetjet me qëllim vlerësues, por në kontekstin e të ndihmuarit të nxënësitduke e formësuar atë, jo duke i dhënë një notë për vlerësim.

- Përdorni pyetjet me qëllim motivues për nxënësit tuaj, sepse ata mund të kenë njëpërgjigje dhe mos ngrini nxënësin tjetër nëse ai nuk formulon dot përgjigjen,jepini kohë e motivoheni me pyetje motivuese.

- Krijo atmosferë pune nëpërmjet të pyeturit, drejto pyetje të cilat ngjallin debate ediskutime.

- Pjesëmarrja e nxënësve në procesin e të pyeturit është një element i rëndësishëmnë krijimin e bashkëpunimit në klasë. Sipas

anketimit të nxënësve u pa se ataishin të gatshëm për të marrë pjesë në procesin e të pyeturit, ndërsa nga vëzhgimidhe intervistimi i mësuesve nxënësit nuk ishin shumë aktivë në këtë proces, ataprisnin që mësuesi t'i drejtohej me emër pa të jepnin përgjigje edhe pse ata mundta dinin ata nuk ishin aktivë.

- Përdorni larmishmëri pyetjesh dhe shmang përdorimin në masë të madhe tëpyetjeve të nivelit të ulët, për të formësuar nxënësin dhe jo vetëm ta pajisësh menjohuri, krijo një nxënës kritik e krijues dhe jo rriprodhues.

- Përdorni pyetje jo vetëm nga përmbajtja e temës mësimore, por edhe bëj analogjime jetën e përditshme, kjo nxit pjesëmarrjen, bashkëpunimin, nxit mendimin teknxenësi, por e bën atë të memorizojë gjatë në kujtesën e tij njohuritë.

- Shmangni përdorimin në masë të drejtuarit të pyetjeve në mënyrë individuale,sepse ajo mund të shkaktojë pasivitet të pjesës tjetër të klasës, drejtojani gjithëklasës.

- Shmangni përdorimin në masë të drejtuarit të pyetjeve në mënyrë individuale,sepse ajo mund të shkaktojë pasivitet të pjesës tjetër të klasës, drejtojuni gjithëklasës.

- Përdorni më shumë pyetje në fazën e realizimit të kuptimit për të mbajtur nëqendër nxënësin dhe aktiv.

- Jepuni nxënësve më shumë kohë për t'u menduar për pyetjet e nivelit të lartë dhemë pak për pyetjet e nivelit të ulët.

- Mos reagoni negativisht ndaj përgjigjeve të gabuara ose të paplota, por motivoiniata që të shkojnë drejt përgjigjes së saktë, sepse regimi negative e dëmtonfunksionimin e të pyeturit.

- Gjatë të pyeturit të gjithë nxënësit duhet të jenë aktivë për këtë, mësuesit duhet të bëjnë një miksim mes nxxënësve që kanë dëshirë të ngrihen dhe atyre që qëndrojnë pasive, jo të ngrihen vetëm nxënësit që janë për t'u vlerësuar.

- Krijojni mundësi dhe kohë nxënësve për të pyetur.

Hartuesve të teksteve:

- Duke qënë se ushtrimet e tekstit përdoren shumë si modele të gatshmepyetjesh nga ana e mësuesve, vendosni një proporcion në masë optimal nëlidhje me nivelet e pyetjeve.

Trajnuesve:

- Vendosni një proporcion të duhur gjatë trajtimit mes kuadrit teorik dhepraktik, vëmendja duhet t'i kushtohet aspektit praktik.

BIBLIOGRAFIA

1. Musai, B. (2014) , ‘’Metodologjia e mësimdhënies’’, Tiranë: Cde.

2.Fondacioni i shoqërisë së hapur SOROS, (2005), ‘’ Të pyeturit në lëndën e edukatës qytetare 5-8’’, Tiranë: AEDP.

3. Instituti i studimeve pedagogjike (2002), ‘’Për çfarë duhet të bashkëbisedojmë? (histori-gjeografi", Tiranë: SHBLU.

4. Teachers' questioning techniques in mathematics at grade 11 level: the case of four selected secondary schools in Petauke district: http://dspace.unza.zm:8080/xmlui/bitstream/handle/123456789/3155/Chidongo%20M..pdf?seqm ence=1&isAlloëed =y

5. Instituti për zhvillimin e arsimit(2017), ‘’Udhëzues për zhvillimin e kurrikulës së në AMU(klasat VI-IX’’), Tiranë:

6. Mësimdhënia dhe të nxënit bazuar në kompetenca, http://ëëë.portalishkollor.al/dokumenta/M%C3%ABsimdh%C3%ABnia%20dhe%20t%

C3%AB%20nx%C3%ABnit%20bazuar%20n%C3%AB%20kompetenca%20.pdf

7. Asking useful questions: goals, engagement and differentiation in technology-enhanced language learning :http://yadda.icm.edu.pl/yadda/element/bëmeta1.element.desklight-bacf0615-cf92-4b6bb51f 87bcc52c8138/c/2._Asking_Useful_Questions_Goals_and_Guides_for_Technology Enhanced_Language_Learning__by_Joy_Egbert__2007-1_.pdf

STRESI DHE PERFORMANCA E STUDENTËVE

Msc. Valbona Caushi

"Universiteti Eqrem Cabej", Gjirokastër

valbona.caushi@gmail.com

Msc. Anxhela Caushi

Universiteti i Tiranë, Fakulteti i Ekonomisë

caushianxhela021@gmail.com

Abstract

Stress is a motivating challenge that affects the increase of students productivity and academic performance when it is at a moderate level. But there is a need for some approaches that reduce the negative aspects of stress, which interfere with the learning process and student performance. The key to reducing academic stress in students is to inform them so that they have a sense of control over their education as well as to improve their performance.To achieve these objectives, students need tobe familiar with academic stress (its resources) and its influence on their performance.

This is also the main purpose of this study.

I. What are the effects of stress on the performance of university students
II. Is gender a determinant variable in the level of stress experienced and determinant in academic performance

Keywords:*Reduction, Academic Stress, Academic Performance, Student, Influence*

Abstrakti

Stresi është një sfidë motivuese për rritje të produktivitetit/ performancës akademike tëstudentëve, në kushte të nivelit të moderuar të tij. Por ndihet nevoja e disa qasjeve që zvogëlojnëaspektet negative të stresit, të cilat interferojnë në procesin e mësimnxënies dhe performancën estudentëve. Çelësi për reduktimin e stresit akademik tek studentët është informimi i tyre, për tëpasur një ndjenjë kontrolli mbi arsimimin e tyre, dhe informacioni për të përmirësuarperformancën e tyre. Për të arritur këto objektiva, studentët duhet të njihen me stresi akademik (burimet e tij) dhe influencën e tij në performancën e tyre. Ky është edhe synimi I këtij studimi.

Për të përmbushur qëllimin e tij, për identifikimin e marrëdhënies mes stresit akademik dhe performancës akademike, ky studim kërkon që t' ju përgjigjet dy pyetjeve kërkimore:

I. Cilat janë efektet e stresit akademik në performancën akademike të studentëve të universitetit ?

II. A është gjinia faktorë/variabël determinant në nivelin e stresit të përjetuar, si rrjedhim dhe determinante e performancës akademike ?

Fjalët kyç :*Reduktim, Stres akademik, Performance akademike, Student, Influenca*

Rishikim i Literaturës

2.1 Stresi: Një hyrje konçize

Koncepti i stresit është huazuar nga fusha e inxhinierisë. Në këtë fushë, stresi është parë si një presion fizik I aplikuar në një strukturë (Kim & Diamond, 2002). Në biologji, ky koncept përshkruan ndonjë situatë në të cilën një organizëm ka dështuar për të arritur homeostazën. Për më tepër, përgjigja ndaj stresi ka si synim sigurimin e mbijetesës, pasi përmes një përgjigje neuroendocrine organizmi synon të kthehet në homeostazë.

Stresi është operacionalizuar si një rritje në nivelin e kortizolit për shkak të presionit psikologjik për të kryer në një provim universiteti. Koncepti I stresit të provimit përdoret për të përshkruar stresin akut që ndodh pak para një provimi (Bosch et al.,2004). Në disa studime perdoret koncepti I stresit akademik që përshkruan presionin e përjetuar nga studentët gjatë javës së provimit. Stresi është i definuar si ndryshim në gjendjen fizike ose mendore në përgjigje të situatave që paraqesin sfidë apo kërcënim *(Krantz et al, 1985;. Zimbardo et al, 2003).* Çdo stres përfshinë tre faktorë: rrethanat objektive apo kushtet të cilat i parashtrojnë kërkesat e posaçme dhe shkaktojnë stress("kërkesave" = "stressors"), individin dhe karakteristikat e tij personale të cilat shkaktojnë përceptime dhe përjetime të ndryshme të situatave; dhe ndërmjetësojnë në mënyrën e reagimit, reaksionet apo përgjigjen adaptive në ngacmimin e stresorit (stresi I perceptuar). *Jeffrey (2006)* përkufizohet stresin si një gjendje zgjimi njohës, emocional dhe fizik, e shkaktuar nga ekspozimi ndaj kërkesave/stimujve actual apo të perceptuar. *Pinel (2003)* e përcakton stresin si përgjigje fiziologjike ndaj një kërcënimit të perceptuar. Për këtë arsye ka efekte negative mbi ngjarjet e jetës *(Benson dhe Stuart, 1992)* dhe në përgjithësi mund të shihet si një grup i reaksioneve neurologjike dhe fiziologjike që shërbejnë për një funksion adaptivë *(Franken, 1994).Holmes dhe Rahe (1967)* treguan se çdo ndryshim që kërkon jeta ,rregullimet e shumta mund të perceptohet si stresuese. *Lazarus dhe Folkman (1984)* e përkufizojnë stresin si perceptimi dhe vlerësimi I ngjarjes/ situatës si stresante. Kur ngjarje apo situata vlerësohet të jetë e vështirë, përgjigja HPA boshti është i aktivizuar. Nivelet e larta të stresit të perceptuar mund të dëmtojnë shëndetin fizik dhe mendor dhe rrisin rrezikun e vdekjes së parakohshme. Perceptimi i stresit është i ndryshëm nga shuma e stresit të përjetuar; p.sh një përvojat edhe pse raporton sasi të ulët të stresit real, është kërcënuese për shëndetin tonë nëse ne e perceptojmë si shumë stresante *(Keller et al., 2012).Ibrahim (1998)* e ka përcaktuar stresin si përgjigje emocionale e nxitur nga ndryshimet e brendshme apo të jashtme. Sipas *Greenberge dhe Baroon (2000)*stresi është tërësia e reagimeve fiziologjike dhe emocionale ndaj stimujve**.** *Hussien dhe Hussien (2006)* e përkufizohen stresin si një situatë me të

cilat individi vuan tensioni fizik dhe psikologjik, që burojnë nga faktorë që tejkalojnë aftësinë e njeriut për t'i përballuar/ për t'u përshtatur.

2.2 Teoritë e stresit

*2.2.1. Walter Cannon: **Përgjigja luftë - ikje***

Fenomeni që përshkruan përfshirjen e sistemit nervor autonomy kur ekspozohen ndaj një stresor të mundshëm në mjedisi(Cannon, 1934).Cannon më tej teorizoi se emocionet janë me përvojë për kohëzgjatja e përgjigjes fiziologjik (Ledoux, 1996).Me fjale te tjera, individët përjetojnë frikë për shkak të reagimit fiziologjik ndaj stresorit, duke rezultuar në një rritje të normës së zemrës dhe vigjilencës. Ideja e tij është përbledhur në teorinë Cannon-Bard, ku theksohet rëndësia e të hipotalamusit për përjetime, si qendër e komunikimit nervor-endokrine. Teoria e tij shërbeu si bazë për kërkime të mëvonshme rreth efekteve të stresorëve në kujtesë, funksionimin imunitar, aktivitet kardiovaskulare, diabetin dhe rregullimet psikosomatike çrregullime (Sapolsky, 2004).

2.2.2 Hans Selye: **Sindroma e përgjithshme e përshtatjes**

Hans Selye gjatë vëzhgimit të përgjigjes ndaj streist te minjtë e laboatorit, vuri në dukje gjatë një krahasimi me minj të "pa stresuar", një gamë të gjerë patologjishë, si rezultat I lëshimit të një hormon stresi(Selye, 1978). Ai e operacionalizoj stresin si çdo kërkesë e cila "prish" homeostazën e organizmit. Selye është arkitekti I ''Sindromës së Përgjithshme të Përshtatjes", si një përgjigje ndaj stresit, që realizohet me pjesëmarrjen e sistemit nervor autonom (GAS) (Selye, 1978). Faza fillestare në GAS përfshin një përgjigje alarmi, e ngjashme me përgjigjen luftë – ikje të prorozuar nga Cannon, i cili promovon një mobilizim qelizore e burimeve për të kapërcyer një kërcënim potencial. Faza e dytë përfshin një përdorim të lartë i burimeve trupore; ky proces biokimike jepvazhdimisht energji për të kapërcyer sfidën e perceptuar. Pas një ekspozimi të zgjatur ndaj stresorit, GAS/SPP përfundon në shterimin e burimeve, dhe shkakton lodhje mendore dhe fizike (Selye, 1978).

2.2.3 Nivelet e Zgjimit dhe Performances: **Ligji Yerkes-Dodson**

Për shumë dekada, ligji Yerkes-Dodson është interpretuar gabimisht si një forëm e përmbysur "U-je", që marrëdhënien mes niveleve të zgjimit/ motivimit dhe të mësuarit/ performances së kujtesës (Diamond et al., 2007).Sipas tij një nivel I caktuar I motivimit është optimal për të mësuarin, por më pak motivim sjell pasivitet në të mësuarin; më shumë motivim ka si rezulltat hiperaktivitet në të mësuar. Ky ligj I botuar si një artikull në Journal of Comparative Neurology and Psychology, 1908, nuk u shpreh në mënyrë eksplicite/ ekzakte dhe ende nuk ishin bërë përpjekje për ta provuar atë në mënyrë shkencore**.** Nixon, P. (1979) shpjegon se si stresi ndikon në performancën në aspektin teorik, duke u bazuar në "kurbën e performancës" që ai ndëroi, e cila është një zgjerim I ligjit Yerkes-Dodson. Kurba tregon se kur niveli i stresit rritet, niveli i performancës gjithashtu rrit, deri në pikën e eustress, ose tensionit të shëndetshme. Në kushtet e stresit të "tepruar", personi arrin një pikë lodhje ku niveli I performancës fillon të bjerë. Në afërsi të pikës së lodhjes, një zonë e identifikuar si "zone comfort" tregon sesi nivelevet e stresit që mund të menaxhohen sjellin nivele të mira të performancës. Interpretimi ku thuhet se performanca e kujtesës përmirësohet me rritjen e zgjimit deri në pikën e zgjimit optimal, po pas këtij kulmi performanca fillon të ulet, është I vlefshëm vetëm për detyra të vështira. Për detyrat më të lehtë, individët vazhdojnë të përmirësohet me rritjen e nivelit të zgjimit (Diamond et al., 2007). Është e vështirë të bësh dallimin ndërmjet detyrave të lehta dhe të vështira.

Eustresi dhe performance akademike

Stresi është pozitiv në atë pikë që mund të shërbejë një forcë e madhe motivuese në kohë. Ky stres na shtyn të shohim përsëritjen për provim si dicka jot ë lehtë dhe ta fillojmë atë më herët, dhe kjo do ndikoj pozitivisht në performncën tonë në provim. Kur ky stress mungon, atëherë motivimi për përsëritje ngjallet vetëm nateën e fundit apo e kalon këtë faë duke shpresuar vetëmnë që mbajmë mend nga leksioni. Në situatën e parë më të ndikuar nga eustresi, pozitiv për performancën tonë. Psikologu Hans

Seley i quajti këto shuma të vogla të stresit pozitiv "eustress". Efektet positive të stresit reflektohen dhe në dy drejtime të tjera. Përballja me stresin bën që ne të fitojmë shprehi të reja, të ndryshojmë sjelljen, të ndryshojmë starategjinë. Nga ana tjetër, familjarizimi me situatat stresante, shërben si një lloj vaksinimi për të qenë më tolerantë ndaj stresit. Stresi nga sezoni te studentët reduktohet me kalimin e viteve.

METODOLOGJIA E STUDIMIT

Dizanji i studimit

Ky studim synon të testoi dy hipoteza. Së pari, performance akademike e studentëve është e ndikuar nga nivelet e stresit akademik që përjetojnë studentët. Së dyti, studentet femra përjetojnë më shumë stress akademik, dhe si rezultat performance e tyre akademike do të jetë më e ulët se ajo e meshkujve homolog (në të vit dhe në të njëjëtën degë). Për të përmbushur këtë qëllim u vendos të pëdorei metodologji sasiore e studimit, përmes vëzhimit/ analizës sasiore/ krahasuese të pyetësorëve vetëraportues.

Kampioni

Pjesëmarrësit në këtë studim janë dhjetë studentë: 5 femra dhe 5 meshkuj (50/ 50 %) nga Universiteti Eqrem Cabej, Gjirokaster. nga pesë degë të ndryshme: cikel I uleët, parashkollor, anglisht, edukatorë në fëmijërinë e hershme, infermieri. Kampioni u përzgjodh në mënyrë rastësore, por që përmbushte kriteret e sipërpërmenduara, por edhe përfshihej në grupmoshën 17- 22 vjec. U përcaktuan këta kufijë moshorë për studentët e nivelit Bachelor në universitete, duke lënë hapsirë ± 1 vjeç.

Procedura

Për realizimin e këtij studimi, fillimisht iu shpjegua pjesëmarrësve qëllimi i studimit dhe të gjitha detajet përkatëse në lidhje me studimin, me synimin për ti motivuar për të marr pjesë në studim. U theksua se përgjigjet e tyre do të trajtoheshin me konfidencialitet gjatë mbledhjes së të dhënave, raportimit dhe shpërndarjes së gjetjeve. Pasi u mor miratimi I informuar në mënyë verbale I studentëve, ata u bënë pjesmarrës në këtë studim me plotësimin e pyetësorit vetëraportues. Qëndrimi pranë

pjesëmarrësve në kohën e plotësimit të pyetësorit ishte I nevojshëmpër informim dhe monitorim deri në finale të plotësimit të të pyetësorëve. Por u ruajt distance fizike dhe paanshmëria në përgjigjet shpjeguese për të mos influencuar në përgjigjet e pjesëmarrësve. Të anketuarit u informuan për të lexuar me kujdes udhëzimet e shkruara në pyetëso dhe iu kërkua të plotësonin pyetësorin gjatë kohës së dhënë. Studentëve nuk u është dhënë asnjë shenjë tjetër për pjesëmarrje në këtë studim.

Instrumenti

Burimet e stresit tek studentët janë të shumtë, por ky studim është fokusuar në burimet e stresit akademik të studentëve. Është përdorur një pyetësor vetëraportues për të mbledhur të dhënat sasiore, i ndarë në tri seksione: I, II dhe III. Seksioni I përfshin profilin e studentit, të dhënat demografike: mosha (duhet të përmbush kriterin 17- 22 vjeç); gjinia (në shërbim të hipotezës së dytë); dega/ viti i studimit (të nevojshme për të bërë dallimin gjinor mes homologëve në të njëjtën vit dhe degë studimi); nota mesatare e vitit paraardhës (p.sh. mesatarja e një student në vitin e dytë përfshn mesataren e vitit të parë dhe atë të semestrit të parë të vitit të dytë, duke qënë se jemi në semestrin e dytë të vitit shkollor); raporti lëndë të kaluara/ të ngelura (informacion i vlefshëm për të qykuar për performancën akademike të studentit)

Seksioni II përmbante Shkallën e Stresit të Perceptuar (PSS), zhvilluar nga Cohen, Kamarck & Mermelstein (1983). PSS u zgjodh në këtë studim sepse kjo shkallë është instrumenti psikologjik më i përdorur gjerësisht për matjen e perceptimit të nivelit të stresit. Ai është projektuar për të matur shkallën në të cilën të anketuarit kanë gjetur jetën e tyre "të paparashikueshme, të pakontrollueshme dhe mbingarkesë" (Cohen, Kamarck & Mermelstein, 1983). . PSS është një shkallë me 10 pika që mund të administrohet në një kohë të shkurtër dhe është e lehtë për t'u plotësuar. PSS- së pyet për shpeshtësinë e ndjenjave dhe mendimeve të të anketuarve gjatë një kohe të caktuar (muajt të kaluar), përgjigjet e së cilave vlerësohen me shkallën Likert që varionin nga 1 (asnjëherë) në 5 (pothuajse gjithmonë). Rezultatet e PSS arrihen duke përmbysur rezultatet në çështjeve pozitive 4, 5, 7, 8, (p.sh., 1 = 5, 2 = 4, 3 = 3, 4 = 2, 5 = 1),

dhe pastaj mblidhen pikët për të gjitha çështjet. Raportimi fokusohet në muajin e kaluar, edhe pse matja e performancës është më afatgjatë, por për efekt të gabimeve që mund të ndodhin gjatë vetëraportimit si rezultat I kujtesës, u pa e arsyeshme raportimi I periudhës më të afërt.

Seksioni III është Anketa e Faktorëve të Stresit. Ky seksion kërkon që pjesëmarrësit të identifikojnë stresin e faktorëve që përjetojnë gjatë kohës së dhënë. Disa faktorë të stresit janë shënuar në pyetësorin dhe të anketuarit mund të tregojnë më shumë se një faktor, të cilin ata i perceptojnë të rëndësishme për ta. Seksioni u zhvillua nga studiuesit dhe burimet e stresit u mblodhën nga kapitulli i dytë i literatures. Faktorët e stresit akademik të përfshira në këtë seksion janë: faktorët akademik; faktorët intrapersonal; faktorët interpersonal; faktorët mjedisor.

Analiza e të dhënave

Për analizë u përdorën të dhjetë pyetësorët e shpërndarë. Edhe pse pjesëmarrësit nuk morën shpërblim për plotësimin e pyetësorit, kontributi I tyre ishe maksimal (100%) në gadishmërinë për plotësimin e plotë dhe dorëzimin e pyetësorit. Rezultatet e pyetësorve janë paraqitur në tabelë.

Nr.i pyetësorit	**I**	**II**	**III**	**IV**	**V**	**VI**	**VII**	**VIII**	**IX**	**X**
Gjinia	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M
Performanca akademike	K.2	K.3	K.2	K.3	K.2	K.1	K.3	K.1	K.2	K.2
	6/6	6/6	16/18	16/16	17/21	13/21	19/19	13/19	32/35	30/35
Pikët e PPS	22	29	35	30	27	35	28	35	37	23
F.akademik	60	70	89	56	71	73	66	88	84	60
F.intrapersonal	101	116	145	88	89	140	88	142	143	99
F.interpersonal	18	30	25	24	21	23	19	34	21	17
F. mjedisor	18	19	21	17	14	25	16	29	17	20
Pikët në total	219	264	315	215	222	296	217	328	302	219

Hipoteza 1 *:Niveli I lartë i stresit akademik që studenti përjeton ndikon negativisht në performancën akademike të ti,* ***u konfirmua*** *sepse:*

40 % e pjesmarrësve raportuan nivele të larta të stresit nga 296- 328 pikë të akumuluara, dhe performanca akademike e tyre ishte në 50 % të rasteve e ulët dhe në 50% e moderuar. 60 % e kampionit raportuan nivele të moderuara të stresit nga 217-265 pikë të akumuluara dhe performanca akademike e tyre ishte e moderuar në 50% të rasteve dhe e lartë në 50% tjetër. Asnjë pjesmarrës nuk raportoi nivele të ulta të stresit (kjo ishte dicka e pritshme pasi jeta akademike është e ekspozuar ndaj shumë faktorëve stresantë).

Pra nivelet e larta të stresit akademik të përjetuara nga studentët, ndikojnë negativisht duke ulur performancën e tyre akademik. Por në të kundërt nivelet e ulta të stresit nuk e rrisin performancën akademike, pasi studentët e kampionuar raportuan performancë akademike të lartë në nivele të moderuara stresi.

Hipoteza 2 *:Studentet femra përjetojnë nivele më të larta të stresit akademik (në kushte specifike), dhe si pasojë, meshkujt demostrojnë performancë më të mirë akademike (në të njëjtat kushte),* ***nuk u konfirmua*** *sepse:*

Në një analizë krahasuese që iu bë cifteve homologe të studentëve në të njëjtin vitë dhe kurs studimi, por me përkatësi gjinore të ndryshme rezultoi se hipoteza 2 konfirmohej vetëm në 20 % të kampionit, pra në dy raste nga pesë tëtillë.në këto dy raste pjesmarrset femra raportuan nivele më të klarta stresi dhe nivele më të ulta performance se pjesmarrësit meshkuj. Në ciftin (IX; X) diferenca në performancën akademike nuk identifikohet nga nota mesatare e viti paraardhës, por raporti nr. I lëndëve kalues/ nr I lëndëve në total ku studentja rezulton të ketë raport më të vogël se student homolog. Në 80% të kampionit hipoteza 2 nuk u vërtetua..

Diskutim

Studentët perceptojnë ngarkesën e kurseve si të papërballueshme në vitin e parë të studimit, gjë që shkakton stresin e provimit. Duke marrë parasysh stresin akademik në mesin e studentëve të universitetit, *studentët e vitit të parë përjetuan më shumë stres nga perceptimi i mbingarkesës akademike*. Kjo i atribuohet faktit që këta studentë universitar duhet të përballojnë kalimin në jetën universitare, si dhe t'i plotësojnë kërkesat akademike. Shumica e studentëve të vitit të pare largohen nga shtëpia për herë të parë dhe prandaj duhet të përshtaten me lirinë e re të gjetur, si dhe si të mbajnë një nivel të lartë të performancës akademike. Monitorimi i vazhdueshëm i performancës së studentëve nga stafi akademik dhe administrata universitare, bën që studentët të gjenden nën presion për të marrë nota të mira, në kushtet e një mjedisi konkurues për të përmbushur pritjet personale dhe sociale dhe prandaj janë të ndjeshme ndaj reagimeve nga njerëzit në jetën e tyre. *Problemet në marrëdhëniet ndërpersonale dhe faktorët mjedisor rezultuan si më pak stresuese*. Prandaj, theksi në zhvillimin dhe zbatimin e strategjive se si të merren me vështirësitë e pashmangshme akademike duhet të orientohet nga studentët e viti të parë dhe gjatë qëndrimit të tyre në universitet. Midis zakoneve të studimit, zakoni më I rëndësishëm është motivimi. *Shumica e studentëve shfaqin motivim ekstremist për marrjen e notave të mira.* Tregues të motivimit janë pëlqimi I degës së studimit, ndjekja e leksioneve jo të "detyruara", besimi në arritje të larta akademike. Në këtë studim, *studentët femra u gjetën të kenë zakone relativisht më të mira studimi;* studiojnë në mënyrë sistematike, mbajnë shënime, realizojnë në kohë detyrat etj. femrat kanë aftësi më të mira të menaxhimit të kohës sa i përket kontrollit të kohës në dispozicion, planifikimit dhe organizimit të detyrave dhe kontrollit të kohës. *Studentet femra ndiqnin strategji aktive të përballimit të stresit akademik, duke u rioorganizuar; ndërsa studentët meshkuj ndiqnin strategjitë pasive.*

Konkluzione

Ky studim konfirmoi informacionin jo të ri, se stresi akademik në nivele të larta I përjetuar nga studentët ndikon negativisht, duke sjell rënie në

nivelin e performancës së tij akademike. Mjedisi akademik i ekspozon studentët universitarë në situata stresuese. Më pak imun ndaj këtye situatave stresante janë studentët e vitit të parë, të cilët pa dallime gjinore përjetojnë nivele më të larta të stresit akademik.

REFERENCAT

Afolayan, J., A., Donald, B., Onasoga, O., et al. (2013). *Relationship betëeen anxiety and academic performance of nursing students, Niger Delta University, Bayelsa State, Nigeria* (fq. 27, 32). Nigeria: Pelagia Research Library.

Marrë nga http://www.imedpub.com/articles/relationship-betëeen-anxiety-and-academic-performance-of-nursing-studentsniger-delta-university-bayelsa-state-nigeria.pdf [Parë për herë të fundit më 2 dhjetor 2016].

Kai-Ëen, C. *A study of stress sources among college students in Taiëan* (fq.2-4). Journal of Academic and Business Ethics. Marrë nga http://www.aabri.com/manuscripts/10471.pdf [Parë për herë të fundit më 18 dhjetor 2016].

Karaj, Th. (2005). Psikologjia e stresit. Tiranë : Emal

Kindermann, H., Javor, A., & Reuter, M. (2016). Playing counter-strike versus running: The impact of leisure time activities and cortisol on intermediate-term memory in male students. *Cognitive Systems Research,* 40(1), fq.1-7. Marrë nga http://dx.doi.org/10.1016/j.cogsys.2016.01.002 [Parë për herë të fundit më 18 dhjetor 2016].

Philip G., Z. & J, R. (2002). *Glossary of Psychological Terms*. Washington DC: American Psychological Association. Parë më 2 dhjetor 2016, nga http://www.apa.org/research/action/glossary.aspx?tab=16

Shastri, S. & Veena, N. (2016). *Stress and Academic Performance* (fq. 73, 76-79). Bangalore: The International Journal of Indian Psychology.

Marrë nga http://oaji.net/articles/2016/1170-1462485066.pdf [Parë për herë të fundit më 18 dhjetor 2016].

Shim, E., Jeon, H., Kim, H., Lee, K., Jung, D., & Noh, H. et al. (2016). Measuring stress in medical education: validation of the Korean version of the higher education stress inventory ëith medical students. *BioMed Central*. Marrë nga http://dx.doi.org/10.1186/s12909-016-0824-9 [Parë për herë të fundit më 5 dhjetor 2016].

KURRIKULA ME BAZË KOMPETENCA NË ARSIMIN FILLOR

Msc. Armanda Xhani (Baça)

Kolegji: "Turgut Özal"

aarmi98@gmail.com

Abstract

Nowadays there has been a lot of talk about increasing the quality of education. Various specialists and many researchers in the field of education have reviewed some successful practices in different countries of the world and have decided to implement the New Competency-Based Curriculum. This applies in the school year 2015-2016 in the first and sixth grades of pre-university education in our country. The study "Competency-based curriculum in primary education, first grade" is an attempt to measure the success of learning achievements, the development of thinking skills and abilities, to make students capable of life. The purpose of this study is to describe and analyze the characteristics of the competency-based curriculum in the first grade of primary education where it is implemented. This study was conducted in schools in the city of Elbasan and Gramsh district. The hypothesis raised in this study is that the competency-based curriculum in the first grade of primary education provides effectiveness in increasing learning outcomes. The study aims to answer these research questions: what are the perceptions of specialists, teachers about the curriculum competency-based; what are the characteristics of a competency-based mathematics curriculum for first grade and how can curriculum materials be constructed to better serve the needs of all students. The population of this study is primary school teachers of the first grades of the city of Elbasan and Gramsh. From this population were selected 80 teachers of the first grades of primary education. The results of the study showed that competency-based curricula have brought about changes in the learning process and learning outcomes. We recommend that this curriculum be improved in the implementation of the new curriculum.

Keywords:*core curriculum, competence, ability, dexterity, behavior*

Abstrakti

Në ditët e sotme është folur shumë për rritjen e cilësisë në arsim. Specialistë të ndryshëm e shumë studiues në fushën e arsimit kanë shqyrtuar disa praktika të suksesshme në vende të ndryshme të botës dhe kanë vendosur zbatimin e Kurrikulës së Re me bazë kompetence. Kjo gjen zbatim në vitin shkollor 2015-2016 në klasat e para dhe të gjashta të arsimit parauniversitar ne vendin tone. Studimi "Kurrikula e bazuar me kompetenca në arsimin fillor, klasa e parë" është një përpjekje për të matur suksesin e arritjeve në të nxënë, në zhvillimin e shprehive dhe aftësivë të të menduarit, për ta bërë nxënësit të aftë për jetën.

Qëllimi i këtij studimi është të përshkruajë dhe të analizojë karakteristikat e kurrikulës së bazuar në kompetenca në klasën e parë te arsimit fillor ku ajo është e implimentuar.Ky studim është kryer në shkolla te qytetit të Elbasanit dhe rrethit të Gramshit. Hipoteza e ngritur në këtë studim është se kurrikula e bazuar me kompetenca ne klasën e parë të arsimit fillorë siguron efektivitet në rritjen e rezutateve të të nxënit.Studimi synon t'u pergjigjet ketyrë pyetjeve kërkimore:cilat janë perceptimet e specialistëve, të mësuesve për kurrikulën e bazuar në kompetenca; cilat janë karakteristikat e kurrikules se bazuar në kompetenca për matematikën e klasës se parë dhe si mund të ndërtohen materiale kurrikulare që t'i shërbejnë më mirë nevojave të të gjithë nxënësve. Popullata e këtij studimi janë mësues të arsimit fillor tëklasave të para të qytetit të Elbasanit dhe të Gramshit.Nga kjo popullatë u përzgjodhën 80 mësues të klasave të para të arsimit fillor.Rezultatet e studimit treguan se kurrikula me bazë kompetenca ka sjellë ndryshime në procesin mësimorë dhe rezultatet e të nxënit.Rekomandojmë qënë këtë kurrikul të ketë përmirësime në zbatimine programit të ri kurrikular.

Fjalët kyce : *kurrikula bërthamë, kompetencë, aftësi, shkathtësi, sjellje*

HYRJE

Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe arsimin fillor, është dokument bazë që rregullon ecurinë e mësimdhënies, mësimnxënies, metodologjisë,

vlerësimit etj. Në nivelin e parë të arsimit të Shqipërisë. Ky dokument, dispozitat e të cilit përcaktohen nga MASHT-i është obligues për të gjitha institucionet edukative arsimore në Republikën e Shqipërisë. Kurrikula bërthamë është dokumenti bazë i procesit mësimor, e bazuar në Korrnizën Kurrikulare të Shqipërisë. Konsiderohet si një tërësi e organizuar ku përfshihen nxënësit, mësuësit,metodologjitë e mësimdhënies,të nxënies, përvojat e parashikuara,rezultatet e mundëshme të drejtpërdrejta afatëgjatë të mundëshme brenda një institucioni arsimor. Kurrikula me bazë kompetence hyri në fuqi në shtator 2015 dhe u aplikua kryesisht në arsimin fillor (klasat 1,6).

Prezantimi i problemit

Në fokus të këtij punimi kemi shqyrtimin e mësimdhënies me bazë kompetenca në arsimin fillor(klasa e parë). Ajo cka hasim në këtë kurrikul të re është mësimdhënia me bazë kompetenca dhe ndërthurja e fushave me njëra tjetrën. Kjo ka bërë që mësimdhënia të dalë më e suksesshme dhe nxënësi të jetë në qendër të vëmendjes.Kjo kurrikul ka sjellë ndryshime të dukshme te nxënësi si në aftësi, në sjellje, në komunikim etj. Ndërthurja e temave mësimore është e përshtatshme në të gjitha fushat e kompetencës dhe kjo e paraprin nxënësin për të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Qëllimi i kërkimit

Qëllimi i këttij studimi është të përshkruajë dhe të analizojë karakteristikat e kurrikulës së bazuar në kompetenca në klasën e parë të arsimit fillor ku ajo është e implimentuar.Ky studim është kryer në shkolla të qytetit të Elbasanit dhe rrethit të Gramshit.

Objektivat e studimit

- Njohja e kurrikulës së re me bazë kompetence nga të gjithë mësuesit e arsimit fillor (klasa e parë).
- Rezultatet e të nxënit për cdo kompetencë kyce dhe ndërlidhja e temave kurrikulare në procesin mësimor.

- Vecoritë specifike të lëndës së matematikës dhe ndërthurja e temës me fushat e tjera.

Hipoteza

Kurrikula e bazuar në kompetenca në klasën e parë të arsimit fillor siguron efektivitet në rritjen e rezultateve të të nxënit.

Pyetjet kërkimore

Studimi merr përsipër tu përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

1.Cilat janë përceptimet e specialistëve,të mësuesëve për kurrikulën e bazuar në kompetenca?

2.Cilat janë karakteristikat e kurrikulës së bazuar në kompetenca për matematikën e klasës së parë ?

3.Si mund të ndërtohen materiale kurrikulare që ti shërbejnë më mirë nevojave të të gjithë nxënësve?

Shqyrtimi i Literaturës për Kurrikulën me Bazë Kompetencash

Kuptimi mbi kurrikulën bërthamë e bazuar me kompetenca

Dokumenti i kurrikulës bërthamë është dokumenti bazë, i cili rregullon ecurinë e procesit mësimor, bazuar në Kornizën Kurrikulare të Shqipërisë.Brenda saj përfshihen :

1.Rezultatet e të nxënit për cdo kompetence kyce

2.Metodologjitë e zbatimit të kurrikulës

3.Vlerësimi i nxënësve dhe shpërndarja kohore(plani mësimor)për secilën fushë.

Dokumenti i kurrikulës bërthamë ndihmon në hartimin e dokumentave kurrikulare:programet lëndore , udhëzuesit kurrikular etj të cilët janë shumë të rendësishëm për procesin mësimor.

Si i tillë ky dokument u shërben:

>>**Nxënësvet** për zhvillimin e kompetencave kyce të të nxënit,në mënyrë që të përballojnë sfidat e jetës dhë të punës dhe integrohen në shoqërinë e së ardhmes.

>>**Mësuesve** për planifikimin dhë realizimin e veprimtarive mësimore në klasë dhe jashtë saj.

>>**Prindërve** për njohjen me kriteret e vlerësimit dhe rezultatet e pritshme në arritjen e fëmijëve.

Kurrikula bërthamë hartohet për të gjitha nivelet formale të arsimit parauniversitar:

1-Kurrikula bërthamë për zhvillimin e fëmijërisë së hershme (3-6vjec)

2-Kurrikula për klasën përgatitore dhe arsimin fillor

3-Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm-të ulët

4-Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm-të lartë

Secila kurrikul bërthamë zbaton dhe respekton qëllimet e përgjithshmë të arsimit si dhe parimet themelore të përcaktuara në Kornizën Kurrikulare së Shqipërisë.Kurrikula bërthamë ka si qëllim njohjen e kompetencave kyçe dhe fushat e të nxënit në të gjitha nivelet e arsimit.Kurrikula bërthamë përfshin edhe hapësirën përtej kufijve lëndorë në mënyrë që nxënësit të ndërtojnë lidhje mes fushavetë të nxënit. Në arsimin fillor procesi i të nxënit përqendrohet në përvetesimin e bazave të leximshkrimit dhe në zhvillimin e njohjes,socio-emocionale dhe motorike. Një rol tjetër i rëndësishëm i kushtohet zhvillimit të personalitetit të fëmijës dhe qëndrimit pozitiv ndaj të nxënit, si bazë të kompetencave kyce “të mësuarit për të nxënë”.Procesi mësimor në arsimin fillor organizohet,ofrohet, lehtësohet dhe bashkërendohet nga mësuesi i klasës i ndihmuar sipas nevojës,dhe asistentit dhe mësuesi i specializuar i lëndes. Në dokumentin e kurrikulës bërrthamë për arsimin fillor paraqiten rezultatet e të nxënit për komptenca kyce dhe fushat e të nxënit, sipas shkallevë për këtë nivel, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë shkollat e Republikes të Shqipërisë, publike dhe private.Në rrafshin e

përmbajtjes, kurrikula e re përcakton themelet e kontratës morale të institucioneve arsimore me shoqërinë, veçanërisht, me prindërit dhe me nxënësit. Ajo e vë theksin në edukimin e gjithanshëm të nxënësve; formimin e tyre gjuhësor dhe matematikor më së pari. Kurrikula përshkruan kompetencat kyçe të cilat u nevojiten nxënësve që të jetojnë, të nxënë, të punojnë dhe të kontribuojnë si anëtarë aktivë të komuniteteve tona. Njëherazi, ajo thekson vlerën e padiskutueshme të aftësimit të nxënësve për të zbatuar njohuritë në situata të njohura ose të panjohura prej tyre.

Paketa është përgatitur që të sigurojë zhvendosjet revolucionare:

a) nga kurrikula që përqendrohet në lëndët, te kurrikula që bazohet në kompetencat;

b) nga përqendrimi te mësuesi, te përqendrimi mbi nxënësin;

c) nga metodologjia ligjëruese, te metodologjitë ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Në dritën e misionit të ri të shkollave(arsim, shoqërizim dhe kualifikim), kurrikula e reformuar përfshin të gjitha përmasat e zhvillimit të nxënësve dhe shërben për të materializuar vizionin e ri arsimor të shoqërisë shqiptare dhe pritshmëritë që duhet të plotësojnë nxënësit tanë.

Në konceptin e qasjes së re arsimore, dije nuk është ajo që është e vërtetë, por ajo që ndihmon; ajo që nxënësit do të përdorin për t'i bërë gjërat të funksionojnë; ajo që lidhet me trajtimin efikas të situatës dhe me rastin. Prandaj, kurrikula e re thekson dhe krijon kushte që nxënësit të jenë tëgatshëm dhe të aftë të kritikojnë, të harmonizojnë, të përpunojnë, të sfidojnë dhe të vazhdojnë së punuari me njohuritë, me vlerat dhe me qëndrimet që kanë sukses.

Struktura e Kurrikulës Bërthamë për klasën parafillor dhe arsimin fillor.

Në Kurrikulën Bërthamë përshkruhen:

• veçoritë e klasës parafillore

• veçoritë e arsimit fillor

• kompetencat e të nxënit për këtë nivel

• shkallët e Kurrikulës

• rezultatet e të nxënit sipas shkallëve

• fushat e Kurrikulës

• plani mësimor

• mësimi me zgjedhje

• udhëzimet (metodologjitë) për organizimin e procesit mësimor

• vlerësimi i nxënësve

• aspekte të tjera lidhur me zbatimin Kurrikula Bërthamë mbulon shtatë fushat kurrikulare, të cilat përcaktohen prej MASHT-it dhe janë të detyrueshme për të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës (publike dhe private).

Kuptimi për kompentencat kyçe

Kompentencat shprehen nëpërmjet përdorimit te njohurive, shkathtësve,vlerave dhe qëndrimeve ne trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave të kontekstit. Nevojat per ndryshime arsimore e bëjnë të qartë domosdoshmërinë për te nxenë gjatë gjithë jetës.

Qytetarëve të shoqërisë së dijeve u nevojitet të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qendrimet vetjake, shoqërore dhe ato që lidhen me botën e punës dhe tregun e lirë. Procesi i arsimit i mundëson cdo nxënësi zotërimin e kompetencave kyce, të nevojshme per jetën dhe punën.

Mënyrat me të cilat njerëzit i qasen sot informacionit dhe sherbimeve ndryshojnë vazhdimisht.Për këtë arsye, të gjitha moshat kanë nevojë të pajisen me kompetenca të reja që i ndihmon në përshtajtjen me botën e sotme dixhitale, jo vetëm nëpërmjet fitimit të njohurive dhe aftësive teknike por nëpërmjet të kuptuarit të thellë të mundësive, sfidave, cështjeve etike,ligjore

dhe shoqërore, që lindin ose shoqërojnë zhvillimet e reja ekonomike, shoqërore dhe teknologjike.

Këto ndryshme sjellin domosdoshmërinë e zotërimit të kompetencave, që aftësojnë nxënësin të menaxhojë ndryshimet dhe situatat e reja.

Kompetencat kryesore janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompenteca e te mësuarit për të nxënë
- Kompetencat për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
- Kompetenca personale
- Kompentenca qytetare
- Kompentenca dixhitale

METODOLOGJIA

Ky studim zbulon mësimdhënien me bazë kompetenca në arsimin fillor, klasa e parë.Qëllimi i studimit është të përshkruajë dhe të analizojë karekteristikat në kurrikulën e bazuar me kompetenca në arsimin fillor, klasa e parë. Bazuar në natyrën dhe qëllimin e këtij punimi informacioni i grumbulluar përfshin literaturë të studiuesve shqiptarë dhe të huaj.

Hipoteza e ngritur në këtë studim është kurrikula e bazuar me kompetenca në arsimin fillor siguron efektivitet në përmisimin e rezultateve në të nxënit.

Ky studim u përgjigjet ketyre pyetjeve kërkimore:

1.Cilat janë përceptimet e specialistëve,të mësuesëve për kurrikulën e bazuar në kompetenca?

2.Cilat janë karakteristikat e kurrikulës e bazuar në kompetenca për matematikën e klasës së parë?

3.Si mund të ndërtohen materiale kurrikulare që ti shërbejnë më mirë nevojave të të gjithë nxënësve?

Popullata e kampionimit të këtij studimi janë mësuesit e shkollave të Elbasanit dhe të Gramshit të arsimit fillor, klasa e parë. Pra kampionimi është bërë në mënyrë të qëllimshme.

Konkretisht, popullata e këtij studimi përbëhet nga klasat e para të Elbasanit (45 mësues) dhe të Gramshit (66 mësues). Për kampionimin janë marrë50 mësues të Elbasanit ku 3 prej tyre janë mësues të klasave të dyta të të shkollave pilot "Naim Frashëri" dhe 20 mësues të Gramshit, pra gjithësej 50 mësues.Metodat e mbledhjes së të dhënave është ajo e anketimit. Pyetjet u ndërtuan në funksion të zbatimit të kurrikulës së re të bazuar në kompetenca.

Instrumentet

Për të arritur në konkluzionet mbi mësimdhënien e bazuar në kompetenca u përdorën pyetsorë për mësuesit e shkollave të qytetit të Elbasanit dhe të Gramshit.

Pyetësori për këtë punim përbëhet nga nëntë pyetje ku tetë prej tyre janë me alternativa dhe një me opionin që mësuesit do të japin rreth kësaj kurrikule që po zbatohet.Ky pyetësor synon të masë shkallën e mësimdhënies së bazuar me kompetenca krahas asaj të përdorur më parë.

Matja dhe analiza e të dhënave

Qëllimi i parë i këtij studimi është për të hetuar mësimdhënien e bazur me kompetenca në arsimin fillor klasa e paret dhe të identifikojë avantazhet dhe disavantazhet e kësaj kurrikule .

Qëllimi i dytë është të identifikojë nëse kjo mësimdhënie me kompetena a është e arritëshme në klasën ë partë identifikojë.

Nga studimi i kryer kemi arritur të hëtojmë preferencat e mësuesve për kurrikulën që po zbatohet.

Gjatë kryrjes së studimit janë mbledhur të dhëna nga shkollat nëntë vjecare klasat e para të qytetit të Elbasanit dhe të Gramshit.

Realizimi i plotësimit të pyetësorit për mësuesit u mundësua nga kontakti i drejtëpërdrejtë me ta. Pyetësorët janë plotësuar nga 30 mësues të Elbasanit dhe 20 të qytetit të Gramshit.

Analiza e të dhënave

Pyetsorët e këtij studimi u plotësuan nga 50 mësues ku tre prej tyre ishin mësues të klasave të dyta në shkolla pilot.Plotësimi i tyre u krye mbas mësimit në një kohë rreth 10 min. Takimi me secilin prej tyre na dha mundësinë të diskutojmë rreth kësaj kurrikule dhe të mirat që ajo ka sjellë.Nuk pati asnjë hezitim për plotësimin e pyetsorëvë nga ana e mësuesëve.

REZULTATET E STUDIMIT

Në lidhje me pyetjen sa përcaktohet në kurrikul regullorja e procesit mësim 6% prej mësuesëve u përgjigën aspak, 8% prej tyre u përgjigjen pak, 52% prej tyre u përgjigjën mjaftueshëm dhe 34% prej tyre u përgjigjën shumë (Shih tabelën 1.)

Tabela 1. Përcaktimi në kurrikul i rregullores së procesit mësimor

Aspak	6%
Pak	8%
Mjaftueshëm	52%
Shumë	34%

Tek pyetja numër një përqindja më e madhe e mësuesve janë përgjigjur mjaftueshëm. Pra ata mendojnë se rregullorja e procesit mësimor përcaktohet

mjaftueshëm në kurrikul.Në lidhjeme pyetjen sa zbatohet kjo kurrikul në procesin mësimor 0% mësues janë përgjigjur aspak, 8% mësues janë përgjigjur pak, 58% mësues janë përergjigjur mjaftueshëm, 34% mësues janë përgjigjur shumë.(shih tabelën 2)

Tabela 2 sa zbatohet në kurrikul procesi mësimor

Aspak	0%
Pak	8%
Mjaftueshëm	58%
Shumë	34%

Mësuesit e klasave të para mendojnë se kjo kurrikul jep rezultate tek nxënësit.Përqindja me e madhe tek kjo pyetje është mjaftueshëm.

Në lidhje me pyetjen: A duhet të zhvillohet gjerësisht në të gjitha shkollat apo vetëm në shkollat pilot 84% mësues janë përgjigjur po, 16% mësues janë përgjigjur jo.(shih tabelen 3)

Tabela 3. Zhvillimi gjerësisht në të gjitha shkollat apo vetëm në shkollat pilot

Po	84%
Jo	16%

Mësuesit e klasave të para mendojnë se kjo kurrikul duhet të zhvillohet gjerësisht në të gjitha shkollat.Pra përgjigja më e madhe është po.

Pyetja cfarë synohet të arrihet me këtë kurrikul 50% mësues janë përgjigjur të nxënit, 28% mësues janë përgjigjur aktivizimi i nxënësve, 12% mësues janë përgjigjur zhvillimi i shprehive, 16% mësues janë përgjigjur të menduarit.(shif tabelën 4)

Tabela 4. Synimi i arritjeve me këtë kompetencë

Të nxënit	50%
Aktivizimi i nxënsve	28%
Zhvillimi i shprehive	12%
Të mendurit	165

Kjo kurrikul ka synime të gjëra për arritjen e saj.Mësuesit janë përgjigjur se në këtë kurrikul synohet më shumë të arrihet të nxënit. Pra përgjigjen më të madhe e zënë të nxënit.

Në lidhje me pyetjen e zhvillimit të kurrikulës së bazuar me kompetenca 94% mësues janë përgjigjur KL e parë,6% mësues janë përgjigjur KL e dytë, 0% mësues jane përgjigjur KL e tretë, 0% mësues janë përgjigjur KL e katërt.(shih tabelën 5)

Tabela 5. Kurrikula e bazuar me kompetenca zhvillohet

Kl I	94%
Kl II	6%
Kl III	0%
Kl IV	0%

Kurrikula e bazuar me kompetenca zhvillohet në klasë të parë dhe klasë të dytë në shkollat pilot.

Pra përqindjen më të madhe e zë klasa e parë.

Në këtë pyetje sa ndihmon ndërlidhja e temave kurrikulare procesin mësimor 2% mësues aspak, 2%mësues janë pergjigjur pak, 62% mësues janë përgjigjur mjaftueshëm, 34%janë përgjigjur shumë.(shih tabelën nr.6)

Tabela 6. Ndërlidhja e temave kurrikulare ndihmon procesin mësimor

Aspak	2%
Pak	2%
Mjaftueshëm	62%
Shumë	34%

Mësuesit në këtë pyetje mendojnë se ndërlidhja e temave kurrikulare e ndihmon procesin mësimor.

Përqindja më e madhe është në sjellje.Në lidhje me pyetje të të mësuarit me kompetenca ndryshon procesin mësimor 24%prej mësuesëve janë përgjigjur të nxënit, 18% mësues janë përgjigjur në komunikim,18% mësues janë përgjigjur në sjellje, 40% mësues janë përgjigjur në sjellje.(shih tabelën nr.7)

Tabela 7. Të mësuarit me kompetenca ndryshon procesin mësimor

Të nxënit	24%
Në komunikim	18%
Në sjellje	18%
Në aftësi	40%

Të mësuarit me kompetenca sipas mësuesve të klasave të para ndryshon procesin mësimor në sjellje.

Përqindja më e madhe është në sjellje.

Në këtë pyetje kurrikula e bazuar në kompetenca është e përshtatshme për klasën e pare,4%prej mesuesëvë janë aspak,4%mësues janë për përgjigjen pak,64%mësues janë për përgjigjen mjaftueshëm,14%janë për përgjigjen shumë.(shih tabelën nr.8)

Tabela 8. Kurrikula me bazë competence dhe përshtatshmëria në klasë

Aspak	4%
Pak	4%
Mjaftueshëm	64%
Shumë	14%

Kurrikula me bazë kompeteca është e përshtatshme për klasën e parë .

Sipas përgjigjeve të mësuesve një përqindje më të madhe e zë mjaftueshëm.

Në lidhe me këtë pyetje ndryshimet që sjell kurrikula aktuale në procesin mësimor ,

duhet të vazhdojë të aplikohetnë të gjitha shkollat, 84% prej mësuesëve janë për përgjigjur po, 16%mësuës janë për përgjigjër për jo (shih tabelën nr.9)

Tabela 9. Ndryshimet që sjell kurrikula në procesin mësimor dhe vazhdimi i aplikimit të saj

Po	84%
Jo	16%

Disa nga mësuesit kanë dhënë mendimin e tyre se kjo kurrikul po sjell ndryshime në komunikim, sjellje dhe aftësi i bën nxënesit të aftë për të përballur sfidat e jetës.

Ata mendojnë se duhet të vazhdojë të aplikohet në të gjitha klasat e arsimit fillor

DISKUTIMI

5.1. Sa përcaktohen në kurrikul rregullorja e procesit mësimorë?

Tek pyetja numër një përqindja më e madhe e mësuesve janë përgjigjur mjaftueshëm. Pra ata mendojnë se rregullorja e procesit mësimor përcaktohet mjaftueshëm në kurrikul.



Grafiku 1.Përcaktimi i kurrikulës në proceset mësimore

5.2. Kjo kurrikul që po zbatohet a jep rezultate te nxënësit?

Mësuesit e klasave të para mendojnë se kjo kurrikul jep rezultate tek nxënësit.

Përqindja me e madhe tek kjo pyetje është mjaftueshëm.



Grafiku.2 Zbatimi i kurrikulës në rezultatet e të nxënit

5.3. A duhet të zhvillohet gjerësisht në të gjitha shkollat apo vetëm në shkollat pilot?

Mësuesit e klasave të para mendojnë se kjo kurrikul duhet të zhvillohet gjerësisht në të gjitha shkollat.Pra përgjigja më e madhe është PO.



Grafiku 3.Zhvillimi i kurrikulës në të gjitha shkollat

5.4. Çfarë synohet të arrihet me këtë kurrikul ?

Kjo kurrikul ka synime të gjëra për arritjen e saj.Mësuesit janë përgjigjur se në këtë kurrikul synohet më shumë të arrihet të nxënit.

Pra përgjigjen më të madhe e zënë të nxënit.



Grafiku 4. Synimet që arrihen në këtë kurrikul

5.5. Kurrikula e bazuar me kompetenca zhvillohet?

Kurrikula e bazuar me kompetenca zhvillohet në klasë të parë dhe klasë të dytë në shkollat pilot.

Pra përqindjen më të madhe e zë klasa e parë.



Grfiku 5.Zbatimi i kurrikulës me bazë kompëtence në klasa

5.6. Ndërlidhja e temave kurrikulare ndihmon në procesin mësimorë ?

Mësuesit në këtë pyetje mendojnë se ndërlidhja e temave kurrikulare e ndihmon procesin mësimor.

Përqindja më e madhe është Mjaftueshëm.



Grafiku 6 Nderlidhja e temave kurrikulare në procesin mësimor

5.7. Të mësuarit me kompetenca ndryshon procesin mësimor

Të mësuarit me kompetenca sipas mësueëve të klasave të para ndryshon procesin mësimor në sjellje. Përqindja më e madhe është në aftësi.



Grafiku 7.të mësuarit me kompentenca ndryshon procesin mësimor

5.8. Kurrikula e bazuar me kompetenca është e përshtatshme për klasën e parë ?

Të mësuarit me kompetenca sipas mësueëve të klasave të para ndryshon procesin mësimor në sjellje. Përqindja më e madhe është mjaftueshëm.



Grafiku 8.pershtatja e kurrikules në klasë të parë

5.9. Cfarë ndryshimesh sjell kurrikula aktuale ne procesin mësimorë ? A duhet të vazhdojë të aplikohet?

Disa nga mësuesit kanë dhënë mendimin e tyre se kjo kurrikul po sjell ndryshime në komunikim, sjellje dhe aftësi.

Ata mendojnë se duhet të vazhdojë të aplikohet.



Grafiku 9.Ndryshimet që sjell kurrikula aktuale ne procesin mësimor

5.10. Analiza e të dhenave për cdo pyetje të pyetsorit të mësuesëvë.

Pyetësori për mësuesit përbëhet nga nëntë pyetje ku 8 prej tyre jane me alternative dhe një më shpjegim.

Nga përgjigjet e grumbulluara të mësuesve rezulton se të mësuarit me bazë kompeteca apo zhvillohet në klasat e para të arsimit fillor dhe klasat e dyta në shkollat pilot.

Në baze të përgjigjeve të tyre rezulton se të mësuarit me bazë kompetenca ka sjell risi tek nxënësit dhe efektivitet.Në pyetjen e parë sipas mendimit të mësuesve rregullorja e procesit mësimorë përcaktohet mjaftueshem. Pra 52 % e mtyre mendojne mjaftueshëm. Në pyetjen e dytë kurrikula që po zbatohet jep rezultate te nxënësit mjaftueshëm. 58 % e mësuesëve mendojnë mjaftueshëm.

Në përgjigjet e marra sipas mendimit të tyre kjo kurrikul duhet të zbatoohet gjerësisht në të gjitha shkollat. 84% e mësuesëve mendojnë po.

Me këtë kompetencë synohet të arrihet: të nxënit, aktivizimi i nxënësve, zhvillimi i shprehive, të menduarit.50 % e mësueseve mendojnë se të nxënit arrihet të synohet me këtë kompetence.

Kurrikula e bazuar me kompetenca zhvillohet në klasë të parë dhe klasë të dytë në shkollat pilot. 94 % e tyre mendojnë se në klasë të dytë ndërlidhja e temave kurrikulare ndihmon procesin mësimor mjaftueshëm. 62% janë për mjaftueshëm pjesa tjetër kanë mendim të ndryshëm.

Të mësuarit me bazë kompetenca ndryshon procesin mësimor: të nxënit , në komunikim, në sjellje. Sipas mendimit të tyre 40% e mësueseve mendojne në aftesi pjesa tjetër mendojnë alternativat tjera. Pra përqindja më e madhe është në aftësi.

Kurrikula e bazuar në kompetenca është e pershtatshme në klasë të parë dhe përqindja 64% më e madhe e mësuesve mendojnë në klasë të parë.

PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përfundime

Nëmbyllje të këtij studimi kemi mbërritur në disa perfundime, të cilat gjenden të argumentuara në studim. Lidhur me pyetjen e parë kërkimore se si e perceptojnë mësuesit kurrikulën e bazuar me kompetenca kemi arritur në përfundimin se kjo kurrikul ka sjell përmirësime në procesin mësimor. Mësimdhënia e matematikës e cila udhëhiqet nga parimi që “çdo nxënës është i aftë të mësojë matematikë”, synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet në mësimdhenien edhe nxënien bazuar në kompetenca, mësimdhenien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien e nxënien e integruar.

Dukshëm materialet kurrikulare u kanë shërbyer nevojave të të gjithë nxënësve duke i bërë ata të aftë gjatë gjithë jetës së tyre.

Rekomandime

Duke parë realitetin nëpër shkolla, vumë re zbatimin e kësaj kurrikule në arsimin fillor, ku duhet të jetë sa më efektiv dhe cilësor në përmirësimin e rezultateve të të nxënit.

Në bazë të këtij studimi rekomandojmë :

1. Njohja dhe zbatimi i kësaj kurrikule të re në të gjithë arsimin fillor.

2. Kurrikula bërthamë me bazë kompetence duhet të zhvillohet gjerësisht në të gjitha klasat e arsimit fillor.
3. Materialet kurrikulare duhet të jenë sa më të përshtatshme për moshat e nxënësve.
4. Një vëmendje e vecantë duhet ti përkushtohet zonave rurale për zbatimin e kësaj kurrikule.
5. Kushtet duhet të jenë sa më cilësore dhe efikase për një mësimdhënie efektive.

BIBLIOGRAFIA

Aguerrondo, I. (2009). Complex knowledge and education competence, UNESCO IBE,

Geneva, Switzerland.

AKAFP (2009). *Udhëzues metodologjik për hartimin e kurrikulave të arsimit dhe formimit*

professional në Shqipëri. Tiranë.

MASHT (2012). *Korniza e kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*.

Prishtinë.Kosova

Gjokutaj . M (2015). *Planifikimi dhe zhvillimi i kurrikulës: metodika e mësuesve, arsimi fillo*r, Kristal , Tiranë.

Zekaj. Xh . (2011), *Bazat e procesit mësimor : kurrikula , hartimi dhe zhvillimi i saj* fq.215 – 216, Kristal, Tiranë.

Kuri. V - Tarusha. F (2016), *Kontrolli i dijeve dhe vlerësimi i nxënësve* fq.5-6 Elbasan.

http://europa.eu/legislation_summaries/education_training_youth/lifelong_learning/c11090_en.htm

http://eur-lex.europa.eu/legal content/EN/ALL/;ELX_SESSIONID=9hQ5TvqCQSNVLh9PëDnn51xhh8GC9rn7C3jFë0TmKDYjmGTxqj4g!-862135581?uri=CELEX:32006H0962

https://www.salto-youth.net/doënloads/4-17-1881/Trainer_%20Competence_study_final.pdf

http://www.britishcouncil.org/sites/britishcouncil.uk2/files/youth-in-action-keycomp-en.pdf

http://www.oecd.org/pisa/35070367.pdf

TURIZMI I AVENTURËS- TREDI AKTUAL I DESTINACIONEVE TURISTIKE NË SHQIPËRI

(RAST PILOT VIA DINARICA – PJESA SHQIPTARE)

Dr. Florina Pazari

f.pazari@umb.edu.al

Dr. Elda Mamoçi

student.dean@umb.edu.al

M.Sc.Esmeralda Hasani

e.hasani@umb.edu.al

ABSTRACT

Albania, although a country with a small area, has many natural and cultural resources, that offerthe possibility of different types of tourism. The rich and diverse nature of Albania offers the opportunity to develop various activities and sports in nature. Tourism in Albania plays an important role in the economic development of the country, generating employment and economic income of related sectors. In the last decade, the number of tourists (domestic and foreign) has increased significantly, which has led to the growth and improvement of tourist infrastructure, development of new tourist destinations and alternative types of nature-based alternative tourism, in function of sustainable development tourism. In the framework of sustainable tourism development, adventure tourism has already become a trend of tourist destinations in our country. More and more tourists are avoiding mass gatherings and are looking for explorations of new destinations, with an authentic culture and numerous outdoor activities and new experiences. The increase in demand comes as a result of a number of factors such as: increasing urbanization and population growth in cities, which are looking for recreational and outdoor recreation areas; enhanced marketing of experienced adventure

experiences; increased commercialization of outdoor and adventure recreation, etc.

The Albanian Alps, part of the Via Dinarica White Trail, are among the main and most popular destinations for the development of adventure tourism in the country and the region. The high altitudes above sea level, the picturesque view of the peaks above 2000 m, the diversity of outdoor sports, the cultural authenticity offered by the villages in the Albanian Alps, etc., are some of the adventurous attractions for tourists. The announcement aims to identify and promote adventure sports tourist destinations in the country, analyze the current trend towards outdoor tourism and unforgettable adventure sports experiences. The Albanian Alps have been selected as a pilot area, as part of Via Dinarica, commercialization of adventure tourism, recognition in the international tourism market, etc.

***Key words**: adventure, outdoors activities, tourism, destination*

ABSTRAKT

Shqipëria, ndonëse nnë vend me sipërfaqe të vogël, ka pasuri të shumta natyrore dhe kulturore, duke ofruar mundësinë e llojeve të ndryshme të turizmit. Natyra epasur dhe e larmishme e Shqipërisë ofrojn mundësinëe zhvillimit tëaktiviteteve dhe sporteve të ndryshme në natyrë. Turizmi në Shqipëri luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit, duke gjeneruar punësim dhe të ardhura ekonomike të sektorëve ndërlidhur me to.Dekadën e fundit numri i turistëve (vendas dhe atyre të huaj) është rritur ndjeshëm, gjë e cila ka çuar në rritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës turistike, zhvillim tëdestinacioneve të reja turistik si dhe llojevetë turizmit alternative të bazuar në natyrë, në mënyrë që të kemi një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit.

Në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit, turizmi i aventurës është shëndërruar tashmë në një trend të destinacioneve turistike, në vendin tonë. Gjithnjë e më shumë turistët po shmangin grumbullimet

masiv dhe po kërkojnë eksplorime të destinacioneve të reja, me një kulturë autentike dhe aktivitete të shumta në natyrë dhe përvoja të reja. Rritja e kërkesës vjen si rezultat e një sërë faktorësh si:rritjen e urbanizimit dhe shtimit të popullsisënë qytete, të cilat janënëkërkim të zonave çlodhëse dhe argëtuese në natyrë;marketing i shtuar i përvojave të aventurave ë përjetuara; komercializim i shtuar i rekreacionit në natyrë dhe atij aventuresk, etj. Alpet Shqiptare, pjesë e Via Dinarica White Trail,janë ndërdestinacionet kryesore dhe më të njohura për zhvillimin e turizmit të aventurës në vend dhe rajon. Lartësitë e mëdha mbi nivelin e detit, pamja piktoreske e majave të larta mbi 2000 m, larmishmëria e sporteve outdoor, autenticizmi kulturor që ofrojnë fshatrat në alpet shqiptare, etj, janë disa nga atraktivitetet aventureske për turistët.Kumtesa ka për qëllim evidentimin dhe promovimin e destinacioneve turistike të sporteve të aventurës në vend, analizimin e trendit aktual drejt turizmit në natyrë si dhe përvojave të paharruara të sporteve të aventurës. Alpet Shqiptare janë përzgjedhur si një zonë pilot, si pjesë e Via Dinarica, komercializimit të llojeve të turizmit të aventurës, njohjes në tregun turistik ndërkombëtar, etj.

Fjalët kyçe: *aventurë, aktivitete outdoor, turizëm,destinacione*

HYRJE

Turizmi dhe industritë ndërlidhur me to kanë pësuar një zhvillim të hovshëm dekadat e fundit në vend dhe rajon, duke zënë një peshë të konsiderueshme në ekonomitë e tyre.Numri i turistëve në Shqipëri është rritur nga viti në vit, duke e kthyer Shqipërinë në një destinacion të rëndësishëm turistik në rajon. Në periudhën 2014-2018, mbërritjet e shtetasve të huaj në Shqipëri ishin afërsisht 23.6 milion turistë. Gjatë vitit 2018 Shqipëria shënoi rritjen më të shpejtë në sektorin e turizmit midis vendeve të Europës Juglindore, me mbi 5.3 milion turistëndërkombëtare. Në vitin 2019, rreth 21.2% e PBB në vend u sigurua nga sektori i turizmit dhe udhëtimeve, gjë e cila u shoqërua me rritje të nivelit të të punësuarve në sektorin e turizmit (22.2% e të të punësuarve në total). Interesi gjithnjë e më i lartë për të vizituar Shqipërinë shihet dhe nga tendencat e shtimit

të netëve të qëndrimit të shtetasve të huaj dhe atyre vendas në strukturat akomoduese. Të dhënat e INSTATtregojnë, që numri i netëve të qëndrimit njeh një trend në rritje nga viti në vit, ku mesatarisht turistët e huaj qëndrojnë 5.6 netë, ndërsa ato për arsye biznesi 4.3 netë. Në kuadër të llojeve të turizmit që zhvillohen në Shqipëri, turizmi i aventurës është një nga format e turizmit me një rritje të shpejtë dhe inters gjithmonë e në rritje si nga turistët vendas ashtu edhe ato të huaj. Turizmi i aventurës është një treg i dukshëm në zhvillim, që përfaqëson një nga segmentet e tregut me rritjen më të shpejtë, me potencialin për t'u bërë shumë popullor dhe me rendiment të lartë. Termi ‘aventurë’ është një lloj eksperience, që përfshin eksitimin personal, i cili mund të përkufizohet si "aktivitete udhëtimi dhe argëtimi që blihen me shpresën se do të prodhojnë një përvojë aventureske të dobishme".Shqipëria, ndonëse një vend me sipërfaqe të vogël, ka një pasuri të madhe të ofertës turistike duke i dhënë mundësi për zhvillimin e formave të ndryshme të turizmit, natyror dhe atij kulturor. Bukuritë natyrore malore, vija bregdetare e paprishura, plazhe të bukura, të identifikuara nga vizitorët ndërkombëtarë si "plazhet e fundit të egra të Mesdheut", male të larta dhe të thepisurasi dhe qytete antike me vende historike, muze si dhe zona arkeologjike dhe kështjellat, e rendisin Shqipërinë si një destinacion turistik që nuk duhet humbur. Turistët që vizitojnë Shqipërinë, gjithnjë e më shumë po shmangin turizmin masiv dhe po kërkojnë eksplorime të destinacioneve të reja, me një kulturë autentike dhe aktivitete të shumta në natyrë.Ky trend vlerësohet dhe nga numri I vizitorëve të cilët frekuentojnë Zonat e Mbrojtura të Shqipërisë, veçanërisht Parqet Kombëtare dhe Peizazhet e Mbrojtura të Burimeve të Menaxhuara.Ky trend ka ardhur si rezultat i sërë pasojash si: rritjes së urbanizimit; marketingut të shtuar të përvojave të aventurave përmes formave të ndryshme të argëtimit masiv; rritja e komercializimit në lidhje me rekreacionin në natyrë; përmirësim I cilësisë së jetës; rrijta e kërkesa të turistëve për përvoja të reja, etj.

Larmishmëria e aktiviteteve që zhvillohen në natyrë, puna e operatorëve turistik, por jo vetëm, në lidhje me organizimet e udhëtimeve me kohjëzgjatje të shkurtër, çmim të arsyeshëm për grupe të ndryshme sociale, etj, janë disa faktorë të shtuar të cilët kanë ndikuar në rritjen e lëvizje turistike me focus natyrën dhe aventurën.

Grafik nr.1: Numri i vizitorëve në Zonat e Mbrojtura në Shqipëri



Burimi:Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

Shqipëria ka një marketing të shtuar në lidhje me promovimin e vendit për turizmin "me interes të veçantë" (përfshini turizmin e aventures), ku turistët mund të zbulojnë vende magjepëse duke u mbështetur në natyrën e egër dhe diversitetin kulturor. Ky produkt është ai që ka më shumë potencial nga të gjithë pasi shumica e turistëve ndërkombëtarë që vizitojnë vendin synojnë turizmin e bazuar në natyrë dhe atë të aventurës.

OFERTA NATYRORE E SHQIPËRISË DHE LLOJET E TURIZMIT NATYROR DHE ATIJ TË AVENTURËS

Pozita gjeografike në të cilën ndodhet Shqipëria, pasuritë natyrore, veçoritë gjeologjike dhe gjeomorfologjike, biodiversiteti i pasur, pasuritë ujore, etj, janëpikat e forta të zhvillimit të turizmit natyror në Shqipëri. Vlerat ekologjike, shkencore, biologjike, hidrologjike, etj që pasuritë natyrore të Shqipërisëdisponojnë, kanë bërë qërreth 16% e territorit të vendit është shpallur Zonë e Mbrojtur dhe mbrohet me ligj. Këto zona të mbrojtura, janë një mundësi e mirë për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, veçanërisht ekoturizmit, turizmit rural, turizmit të aventurës, etj. Popullsia lokale që jetojnë në afërsi të këtyre zonave ende ruajnë një një stil jetese tradicionale dhe kanë një trashëgimi kulturore të pasur dhe autentike, e cila është një vlerë e shtuar e këtyre pasurive natyrore dhe

formave të mundshme të turizmit që mund të zhvillohen. Zonat natyrore dhe ato rurale në Shqipëri ofrojnë mundësi për zhvillimin e ekoturizmit dhe turizmit të aventurës si rafting, hedhje me parashutë, ciklizëm malor, peshkim, trekking, hiking (ecje në natyrë) ngjitjet alpinistike, shëtitje me kuaj, eksplorim të shpellave, etj.

Harta 1: Harta fizike dhe e mbulesës bimor të Shqipërisë



Burimi: Harta fizike dhe bimore e Shqipërisë

Përpunimi hartografik: F.Pazari

Ndryshimi i trendeve të interesit të turistëve, mbi forma alternative të aktiviteteve dhe sporteve në natyre, ka bërë që një numër i konsiderueshëm i tureve turistike të përshkojnë zona gjeografike të vendit të panjohura në tregun turistik ndërkombëatr dhe të paprekura nga ture masive. vargmalet e Korabit dhe Lurës; zonat malore përreth Tiranës, malësitë Martanesh,Çermenikë dhe Gollobordë, zona malore e Korcës

Këtu mund të përmendim zonën e Alpeve Shqiptare (Theth, Valbonë, Lëpushë, Vermosh, etj); zonën Topojan-Shishtavec në Kukës; dhe Ersekës (Morava, Mali i Thatë, Gramozi, etj); mali i Tomorit; Llogara-Karaburuni, etj.

1. Bazuar në potencialet natyrore që Shqipëria disponon bëhet e mundur zhvillimi i një disa llojeve të turizmit të aventurës në vendin tonë si ato të zhvillohen në tokë (ecjet në natyrë (hiking), trekking, alpinizmi, çiklizmi malor, garat Really 4*4, ski, kalërimi, gjuetia e egër, etj), në ujë (kanoe, rafting, kayaking, zhytjet në ujë, peshkimi, etj); në ajër (hedhjet me parashutë, etj).Disa nga destinacionet më të frekuentuara nga turistët dhe me promovim të vazhdueshëm të operatorëve turistik, të cilët I kanë përfshirë dhe në guidat turistike, janë:*Hiking***:** Jezerca,Maja e Hekurve**,** Razma, Munella në Pukë**,** Korabi, Radomira**,** Lura **,** Biza në Tiranë**,** Maja e Çikës**,** Mali i Tomorit**,** Gjinari në Elbasan**,** Maja e Rungajës në Vithkuq**,** etj.

2. *Trekking***:** Dukat**,** Mali i Çikës**,** Kurvelesh**,** Vermosh**,** Theth**,** Razem**,** Bogë**,** Valbonë,Tomorr**,** Vithkuq**,** Voskopojë**,** Drenovë

Harta nr.2: Lokacioni i destinacioneve kryesore të turizmit të aventurës në Shqipëri (hiking dhe treking)



Përpunimi hartografik: F.Pazari

3. *Çiklizmi malor*

Interesi për çiklizmin malor, si formë e turizmit të aventurës po fiton gjithmonë dhe më shumë vëmendje. Turet e biçikletave malore nëpër zona të cilat kanë një shkallë vështirësie po vjen gjithmonë e në rritje. Operatorët turistik si dhe guidat turistike locale në bashkëpunim dhe më zyrat e zhvillimit të turizmit nëpër bashki, po bashkëpunojnë për mundësitë e organizimeve të tureve të ciklistëve malor. Këtu mund të përmendim turet në Alpet shqiptare, turet në malësitë e Dibrës (Lurë dhe Korab, etj).

4. *Kalërimi*është një sport i cii ka një historik zhvillimi në Shqipëri.Shkodra, Durrësi, Tirana, Elbasani (Cërrik), Korça, Divjaka, Berati, Vlora, Fusha e Pelave në Lurë, Shishtaveci në Kukës, etj, janë disa nga zonat që kanë qenë të njohura për garat me kuaj dhe kalërimet. Ky lloj sporti vijon të mbeëtet traditë në vendin tonë, ku çdo vit organizohen gara me kuaj si në veri dhe në jug të vendit, ku pjesëmarrës janë si garuesit Brenda vendit ashtu dhe të huajtë.

5. *Sportet e ujit*(kanoe, kayaking, rafting, zhytjet nënujore, etj): Kanionet e Osumit, Riviera Shqiptare, lugina e Vjosës, lumi Buna, liqeni i Ohrit, liqeni i Shkodrës, liqeni i Komanit, liqeni i Ulzës, liqenet e Lurës, etj.

6. *Sportet e ajrit* (hedhja me parashutë): Llogara, Moravë, Dajt, Tarabosh, etj.

VIA DINARICA – DESTINACIONI MËI RI I TURIZMIT TË AVENTURËS NËSHQIPËRI

Via Dinarica

Via Dinarica i referohet zhvillimit të turizmit të aventurës që lidh vendet e Ballkanit Perëndimor nga Sllovenia në Shqipëri (Sllovenia, Kroacia, Bosnja Hercegovina, Monetegro, Shqipëria). Ai përfshin tre shtigje: Shtegun e Bardhë, Shtegun Blu dhe Shtegun e Gjelbërt. Shtegu i Bardhë është shtegu kryesor që ndjek rrjedhën natyrore të majave më të larta të Alpeve Dinarike, nga i cili ka marrë dhe emrin. Ndonëse gjurmët e këtij shtegu përfshijnë një sërë aktivitetesh të ndryshme në natyrë, të tilla si biçikleta në mal dhe rafting, funksioni i saj kryesor është ecja në natyrë, që ndryshe njihet si hiking si një. Ai ka një gjatësi prej 1930 km dhe përshkruhet në këmbë në një distancë kohore prej528 orë dhe 27 min. Maja më e lartë e këtij shtegu është Maja e Jezercës (2694 m) në Shqipëri, ndërsa maja më e ulët është Predjama (188 m) në Sllloveni. Rreth 51,8 km e kësaj shtegu janë në ngjitje dhe 51,7 km janë zbritje. Ky shteg ka një nivel të lartë vështirësie, sepse është i pjerrët dhe kërkon një rezistencë të lartë dhë përgatitje të fortë fizike. Periudha më e mirë e vitit për të ndjekur këtë shteg është nga maji deri në nëntor, për shkak të mungesës së borës. Aktivitetet përgjatë këtij shtegu përfshijnë hiking, çiklizëm, ski, kayaking, rafting dhe pothuajse çdo lloj tjetër të turizmit të avennturës që mund të zhvillohet në tokë, ujë dhe ajër. Via Dinarica synon krijimin e një lidhje tëmidis qyteteve dhe komuniteteve rurale në rajon, të rrisë ndërgjegjësimin për praktikat e mira të biznesit dhe mbrojtjen e mjedisit dhe të ndihmojë një ofertë të lulëzuar të turizmit të aventurës në rajonin e Ballkanit e mbështëtur në natyrë, traditë, produktet tradicionale vendase dhe trashëgiminë e saj unike kulturore.

Harta nr.3: Shtrirja Gjeografike e shtigjeve të Via Dinarica

Burimi: Regional Cooperation Council

Via Dinarica në Shqipëri

Shtegu i Bardhë iVia Dinarica në Shqipëri është një nga zonat më tërheqëse dhe magjepsëse në vend. Bukuria e tyre natyrore dhe vlerat unike mund të konsiderohen si një thesar i fshehur që kërkon kujdesin dhe mbrojtjen e të gjithëve. Alpet shqiptare (pjesë e Via Dinarica) janë shtëpia e një larmie interesante të bukurive natyrore dhe sigurojnë një habitat për shumë specie të botës së egër. Zona ka një klimë mesdhetare kontinentale, e karakterizuar nga dimër të ftohtë dhe verë të shkurtër dhe relativisht të freskët. Reshjet e borës në dimër arrijnë mesatarisht deri në 60 centimetra, madje edhe gjatë muajve të verës copa dëbore janë të dukshme në majat e maleve.Këto zona janë të pasura me burime ujore,

me disa lumenj si Valbona, Shala, Cemi dhe Kiri, të cilët kanë një regjim tipik alpin. Liqenet janë kryesisht me origjinë akullnajore dhe për këtë arsye janëtë varfër në specie. Lloji më i zakonshëm i bimësisë është pylli i ahut, pyjet e lisit, bredhat dhe bredhat, dhe pyjet e ahut. Në disa raste, bashkësitë bimorepasuritë floristike përfshijnë si specie endemike ashtu edhe subendemike. Llojet e pasura dhe të larmishme të bimëve të zonës i përkasin llojit të bimësisë kontinentale të Evropës Qendrore. Pemët e lisit zakonisht gjenden në lartësi midis 800 dhe 1,100 m; në lartësitë midis 1,200 dhe 1,800 m mbulesa e bimësisë përfshin pyje ahu dhe halore; ndërsa kullota alpine është tipike mbi 2.000 m. Kjo zonë është shumë e pasur me bimë të egra medicinale dhe aromatike, të cilat kërkohen në tregun ndërkombëtar. Shpellat karstike, të cilat janë një pjesë relativisht e panjohur dhe e paeksploruar e Alpeve, formojnë një habitat unik veçanërisht për lakuriqët e natës.

Bazuar në pasuritë natyrore si dhe vlerat që përmbajnë, një pjesë e konsideruashme e territorit të Alpeve të Shqipërisë janë të shpallura Zona të Mbrojtura, sipas kategorive tëIUCN-së si: Rezervat Strikt Natyror (Kategoria e Parë - Lumi Gashi), Parku Kombëtar (Kategoria e Dytë - Thethi dhe Valbona), Monumentet e Natyrës (Kategoria e Tretë - mbi 25 Monumente Natyre) dhe dy parqe rajonale të natyrës, Nikaj-Mërturi (17,505 ha) dhe Shkreli (20,282 ha), u shtuan në zonat e mbrojtura në Alpe.

Llojet e sporteve të aventurës përgjatë Via Dinarica në Shqipëri

Përgjatë shtegut të Bardhë të Via Dinarica në Shqipëri mund të zhvillohen një sërë aktivitetesh outdoor për atë grup turistësh të apasionuar pas adrenalinës dhe aventurës. Disa nga këto lloje sportesh dhe itineraret e tyre janë të listuara më poshtë:

1. *Hiking dhe treking*

Ecja në natyrë (hiking) dhe treking përgjatë Via Dinarica në Shqipëri kombinon ecjen në natyrë me eksplorimin e kulturës autentike vendase. Përgjatë këtij turi kalohet nëpër Parkun Kombëtar të Thethit dhe Valbonës, me vlera të larta biologjike, ekologjike dhe gjeomorfologjike.

Disa nga majat e lartë të cilat përshkohen përgjatë këtij turi janë: Jezerca, Maja e Hekurave, Razma, Lepusha, Maja e Rosit, Maja e Pojanikut, Vermosh, etj Shtigjet të cilat mund të ndiqen përgjatë këtij turi janë:Tiranë – Shkodër – Vermosh; Vermosh - Pojanic – Vermosh;Vermosh – Gusinjë;Gusinjë - Liqeni Buni i Jezercës - Maja e Jezercës –Theth;Vermosh – Lëpushë – Theth;Theth – Syri i Kaltër – Theth;Theth – Qafa e Valbonës – Valbonë; Valbonë – Quku i Dunishtës – Gjakovë; Valbonë – Maja e Rosit – Valbonë; etj.

2. Çiklizmi malor

Çkilizmi malor është një sport interesant që zhvillohet gjatë Via Dinarica. Ai është I kombinuar me shitgjet që ndiqen gjatëhiking dhe trekking. Zonat më të zakonshme që zhvillohen këto ture janë Thethi, Boga dhe Vermoshi. Disa nga këto ititnerare janë:

- *Vermosh – fundi i luginës nëVelipojë - Vermosh*

Turi fillon në qëndër të Vermoshit, kalon përgjatë luginës së Vermoshit deri në fund të saj dhe rikthehen sërish në Vermosh. Ai ka një gjatësi 17 km dhe është tur 1 ditor. Rruga është e paasfaltuar dhe me shkallë të lartë vështirësie.

- *Shtegu Ivanaj (Selcë)*

Shtegu Ivanaj fillon në afërsi të fshatit Selcë dhe përfundon në ujvarësn e Selcës, me një gjatësi prej 2.5 kmThis biking trail is 2.5 km. Lartësia mbi nivelin e detit varion 683-1016 m dhe mund të kombinohet dhe me aktivitete të tjera siç janë hiking, garat e vrapimit dhe garat me kuaj.

- *Turi Pylli i Dobkut - Maja e Vajushes*

Shtegu Pylli I Dobkut-Maja e Vajushës shtrihet në zonën e Lëpushës, në afërsi të kufirit me Malin e Zi dhe ka një gjatësi prej 3.7 km. Lartësia mbi nivelin e detit varion 1300-1700 m dhe mund të ushtrohen dhe një sërë aktivitetesh të tjera në natyrë si hiking, gara vapimi, gara me kuaj, ski, etj.

3. Eksplorim i shpellave

Alpet shqptare kanë një perizash karstic, i cili njihet si njëmjaft i përhapur nëkëtëzonë si rezultat iformacioneve karbonatike dhe atyre evaporate. Format karstike më të përhapura në shkëmbinjtë karbonatikë janë luginat, shpellat, kone, puset karstike, etj. Shpellat karstike, të formuara si rezultat i tretjes nga ujërat sipërfaqësorë, veçanërisht ujërat e borës, kanë një interes të veçantë për speleologët. Në Alpet Shqiptare gjenden disa shpella, ku turistët e apasionuar pas speleologjisë, mund të eksplorojnë si: Shpella e Zezë, Shpella e Dragobisë, Shpella e Arapit, Shpella e Thethit, Shpella e Jubanit, Shpella e Muriqit, Shpella e Pusit, Shpella e Harapit, etj.

Forma të tjera të llojeve të turizmit të aventurës që mund të realizohen përgjatë shtegut Via Dinarica në Shqipëri janë: ski, ku ka terrene të përshtatshme për ndërtimin e qendrave të skive; peshkimi në lumenjt e Valbonës, Thethit, Shalës, etj; kanoe dhe kayaking në lumen e Valbonës, Thethit, Shalës, liqenin e Komanit, etj.

KONKLUZIONE

Mjedisi natyror i Shqipërisë ofron një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit, duke e renditur atë në një ndër sektoërët kyç të zhvillimit ekonomik në vend. Oferta natyrore e vendit, dominimi i relievit malor dhe kodrinor, pasuritë klimatike, hidrike si dhe të biodiversitetit, ofrojnë mundësinë e zhvillimit të një sërë aktivitetesh në natyrë si dhe zhvillimin e turizmit natyror. Promovimi i Shqipërisë si një destinacion turistik që nuk duhet humbur, ka rritur interesin e turistëve vendas dhe atyre të huaj për të vizituar këto destinacione.

Në kuadër të zhvillimit të turizmit, turizmi i aventurës është një nga format më të reja të turizmit në vend, ku turistët gjithmonë e më shumë po orientohen drejt llojeve të sportit të aventurësdhe aktiviteteve në natyrë. Disa nga format më tëpërhapura të turizmit të aventurës janë: hiking, trekking, alpinizmi, çiklizmi malor, rafting, kanoe, kayakin, kalërimet, hedhja me parashutë, zhytjet nënujore, eksplorimi i shpellave,

Politikë- bërësit në nivelet me të larta duhet të njohin potencialin e sektorit të turizmit dhe t'i japin përparësi përkatëse. Duke parë Raportin e Konkurrencës për Udhëtimet dhe Turizmin për vitin 2019, ndërmjet tre shteteve, në nën-indeksin: Priorizimi i Udhëtimeve dhe Turizmit, vetëm Shqipëria shënoi 5.0, duke u renditur në vendin e 43-te midis 140 vendeve. Bosnja dhe Hercegovina shënoi 4.1 duke u renditur e 104-ta ndër 140 vende, ndërsa Serbia shënoi 3.9 duke u renditur në vendin e 109/140. Priorizimi i turizmit kërkon institucione të dedikuara që mbikëqyrin promovimin dhe zhvillimin e turizmit në një nivel kombëtar. Si një segment Specifik i tregut të turizmit, Turizmittë Aventurësduhet të ketë përfaqesimin e tij brenda institucioneve qe merren me turizmin. Investimi për hulumtime në tregjet e synuara të turizmit të aventures, tendencat ne turizmin e aventures, produktet me potencial dhe ndarja e këtyre informacioneve me sektorin privat do të demonstrojë më tej përparësinë e sektorit të turizmit te aventures dhe do të inkurajojë partneritete publike-private që rezultojnë në një sektor të shëndetshëm të turizmit te aventures (UNWTO, 2014).

Rritja e aktiviteteve te Marketingut

Të tre shtetet aktualisht ofrojnë të gjithë gamën e produkteve të turizmit te aventurës si çiklizëm malor, shtigje për ngjitje alpinistike, shtigje per kalërim, lumenj për rafting, kanoe, kayaking, vëzhgime të kafshëve të egra, fotografi dhe pista per ski. Tre vendet duhet të merren se pari me mungesën e njohjes së destinacioneve të rajonit ndërmjet turistëve të

aventurës. Kjo mund të bëhet duke nxitur ato aktivitete të marketingut që promovojnë rajonin si një destinacion që ofron një gamë të tërë të produkteve të turizmit të aventurës në një mjedis piktoresk, ose një mundësipër të përjetuar të panjohurën.

Është e rëndësishme për të përcjellë ndjenjën e sfidës dhe përvojën unike që ofron ky rajon. Shumë nga këto aktivitete janë në dispozicion përmes operatorëve turistik ose mund të bëhen në bazë të vetë-drejtimit.

Me potencialin që ky treg ofron, me atraktivitetin e veprimtarive të mundshme dhe duke marrë në konsideratë edhe vendndodhjen e rajonit, eksistojne mundësi të shumta për të rritur kapacitetin me produktine duhur dhe zhvillimin e tregut.

Rritja e Kapaciteteve Akomoduese

Akomodimi është i përshtatshëm sipas standarteve të turizmit të aventurës, megjithëse në periudha të vecanta, i rezervuar plotësisht. Shpeshherë ka patur shqtësime lidhur me sasinë dhe llojshmërinë e akomodimeve të vlefshme, por eksperienca ka treguar se turisti/udhëtari i aventurës është nga natyra më fleksibël në pranimin e njësive akomoduese edhe të një cilësie më të ulët nëse përvojat që ai përjeton janë unike dhe të mire-ofruara. Është e rëndësishme që pavarësisht se strukturat akomoduese ekzistojnë, për të qenë konkurues si destinacion i turizmit të aventurës, rajoni duhet të shfrytëzojë cdo mundësi për zhvillim në të ardhmen.

Bashkëpunimi midis ekonomive dhe promovimi i produkteve të integruara të turizmit

Një mundësi tjetër për tre vendet dhe për rajonin është të kombinohen atraksionet dhe aktivitetet turistike në produkte të konsoliduara të turizmit dhe t'i promovojnë ato si produkte rajonale në tregjet evropiane dhe globale. Promovimi i rajonit si një destinacion i sigurt dhe mikpritës turistik, me një ofertë të konsoliduar turistike dhe produkte autentike lidhet ngushtë me këtë element.

Nismat e suksesshme të turizmit ndërkufitar si Via Dinarica tregojnë potencialin për zhvillimin e turizmit rreth temave dhe rrugëve të përbashkëta. Përmirësimet në këtë fushë jo vetëm që do të çojnë në pajtim dhe stabilizim në rajonin pas konfliktit, por gjithashtu në një mjedis të përmirësuar biznesi në të cilin rrjetet, marrëveshjet dhe partneritetet, do të çojnë në përshpejtimin e rritjes së biznesit, përfshirë turizmin.

Krijimi i një sistemi efikas për trajnimin e vazhdueshëm profesional të burimeve njerëzore të angazhuara në turizëm

Rritja e pritshme e numrit të turistëve do të ushtrojë presion në rritje mbi burimet njerëzore dhe veçanërisht në cilësinë e shërbimeve. Trajtimi i masivitetit të turizmit të aventurës do të jetë një sfidë dhe për këtë ne duhet të krijojmë një sistem efikas të aftësimit profesional që do të mundësojë trajnim të vazhdueshëm për stafin e njësive akomoduese dhe restoranteve, për udhëzuesit turistikë dhe kështu me radhë për të gjithë ofruesit e tjerë të shërbimeve, duke u mundësuar atyre të provojnë cilësinë e tyre.

Për të promovuar dhe zhvilluar turizmin e aventures, është e nevojshme të vendoset një lidhje funksionale më e fortë midis Ministrive përgjegjëse për turizmin në secilin vend dhe Organizatave Turistike dhe agjencive lokale turistike. Shoqëritë e alpinizmit, klubet sportive dhe organizatat joqeveritare duhet të mbështeten në promovimin e këtij lloji të turizmit.

FALENDERIME.

Ky studim eshte financuar nepermjet nje granti te ofruar nga Projekti per Zhvillimin dhe Promovimin e Turizmit te Keshillit te Bashkepunimit Rajonal (RCC)(Grant Nr. TAR0020-089A-2019)

Literatura

AKT (Agjensia Kombetare e Turizmit). (2021). Natyra dhe Aventura. Broshure (http://albania.al/wp-content/uploads/2019/08/NATURE-AND-ADVENTURE-compressed.pdf)

Antić, A., & Tomić, N. (2019). Assessing the speleotourism potential together with archaeological and palaeontological heritage in Risovača Cave (Central Serbia). Acta Geoturistica, 10(1), 1-11.

Ashley, M. &. (2009). Can the private sector reducepoverty at scale? – evidence from the tourism valuechain. *The Commonwealth Ministers Reference Book*, 1-4.

ATDI (Adventure Tourism Development Index)(2021).Adventure Tourism Market Competitiveness (http://www.adventureindex.travel/rankings.html).

ATTA (Adventure Travel Trade Association) (2014).Adventure Travel Guide Standard (https://www.adventuretravel.biz/)

Beard, C., Swarbrooke, J., Leckie, S., & Pomfret, G.(2012). Adventure tourism. Routledge.

Causevic, S. (2010). Tourism which erases borders:An introspection into Bosnia and Herzegovina.*Tourism, progress and peace*, 48-64.

Ciro, A. (2019).Tourism Governance in Albania: AnAssessment of the Policy Framework for the TourismSector in Albania. *Annual Review of TerritorialGovernance in the Western Balkans*, I, 2019, 69-85

Hudelson, J. (2014). Sustainable Mountain Tourism:An Analysis of Bosnia-Herzegovina's Wine Tourismand its Future. In SHS Web of Conferences (Vol. 12,p. 01020). EDP Sciences.

Kane, M. J., & Tucker, H. (2004). Adventure tourism: The freedom to play with reality. Tourist studies, 4(3), 217-234.

Nagy, H., Káposzta, J., & Meta, B. (2017). Thepotentials of rural tourism in developing rural areasin Albania. *Deturope–The Central European Journalof Regional Development and Tourism*, 9(3), 188-206.

NTOS (National Tourism Organisation of Serbia) (2021). Experience Serbia (https://www.serbia.travel/dozivi-srbiju/priroda)

Petticrew, M., & Roberts, H. (2008) Systematic Reviews in the Social Sciences: A Practical Guide; Blackwell Publishing: Malden, MA, USA,

Sekulovic, N. (2015). Trends and new initiatives in tourism at the time of the general economic crisis and the current situation in Serbian tourism. *Procedia economics and finance*, 23, 1628-1634.

Spalević, A., & Igračev, N. (2011). The naturalgeographicalbasics for the development of theadventure tourism in Serbia. *Journal of the Geographical Institute" Jovan Cvijic"*, SASA, 61(3),137-150.

Trišić, I., Štetić, S., & Maksin, M. (2020). Thesignificance of protected natural areas for tourism inthe Vojvodina Province (Northern Serbia)–analysis ofsustainable tourism development. *Spatium*, 1-7.

Vujadinović, S., Šabić, D., Joksimović, M., Golić, R.,Gajić, M., Živković, L., Milinčić, M. (2013).Possibilities for mountain-based adventure tourism:the case of Serbia. *Bulletin of Geography. Socioeconomic Series, 19(19),* 99-111.

Vujko, A., Plavša, J., & Ostojić, N. (2013). Impact of the "Danube cycling route" on the development of cycling tourism in Serbia. Polish Journal of Sport and Tourism, 20(3), 227-233.

World Economic Forum (2017). The travel & tourismcompetitiveness 2017,https://reports.weforum.org/travel-and-tourismcompetitiveness-report-2017/

World Economic Forum (2019). The travel & tourismcompetitiveness 2019.https://reports.weforum.org/travel-and-tourismcompetitiveness-report-2019/

Zerva, E (2018). Legal andInstitutionalFramework onTourism. Investment Council Secretariat. 24 pages

TURIZMI KULTUROR SI MUNDËSI PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM NË QARKUN E GJIROKASTRËS

Prof. Dr. Gëzim SALA

Prof. Asoc. Dr. Albina SINANI

Abstract

Gjirokastra county has valuable tourism resources, that attract the local, regional, domestic as well as the international tourist. This considerable potential of historical and cultural values should be utilized to attract as many domestic and foreign visitors. This resource is of special interest also due to the location of the county in a region rich in tourist traditions and near important corridors of tourist movement patterns. Tourism movement patterns take place throughout the space and are year-round, with the purpose of recreation (in the form of picnics and excursions), health, cultural, political, social, educational, economic, etc. A revival of historical and cultural traditions will be realized through big and systematic efforts for the recognition and promotion of cultural heritage sites. These values of tourism resources should be integrated with the development of cultural tourism and education through them of the domestic and foreign tourists on the best values and achievements of the society in the past. Material cultural heritage is a product of local historical and cultural circumstances, but it is also is also a testament to the beliefs and important values that prevailed at the time the object/place was created. To date, historical and cultural assets have not been used efficiently.

However, historical-cultural tourism offers opportunities for attracting tourist groups, who show interest in the day-to-day life of the county, traditions, customs, culture, lifestyle and cuisine. This is reinforced by the fact that, for the original historical and cultural values it carries, the historical-cultural tourism in the Gjirokastra county is unique.

Key words: historical-cultural tourism resources, historical and cultural object, historical-cultural heritage, historical-cultural values, preservation of cultural monuments, restoration of cultural heritage.

Abstrakt

Qarku i Gjirokastrës ka pasuri turistike të çmuara, si për tregun vendor, rajonal e kombëtar, ashtu edhe për atë ndërkombëtar. Ky potencial i konsiderueshëm vlerash historike dhe kulturore,duhet të shfrytëzohet, për të tërhequr sa më shumë vizitorë vendas dhe të huaj. Kjo pasuri paraqet interes të veçantë edhe për shkak të pozicionimit të qarkut në një rajon me tradita turistike dhe pranë korridoreve të rëndësishme të lëvizjes turistike. Lëvizjet turistike zhvillohen në gjithë hapësirën dhe janë gjithëvjetore, me qëllim çlodhës (në formë piknikesh dhe eksursionesh), shëndetësor, kulturor, politik, social, edukativ, ekonomik etj. Një ringjallje e traditave historiko-kulturore do të realizohet përmes përpjekjesh të mëdha dhe sistematike për njohjen, propogandimin dhe promovimin e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe historike. Këto vlera të aseteve kryesore turistike, duhet të integrohen edhe me zhvillimin e turizmit kulturor dhe edukimin nëpërmjet tyre të publikut vendas dhe të huaj me vlerat më të mira dhe arritjet e shoqërisë në të kaluarën. Trashëgimia kulturore materiale është produkt i rrethanave historiko-kulturore lokale, por edhe përfaqësuese e dukurive kulturore të një natyre të gjërë njerëzore. Deri më sot pasuritë historiko-kulturore nuk janë shfrytëzuar në mënyrë efikase.

Megjithatë, turizmi historik-kulturor ofron mundësi për tërheqjen e grupeve turistike, që shfaqin interes për kuadrin jetësor të qarkut, traditat, zakonet, kulturën, mënyrën e jetesës dhe të ushqyerit. Kjo përforcohet me faktin se, për vlerat origjinale historike dhe kulturore që mbart, turizmi historik-kulturor në qarkun e Gjirokastrës është unikal.

Key words: potenciale turistike historiko-kulturore, objekte historike dhe kulturore, trashëgimi kulturore-historike, vlera kulturore-historike, konservimi i monumenteve të kulturës, restaurim i pasurive kulturore-historike.

Hyrje

Fondi historik-kulturor, qendrat arkeologjike dhe muzeale janë një ofertë mjaft e pasur, për zhvillimin e turizmit historik dhe kulturor në qarkun e Gjirokastrës. Kjo trashëgimi historike, arkeologjike, arkitektonike dhe kulturore, institucionet muzeale, historike, etnografike, traditat kulturore, artizanatet tradicionale, gastronomia, folklori etj, si dhe pasuritë natyrore përbëjnë një ofertë të pasur, të larmishme dhe të veçantë për zhvillimin e turizmit në qarkun e Gjirokastrës. Institucionet qëndrore dhe vendore, subjektet turistike dhe institucionet kërkimore-shkencore duhet të angazhohen në vlerësimin dhe valorizimin e ofertës turistike, me qëllim promovimin e sektorit të turizmit, gjallërimin e lëvizjes turistike, si burim të ardhurash dhe zhvillimin social-kulturor dhe ekonomik të qarkut. Ndërthurja e trashëgimisë kulturore me fondin e "*të mirave natyrore*", në kuadër të politikave dhe strategjive të zhvillimit të qëndrueshëm, do të mundësojë zhvillimin e turizmit, rritjen e punësimit dhe të ardhurave.

Të mirat kulturore, një potencial turistik efiçent i qarkut Gjirokastër

Objektet dhe monumentet historiko- kulturore, qendrat arkeologjike dhe muzeale etj, përbëjnë një ofertë të pasur për zhvillimin e turizmit kulturor dhe historik në qarkun Gjirokastër, ku numërohen rreth 189 monumente kulturore. Numri më i madh i tyre, rreth 147 të tilla gjenden në bashkinë Gjirokastër, 26 në atë të Përmetit dhe 16 monumente në bashkinë e Tepelenës.

Në aspektin kronologjik, kuadri i inventarit të "*të mirave kulturore*"në qarkun e Gjirokastrës, pasqyrohet, *si më poshtë vijon*:

Qendrat arkeologjike, të cilat datojnë, që në epokën e paleolitit dhe mezolitit në luginën e Drinos, Lazarat, Dervician, Goranxi, Haskovë etj. Ato përbëjnë dhe gjurmët më të hershme të popullimit në këtë territor. Një sërë stacionesh të tjera arkeologjike, si nekropolet tumulare të Piskovës, të luginës së Drinos (në Bodrishtë, Kakavije e Çepunë), janë dëshmi e kalimit në epokën e hekurit. Kësaj periudhe i përkasin edhe fortifikimet e para, të cilat janë tregues i fillimit të jetës urbane. Si

fortifikimi më i hershëm datohet ai i Pepelit në krahun perëndimor të luginës së Drinos. Ngritja e vendbanimeve të përmendura ishte rezultat i zhvillimit të brendshëm ekonomik dhe kulturor i bashkësisë fisnore. Diferencimi ekonomik, u shoqërua me rivalitetin luftarak, për mbijetesë.

Objektet dhe monumentet historiko-kulturore, qendrat arkeologjike e muzeale, përbëjnë një ofertë mjaft të pasur për zhvillimin e turizmit historik-kulturor, me mbi 70 monumente kulture. Inventari i *të mirave kulturore* përbëhet nga: qëndrat e vjetra dhe te reja arkeologjike; fortifikimet e para, si tregues i fillimit të jetës urbane; qendrat qytetare dhe kështjellat antike, mbi 15 të tilla, ku veçohet qyteti antik i Antigonese, ballkoni i luginës së Drinos, muzeume etj. Trashëgimia historike, kulturore, materiale, shpirtërore dhe toponomastika vendore përbëjnë një tjeter pasuri me vlerë për zhvillimin e turizmit. Në këtë aspekt një rëndësi kanë, banesat, ndërtimet hidroteknike, zejet etj. Antikiteti rezulton si epoka më e ndritur dhe më e evidentuar, në luginat e Drinos dhe të Vjosës. *Rreth 15 qendra qytetare dhe kështjella antike* u ndërtuan dhe lulëzuan gjatë kësaj periudhe. Nga mesi i shekullit V, në luginën e Drinosit u ndërtua për herë të parë një qytet i mirëfilltë, që tentoi të zgjerohet në hapësirë, me sistem përgjithësisht të rregullt urbanistik, i cili ishte *qyteti antik i Melanit*, i pari qytet antik, në luginën e Drinosit. Të kësaj kohe datojnë edhe kështjella e Leklit, qyteza ilire e Rabies ose Gradishta e Rabies, kështjellat e Selckës dhe Kardhiqit etj. Në territorin e qarkut, faza e katërt e urbanizimit që përfshin 30 vitet e para të shekullit të III pr.K., përfaqësohet me qytetin e Antigonesë, i ndërtuar me dekret të posaçëm të Pirros së Epirit, në vitin 295 p.k.). Kësaj faze i përkasin edhe kalaja antike Nivicës, shek III-II pr.k si dhe qyteza ilire e Qesaratit. Qyteti antik i Antigonesë përbën një nga modelet më tipike të zbatimit të sistemit të rregullt urbanistik. Në planimetrinë e qytetit veçohet për herë të parë, si ndërtim i mirëfilltë akropoli, që zë pjesën më të lartë të kodrës. Ky qytet midis 5 qendrave të fortifikuara të luginës së Drinosit, zinte vendin qëndror, jo vetëm nga pikëpamja e pozicionit gjeografik, por edhe nga madhësia, rëndësia ekonomike, politiko-administrative e saj. Pas djegjes së Antigonesë, në qendër të luginës së Drinosit ndërtohet Hadrianopoli, shek II-VI, qendra më e rëndësishme qytetare, administrative e politike e luginës së Drinosit. Pas përmbytjes së

Hadrianopolit, filloi të lulëzojë si qendër qytetare, qyteti i Gjirokastrës. Fillimet e Gjirokastrës si vendbanim, lidhen ngushtësisht me simbolin e saj, kalanë. Të dhëna me interes për kalanë vijnë nga *Evlia Çelebi*. Sistemi i ndërtimit të mureve të kalasë në Gjirokastër është shembulli më unikal në të gjithë botën. *Ato janë ndërtuar 20 kut të larta prej gurëve të kuq e të rregullt, me pak baltë e gëlqere. Në plasat e tyre nuk mund të qëndrojnë as harabeli e dallandyshja për arësye se nuk kanë ku të futin e kapin kthetrat.*

Kjo mjeshtëri e hollë është shumë e moçme në këtë vend. Kështjella e Gjirokastrës i përket shek. XII-XIII, më e madhja në vendin tonë, me sipërfaqe 4 ha si dhe një nga më madhështoret në rajonin jugor. Në kështjellë është skena tradicionale e *Festivalit Folklorik Kombëtar*, i cili zhvillohet çdo 4 vjet, me pjesëmarrje mjaft të gjerë, nga e gjithë Shqipëria dhe diaspora. Kalaja dher *Pazari i Vjetër*,ndërtuar në shek.VIIdhe rindërtuar në shek. XIX., përbëjnë epiqendrën kompozicionale të qytetit të Gjirokastrës, ku përfundojnë arteriet kryesore rrugore, që lidhin qendrën me lagjet e banuara të sitit më të vjetër historik.Kalaja dhe pazari bërbëjnë bërthamën urbanistike të qytetit, me vlerë historike.

Kalaja e Ali Pashës, ndërtuar në verilindje të qytetit të Tepelenës, gjatë sundimit të tij, përbën një nga perlat më të bukura të qarkut të Gjirokastrës. Në kohën e tij thuhet se kalaja i ngjante një ballkoni të perëndive pagane, për ndërtimin e së cilës u desh shumë punë, pasi rrjedha e Vjosës shpesh herë i bënte punimet të vështira dhe të pamundura.

Si pjesë e ofertës turistike, nje pasuri me vete janë dhe *objektet e kultit*, të cilat paraqesin interes, me stilet, arkitekturën, mozaikët, pikturat si dhe elementet e tjera. Sot ruhen pjesërisht ndërtesa, bazilika, pagëzimore, si Shën Mëria e veçantë e Sopikut, me ikonostasin më të pasur me gdhendje e prarime, kishat e Labovës së Kryqit (*monument arkitekturor bizantin i shek. XIII*), kisha e Shën Thanasit, kisha e re në Goranxi, kisha e Sopikut, Tërbuqit, Poliçanit, manastiret e Goranxisë, Pepelit, Poliçanit, teqeja e Melanit në bashkinë e Gjirokastrës, kishat e Kosinës (*gjysma e parë e shek.XII*), kisha e tipit bazilikal në Leusë (*e fundit të shek. XVIII*), kisha e

Malëshovës, Ogrenit, xhamia e Sukës, teqeja e Frashërit etj, në bashkinë e Përmetit dhe objektet e kultit në Lekdush, teqeja e Gusmarit etj, në bashkinë e Tepelenës etj. Ato kanë dekoracion shumë të pasur arkitektonik, me motive bizantine (*piktura murale të papërsëritshme*) dhe përbëjnë veprat e arkitekturës dhe artit mesjetar. Në këto objekte kulti ndodhen afreske kishtare me ikona të mrekullueshme të kohës së Justinianit, shumë tërheqëse për turistët. Restaurimi i tyre dhe përfshirja në itineraret turistike do të nxiste institucionet dhe komunitetet e interesuara të investonin edhe në përmirësimin e infrastrukturës rrugore të zonave rurale të qarkut. Inventari i objekteve te kësaj natyre i specifikuar rezulton në *14 manastire*, ndër to përmendim: Kryeengjëjve (Dervician), Shendlliut (Jergucat), Shën Mërisë (Zervat), Shën Mërisë në Goranxi etj. Inventari i kishave numëron*30 kisha*: Shënkollit (Dhuvjan), Burimi jetëdhënës (Dervician), Shënkollit (Vanistër), Shpërfytyrimit (Mitropolia-qyteti Gjirokastër), Shën Mëhillit (qyteti Gjirokastër) etj. Sot ruhen pjesërisht ndërtesa, bazilika, pagëzimore (baptistere) si Shën Mëria e veçantë e Sopikut në Gjirokastër, me ikonostasin më të pasur me gdhendje e prarime. *Disa teqe dhe xhami si*: Melani në Gjirokastër, Frashërit, Hormovës, Gusmarit, xhamitë në Gjirokaster, Sukë etj.

Në qarkun e Gjirokastrës, evidentohet prezenca e *18 kalave*, prej të cilave, 9 në Gjirokastër: kalaja e Gjirokastrës, Melanit , Labovës së Kryqit, Selos, Shtëpëzit, Jermës (Saraqinishtë), Kardhiqit, Libohovës, Shën Triadhës në fushën e Valaresë (në qytetin e Gjirokastrës); 2 në Përmet: kalaja e Përmetit, Limarit (Malëshovë), Këlcyrë (Fshat Këlcyrë) dhe 7 në rrethin e Tepelenës: kalaja e Ali Pashës, Leklit, Matohasanaj, Qytezës (Dukaj), Kalivaçit, Nivicës, Zharës (Dukaj).

Banorët besimtarë, kanë lënë gjurmët e tyre në objektet natyrore, të cilave iu kanë dhënë vlera fetare. Të tilla janë shpellat e stolisura, që mund të shërbejnë si mjedise natyrore, për zhvillimin e turizmit speleologjik dhe religjioz. Pikërisht, kjo trashëgimi e vyer e këtyre *vendeve të shenjta*, në qafat malore, rrugë e kryqëzime, pranë burimeve ujore si dhe në hyrje të shpellave, na vjen sot në fomën e simboleve prej guri, druri e metali. Vepra arti me rëndësi për turizmin janë objektet fetare të zbuluara në

qarkun e Gjirokastrës: harqe, ura, varre, amfiteatre, ndërtesa, tempuj etj, që krijojnë një mjedis specifik, me rëndësi fetare e turistike.



Figura 1. Pamje nga kisha e Goranxisë dhe teqe e Melanit, në Nepravishtë (*A.Sinani*)

Padyshim, në qarkun e Gjirokastrës, mjaft i pasur është dhe fondi i objekteve historike e kulturore të muzeumeve, si: Muzeu Kombëtar i Armëve (brenda kështjelës), ku janë ekspozuar armë nga periudha neolitike deri në Luftën II Botërore, Muzeu i Rilindjes, Muzeu i Luftës ANÇL, Muzeu i Sazeve "Laver Bariu" etj.

Trashëgimia materiale, shpirtërore, ndërtimore dhe toponomastika vendore

Ky fond përbën një tjetër pasuri me vlerë, për zhvillimin e turizmit historik-kulturor në qarkun e Gjirokastrës. Në këtë aspekt rëndësi kanë,

banesat, ndërtimet hidroteknike, zejet etj. Rrjeti i qendrave të banuara është krijuar gjatë një procesi të gjatë historik, nën ndikimin e kushteve ekonomike dhe shoqërore, duke marrë tipare të përcaktuara tipologjike dhe funksionale. Në këtë proces të gjatë historik, një atribut të padiskutueshëm kanë kushtet specifike fiziko-gjeografike. Kulla ka qënë një tipar i veçantë arkitektonik në luginën e Drinosit. Faktori tjetër i rëndësishëm, i cili ka përcaktuar arkitektonikën e qytetit të Gjirokastrës, ka qënë karakteri fortifikues dhe mbrojtës i shtëpive autentike të banimit.

Figura 2. Pamje veshjesh dhe kostumesh të vjetra si dhe shtëpia e vëllezërve Frashëri (*A.Sinani*)

Gjirokastra, si një qendër e rëndësishme qytetare, administrative dhe ushtarake, krijoi në mungesë të ligjeve, një sistem mbrojtës të vetin, për ti bërë ballë armiqësive dhe konflikteve të vazhdueshme në gjirin e klasës feudale. Ky sistem mbrojtës, provokuar nga faktorët ekonomik, politikë dhe shoqërorë, gjeti shprehjen e vet në formulimin arkitektonik të shtëpisë qytetare, kështjellës së fortifikuar prej guri. *Pukvili*, i përshkruante ato si banesa-kullë të ngritura në qiell dhe të varura mbi shkëmbinj. Prandaj, qyteti i Gjirokastrës është një qytet tipik shqiptar, me arkitekturë shumë të pasur origjinale, me ndërtime karakteristike, të cilat shquhen për bukurinë dhe larminë e tyre. Banesat e kësaj qyteti janë simbolet e një arkitekture mesjetare të përkryer. *Banesa gjirokastrite*, përbën tipin më origjinal dhe karakteristik të banesës qytetare shqiptare, me një pozitë të veçantë, në arkitekturën e banesave, në mbarë trevën e gjerë ballkanike.

Vlerat e mbrekullueshme arkitektonike, ansambli i papërsëritshëm i banesave gjirokastrite, kalaja madhështore në mes të qytetit, pazari etj, do të befasojnë gjithmonë çdo vizitor apo investitor që do të trokasë në dyert e saj.

Gjirokastra, jo vetëm ndan një trashëgimi kulturore nga Evropa e vjetër, por ajo ka kontribuar në krijimin e kësaj kulture, duke i shtuar asaj pasuri të paçmuara, nga thesari i vet. Banesa, si elementi më i rëndësishëm i arkitekturës së saj, ka lënë të habitur të gjithë studiuesit që e kanë analizuar e studiuar duke prekur çdo gur të saj.

Një *"qytet me gur, mbi gur e nën gur që të mbrekullon me stilin e vet oriental apo antik"* është cilësuar nga Kadare. *Një ansambël arkitektonik*, që duket sikur ka marrë diçka nga qytetet mesdhetare, për ti dhënë jetë zhvillimit të artizanatit apo zejeve dhe frymëmarrjes së një populli që shquhet me historinë e vet, *rreth 200 shtëpi karakteristike*, që kanë statusin "*shtëpi muze*". Ato mbartin vlera të rralla arkitekturore, pasi përbëjnë banesën qytetare më origjinale shqiptare, me ndikim të madh edhe në banesën rurale.

Në këtë aspekt rëndësi kanë objektet etnografike të kulturës së banimit dhe jetesës, social-kulturore si dhe jetës shpirtërore dhe artistike, të pasur me elemente tradicionale të veshjeve kombëtare, këngëve, valleve, instrumentave muzikore etj.

Në hapësirën e qarkut, për më tepër atë rurale, fondi i veshjeve, kostumeve popullore dhe këngëve të të gjitha gjinive është mjaft i pasur dhe pasqyron vlerat social-kulturore dhe historike të periudhave të ndryshme.

Veshjet janë klasifikuar si kombëtare shqiptare. Spikasin veshjet dhe orenditë shtëpiake të Labërisë në Kurvelesh, Lunxhërisë, Zagories, Përmetit etj. Veshjet popullore tradicionale me format e thjeshta, larminë dhe estetikën e tyre (linjat, fustanellat, brezi, gunat, qeleshet, llabania, zhapat, veshja me poture, kostumet e fëmijëve, vajzave, djemve etj.), janë të dokumentuara që nga periudha antike, shprehje e kulturës materiale popullore dhe origjinalitetit të krahinës, që tërheqin shumë vizitorët e huaj. Krahas civilizimit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, veshjet

kanë evoluar, por duke ruajtur elemetet origjinale. Kjo pasuri e paçmuar etnografike dhe artistike duhet ruajtur dhe kultivuar jo vetëm për interesa turistiko-ekonomike, por veçanërisht si dëshmi autentike e origjinalitetit kombëtar dhe autoktonisë shqiptare në këtë hapësirë. Në qarkun Gjirokastër, fondi i objekteve kulturore të galerive, panaireve, teatrove, shesheve sportive etj, rezulton gjithashtu shumë i larmishëm.



Figura 3. Pamje nga manastiri i Poliçanit, Gjirokastër dhe nga Xhamia e Sukës, Përmet (*A.Sinani*)

Mjeshtëritë popullore në qarkun e Gjirokastrës

Qarku i Gjirokastrës, *ka tradita të pasura në mjeshtëritë popullore* (ndërtimtari, hidraulikë, artizanat etj.

Ndërtimet hidraulike, vijnë nga kohët antike me ujësjellësin në krahinën e Lunxhërisë (në fshatrat Nokovë, Dhoksat, Këllëz) dhe mesjeta me pusaxhinjtë dhe sterrëxhinjtë e njohur e të përzgjedhur nga Sulltanët e Perandorisë Osmane. Ndër realizimet inxhinieriko-hidraulike më interesante përmendim ndërtimet hidraulike si: urë-kanali i Bënçës i fillimit të shek. XIX (akuadukt i ardhur deri në ditët e sotme dhe i

dëmtuar nga tërmeti i vitit 1920), akuadukti me vlerë monumentale e arkitektonike i kalasë së Gjirokastrës, ujësjellësi i Gjirokastrës i vitit 1812 (10 km i gjatë), ujësjellësi i Teqesë së Melanit, pranë fshatit Vllaho-Goranxi (ruhet mirë edhe sot), çezmat e vjetra me tipare lokale, si në Gjirokastër (Dhuvjan, Goranxi, Zagori) e Përmet etj, të cilat janë objekte që përfaqësojnë realizimet inxhinieriko-hidraulike më interesante të periudhës së Ali Pashë Tepelenës.

Urat e larta, të cilat janë ndërtuar gjatë shek. XII-XIX për të lidhur fshatrat dhe krahinat midis tyre. Ndërtimi i 5 urave në një distancë 15 km, nga Petrani në Përmet, dëshmon për një traditë të pasur profesionale. Urat e larta prej guri paraqesin vlera kompozicionale dhe arkitektonike të spikatura dhe janë dëshmi të aftësive të rralla të realizimit teknik-konstruktiv. Ato janë të ndërtuara, gjatë shek. XII-XIX, për të lidhur fshatrat dhe krahinat midis tyre, duke mundësuar zhvillimin e marrëdhënieve social-ekonomike midis dy brigjeve të Vjosës dhe degëve të saj. Ato janë: ura e qytetit të Përmetit, e Çarshovës (që lidhte Përmetin me Leskovikun), e Petranit (që lidhte Petranin dhe fshatrat e Shqerisë me fshatrat e anës së majtë të rrjedhjes së sipërme të Vjosës), e Katiut (që lidh Bënjën e Përmetin me fshatrat e Shqerisë etj.), e Limarit (në Malëshovë, që ruhet ende teknikisht edhe sot).



Harta 1. Harta e turizmit historik dhe kulturor të qarkut të Gjirokastrës (*A.Sinani*)

Trashëgimia historike, arkeologjike arkitektonike, kulturore, institucionet muzeale historike, etnografike, traditat kulturore, artizanatet tradicionale, gastronomia, folklori etj, së bashku me pasuritë natyrore përbëjnë një ofertë të pasur, të larmishme dhe të veçantë për zhvillimin e turizmit në territorin e qarkut të Gjirokastrës.

Urbanistika dhe arkitektura e periudhës së Rilindjes, me gjurmët e arkitekturës së vjetër, orientale e ballkanase, përbëjnë një pasuri historike kombëtare, që vjen deri në ditët e sotme, duke mbartur në vetvete vlera të mëdha turistike. Kjo ofertë e pasur gjeografiko-kulturore (trashëgimia materiale dhe shpirtërore, objektet arkeologjike, kështjellat, muzeumet dhe zonat muzeale, ndërtesat karakteristike, institucionet kulturore dhe

sportive etj) duhet të vihet në shfrytëzim turistik dhe të kthehet në burim të ardhurash të rëndësishme, për komunitetet e qarkut të Gjirokastrës.

Pozicionimi në jug të vendit, *kufizuar me Greqinë (rreth 30 km larg nga kufiri, 60 km larg Janinës, apo 160 km larg portit të Igumenicës), vetëm 60 km larg portit të Sarandës, 70 km larg nga Butrinti (një nga qëndrat më të rëndësishme arkeologjike të vendit), rreth 150 km nga Vlora dhe 250 km nga Tirana*, dhe gjithe ky inventar i plotë i të mirave histriko-kulturore, përbëjnë për Qarkun e Gjirokastrës një mundësi mjaft të volitshme për zhvillimin e turizmit në përgjithësi dhe llojeve të tij në veçanti.

Krahas pasurive turistike, si domosdoshmëri për zhvillimin e turizmit janë: infrastruktura, investimet dhe historia dhe kultura e kësaj populsie të lashtë.

- Infrastruktura e kufizuar në jo pak territore të qarkut është një pengesë serioze dhe për zhvillimin e shpejtë të turizmit, prandaj zgjerimi dhe përmirësimi i saj duhet parë me përparësi nga institucionet qëndrore dhe vendore, publike dhe private. Rikonstruksioni i aeroportit të Gjirokastrës për përdorim civil (fluturimeve charter) do të kishte një rëndësi të jashtëzakonshme, për zhvillimin e tregut të turizmit kombëtar dhe rajonal, duke nxitur lëvizjen turistike, investimet dhe punësimin në veprimtaritë turistike, infrastrukturë dhe sektorë të tjerë ekonomikë e socialë.
- Investimet përbëjnë në faktor të rëndësishëm për mbarëvajtjen e sektorit turistik në qark, sidomos investimet në trajtimin e kësaj pasurie kaq të larmishme, jo vetëm në strukturë.

Monumentet e kulturës në Gjirokastër (qytet që gëzon statusin pasuri universale e UNESKO-s), janë përfshirë në një sërë projektesh dhe ndërhyrjesh konservuese, hartuar pas studimesh të përbashkëta mes palës shqiptare dhe asaj italiane. Projekt- plani i ndërhyrjeve konservuese në qendrën historike të Gjirokastrës bazohet mbi hartën aerofotogrametrike të Gjirokastrës, hartuar nga pala italiane, mbi bazën e kooperimit për zhvillim ndërmjet rajonit të Markes, komuna e Grottammares (Itali) dhe asaj të Gjirokastrës. Këtu përfshihet harta e ndërhyrjeve restauruese deri

në vitin 1991, harta e monumenteve në gjendjen e sotme, sipas rrezikshmërisë së rëndë, të mesme dhe të lehtë, si dhe harta me monumentet në të cilët, sipas viteve do të ndërhyhet në vitet 2007-2011.

Fondet e akorduara nga Qeveria shqiptare, i kanë shërbyer shpëtimit të qytetit të gurtë dhe tregon në radhë të parë sensibilizimin e saj për Gjirokastrën. Me këtë fonde, ndërhyrjet e fuqishme restauruese në zonën muzeale të qytetit e kanë rijetëzuar atë totalisht. Këto investime insistojnë kryesisht në qendrën historike nga Qafa e Pazarit, deri te kompleksi i banesave monumentale të Angonatëve. Specialistët e monumenteve të kulturës kanë përpiluar me hollësi projektet, të gjithë objektet historike dhe monumentale që kanë përfituar nga fondi i buxhetit të shtetit. *Të gjithë objektet e kategorisë së parë dhe të dytë* kanë pësuar ndryshime të jashtëzakonshme, në aspektin e restaurimeve**.**

Sugjerime

- Të restaurohen monumentet e kulturës, të mbrohen nga degradimet dhe dëmtimet dhe të administrohen me sa më efektivitet;
- Institucionet qendrore dhe vendore, subjektet turistike, institucionet kërkimore-shkencore duhet të angazhohen në vlerësimin dhe valorizimin e ofertës turistike të rajonit, me qëllim promovimin e rëndësisë që ka zhvillimi i sektorit të turizmit dhe gjallërimin e lëvizjes turistike, si burim të ardhurash dhe zhvillimi social-kulturor dhe ekonomik i hapësirës së qarkut;
- Të ruhen, mbështeten dhe zhvillohen traditat më të mira turistike të qarkut, të zhvillohet një treg turistik vendor, rajonal e ndërkombëtar, i garantuar dhe reciprok;
- Të shfrytëzohet produkti turistik i hapësirës në mënyrë racionale dhe efikase;
- Të organizohen dhe mbështen aktivitetet turistike;

- Të sigurohen guida turistike në gjuhë të huaj;
- Të ndërgjegjësohet popullsia e qarkut për vlerat e monumenteve dhe mundësinë e shfrytëzimit turistik të tyre;
- Të promovohen pasuritë turistike të rajonit nëpërmjet botimeve, mjeteve të informacionit masiv dhe edukimit shkollor të të gjitha niveleve;
- Mirëmbajtja e vlerave turistike duhet të jenë preokupim i institucioneve shtetërore, organizatave joqeveritare dhe i gjithë komunitetit;
- Valorizimi i një pasurie të tillë të rrallë dhe të papërsëritshme do ti shërbejë zhvillimit të turizmit në qark në funksion të rritjes së punësimit dhe të ardhurave të popullsisë.

Bibliografia

1. Çelebi E., *Shqipëria 350 vjet më parë*. Horizont 2000.

2. Doka Dh., *Mundësi dhe probleme të zhvillimit të turizmit në Shqipëri*, Studime Gjeografike 11.

3. *Enciklopedia e Tepelenës*.

4. Gashi M., *Bazat e turizmit*, Prishtinë 1986.

5. Gjirokastër, *Ringjallja e madhe 2004-2006*, Bashkia Gjirokastër.

6. *Gjirokastra analisi ed indirizzi per lo svilupo futuro*, 2002.

7. *Guidë turistike e Qarkut Gjirokastër*, Toena, Tiranë 2005.

8. Hoti M., Dibra N., *Probleme të gjeografisë së turizmit*, Studime Gjeografike 9.

9. *Ilirët dhe Iliria nga autorët antikë*, Tiranë 1965.

10. Lole Dh., *Përmeti dhe trevat e tij deri në vitin 1912*, "Luarasi", Tiranë 2000.

11. Prendi F., Budina Dh., *Kultura Ilire e luginës së Drinosit në epokën e Hekurit*. Studime historike nr 2, Tiranë 1971.

12. Riza E., *Mbrojtja dhe restaurimi i monumenteve në Shqipëri*, Dituria, Tiranë 1997.

13. *Strategji e zhvillimit të turizmit në Shqipëri deri në 2012*, Ministria e Rregullimit të Territorit e Turizmit, Tiranë 2003.

14. *Strategjia e zhvillimit të qarkut Gjirokastër*, Gjirokastër 2005

TURIZMI I AVENTURËS NË SHQIPËRI-MUNDËSITË DHE SFIDAT
(Rast pilot qarku i Dibrës)

Ardi Malaj[6]

Ekspert Turizmi, Zyra e Turizmit, Bashkia Mat

ardi_malaj@yahoo.com

ABSTRACT

Tourism is one of the sectors with the fastest growth and significant contribution to the country's GDP. In recent decades the number of tourists visiting Albania has been increasing progressively. Albania with its natural and cultural potentials offers the possibility of developing different types of tourism such as cultural, natural, ecotourism, agritourism, religious, adventurer, etc. Tourism of adventure, as a form of tourism, is one of the newest forms of tourism in Albania, but with the most rapid development. The natural potentials that Albania owns offer the opportunity of adventure tourism development with a variety of activities such as rafting, diving, walking, riding, mountain hiking, fishing, exploration, and many other sports that are environmentally friendly. The rapid development of adventure tourism in the country, found the interested parties unprepared, which has been accompanied by various problems and challenges such as: arrangement of itineraries, marking the crossing paths, poor road, and tourist infrastructure conditions, etc.Recently, in national tourism development strategies, more and more the emphasis is being placed on improving infrastructure as well as preparing professionals to lead certain groups of adventurous tourists. In terms of the use of adventure tourism in the country, the region of Dibra is one of the areas with the most potential to develop different adventurous sports. Although the Dibra region owns multiple potentials to develop tourism, there have been few investments in this

[6] Ekspert i turizmit, Zyra e Turizmit, Bashkia Mat

sector but during the last years has caught adventurous tourist eyes. Dibra is becoming one of the main destinations for some forms of adventurous tourism such as hiking, cycling, parachuting, canoeing, etc. Rugged mountain terrain, natural beauties as well as an authentic culture have been among the main factors attracting tourists in recent years.

This paper's main purpose is to identify the possibility of adventure tourism development in our country, the problems and challenges they face as well as the alternatives for developing new destinations of adventurous tourism in the country. Literary research, questionnaires with interviews with the locals and tourists who visit there as well as the identification of gaps and problems which adventurous tourism deals with, are some of the methodologies used to conduct this study.

***Keywords**: adventure tourism, gaps, SWOT analysis, tourist trails, Dibra*

ABSTRAKT

Turizmi është një ndër sektorët me rritje më të shpejtë dhe kontribut të rëndësishëm në GDP e vendit. Dekadat e fundit numri i turistëve që vizitojnë Shqipërinë kanë ardhur duke u rritur në mënyrë progresive. Shqipëria me potencialet natyrore dhe kulturore që disponon ofron mundësinë e zhvillimit të disa lloje turizmi si ai kulturor, natyror, ekoturizëm, agroturizëm, fetar, aventurier, etj.

Turizmi i aventurës, si formë e turizmit, është një ndër format më të reja të turizmit në Shqipëri, por me një shpjetësi zhvillimi shumë të shpejtë. Potencialet natyrore që Shqipëria disponon ofron mundësinë e zhvillimit të turizmit të aventurës me një larmishmëri aktivitetesh si rafting, diving, hiking, kalërimet, alpinizëm, peshkim, eksplorime dhe shumë sporte të tjera që janë miqësore me mjedisin. Zhvillimi i shpejtë dhe i vrullshëm i turizmit të aventurës në vend, i gjeti palët e interesuara të papërgatitura, cka është shoqëruar me problematika dhe sfida të ndryshme si: përcaktimi i itinerareve, shënjimi i shtigjeve të kalimit, infrastrukurë e dobët rrugore dhe turistike, etj. Në strategjitë kombëtare të zhvillimit të

turizmit gjatë viteve të fundit, gjithmonë e më shumë po vihet theksi në përmirësimin e infrastrukturës si dhe përgatitjen e profesionistëve për udhëheqjen e grupeve të caktuara të turistëve aventureskë.

Në kuadër të zhvillimit të turizmit të aventurës në vend, qarku i Dibrës është një ndër zonat me potenciale të shumta për zhvillimin e sporteve të ndryshme avetureske. Ndonëse rajoni i Dibrës disponon potenciale të shumta për zhvillimin e turizmit, investimet në këtë sektor kanë qenë të pakta, por që vitet e fundit nuk i ka shpëtuar syrit të turistit aventuresk. Dibra po shndërrohet në një nga destinacionet kryesore të disa formave të turizmit të aventurës si hiking, ciklizëm, hedhja me parashutë, kanoe, etj. Terrenet e thyera malore, bukuritë natyrore si dhe kultura autentike kanë qenë ndër faktorët kryesor të tërheqjes së turistëve vitet e fundit.

Ky punim ka për qëllim evidentimin e mundësisë së zhvillimit të turizmit të aventurës në vendin tonë, problemet dhe sfidat me të cilat ai po përballet si dhe alternativat e zhvillimit të destinacioneve të reja të turizmit të aventurës në vend. Hulumtimi i literaturës, pyetësorët me intervistat me popullsinë e zonës dhe turistët që vizitojnë atë si dhe identifikimi i boshllëqeve dhe problemeve me të cilat përballet turizmi i aventurës, janë disa nga metodologjitë e përdorura për realizimin e këtij studimi.

Fjalët kyce: *turizëm i aventurës, boshllëqë, analiza SWOT, shtigje turistike, Dibër*

Turızmı ı aventurës në Shqıpërı-mundësıtë dhe sfıdat (Rast pilot Qarku i Dibrës).

Shqipëria me potencialet natyrore dhe kulturore që disponon ofron mundësinë e zhvillimit të disa lloje dhe forma të turizmit si ai kulturor, natyror, ekoturizëm, agroturizëm, fetar, aventurier, etj. Në këtë punim turizmi i aventurës është evidentuar si një formë e e vecantë e turizmit bashkë me aktivitetet që ai mbart, si; rafting, diving, hiking, kalërimet, alpinizëm, peshkim, eksplorime dhe shumë sporte të tjera që janë miqësore me mjedisin, çka mund të sillte krijimin e produktit turistik që ofron Shqipëria, në konkurencën e fortë që i bëhet nga vendet e tjera. Aplikimi dhe zhvillimi i turizmit të aventurës në vendin tonë do të luante një rol të rëndësishëm në rritjen e nivelit ekonomik, pasi ka potencialin që të transformojë pozitivisht ambjentin dhe ekonominë. Turizmi aventurier mund të bëhet një katalizator, duke dhënë një shkëndijë në rritjen ekonomike te vendit. Pra është e kuptueshme që ndërtimi i tregut në turizmin e aventures kërkon një këndvështrim ndryshe nga ai i përdorur në zhvillimin e tregut te zakonshëm turistik. Ndonëse në Shqipëri ekzistojnë vlera e premisa të mira për zhvillimin e turizmit në përgjithësi dhe turizmit të aventurës në veçanti, nuk mund të flasim për një zhvillim të mirëfilltë të turizmit aventurier. Ky fakt lidhet me zhvillimin e pakët në tërësi të turizmit në vendin tonë. Megjithëse Shqipëria si vend mesdhetar i kishte të gjitha mundësitë që të radhitej midis vendeve të tjera medhetare në zhvillimin e turizmit, faktorë të ndryshëm nuk e lejuan një gjë të tillë. Deri në vitin 1945 gjëndja e vështirë e vendit dhe luftërat e shumta, penguan zhvillimin e turizmit, faktorë të ndryshëm ekonomikë, shoqërorë, politikë nuk e lejuan një zhvillim të tillë. Megjithatë mund të themi se Shqipëria ka qënë gjithmonë qëllim i vizitave nga persona të ndryshëm, i udhëtarve, i njerzëve që i ka çuar rasti, apo në kërkim të së bukurës, në kërkim të aventurës, etj. Nuk mund të lëmë pa përmendur udhëtarët Anglezë, si; Bajronin, E. Liku dhe Durhamin. Kanë qënë pikërish këta udhëtarë, guximtarë, me shpirt të shfrenuar aventurier, të magjepsur nga mrekullitë e natyrës Shqiptare dhe trashëgimia jonë material-shpirtërore, kanë shtuar kryezitetin duke kaluar mal në mal dhe shteg me shteg, duke rrezikuar

edhe jetën e tyre, për të mos humbur asgjë, nga ky vend frymëzues për ta, që u fali aq shumë.

Turizmi i aventurës është një formë e veçantë e turizmit. Aktivitetet aventuriere, janë përgjithësisht aktivitete që kanë në thelb rritjen e adrenalinës, sfidës, emocionit, që përfshijnë riskun dhe ekzaltimin e turistëve. Të gjitha aktivitetet e turizmit aventurier lidhen me natyrën. Për më tepër, paparashikueshmëria e natyrës i shtohet të papriturave të aktiviteteve aventuriere. Produktet e turizmit të aventures në shqipëri mund të klasifikoheshin në tre kategori të listuara si më poshtë.

Aventurat Ujore

Aventurat ujore/ në ujëmund të organizohen në liqene, lumenj, dete,në ujëvara, burime të fuqishme, etj. Zhytja është një nga sportet më të zakonta ujore. Zhytjet janë të njohura anembanë veçanërisht për të parë koralet nënujore, faunën dhe florën, parqet arkeologjike nënujore, etj. Në ditët e sotme xhytjet në det po marrin gjithashtu shumë popullaritet. Rafting dheKanotazhi janë shumë të kërkuara nga turistët aventurierë, dhe ka marrë një zhvillim të vrullshëm vitet e fundit si aktivitet pasi kërkesat për të, po rriten dita ditës. Aventura sportive në uji të tilla si; ski në ujë, sërf sipas erës dhe sërf normal janë aq të popullarizuara, saqë organizohen konkurse vjetore.Përsa i përket potencialeve dhe mundësive të zhvillimit të aventurës ujore në vendin tonë po i trajtojmë më poshtë:

Aventurat Tokësore

Aventurat në tokë mund të jenë, kampingjet, eksplorimet në shpella, kalërimet, trekking, hiking, etj. Kampingjet janë forumet më të njohura të maleve që zhvillohen në dy forma: a)- me tendë ose b)- ose në auto-kamp. Kjo formë po aplikohet nga të gjithë grupmoshat e turistëve. Tjetër formë me interes të veçantë janë eksplorimet në Shpella, megjithse e kemi dëgjuar shpesh me termin turizmi spelologjik, turistët aventurierë nuk heqin dorë ngo kjo formë dhe lloj turizmi në kërkim të thesareve dhe historive të fshehura nëpër shpella. Safari i ditëve moderne organizohet nga një grup që udhëtojnë në formën e karvanit, mbi një distancë të gjatë specifike me fuoristrada 4X4. Safari mund të jetë një safari në shkretëtirë

ose një ekskursion i ashpër/egër, një udhëtim në zonat malore, ku ekzistojnë elementë të shumtë të aventurës, ku testojnë durimin e tyre dhe makinerive me aftësitë drejtuese të një personi. Aventurat e bazuara në tokat e njohura i bien përqark maleve ose konceptojnë aventura të tilla si trekking (ngjitja në mal)**.** Ngjitja në mal, zakonisht janë më të vështira se trekking, meqë kërkon aftësi të specializuara, të cilat mund të përvetësohen përmes trajnimeve. Tjetër formë e vjetër që vozhdon të aplikohet akoma është ngjitja e shkëmbinjëve, që është pjesë e malengjitjeve dhe shpesh përformohet si sporti i alpinizmit. Të gjitha këto aktivitete që përmendëm më lartë do ti shtjellojmë më poshtë:

Aventurat ajrore

Forma më e vjetër e aventurave ajrore që aplikohen në shumë vende që kanë të zhvilluar turizmin janë balonat. Madje edhe sot, një numër shumë i vogël turistësh mund të ketë përjetuar këtë aventurë sërish. Shancet për ta shitur këtë produkt të turizmit janë të mëdha dhe tregu është i hapur. Do të ishte një itinerar shumë tërheqës nëse do të shihnim Shqipërinë nga ajri nëpermjet Balonës, pasi kjo është e mundshme sepse vendi ynë nuk ka ndonjë gjatësi të madhe në vijë ajrore dhe mund të jetë e përshkueshme edhe nga Balonat. Aventurierët do të shkojnë gjithashtu për hedhje me Parashutë ose sky diving, por këtë kërkojnë trajnime specifike që janë dhe goxha të kushtueshme, por bëhet fjalë për atë kategori turistësh që mund ti kenë mundësitë. Në vendin tonë ky aktivitet nuk është i zhvilluar akoma, por i ka të gjitha shancet dhe mundësitë për zhvillimin e tij në të ardhmen. Një tjetër aventurë ajrore, është paragliding, bëhet gjithashtu duke përdorur mbajtëse të lehta, por ndryshon nga hedhja me parashutë nga aeroplanët pasi ai është një fluturim i lirë që niset nga toka. Parasailingështë një zhvillin i fundit, ku përdorimi anijes në ujë ndihmon në rimorkimin e vozitësve dhe ndalimin me makinerisë bëhet e mundur zbritja. Hang Gliding (rreshqitja me të varur) është një variacion i rrëshqitjes, i cili është bërë shumë popullor. Ndryshe nga kjo Hedhja Bungee (hedhje nga lartësitë e mëdha me një litar elastik) mund të konsiderohet gjithashtu një formë e aventurës ajrore. Masa më të rëndësishme para pjesëmarrjes në ndonjë nga format e aventurave ajrore, është të marrësh në konsideratë

parashikimet e motit dhe eksperiencën e trajnuesit, gjithashtu dhe backgroundin e tij në masat paraprake që duhet të marrë për turistët, sepse nëse ato nuk kanë marrë trajnimin dhe formimin e duhur mund të shkaktojnë një eksperiencë që mund të lë shije të hidhur.

Si konkluzion mund të themi se një zhvillim i tillë është i lidhur ngushtë me përmirsimin e përgjithshëm të situatës në Shqipëri e rajon, me rritjen e rolit dhe rëndësisë së vendit në kuadrin e hapësirës mesdhetare, ndërtimin e artereve rrugore në katër anët e Shqipërisë. Problemet e hasura në zhvillimin e turizmit në Shqipëri duhet të zgjidhen nga vetë ne, duke marrë eksperiencat pozitive nga vende që e kanë të zhvilluar turizmin dhe kanë tashmë një traditë në turizëm, në ndërtimin e infrastrukturës turistike, në edukimin profesional të stafit që do të ofrojë shërbimet, etj.

Potencialet turistike që ofron Qarku i Dibrës

Qarku i Dibrës ndodhet në pjesën verilindore të Shqipërisë, në zonën malore qëndore, në të dy anët e lumit Drini i Zi dhe në luginën e Matit. Ai kufizohet në lindje me Maqedoninë, në veri me qarkun e Kukësit, në veriperëndim me qarkun e Lezhës, në perëndim me qarqet e Durrësit dhe Tiranës dhe në jug me Qarkun e Elbasanit. Dibra pozicionohet në këto koordinata gjeografike: **gjerësia veriore, 41° 54′ 28″, dhe gjerësia jugore 41° 20′ 50″, gjatësi lindore 20° 34′ 50″gjatësi perëndimore 19° 48′ 36″. Nën-Rajoni Verilindor** karakterizohet nga një ndërtim gjeologjiki ndryshëm. Në këtë rajon, gjenden zona të ndryshme tektonike, si Korabi, Mirdita, Krasta – Cukali dhe Kruja. Nën-rajoni verilindor dominohet nga shkëmbinj të ndryshëm shtresë hollë dhe magmatik, sidomos ato ultra-bazikë. **Relievi** i nën-rajonit është i shumëllojshëm. Ky tipar lidhet me përbërjen e ndryshme litologjike, lëvizjet neotektonike, shirat e bollshëm, kontrastet termale, pjerrësitë e mëdha kodrinore, përhapjen e mbetjeve të erozionit dhe praninë e rrjetit të dendur të lumenjve. Qarku i Dibrës karakterizohet nga pasuri të mëdha ujore. **Klima** është mesdhetare kodrinore paramalore dhe mesdhetare malore. Terreni është kryesisht kodrinoro-malor ndërsa zona fushore dhe kodrinore janë bazë e zhvillimit të prodhimit bujqësor ku gjithashtu

sigurohen dhe nje sërë prodhimesh bujqësore. Malet dhe luginat perbejne burime te medha pyjore dhe kullosore si ponteciale te prdhimeve pyjore. Dibra njihet për objektet natyrore, historike dhe kulturore që duke u rikonstuktuar dhe promovuar si duhet do të përbëjnë një bazë të mirë të ofertes turistike të Dibrës. Peizazhi dominues në territorin e Dibrës është ai rural, si në aspektin e përdorimit të hapësirave të tokës, në ngastra të vogla dhe me diversitet kultivimi, si në stilin e ndërtimit të fshatrave, tipike e familjeve dhe ekonomive rurale. Peizazhi rural është i ndryshëm. Në të dallohen qartë pjesa e territoreve në zonat malore, ku përdoret guri për ndërtim, rasat për mbulim dhe tokat në ngastra të vogla e të pjerrëta. Dallohen gjithashtu edhe zona fushore me shtëpi të mëdha që kanë oborre të mbjella me pemë frutore, tokat e sistemuara të mbjella me drithëra, foragjere dhe pemë frutore. Kjo gjë konsiderohet një aset shumë tërheqës për vizitorët dhe turistët, që janë të interesuar për turizmin rural. **Trashëgimia kulturore përbëhet nga vlera materiale dhe jo-materiale**, të cilat janë pjesë e pasurisë kombëtare. Trashëgimia kulturore materiale përfaqëson një bashkësi vlerash kulturore dhe historike të trashëguara, të shprehura përmes tipologjive të ndryshme arkeologjike, arkitekturore, historike, artistike etj. Trashëgimia shpirtërore përfaqësohet nga folklori i pasur gojor, muzikor dhe koreografik, festat lokale, artizanati, zejet e ndryshme etj. Meqenëse kjo zonë është e populluar që në lashtësi, Dibra zotëron një pasuri të madhe kulturore materiale dhe shpirtërore. Trashëgimia materiale në këtë rajon përfaqësohet nga larmia e objekteve historike si: kalatë, banesat karakteristike të zonës, muzetë historikë, objektet e kulteve të ndryshme fetare dhe një sërë objektesh apo rrënojash arkeologjike. Një pjesë e madhe e tyre janë shpallur monumente të kulturës. Dibra përbëhet gjithashtu edhe nga një trashëgimi shpirtërore e pasur që përfaqësohet nga këngët dhe vallet tradicionale, festat e shumta lokale, kuzhina tradicionale e shumëllojshme dhe e shijshme, lojërat popullore etj. Kjo pasuri dëshmon aftësinë krijuese të popullit dibran në shekuj, marrëdhëniet me vendet fqinje si dhe shkëmbimet apo ndikimet e kulturave të ndërsjellta. Pasuritë kulturore përbëjnë edhe një potencial të madh për zhvillimin e turizmit kulturor në vendin ku ndodhen apo manifestohen. Si konkluzion mund te themi që qarku i dibrës me potencialin që ai mbart ofron mundësi për

zhvillimin e të gjithë llojeve dhe formave të turizmit në përgjithësi, dhe të turizmit të Aventurës në vecanti. Nuk mund të lëmë pa përmendur që në Dibër ndodhet edhe Mali i Korabit, që është mali më i lartë ne Shqipëri dhe turistët janë kurjozë të ngjiten në majën më të lartë të Shqipërisë.

Turizmit i aventurës në raport me llojet dhe format e tjera të turizmit në Qarkun Dibër

Nga analiza dhe trajtimi i deritanishëm, kemi dhënë në formë të përmbledhur të parimeve që e bëjnë konkurues tregun e turizmit të aventurës në qarkun Dibër, duke i bazuar dhe zhvilluar ato përmes analizave dhe punës në vende të ndryshme ku është i zhvilluar ky treg. Ky set parimesh është mbështetur nga studime dhe vizita në tërren. Dhjetë shtyllat nisin nga filozofia e drejtuar për nga konsumatori dhe inkurajojnë zhvillimin e tregut aventurier turistik, që ofron produkte dhe shërbime të dëshiruara nga konsumatori, kuptohet që mund të jenë efikase edhe për vendin tonë. Ky seksion përshkruan 10 shtyllat në detaje dhe siguron informacion në mënyrën sesi arrihet terheqja e turistëve aventurierë nga çdo vend. Për shumicën e shtyllave, të dhënat janë mbledhur nga informacionet e vlefshme publike dhe nga praktikat më të mira. Dhjetë shtyllat janë:

1. Politikat e zhvillimit të qëndrueshëm në qarkun Dibër

2. Siguria e turistëve

3. Infrastruktura Turistike

4. Burimet Natyrore

5. Burimet Kulturore

6. Burimet e aktiviteteve aventureske(Diving, rafting climbing, hiking, etj.)

7. Vendimarrja

8. Mikpritja

9. Shëndeti

10. Krijimi i brand-it

Llojet e turizmit, karakteri i ofertës, potencialet e zonës përveç të tjerave përcaktohet edhe nga kërkesa turistike. Kështu mbi bazën e kërkesave turistike ato varen nga disa faktorë, si: niveli i të ardhurave të turistëve, mosha, vendi ose zona turistike, periudha e vitit, forma dhe llojet e turizmit,etj. Në qarkun Dibër mund të zhvillohet turizmi cilësor, pasi është i përbërë nga turistë me të ardhura të mëdha që kërkojnë komoditet të lartë ku dëshirojnë të akomodohen në Bujtinat dhe hotelet që ndodhen në zonën e qarkut Dibër dhe kanë një ofertë turistike të pasur me mundësi zgjedhje të shumta dhe turizëm i nivelit të mesëm ku ofron një ofertë e konsiderueshme. Sipas grup moshave dallohet:

Turizmi i moshave të reja, deri në 35 vjeç, janë të prirur drejt aktiviteteve sportive, aventuriere, dhe rekreacionit. Oferta që ofron qarku Dibër është shumë e larmishme, duke plotësuar kërkesat e turistëve për këto grupmosha. Turizmi i moshave më të mëdha që kërkojnë qetësi, rekreacion, komoditet, etj. Ky kasifikim ka rëndësi për të njohur larminë e tij, për të përshtatur këto lloje sipas kushteve dhe ofertës konkrete turistike ku po i listojmë më poshte itineraret, kampingjet dhe bujtinat më të rëndësishme që operojn aktualisht në Qarkun Dibër .

Turizmi i Aventurës ne Qarkun Dibër dhe mundësitë që ofron

Në qarkun e Dibrës ndodhen 85 monumente natyre dhe 67 monumente kulture, po ashtu në qarkun Dibër ndodhet edhe Mali me i lartë i Shqipërisë Korabi. Potencialet e shumta turistike që ofron kjo zonë dhe relievi i thyer ka bërë që udhëtarë të pavarur të cilët dëshirojnë të zbulojnë destinacione ‘të veçanta”., kjo zonë i ofron këto potenciale më së miri. Aventurat janë eksperienca të paharrueshmë që shkojnë përtej itinerareve të zakonshme turistike, dhe zakonisht kombinohen me aktivitetet fizike dhe eksperiencat kulturore. Një numër i madh turistësh janë kuriozë për tu ngjitur në Malin më të lartë të Shqipërisë, pasi është

vend i pasur me bukuri të rralla natyrore, me gurë, shkëmbinj dhe kullota, i cili vizitohet nga një numër i madh i turistësh të aventurës dhe grupe alpinistësh të cilët arrijnë të ngjiten edhe deri në majën e saj e cila ka lartësinë 2764 m. Vargmali i Korabit shtrihet mbi 40 kilometra në drejtimin veri-jug midis pjesës së poshtme të Drinit të Zi. Është i vendosur rreth trekëndëshit kufitar të Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kosovës, në jugperëndim të maleve të Sharit. Korabi është një masiv shumë i thyer malor dhe përbëhet kryesisht nga rreshpe dhe gëlqeror të Paleozoikut me strukturat në blloqe, si dhe disa shkëmbinj të dëmtuar rëndë prej gipsi të Triasikut Permian. Në anën perëndimore, mali bie thikë mbi muret shkëmbore. Ana veriore përbëhet nga shkëmbinj të thepisur. Përveç majës së Korabit, ka disa të tjera, pothuajse në të njëjtën kuotë lartësie të barabartë. Disa qindra metra në jug, është një tjetër majë mali, maja e Moravës, e cila është 2718 metra. me vetëm pak metra më e ulët. Klima është alpine dhe përfshin disa elemente të florës alpine. Mali Korab ofron pamje dhe ujvara spektakolare.

Shtigjet që janë markuar me drejtimet përkatese dhe sipas nivelit të vështirsisë:

-Parku korab-Kortnik

-Lugina Sherimit

-Liqene akullnajore te Kacnise

-Parku Lures

-Bjeshka Grames

- Ulza

Shtigjet që pritet të markohen:

-Parku i Zall-Gjocajt

-Bruci

-Macukulli

-Kalaja e Stellushit

Kampingjet:

Kampingjet jane:

-Butterfly Camping

-kampinga Korabi

-kamping Hoxha

-Kamping Kapxhiu

-Bujtina dhe kamping Arberi

Bujtinat:

-Agro-Zerja

-Bujtina Korabi

-Konaku

-Kulla Hupi

-Bujtina Celiku

-Bujtina Bukaci

-Bujtina Muharremi

Në këtë artikull jemi munduar të sjellim disa ide të reja sepse tani duhet të mendohet seriozisht për riskun, burimet njerzore dhe kulturën e shërbimit para se mikpritja tradicionale në Qarkun Dibër të komercializohet e të transformohet në kulturën e moskujdesit, shërbimit të dobët, apo zhvatjes së turistëve, sepse do të përballoheshim me pasoja të paripareshme të moskthimit dhe rrjedhjes së numrit të turistëve në këtë zonë. Deri më tani i është kushtuar më shumë vëmendje faqes së dukshme të turizmit: infrastrukturës dhe ndërtimeve të njësive akomoduese. Ndërkohë shumë pak vëmendje i është kushtuar asaj që

përbën pjesën e paprekshme, si: shërbimi, sjellja e komunitetit pritës, mikpritja dhe problemet që lidhen me të. Duhet theksuar që në Mat dhe Dibër rol të madh ka luajtur mikpritja e kultivuar brez pas brezi në këtë zonë. Burimet njerëzore për këtë industri janë vlerësuar si lëndë e parë apo janë cilësuar nga ekspertët si faktori më i rëndësishëm për zhvillimin e kësaj industrie edhe në vendin tonë. Edhe pse diçka ka filluar të lëvizë këto vitet e fundit, ajo ngelet akoma në kuadrin e propogandës politike gjatë muajve të sezonit turistik.

Biblografia

1. *Bakiu* V. "Zhvillimi i qëndrueshëm" Tiranë, 2007
2. Doka Dh. " Turizmi Qytetar dhe Vlerat Turistike të Qyteteve" Tiranë 1996
3. *Doka* Dh, *Draçi*B."Gjeografia e Turizmit", Tiranë, 2002
4. *Doka.Dh "Zhvillime socio-ekonomike dhe rajonale të Shqipërisë pas vitit 1990*
5. *Dida* M, *Dragoti* N, *Kromidha* G, *Fierza* Gj. Parqet Kombëtare të Shqipërisë. Tiranë, 2004
6. *Durham* E. "Brenga e Ballkanit" Tiranë, 1990
7. *Gruda* Gj. "Malet e Lurës". Monografia Gjeografike Fizike e Shqipërisë, Vëllimi II, Tiranë 1990
8. Giuliani . P. "Itinerari spelologici" Puglia 1999
9. Gorica, K. Dhe Vela, F. *"Strategjia e Turizmit (politika, projekte, plane"*, Tiranë 2005
10. Korkuti M. "Arti Shkëmbor në Shqipëri", Tiranë 2008

11. Kondi A. “Guida Turistike” Tiranë 2009

12. *Kona* V. “Udhëtim në Lurë, atje ku ka lindur urtia dhe bukuria. Ruga e Arbërit Nr:5, Shtator 2006

13. *Lleshi* B. “Mundësitë e zhvillimit të Lurës”. Ruga e Arbërit N12, Prill 2007

14. Ndou (Dardha) V. “Le Pottencialita e le sfide dello sviluppo turistico a Scutari” Shkodër 2009

15. *Pano* N. “Liqenet e Lurës”, “Ylli”, 1985. Nr 10.

16. *Perleka* A. “ Lura, nga lashtësia në ditët tona” Tiranë, 2003

17. *Përleka* A. “ Të huajt për Lurën”, Rruga e Arbërit. Nr: 2. Qershor 2007

18. *Qiriazi* P. “Gjeografia Fizike e Shqipërisë”, 2006, Tiranë.

19. *Qiriazi* P, *Sala* S. Monumentet e Natyrës së Shqipërisë, Tiranë, 2006.

20. *Qiriazi* P, *Hoxha* G, *Kola* B. Gjeografia 3 (Për shkollat e mesme)

21. *Tollja* Xh. “Lura” , Tiranë 2007

22. *Tirtja* P. “Revista humanitare bektashiane”

23. *Sinani* Sh. Një vështrim perendimor për Lurën”. Ruga e Arbërit Nr:10,Shkurt 2007

24. Chopra, S. *Tourism and Development*, Ashish Publishers, Neë York 1991

25. “Strategjia e zhvillimit të Turizmit 2002-2012”

26. Çelsi “Bregdeti Shqiptar” Tiranë 2006

27. Albania Guide “Vlora” Tiranë 2007

28. Studime Albanologjike nr . IV, Tiranë 2010

29. Gruppo Speleologico Faentinino “ IPOGEA” 1994-1999

30. Të dhënat nga Drejtoria Pyjore Dibër, 2011

31. Të dhëna nga bashkia e Dibrës

32. Të dhëna nga bashkia e Matit

33. Arkivi i Institutit të Kulturës Popullore

34. *Intervista me turistë të huaj në zonën e Lurës*

35. Instituti i Monumenteve të Kulturës

36. Studime gjeografike 16, Tiranë 2005

37. *SNV Dibër. Ndeu* Rexhep. Lura pas viteve 1990.

38. Ligji i zonave të mbrojtura nr. 8906, datë, 06.06.2002.

39. *Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.*Të dhëna të marra në Drejtorinë e Zonave të Mbrojtura.

40. *Të dhëna nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.* Studime për Biodiversitetin

41. *Të dhëna mga Agjensia Kombëtare e Turizmit*

42. *Të dhëna nga Ministria e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve,*

43. *Qarku i Dibrës.* Nxitja e Zhvillimit Rajonal Nëpërmjet Objektivave të Mijëvjecarit

44. *Instat*

VLERAT HISTORIKE DHE ARKITEKTURORE TË KALAVE NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT TË TURIZMIT KULTUROR NË SHQIPËRI

Dr. Elda MAMOÇI

Universiteti "Barleti"

student.dean@umb.edu.al

Dr. Florina PAZARI

Universiteti "Barleti"

f.pazari@umb.edu.al

ABSTRACT

Albania, with a relatively small area, has a rich material and intangible cultural heritage. Its geographical position, in the western part of the Balkan Peninsula, has made the territory of Albania cross a series of different roads and cultures from antiquity to the present day, which have left traces in the tangible and intangible cultural heritage. This heritage has stimulated the interest of domestic and foreign tourists to visit Albania, where the castles of Albania have been constantly in the focus of visitors' attention. The existence of about 150 castles of different periods constitutes a great historical, architectural and tourist wealth of our country. The history they carry, the legends, the architectural values, the style of construction, the cultural objects that are located inside them have encouraged tourists to have Albanian castles as part of their itineraries. Albanian forts have great historical values as expressions of the history of the creators being a proof of the history and developments of the time, expressed in their construction, fortification objects, architectural objects etc. In addition to historical values, Albanian forts also prove great architectural values, which are expressed in the style of construction of the castles themselves and the objects found within them.This article aims to highlight the historical and architectural values of Albanian castles in order to develop cultural tourism in Albania and

the importance of their protection and restoration in order to escape the degradation that is coming from natural and human causes.

***Keywords**:* tourist attractions, fortifications, castles, restoration, tourism, values.

ABSTRAKT

Shqipëria, me një sipërfaqe relativisht të vogël, ka një trashëgimi të pasur kulturore materiale dhe jomateriale. Pozicioni i saj gjeografik, në pjesën perëndimore të Gadishullit të Ballkanit, ka bërë që në territorin e Shqipërisë të kryqëzohen një sërë rrugësh dhe kultura të ndryshme që nga antikiteti e deri në ditët e sotme, të cilat kanë lënë gjurmë në trashëgiminë kulturore materiale dhe jomateriale. Kjo trashëgimi ka nxitur interesin e turistëve vendas dhe të huaj për të vizituar Shqipërinë, ku në kuadër të trashëgimisë kulturore materiale, kalátë e Shqipërisë kanë qenë vazhdimisht në fokus të vëmendjes së vizitorëve. Ekzistenca e rreth 150 kalave të periudhave të ndyshme përbën një pasuri të madhe historike, arkitekturore dhe turistike të vendit tonë. Historia që ato mbartin, legjendat, vlerat arkitekturore, stili i ndërtimit, objektet kulturore që ndodhen brenda tyre kanë nxitur turistët që pjesë të itinerareve të tyre të kenë dhe kalátë e Shqipërisë. Kalatë shqiptare kanë vlera të mëdha historike si shprehëse të historisë së krijuesve duke qënë një dëshmi e historisë dhe zhvillimeve të kohës, të shprehura në konstruksionin e tyre, objektet fortifikuese, objektet arkitekturore etj. Përveç vlerave historike, kalatë shqiptare dëshmojnë edhe vlera të mëdha arkitekturore, që shprehen në stilin e ndërtimit të vetë kalave si dhe objekteve që gjenden brenda tyre.Kjo kumtesë synon të evidentojë vlerat historike dhe arkitektonike të kalave shqiptare në funksion të zhvillimit të turizmit kulturor në Shqipëri dhe rëndësinë e mbrojtjes dhe restaurimit të tyre në mënyrë që ti shpëtojnë degradimit që po i vjen nga shkaqe natyrore dhe njerëzore.

Fjalë kyce: atraksione turistike, fortifikime, kala, restaurim, turizëm, vlera.

1. Potenciali i kalave të Shqipërisë në funksion të zhvillimit të turizmit kulturor

Shqipëria është një vend i pasur me fortifikime dhe kala, mbi 150 të tilla, të cilat përbëjnë një mundësi shumë të mirë për zhvillimin e turizmit kulturor. Ndryshimi i sistemit politik në Shqipëri në vitin 1990 solli një rritje të ndjeshme të turistëve të huaj dhe shqiptarë të interesuar për turizmin kulturor, ku pjesë të tureve të tyre kishin dhe kalatë e Shqipërisë. Vizita e turistëve në kala lidhet dhe me ekzistencën e një sërë objektesh historike dhe arkitekturore. Për këtë arsye po tërheq gjithmonë e më shumë vëmendjen e shumë vizitorëve, të cilët në axhendën e tyre turistike kanë të përfshira dhe kalatë e Shqipërisë. Shumë nga kalatë e Shqipërisë për vlerat e tyre të shumta arkitekturore, historike dhe kulturore janë shpallur monumente kulture dhe mbrohen e menaxhohen nga shteti.Kalatë ofrojnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit, duke gjeneruar të ardhura ekonomike për zonën ku ndodhen. Rritja e turistëve ka çuar në përmirësimin e infrastrukturës turistike, duke bërë që popullsia të përqëndrohet në ngritjen e kapaciteteve pritëse (hoteleve, shtëpive apo bujtinave) si dhe përmirësimin e gastronomisë dhe produkteve lokale artizanale.Këto të ardhura vijnë nëpërmjet shitjes së biletave për hyrje në kalá apo objekte të tjera kulturore që ndodhen brenda kalave (muzetë) si dhe nga shpenzimet që bëjnë turistët për blerjen e suvenireve apo shërbimeve të tjera në kalá. Prania e këtij potenciali të rëndësishëm kulturor në Shqipëri i shton përgjegjësinë autoriteteve shtetërore dhe lokale për mirëmenaxhimin e tyre. Shqipëria është bërë pjesë e një sërë konventash ndërkombëtare dhe ka hartuar legjislacionin përkatës për ruajtjen dhe mirëmenaxhimin e trashëgimisë kulturore. Zbatueshmëria e këtij legjislacioni mbetet detyrë e institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e tyre. Disa nga kalatë Shqiptare si kalaja e Krujës, Shkodrës, Beratit, Gjirokastrës, Lëkursit, Butrintit, Prezës, etj., kanë një pozitë të përshtatshme për të tërhequr një numër të madh vizitorësh.

2. Vlerat historike dhe arkitekturore të kalave

Kalatë e Shqipërisë kanë një numër të lartë atraksionesh historike dhe arkitekturore me shumë interes për turistët vendas dhe të huaj. Pozicioni i tyre strategjik, të ngritura kryesisht mbi kodra, rrethuar pjesërisht nga shkëmbinj natyrorë, historia që mbartin, arkitektura e ndërtimit, etj, i kanë kthyer kalatë shqiptare në objekte tërheqëse të një rëndësie të veçantë për turistët. Kalatë shqiptare kanë vlera të mëdha historike si shprehëse të historisë së krijuesve duke qënë një dëshmi e historisë dhe zhvillimeve të kohës, të shprehura në konstruksionin e tyre, objektet fortifikuese, objektet arkitekturore, etj (Dollma, Mamoci, 2010, f. 323) . Ato ofrojnë një pamje të këndshme, shpesh dominuese mbi të gjithë peizazhin përreth.Shumë nga kalatë kanë tërhequr vëmendjen e turistëve pasi kanë shërbyer si rezidencë e fiseve të hershme dhe sundimtarëve të kohës, si kalaja e Albanopolis në Krujë, e cila ishte qendër e fiseve të Albanëve, duke i dhënë emrin gjithë trevës ku shtriheshin Ilirët e Jugut, Albania; kalaja e Nivicës në Vlorë e shndërruar në qendrën e dytë të banuar për fisin e Amantëve, kalaja e Drishtit e Mbretërisë së Zetës, kalaja e Tiranës si rezidencë e Toptanëve të ardhur nga Kruja, kalaja e Gjirokastrës, e cila ka shërbyer edhe si një nga rezidencat e Ali Pashës, etj. Në vendin tonë ka kala me vlera që lidhen me figura të rëndësishme historike, si kalatë e lidhura me heroin tonë kombëtar, Skëndërbeun, ku më e rendësishmja dhe më e frekuentuara nga turistët është kalaja e Krujës. Kala të tjera të lidhura me figurën e Skënderbeut janë kalaja e Petrelës, e cila ka shërbyer edhe si banesë për një kohë për motrën e Skënderbeut, Mamicën si dhe familjen e saj (Dollma, 2008, f. 106), kalaja e Rodonit, e quajtur populli si kalaja e Muzhlit të Skëndërbeut (Monumentet 1, 1988, , f. 87), kalaja e Cerujëse ndërtuar në kohën e Skëndërbeut, që nga banorët quhet “Kalaja e Skëndërbeut” e cila bashkë me disa kala të tjera në Mat përbëjnë kompleksin fortifikues kundër ushtrisë osmane, kalaja e Skënderbeut në Varosh-Stelushi, e cila gjithashtu nga banorët vendas quhet Kalaja e Skënderbeut. (Dollma, Pazari, 2010, f. 140). Disa kala të tjera kanë tërhequr vëmendjen e turistëve, pasi kanë shërbyer si fortesa të principatave shqiptare si Principata e Kastriotëve në kalanë e Krujës, principata e Dukagjinëve në kalanë e Lezhës, principata e Balshajve në kalanë e Shkodrës, principata

e Muzakajve në kalanë e Beratit, principata e Topiajve në kalanë e Durrësit dhe Tiranës, principata e Zenebishëve në kalanë e Gjirokastrës, etj. (Akademia e Shkencave, 2002, f. 284)

Në shekullin e XIX një numër i madh kalash u ndërtuan ose përforcuan nga Ali Pashë Tepelena, si kalaja e Tepelenës, e cila ishte rezidenca e dytë e Ali Pashë Tepelenës (Bejko, 1971, f. 103-106), kalaja e Porto Palermos, të cilën Ali Pasha e ndërtoi për nder të së shoqes,Vasiliqi, kalaja e Libohovës, dhuratë e Ali Pashë Tepelenës për motrën e tij Shanisha e martuar në Libohovë. (Karaiskaj, 1981, f. 242). Kala të tjera kanë tërhequr vizitorët e shumtë për legjendat, si kalaja e Beratit e lidhur me legjendën e Tomorrit, Shpiragut dhe Osumit, Kalaja e Shkodrës e lidhur me legjendën e Rozafës, sakrificës së murosjes së gjallë, etj.Përveç vlerave historike, kalatë shqiptare dëshmojnë edhe vlera të mëdha arkitekturore, që shprehen në stilin e ndërtimit të vetë kalave si dhe objekteve që gjenden brenda tyre. Të tillë përmendim kullat, frengjitë për topa, urat, hamamet, varret monumentale, kishat, xhamitë, teqet, pazaret etj, të lokalizuara në pjesën më të madhe të kalave shqiptare. Këto objekte i përkasin periudhave të ndryshme të ndërtimit, një pjesë e të cilave janë të ruajtura në gjendje të mirë. Kalaja e Beratit, Gjirokastrës ofrojnë një varietet stilesh e kontributesh të epokave të ndryshme, si asaj romane, bizantine, shqiptare dhe otomane. Kalaja e Kaninës dallohet për arkitekturën bizantine, veneciane dhe turke. Në kalanë e Lezhës mund të shikohen gjurmë të arkitekturës ilire, romake, bizantine dhe osmane(Karaiskaj, 1981, f. 242). Sot shumica e mbetjeve të kalasë së Shkodrës i përkasin periudhës veneciane, por ka edhe gjurmë të periudhës osmane (shek XVI-XVII) dhe Bushatllinjve (shek XVIII-XIX) (Zyra e Muzeut Historik Shkodër, 2019).Shumë nga kalatë si ajo e Gjirokastrës, Lëkursit, Krujës, Shkodrës, Beratit, Petrelës, Prezës, etj., falë arkitekturës së tyre, shtrirjes, historisë si dhe pamjes mbresëlënëse të zonës përreth, përbëjnë një destinacion të rëndësishëm turistik për çdo turist që viziton Shqipërinë. Për vlerat e rralla historike dhe arkitekturore, për origjinalitetin, unikalitetin, etj, shumica e kalave të Shqipërisë janë shpallur monumente kulture dhe mbrohen nga shteti.

2.1 Identifikimi i objekteve kryesore të kalave

Një nga arsyet kryesore që i kanë shndërruar kështjellat shqiptare në atraksionet më të pëlqyera turistike është prania e objekteve historike dhe arkitekturore brenda mureve të tyre. Ndër objektet më kryesore historike dhe arkitekturore brenda mureve të kalave shqiptare përmendim muzetë, hamamet, kullat e bedenat, objektet e kultit, shtëpitë karakteristike, etj.

2.1.1 Muze brenda mureve të kalave

Kalatë brenda mureve të tyre kanë të lokalizuar muze historikë dhe etnografikë me vlera kulturore dhe historike të zonës ku ndodhen. Si të tilla përmendim muzeun Historik Kombëtar "Gjergj Kastrioti Skëndërbeu" dhe muzeun Etnografik në kala të Krujës, muzeun Ikonografik Onufri në Berat, muzeun e Armëve në Gjirokastër, muzeun Historik në kalanë e Shkodrës, etj.

2.1.2 Kullat e bedenat

Objekte të tjera brenda mureve të kalave që tërheqin vëmendjen e turistëve janë kullat e bedenat, si; kulla e Sahatit në kalanë e Krujës, Kulla e Sahatit në kalanë e Prezës, kulla e vëzhgimit në kalanë e Petrelës, kullat e kalasë së Elbasanit, kulla e kalasë së Lezhës dhe kalasë së Shkodrës, etj.

2.1.3 Hamamet

Hamamet janë banja allaturka ose banjë turke. Ndër hamamet brenda mureve të kalasë përmendim hamamet dhe banjot mesjetare në kalanë e Krujës, hamamet në kalanë e Elbasanit, etj.

2.1.4 Kroje e ujësjellësa

Krojet janë burim uji, që në vendin ku del pajiset zakonisht me një lug, me ndonjë mur të posaçëm. Ujësjellësat janë tërësi gypash, kanalesh e pajisjesh të tjera që shërbejnë për të çuar ujin nga burimi deri në një qendër banimi ose prodhimi (Akademia e Shkencave, 2002). Vlera e tyre qëndron në hershmërinë e tyre, emërtimin origjinal dhe vlerat historike që mbartin. Brenda mureve të kalave shqiptare gjenden kroje, ujësjellësa,

çisterna uji si ato të kalasë së Shkodrës të shekullit XV (Ceka, 2006, f.32-33), puse si ai i Dollmës në kalanë e Krujës, etj.

2.1.5 Gjetje arkeologjike

Brenda mureve të fortifikimeve dhe kalave shqiptare janë gjetur objekte të ndryshme zbukurimi si: gjilpëra prej bronzi, vazo në kalanë e Marshejt e Gajtanit në Shkodër (Karaiskaj, 1981, f.13), objekte argjendi, objekte të ndryshme qeramike, furra për pjekje qeramike, sende zbukurimi, etj, që tregojnë për zhvillimin ekonomiko-shoqëror të kalasë së Gajtanit. Brenda mureve të kalasë së Mbolanit janë evidentuar gjurmë të një stere uji, gjurmë të shumta qeramike, të cilat janë kryesisht tjegulla e parete qeramike. Gjatë gërmimeve që janë bërë në kalanë e Ndroqit, janë zbuluar dy stera për grumbullimin e ujit, objekte qeramike që i takojnë shek. IV-VI. Në kala janë gjetur disa fragmente amforash që datohen si të shek I dhe IV p.e.s, si dhe fragmente të mesjetës së vonë (Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, 2019).Në kalanë e Lalmit ose Bixhit janë gjetur fragmente të ndryshme tjegullash dhe qeramike që i përkasin antikitetit të vonë. Gjithashtu është gjetur dhe një mbishkrim varri që i dedikohet një skllaveje të liruar, ç'ka dëshmon se ky territor është banuar që në shekujt e parë të erës sonë. Brenda mureve të kështjellës së Rosujës në Tropojë, janë gjetur edhe një numër i madh copash enësh prej qeramike të prodhuara nga zejtarët vendës, por edhe të sjella nga tregtarët nga Dyrrahu e qendrat e tjera, monedha të mbretit Gent që dëshmonin për tregtinë me Shkodrën, por edhe kontrollin e kështjellës nga mbreti ilir.Gjithashtu është gjetur edhe një depo me pitosa, mbi faqet e të cilave ishte vulosur emri Morg, i cili ishte një njeri besnik i mbretit Gent (Ceka, 2006, f. 43-44). Brenda mureve rrethuese të kalasë së Shëngjergjit janë gjetur mjaft gjurmë të banesave të mëparshme, ç'ka tregon se kjo kala mund të ketë shërbyer dhe si vendbanim apo për strehimin e banorëve të zonës në kohë të pasigurta.Brenda mureve janë gjetur edhe enë prej qeramike, tjegulla solene, që datohen në shek.IV-VI p.e.s (Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, 2019).

Nga gjetjet brenda kështjellës së Vigut përmenden: një monedhë të Kostandinit e viteve 312-320, një mbishkrim dhe një drapër.Brenda

mureve të kalasë së Gavovës, e cila ndodhej pranë rrugëve që lidhnin luginën e Osumit me atë të Devollit në drejtim të Korçës, janë gjetur shumë fragmente qeramike enësh me parete të holla, pitosash, etj (Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, 2019). Brenda mureve të kështjellës së Bushatit janë gjetur fragmente enësh si vorba, tasa, pitosa, amphora, enë tryeze, qeramikë ndërtimore,etj., si dhe disa objekte të fragmentuara të shek.IV-VI. Në brendësi të mureve rrethuese të fortifikimit të Tujanit janë vërejtur gjurmë banesash me mure 0.8 m të gjera si dhe një sterë uji me diametër 3 m. Tjegullat solene të gjetura këtu që i takojnë periudhës antike të vonë, kanë në sipërfaqen e tyre shenja në trajtën e shkronjës α (alfa). Në kufirin e Komsisë me fshatin e Muzhakës ekzistojnë akoma rrënojat e një monumenti paleokristian, ndërsa e gjithë fusha e Muzhakës ka qeramikë dhe objekte kryesisht të periudhës së vonë antike **(**Dollma, Pazari, 2010, f.140-150). Brenda kështjellës së Sebastjes ndodhen gjurmë muresh banesash, si dhe një ndërtim katërkëndësh në anën lindore që duket se i përket një sterre. Në territorin e kalasë janë gjetur fragmente qeramike karakteristike për shekullin e VI. Brenda mureve të kalasë së Domajve janë gjetur objekte metalike si fibula, majë shtize, kapëse, monedha te perandorit Justinian etj. Brenda mureve së kalasë së Dragotit në Qafë të Sulovës janë gjetur vegla bujqësore që tregojnë për karakterin e dyfishtë bujqësor dhe ushtarak të fortifikimit (Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, 2019). Brenda mureve të kalasë së Va-Spasit në Kukës janë gjetur vazo, pjata, tasa e vorba, zbukurime të tjera. Gjithashtu është gjetur edhe pjesa e një pjate të importuar, e zbukuruar me teknikën zgrafito, që daton rreth shekullit XV(Përzhita, 2004, f. 49-53).

2.1.6 Objektet e kultit

Kalatë shqiptare kanë tërhequr vëmendjen e vizitorëve nga prania e objekteve të kultit brenda mureve të tyre. Ndërtimet e kultit dallohen për arkitekturën e spikatur, afresket dhe shkrimet brenda tyre. Ndër objektet e kultit Kristian përmendim kishat e kalasë së Beratit dhe të kalasë së Krujës. Ndërsa ndër objektet e kultit islam përmendim xhaminë në kalanë e Prezës, xhaminëe Kalasë së Krujës, teqenë e Dollmës në kala të Krujës, xhaminë e Kuqe dhe xhaminë e Bardhë në kalanë e Beratit, kishën e konvertuar në xhami në kalanë e Shkodrës, etj.

2.1.7 Lagjet e banuara brenda kalave

2.1.7.*1 Lagjia kala e Krujës*

Brenda mureve të kalasë është një lagje e tërë që mban edhe sot emrin lagjia Kala. Pjesa më e madhe e shtëpive ndodhen në anën perendimore. Shtëpitë e vjetra (ato që kanë mbetur) janë prej guri dhe druri, me shumë dritare, dykatëshe, të dekoruara me dru dhe herë-herë me piktura. Historikisht lagjia Kala ka qenë banuar dhe numri i shtëpive, sipas gërmimeve arkeologjike ka qenë shumë më i madh. Një pjesë e tyre u shkatërruan gjatë dy luftrave botërore, një pjesë u prishën gjatë viteve '80 për të siguruar hapësirën e muzeut historik, dhe sot kalaja numëron 22 familje. Ndër familjet më të vjetra janë familja Toptani (sot nuk është më), familja Dollma (Plaku) rreth 300 vjet e vjetër, familja Topçiu, Kalaja, Kaçiu pasardhësit e së cilëve jetojnë akoma në kala. Një pjesë e familjeve janë shpërngulur nga kalaja, dhe të tjera familje nga Kruja janë vendosur në kala gjatë 100 viteve të fundit (Agai, Bardhi, Citozi, Kacanja, Kaloshi, Llubani, Merlika, Nova, Pikli, Sallaku, Varoshi) (Dollma, 2006, f.119).

2.1.7.*2 Lagjia kala e Beratit*

Kalaja e Beratit është një tjetër kala e banuar në Shqipëri. Brenda sipërfaqes prej 9.6 ha të kalasë ndodhen disa kisha, sarajet turke, rrënojat e dy xhamive, sternat e ujit të quajtura saranxha, sheshi i Sallabandës, sheshi i quajtur fusha e madhe, etj. Por pjesën më të madhe të oborrit të brendshëm të kalasë e zënë një sërë rrugicash, kopshtesh, bacesh dhe shtëpish banimi, të cilat përbëjnë lagjen e quajtur kala (Drejtoria e Kulturës Kombëtare, Bashkia Berat, 2013).

3. Organizimi i itinerareve turistike në kala dhe zonat përreth

Itineraret turistike janë udhërrëfyesi më i mirë historik dhe kulturor i një vendi. Krijimi i itinerarëve ka për qëllim t'u tregojë turistëve se çfarë është e rëndësishme për të parë e për të dëgjuar në një destinacion të caktuar turistik (Bakiu, 2009, f. 52). Itineraret turistike krijohen mbi

bazën e potencialit turistik që ofron një zonë e caktuar, interesit të turistit si dhe kohës që ai ka në dispozicion për të harxhuar.

Për krijimin e itinerareve turistike është marrë për bazë interesi i turistëve që vizitojnë kalatë e Shqipërisë si dhe koha që ato shpenzojnë aty (rezultate e anketimeve në terren) (E.Mamoci, 2017, fq 54). Në përcaktimin e këtyre itinerareve janë përzgjedhur dy qytete të Shqipërisë (Shkodër dhe Krujë), ku vizitorët apo turistët, objekt të parë të vizitës së tyre kanë kryesisht kalatë që ndodhen në këto qytete.

3.1 Itinerari turistik në kalanë e Rozafës (Shkodrës)

Në krijimin e itinerarit brenda kalasë së Rozafës janë marrë për bazë objektet kulturore që ndodhen brenda saj si dhe kohën që kanë në dispozicion turistët. Në varësi të këtyre dy variablave janë përcaktuar tre itinerare brenda kalasë: itinerar i shkurtër (deri në 30 min); itinerar i gjatë (1-2 orë); itinerar historik dhe panoramik.

Itinerari i shkurtër është krijuar duke pasur parasysh kohën e shkurtër që turisti ka në dispozicion për të vizituar kalanë e Shkodrës, deri në 30 minuta. Bazuar në këtë kriter janë përcaktuar disa nga objektet kryesore kulturore dhe historike që turisti mund të vizitojë brenda kalasë. Për përcaktimin e tyre është ndjekur rruga kryesore që ndodhet brenda kalasë dhe objektet që mund të vizitohen përgjatë saj. Ky itinerar përfshin vizitën e këtyre objekteve: Barbakani – hyrja kryesore e fortifikuar e kalasë (shek. XV)- Trakt muri Ilir (shek. IV p.e.s)-Kompleksi dhe kulla veneciane Don Zhon (Shek. XV)-Saranxha Çisterna mesjetare nr.1 (Shek.XIV) -Saranxha Çisterna mesjetare nr.2 (Shek. XIV) - Saranxha Çisterna mesjetare nr.3 (Shek. XV) – Burgu Otoman (shek. XVII-XVII) – Pallati i Bushatllinjëve (shek. XVIII-XIX) – Depo Municionesh Otomane – Kulla Veneciane e Çitadelës (shek. XV) - Saranxha Çisterna mesjetare nr.6 (Shek. XVI-XVII) dhe përfundon në pikën panoramike nr. 5, ku shikohen lumenjte, liqeni dhe peizazhi përreth. Në këtë itinerar turistik shikon disa nga objektet kryesore të kalasë, të cilat paraqesin vlerat arkitekturore dhe historike të kalasë së Rozafës.

Harta 1- Harta e itinerarit të shkurtër turistik në kalanë e Shkodrës



Punuan: Pazari.F, Mamoçi.E

Itinerari i gjatë është krijuar duke marrë në konsideratë atë pjesë të turistëve të cilët kanë kohë të mjaftueshme për të vizituar kalanë dhe që mund të shoqërohen dhe nga një ciceron. Në këtë itinerar janë të përfshira të gjitha objektet kulturore dhe pamjet panoramike që gjenden brenda mureve rrethuese të kalasë. Itinerari nis me vizitën e Tyrbesë së Kajë Hamnit (shek. XIX) dhe Tyrben e Mujë Babës (shek. XVI), të cilat ndodhet para se të shkojmë në hyrjen kryesore të kalasë. Më tej itinerari vazhdon me vizitën e objekteve brenda kalasë (të cilat paraqiten në hartën e mëposhtme) si: Barbakani–Trakt muri ilir i shek IV p.e.s– Banesa

mesjetare– Kompleksi dhe kulla veneciane Don Zhon– pamje panoramike e qytetit të Shkodrës dhe liqenit - kulla e Balshajve –Hyrja e mbuluar mes oborrit të I dhe II – Saranxha Çisterna mesjetare nr.1- Saranxha Çisterna mesjetare nr.2 – Katedraja e Shën Stefanit dhe ngjitur me të xhamia e Sulltan Mehmet Fatihut –Saranxha Çisterna mesjetare nr.3 –Burgu Otoman - Saranxha Çisterna mesjetare nr.4 –Banesa e Hydilaver Pashës – Ndërtesa Otomane – pamje panoramike e liqenit të Shkodrës dhe rrjedhjes së lumit Buna prej tij–Kulla e hyrjes së oborrit III – pamje panoramike e gjithë kalasë së Rozafës - Kapiteneria, Selia e sundimtarit venecian – Muzeu historik i kalasë – Pallati i Bushatllinjëve - Saranxha Çishterna mesjetare nr.5 – Hamami – Dalja e fshehtë nga kalaja – Kulla e madhe e Bushatllinjëve – Pamje panoramike e pikës së takimit të lumenjve Drin dhe Buna - Depo municionesh otomane – Kulla veneciane e Çitadelës –Pikë panoramike e lumit të Drinit dhe bashkimi i tij me lumin Kir - Saranxha Çisterna mesjetare nr.6 – Burgu venecian – Ndërtesa e repartit ushtarak të periudhës moniste – Hyrje e mbuluar mes oborrit të II dhe oborrit të III të kështjellës – Kazermë dhe depo municionesh otomane – Kulla lindore e Bushatllinjëve – Pamje panoramike e Ultësirës së Nënshkodrës – Hyrja lindore e kalasë – Galeri mes oborrit të I dhe II –Kompleks i banesave veneciane.

Itinerar historik dhe panoramik i kalasë së Rozafës. Ky itinerar është krijuar duke pasur parasysh atë pjesë të turistëve të cilët janë të interesuar më shumë për pjesën historike dhe panoramike të kalasë. Në këtë itinerar janë të gërshetuara shtigjet historike të kalimit brenda kalasë dhe jashtë mureve të saj (kryesisht në pjesën lindore të kalasë), hyrjet kryesore në kalá si ato të fshehta brenda kalasë si dhe shijimi i pamjeve panoramike që ofrohen nga kalaja. Ky itinerar fillon me hyrjen qëndrore të kalasë vijon më tej me shtigjet historike në pjesën veriore të kalasë, ku vizitohet trakti i murit Ilir dhe një banesë mesjetare, për të përfunduar në pamjen panoramike të qytetit dhe liqenit të Shkodrës. Më tej vijon shtegun për në kullën e Balshajve, hyrjen e mbuluar midis oborrit I dhe II për të vazhduar më tej drejt kompleksit të kullave veneciane - Galerinë e oborrit I dhe II-Çisterna mesjetare 1 dhe 2- Kazermën dhe Depon e municioneve

otomane-vazhdon më tej në drejtim të juglindjes në hyrjen e mbuluar mes oborrit II dhe III, kulla veneciane e Çitadelës dhe Çisternën mesjetare nr.6-pamje panoramike e lumit Drin-Kulla e Hyrjes së oborrit III-pamje panoramike e kalasë-ndërtesa otomane e shek. XVII-XVII-pamje panoramike e lumit Buna dhe liqenit të Shkodrës- Pallati i Bushatllinjëve-Çisterna Mesjetare nr.5- Hamami-del nga kalaja nëpërmjet daljes së fshehtë- ecje drejt shtegut historik jashtë mureve të kalasë dhe futja në hyrjen lindore të kalasë - Kulla lindore e Bushatllinjëve- dhe vijon më tej në shtegun historik për daljen qendrore nga kalaja.

Harta 2- Harta e itinerarit të gjatë turistik në kalanë e Shkodrës



Punuan: Pazari.F, Mamoçi.E

3.5.2 Itinerare turistike në qytetin e Krujës

Ashtu siç rezultoi edhe nga anketimet, vizitorët e Krujës objekt të parë turistik kanë kalanë e Krujës dhe monumentet kulturore që ndodhen brenda saj. Turistët janë kryesisht ditor, por për të zgjatur kohën e qëndrimit të tyre ne kemi përcaktuar disa itinerare turistike me fokus kulturor dhe natyror në qytetin e Krujës dhe zonën përreth saj. Itinerari i pare është i përqëndruar në kalanë e Krujës, ku në varësi të interesit dhe kohës në dispozicion të turistëve janë përcaktuar disa itinerare si itinerarii shkurtër (nga 30 minuta deri në 2 orë), itinerarii gjatë (disa orë), itinerari fetar dhe itinerare sportive. Ndërsa itinerari i dytë përfshin një kohëqëndrim më të gjatë të turistëve në qytetin e Krujës, duke ofruar itinerarin turistik kulturor dhe atë natyror.

3.5.2.1. Itinerar turistik brenda kalasë së Krujës

Kalaja e Krujës paraqet vlera të rëndësishme arkitekturore, historike, kulturore, fetare, etj, duke e bërë atë mjaft atraktive për turistët vendas dhe të huaj. Bazuar në vlerat që ajo përmban, kohës në dispozicion të turistëve si dhe interesit të turistëve kemi propozuar disa itinerare brenda kalasë.

Itinerari i shkurtër ka për qëllim njohjen e turistëve me objektet kryesore dhe më të rëndësishme brenda kalasë. Ai është një formë e lëvizjes kulturore me rreze të shkurtër zhvendosjeje dhe kohëqëndrim relativisht të shkurtër. Klientela turistike që merr pjesë në këtë lëvizje karakterizohet nga një nivel i lartë kulturor, por me shumë pak kohë në dispozicion për të harxhuar në kala. Objektet për t‘u vizituar në këtë itinerar, të paraqitura edhe në hartën e mëposhtme janë 1-Muzeu Kombëtar “Gjergj Kastrioti”, 4-Muzeu etnografik.Koha që mund të shpenzohet nga ky itinerar varion nga 30 minuta (në rastin kur turistët nuk vizitojnë nga brenda Muzeun “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” dhe Muzeun Etnografik) deri në 2 orë në rastin kur ato vizitojnë dy muzetë, të cilat janë të shoqëruar me ciceronët përkatës.

Harta 3- Intinerar i shkurtër në kalanë e Krujës



Punuan: Pazari.F, Mamoçi.E

Itinerari i gjatë përfshin vizitën në të gjitha objektet që ndodhen brenda kalasë së Krujës, ku turistët duhet të shoqërohen nga një ciceron. Itinerari fillon nga hyrja në portën e kalasë, xhaminë e kalasë, Muzeun "Gjergj Kastrioti", Muzeun Etnografik, kullën e sahatit dhe kishën, teqenë e Dollmës, hamamin, si dhe rrugicat e lagjes "Kala". Në kala ndodhen dhe rreth 8 pika vrojtimi, të cilat turistët mund ti shfrytëzojnë për pamje panoramike të qytetit dhe zonave përreth.

Harta 4- Intinerari i gjatë në kalanë e Krujës

Punuan: Pazari.F, Mamoçi.E

Itinerari fetar është për atë kategori turistësh të cilët janë të interesuar për pjesën e historisë fetare brenda kalasë. Kjo dëshmohet në rrënojat e dy kishave, xhamisëdhe teqesë së Dollmës.

Harta 5- Itinerari fetar brenda kalasë së Krujës

Punuan: Pazari.F, Mamoçi.E

Itinerari sportiv është krijuar për atë grup turistësh që janë të pasionuar pas ecjes dhe, njëkohësisht, zbulimit të shtigjeve jashtë mureve të kalasë. Kohëqëndrimi i tyre është relativisht i gjatë dhe mund të zgjasë rreth 2 orë. Ky lloj itinerari është përcaktuar jashtë mureve mbrojtëse të kalasë, ku turistët mund të ecin, të shikojnë shtigje historike të kalimit si dhe të ndalen në disa pika vrojtimi përreth mureve të kalasë ku mund të shijojnë bukuritë e qytetit të Krujës dhe zonës përreth.

Harta 6- Itinerari sportiv në kalanë e Krujës



Punuan: Pazari.F, Mamoçi.E

Përfundime dhe rekomandime

Kalatë zënë një vend të rëndësishëm në trashëgiminë kulturore materiale të Shqipërisë, të cilat janë ndër objektet kulturore më të frekuentuara nga turistët. Pozicioni gjeostrategjik i ndërtimit të tyre, vlerat historike dhe arkitekturore i kanë shëndërruar kalatë në destinacione të rëndësishme turistike në vend.

Vizita e turistëve në kala lidhet dhe me ekzistencën e një sërë objektesh të tjera kulturore brenda tyre siç janë muzetë, kullat, hamamet, objektet e kultit, lagje banimi, etj. Prezenca e një sërë monumentesh kulture dhe

objektesh të tjera kulturore brenda mureve të kalave si muzé, kulla, hamame, kroje, gjetje arkeologjike, objekte kulti, lagje (të cilat vazhdojnë të jenë të banueshme deri në ditët e sotme) etj. ua shtojnë interesin turistëve për t‟i bërë kalatë pjesë të tureve të tyre turistike. Rritja e frekuentimit turistik të kalave është e lidhur me rritjen e numrit të përgjithshëm të turistëve në Shqipëri. Kjo është e lidhur me evidentimin dhe promovimin e vlerave historike dhe arkitekturore të kalave, përmirësimin e infrastrukturës rrugore, përmirësimin e infrastrukturës turistike, promovimin e imazhit të Shqipërisë në tregun turistik, etj. Një nga rekomandimet është promovimi dhe futja në guida turistike e kalave të tjera të Shqipërisë me potencial të rëndësishëm turistik. Forcimi i bashkëpunimit midis sektorit publik me atij privat në fushën e investimeve në drejtim të infrastrukturës turistike, financimit të restaurimit të objekteve brenda mureve të kalave, nxitjen e arsimit profesional në profesione që lidhen me artizanatin dhe traditat kulturore të zonës, etj Shumë kalá në Shqipëri janë të dëmtuara dhe nuk frekuentohen nga turistët. Kthimi i tyre në objekte të vizitueshme do të rriste nivelin e të ardhurave dhe rritjen e punësimit për komunitetin pranë tyre. Për këtë arsye duhet të hartohen dhe zbatohen projekte për rijetëzimin e tyre në mënyrë që të mos humbasin vlerat e tyre dhe të jenë në funksion të vizitorëve. Hartimi dhe zbatimi i projekteve për rijetëzimin e tyre në mënyrë që të mos humbasin vlerat e tyre dhe të jenë në funksion të vizitorëve.

BIBLIOGRAFIA

3. *5000 vjet fortifikime në Shqipëri*: Karaiskaj, Gj (1981). Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “8 Nëntori“.

4. *Drejtoria e Kulturës Kombëtare*, Bashkia Berat, 2013.

5. *Fjalori i Gjuhës Shqipe*: Akademia e Shkencave (2002). Botimi II. Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Toena”.

6. *Guida Turistike*: Bakiu, V (2009). Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “ERIK”.

7. *Historia e Popullit Shqiptar*: Akademia e Shkencave (2002). Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Toena”.

8. *IBU-Journal of Social and Human Sciences*: Mamoçi, E (2014), The economic and touristic evoluation of Rozafa castel**.** FYROM: International Balkan University.

9. *Kukësi, vështrim arkeologjik*: Përzhita, L (2004). Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Çinamak“.

10. *La porta d"oriente, Arti Grafiche Stibu di Urbania*: Dollma, M (2006). Itali.

11. *Monumentet 2*: Bejko, S (1971). Tiranë, Shqipëri: Instituti i Monumenteve të Kulturës.

12. *Monumentet 1*: Instituti i Monumenteve të Kulturës (1988). Tiranë, Shqipëri: Komiteti i Kulturës dhe i Arteve.

13. *Ministria e Kulturës*, Drejtoria e Marketingut dhe Koordinimit (2019).

14. *Muzeu Etnografik i Krujës* (2020). Raport Vjetor, Krujë.

15. *Revista “Kuvendi”:* Dollma, M. Pazari, F (2010). Potenciali turistik i qarkut Dibër. Michigan, SHBA.

16. *Studime Albanologjike*: Dollma, M. Mamoci, E (2010). Kalatë e Shqipërisë dhe rreziqet natyrore dhe humane ndaj tyre. Tiranë, Shqipëri: Universiteti i Tiranës.

17. *Trevat Shqiptare*: Dollma, M (2008). Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Dajti 2000”.

18. *Udhëtim në kështjellat Ilire*: Ceka, N (2006). Tiranë, Shqipëri: Shtëpia botuese “Migjeni”.

Vlerësimi ekonomik i kalave të Shqipërisë në funksion të zhvillimit të turizmit, Mamoci. E (2017). Dezertacion. Tiranë.*Zyra e Muzeut Historik Shkodër* (2019).

TURIZMI NË KURRIKULAT E ARSIMIT TË LARTË SHQIPTAR

Dr. Mariglen Sherifaj

Universiteti "Eqrem Çabej",Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Sociale, Gjirokastër

mariglens@yahoo.com

Doc. Dr. Gentian Ruspi

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën, Durrës

gengjeo@yahoo.com

ABSTRACT

The end of the twentieth century opened a new page in the development of tourism in our country. The fall of political barriers, the facilitation of free movement, the improvement of infrastructure, the increase of investments, the inclusion of tourism in government strategies and projects, the increase of promotion, etc., created a positive environment in its progressive performance. Business, tour operators, local and central government, community, but also educational institutions mainly those of higher education faced with tasks and responsibilities in the role they would play in the face of the needs for a sustainable, rational and optimally profitable tourism. The study of the tourism-higher education link served as a motive for this study, the first in the context of highlighting the mission of higher education institutions in support of the challenges for the prosperity and development of society. The main object of the paper is to highlight the role of higher education in Albania in meeting

the needs of the tourism sector, in meeting and building the capacity of human resources and in the preparation of qualified researchers.

Some of the other goals of the study will come from answering research questions such as:

- What is the importance of reflecting tourism in higher education curricula?
- How did the political, social and economic changes of the 1990s in Albania affect the new perspective with which tourism education would be evaluated by higher education institutions?
- How is tourism currently presented in the curricula based on the analysis and evaluation of measurable indicators?
- What recommendations emerge in terms of better adaptation of the requirements of the tourism sector to higher education in Albania?

The study methodology is based on the analysis and interpretation of data, the study of contemporary literature with a focus on this field of study, the dynamic comparative analysis of these indicators for Albania and the assessment of the impact of higher education on promoting tourism development.

Keywords: sustainable tourism, heritage, curricula, study program, research,

ABSTRAKT

Fundi i shekullit XX-të hapi një faqe të re në zhvillimin e turizmit në vendin tonë. Rënia e barrierave politike, lehtësimi i lëvizjes së lirë, përmirësimi i infrastrukturës, rritja e investimeve, përfshirja e turizmit në strategjitë dhe projektet qeverisëse, shtimi i promocionit etj, krijuan një mjedis pozitiv në ecurinë progresive të tij. Biznesi, operatorët turistik, pushteti lokal dhe qendror, komuniteti, por edhe institucionet arsimore

kryesisht ato të arsimit të lartë u përballën më detyra dhe përgjegjegjësi në rolin që ata do të luanin përballë nevojave për një turizëm të qëndrueshëm, racional dhe optimalisht fitimprurës. Studimi i lidhjes turizëm-arsim i lartë shërbeu si motiv për këtë studim, e parë kjo në kuadër të evidentimit të misonit të institucioneve të arsimit të lartë në mbështetje të sfidave për prosperitet e zhvillim të shoqërisë.

Punimi ka si objekt kryesor evidentimin e rolit të arsimit të lartë në Shqipëri në përmbushjen e nevojave që ka sektori i turizmit në plotësimin dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore si dhe në përgatitjen e studiuesve të kualifikuar.

Disa nga qëllimet e tjera që ka studimi do të dalin nga përgjigjja e pyetjeve kërkimore të tilla si:

- Çfarë rëndësie paraqet pasqyrimi i turizmit në kurrikulat e arsimit të lartë?
- Si ndikuan ndryshimet politike, sociale dhe ekonomike të viteve 1990 në Shqipëri në këndvështrimin e ri me të cilin do të vlerësohej turizmi në arsim nga institucionet e arsimit të lartë?
- Si paraqitet aktualisht turizmi në kurrikulat nisur nga analiza dhe vlerësimi i treguesve të matshëm?
- Çfarë rekomandimesh dalin në drejtim të përshtatjes sa më mirë të kërkesave që ka sektori i turizmit ndaj arsimit të lartë në Shqipëri?

Metodologjia e studimit bazohet në analizën dhe interpretimin e të dhënave, studimin e literaturës bashkëkohore me fokus në këtë fushë studimi, në analizën krahasuese dinamike të këtyre treguesve për Shqipërinë si dhe në vlerësimin e ndikimit që ka arsimi i lartë në nxitjen e zhvillimit të turizmit.

Fjalë kyçe:*turizëm i qendrueshëm, trashëgimi, kurrikula, program studimi, kërkim shkencor,*

1. Historiku i turizmit dhe trajtimi shkencor i tij

Ndonëse fenomeni turizëm është i vjetër, koncepti, trajtimi shkencor dhe përfshirja e tij në kurrikulat e arsimit janë të vonshme (pas shek XIX). Fjala turist është përdorur për herë të parë në Britaninë e Madhe shek XVII[7] në 1772[8] dhe turizëm në 1811[9]. Bazohet te fjala "tour". Etimologjia e kësaj fjale rrjedh nga disa gjuhë si nga: anglishtja e vjetër "turian"; frëngjishtja e vjetër "torner"; latinishtja "tornare"; Greqishtja e lashtë tornos (τόρνος); "torno"-rrotullues[10]. Që nga ajo kohë deri në ditën e sotme turizmi si një aktivitet rekreativ njëkohësisht ekonomik ka marrë dimensione mjaft të gjera duke u bërë një fenomen tepër masiv.

Përsa i përket studimit shkencor të turizmit dhe punimeve shkencore rreth tij mund të themi se, botimet e para shkencore rreth turizmit datojnë në vitet 1884 dhe 1894. Ato trajtonin nocionin dhe fenomenin turizëm si dhe përshkrimin e destinacioneve turistike më të njohura të asaj periudhe. Masivizmi gjithnjë e më tepër i turizmit, sidmos në Europë bëri që të rritet numri i autorëve dhe punimet shkencore në lidhje me turizmin[11].

Shkenca të ndryshme sidomos ato ekonomike kanë tentuar që herët të merren me studimin shkencor të tij, studimi i mirëfilltë gjeografik i turizmit është relativisht i ri. Fillimet e këtij studimi llogariten të jenë nga fundi i shek XIX-të, megjithatë vitet 30-të të shek XX-të konsiderohen si vitet kur turizmi filloi të zërë vendin e tij të duhur midis pjesëve të tjera të trungut të shkencës së gjeografisë[12]. Ekzistojnë një sërë studimesh gjeografike që trajtojnë turizmin si: Gjoegrafia e turizmit, Gjoegrafia e kohës së lirë, Gjeografia e rekreacionit[13].

[7] Doka, Dh, Draçi B, Gjeografia e Turizmit, fq 9, SHBLU, Tiranë 2009
[8] Griffiths, Ralph; Griffiths, G.E. (1772). "Pennant's Tour in Scotland in 1769". The Monthly Review, Or, Literary Journal. 46: 150. Retrieved 23 December 2011.
[9] Harper, Douglas. "tour (n.)". Online Etymology Dictionary. Retrieved 23 December 2011.
[10] "Online Etymology Dictionary". etymonline.com. Retrieved 2 June 2016.
[11] Doka, Dh, Draçi B, Gjeografia e Turizmit, fq 13, SHBLU, Tiranë 2009
[12] Po aty, fq. 37.
[13] Po aty, fq. 14.

Koncepti i parë mbi gjeografinë turistike do të paraqitej që në vitin 1905 nga autori Shtrander. Ndërsa Vegener në studimin e tij në 1929 do të theksonte lidhjet e ndërsjellta midis turizmit dhe faktorëve të tjerë si vendbanimet, ekonomia, transporti etj ndërsa nga ana tjetër ndikimet e turizmit në pamjen e peisazhit natyror[14] .

Që nga mesi i vitit 1970, turizmi bëhet subjekt kërkimor i rëndësishëm duke kontribuar në hedhjen e bazave të sigurta të gjeografisë së turizmit[15].

Në ditët e sotme shkencat që merren me trajtimin e turizmit ndahen në dy grupe të mëdha: në ato ekonomike (ku përfshihen ekonomia turistike, marketingu, drejtimi ekonomik, drejtimi finaciar dhe grupi i shkencave të tjera. Në grupin e dytë të shkencave të tjera bëjnë pjesë gjeografia, psikologjia, sociologjia, shkencat politike, arkitektura, historia, etnografia, ekologjia, planifikim territorri etj .

2. Domosdoshmëria e turizmit në kurrikulat e arsimit të lartë shqiptar pas viteve 90-të

Nëse do të krahasojmë zhvillimin dhe peshën që mbante turizmi në ekonominë e vendit tonë me atë që mbante në vendet e tjera të rajonit dhe Europës gjatë periudhës 1945-1990, kjo peshë ishte papërfillshme. Numri i pakët i turistëve, të ardhurat tepër të vogla, infrastruktura e dobët, ishin pasojë e pengimit të lëvizjes së lirë, izolimi të vendit tonë nga vendet e tjera, lënia në harresë nga politikat dhe strategjitë qeverisëse etj.

Fillim vitet 90-të sollën ndryshime të mëdha në politikë, ekonominë e vendit tonë, ndër të tjera edhe në arsimin e lartë. Hyrja në një epokë të re të zhvllimit ekonomik-shoqëror u shoqërua me ndryshime thelbësore jo vetëm në perceptimin dhe rolin që ka arsimi i lartë, por edhe me ristrukturimin, riorganizmin e tij duke iu përshtatur zhvillimeve të kohës në vendin tonë, rajon dhe më gjerë. Ekonomia e tregut i diktoi dhe e përballi arsimin e lartë me një sërë kërkesash dhe sfidash të cilat kërkonin

[14] Po aty, fq. 37, 38.
[15]Meçaj. N, Gjeografi e Aplikuar, fq 328, Toena, Tiranë 2004

zgjidhje, ekspertizë të thelluar dhe prognoza për të ardhmen e tyre.Një ndër degët e ekonomisë që u pa me interes nga investitorët vendas dhe të huaj ishte turizmi i cili po njeh ritme të larta zhvillimi.Në koherencë me zhvillimet e vendeve fqinje, ato të rajonit, u evidentuan potencialet e madha turistike që ka vendi ynë, kjo degë u cilësua si tepër premtuese për ekonominë shqiptare.Lejimi i lëvizjes së lirë të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve, hapja e kufijve, lejimi i sipërmarrjes së lirë etj ishin si parakushte për zhvillimin e ekonomisë së turizmit.Meqënese kjo degë ekonomisë ishte tepër e brishtë, ajo u përball me një sërë pengesh dhe veshtirësish ku ndër të tjera ishte edhe mungesa burimeve njerëzore të arsimuara dhe të plotësuar me aftësi profesionale. Agjensitë turistike, bizneset e turizmit, shërbimi hoteleri-restorant, kompanitë e udhëtimeve, etj. kishin mungesë stafi ose kishin të punësuar personel që nuk i ishte i kualifikuar në fushën e turizmit. E njëjta gjë u konstatua në shumë digastere dhe institucione të pushtetit lokal dhe qendror, të cilat duhet të ishin tepër aktive në krijimin e lehëtsirave në dobi të zhvillimit të turizmit.Kështu këto vende pune të reja që u hapën, u zunë nga punonjës jo të kualifikuar me arsimin përkatës në fushën e turizmit, apo nga kuadro që ishin arsimuar në profile të afërta me turizmin. Kjo gjë përbënte një disavantazh të madh në zhvillin e turizmit, kur dihet se në vendet fqinje turizmi po lulëzonte falë e faktorëve pengues që ishin ezauruar.Meqënëse kjo degë e sektorit të shërbimeve u konsiderua si një degët prioritare për vendin tonë nevojitej kontributi i të gjithë aktorëve dhe faktorëve që do të sillin zhvillimin e saj.E parë në këtë prizëm, institucionet e arsimit të lartë, kërkuesit shkencor, rrjetet akademike, u treguan të gatshëm që të jepnin kontributin e tyre duke iu përgjigjur kërkesave të kohës me synimin afrimin me tregun e punës. Edukimi i brezave të rinj, ndërgjegjësimi i popullatës për të ruajtur, menaxhuar dhe përdorur me racionalitet burimet dhe asetet turistike, aftësimi profesional i kuadrove të rinj, puna kërkimore–shkencore, fushata sensibilizuese në fushën e turizmit, ishin disa sfidat që i parashtroheshin arsimit të lartë në këtë fundshekulli. Duke pasur parasysh kërkesat në rritje për kuadro me aftësi të profesionale të mira në fushën e turizmit, qytetet universitare si Tirana, Shkodra, Gjirokastra, Elbasani, Vlora, Korça, Durrësi etj. kanë hapur programe të reja studimi me drejtim turizmin.Pas viteve 90-të, turizmi ka

filluar të trajtohet gjerësisht në ambientet universitare duke u bërë pjesë e kurrikulave të arsimit të lartë. Kështu lëndë, programe studimi, aktivitete kurrikulare dhe ekstrakurrikulare filluan të shtohen në universitete. Futja e lëndëve të reja dhe hapja e programeve studimit me fokus turizmin sidomos në universitetet të cilat gjenden në qytete që janë destinacione të rëndësishmë të vendit tonë përbën kushte mjaft të mira për aftësimin teorik dhe praktik te kudrove të rinj që dalin nga bankat e univeristetit.

Duke pasur parasysh këto rrethana nevojitej që koncepti dhe fenomeni turizëm të studiohej shkencërisht dhe të përfshihej në kurrikulat e arsimit.

3. Përfshirja e turizmit në kurrikulat e arsimit shqiptar

Në arsim turizmi fillimisht u përdor si koncept, fenomen, për t'u atashuar si lëndë mësimore në kurrikulat e arsimit.

Sot, për termin kurrikul, ekzistojnë ka katër përkufizime:

1.Kurrikul si një plan veprimi ose dokument i shkruar që përfshin strategjitë për arritjen e qëllimeve.

2.Në një kuptim më të gjërë, si gjithë përvoja shkollore dhe jashtëshkollore (brenda një viti shkollor).

3.Kurrikul si fushë studimi.

4.Kurrikul mund të vështrohet dhe në lidhje me lëndët mësimore dhe përmbajtjen e tyre.

Përmbajtja e konceptit kurrikul përfshin planin dhe programin e lëndëve mësimore dhe atyre që shkolla u ofron nxënësve për të marrë një diplomë. Pra, kurrikula e turizmit nënkupton ndërtimin dhe zbatimin e kësaj lënde, pra strukturën, objektivat, standartet, përmbajtjen dhe drejtimin bazë të njohurive, burimet e studimet dhe të përvetësimit të saj. P.sh kurrikula e turizmit kulturor, kurrikula e turizimit rural, gjeografisë së turzmit etj.

Në kuptimin më të gjërë me fjalën Kurrikul do të kuptojmë – planifikimin, programin, dokumentacionin, filozofinë, strategjinë,

metodologjinë, teknikat, vlerësime, raporte mësues-nxënës, kushtet e mësimdhënies, nxënies, të gjitha këto ndikojnë në procesin me sukses të mësimit/arsimit.

Kurrikula përbëhet nga:

1. Objektivat që do arrihen ne fund të shkollës

2. Përmbajtja që do t'u jepet nxënësve, studentëve

3. Metodat që do të përdoren

4. Vlerësimi

Kurrikula bëhet me vlerë kur janë përcaktuar në të se çfarë duhet të mësohet në shkollë, duke patur parasysh ndikimet sociale, kulturore, politike, mjedisore, dhe problematikat.

Reformimi i arsimit shqiptar si një domosdoshmëri e tranzicionit politik, ekonomik dhe sfida të reja që u përball vendi ynë në fundshekullin e XX-të, diktuan nevojën e përfshirjes së turizmit gjerësisht në kurrikulat e arsimit shqiptar jo vetëm në arsimin parauniversitar por edhe institucionet e arsimit të lartë në format e studimit si:

- Studime profesionale 1 ose 2 vjeçare;
- Bachelor;
- Master;
- Doktoraturë.

Fillimisht turizmi u përfshi në programet mësimore parauniversitare të arsimit profesional në shkollat mesme që nga mesi i viteve 1990-të, përkatësisht, Tiranë (1995), Sarandë (1999), Durrës (1997) për tu përfshirë aktualisht edhe në shkollat e mesme të përgjithshme ku lëndë me përmbajtje turizmin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore etj janë pjesë e kurrikulave të arsimit të mesëm.

Kështu ish shkolla ”Teknologjike”në Tiranë e cila daton që nga viti 1958, në ditët e sotme e rimemërtuar “Shkolla Hoteleri-Turizëm”, për shkak të ristrukturimit dhe riorganizimit të saj ku degët e vjetra ishin jo të kërkuara në tregun e punës, hapi në vitin 1995 degën Hoteleri-Turizëm , e cila ka mbijetuar kërkesave të tregut duke i dhënë edhe emrin shkollës. Kjo degë e re u hap si rezultat i marëveshjes së bashkëpunimit midis Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe donatorëve austriak të cilët duke parë potencialet e mëdha turistike të vendin tonë si mungësën e fuqisë punëtore të profilizuar me drejtim turizmin, mbështën idenë e tyre për hapjen e një degë studimi tepër të kërkuar në ekonominë turisitike që po rritej me shpejtësi dhe ku boshllëku për punonjës me aftësi profesionale të tilla mungonin. Në vitin e parë të hapjes, në këtë degë, filluan studimet 29 nxënës, numër i cili vazhdoi të rritej në mënyrë të konsiderueshme nga viti në vit . Ky drejtim mësimor do të furnizonte me punonjës të kualifikuar dhe drejtues sektorialë të gjitha agjencitë turistike, hotelet dhe restorantet që po ndërtoheshin vazhdimisht dhe kudo nëpër Shqipëri. Deri në ato kohë përgatitja e këtyre punonjësve ishte bërë me anë të disa kurseve ose rastësisht, nga përvoja e disa njerezve direkt në punë. Kontribut të veçantë në konkretizimin dhe zbatimin e marreveshjes ka dhënë projekti austriak, nëpërmjet zyrës për arsim në Tiranë, Kulturë - Kontakt, Austria. Në vitet 1997-2007, janë realizuar aktivitete trajnimi te gjithëanshëm me mësuesit dhe drejtuesit, kryesisht në Austri por edhe në Shqipëri . Në arsimin e lartë trajtimi i turizmit në kurrikulat e studimit ka njohur një përhapje më të shpejtë dhe me një intesitet më të lartë duke pasur parasysh faktin se pas viteve 1990-të iu kushtua më tepër rëndësi arsimit universitar sesa atij professional që ofrohejt kryesisht nga shkollat e mesme.Një faktor tjetër që ndikoi në këtë drejtim ishte preferenca e tregut të punës për punonjës me arsim universitar sesa ata me arsim të mesëm duke mos vlerësuar realisht kontributin që jepte me kuadro të rinj.Në kurrikulat e arsimit të lartë shqiptar turizmi është përmendur fillimisht në lëndë të ndryshme të programeve të studimit si ekonomi, gjeografi, histori etj. Në fillim turizmi u trajtua në lëndë të tilla si Gjeografia e Turizmit, Guidat e udhëtimeve, Menaxhim turizmi etj. Më vonë, duke parë interesin e shtuar për punonjës të kualifikuar në fushën e turizmit dhe ritmet e shpejta të rritjes së ekonomisë turistike u hapën

programe të reja studimi. Në këto programe studimi turizmi ose "industria e mikpritjes" trajtohej si fenomen në aspektin social, ekonomik, hapësinor, duke u zgjeruar gama e tij në aspektin menaxherial, promocional, akomodues, historik, filozofik, kulturor, politik etj. Vitet e fundit janë shkruar tekste universitare ku trajtohet turizmi, gjithashtu ai është përfshirë si një disiplinë mësimore në shumë programe studimi.

Tashmë në universitet shqiptare, turizmi trajtohet në një mori e madhe lëndësh. Programe studimi për turizmin janë hapur në IAL[16] publike dhe private, në të gjitha ciklet e studimit Bachelor, master professional, master shkencor madje studime profesionale 2 vjeçare. Turizmi është trajtuar gjerësisht në shumë dizertacione doktorale, të cilat përbëjnë produkte shkencore me shumë vlerë në funksion të kësaj dege të ekonomisë. Departamente të tilla historia, arkeologjia, gjeografia, turizmi, biznesi, hoteleri –restorant etj. kanë hapur programe studimi ose kanë futur lëndë me optikë të ndryshme studimi në fushën e turizmit.

Edhe studimet e thelluara në doktoraturë, konferencat, workshopet, botimet, artikujt shkencor, monografitë, tekstet mësimore universitare ose jo janë pasuri dhe kontribut i rëndësishëm në zhvillimin e turizmit. Veprimtaritë kurrikulare dhe ekstrakurrikulare që kanë në fokus të tyre marrjen dhe krijimin e aftësive praktike të studentëve të tilla si; ekspeditat, praktikë në terren, guidat turistike, panairet turistike, eksplorimin e stiteve natyrore dhe kulturore etj. aftësojnë studentët, me aftësi teorike, praktike, organizative. të cilat mund t'u shërbejnë atyre në të tashmen dhe të ardhmen brenda dhe jashtë vendit (pasi diplomat dhe tregu i punës ka tendencë drejt unifikimit).

Mjaft punonjës të stafit akademik, student të diplomuar, janë punësuar në sektorin e turizmit duke marr role dhe funksione të ndryshme si sipërmarrës, menaxher, udhërrëfyes turistik, cicëron, ekspert të turizmit etj.

[16]Institucion I Arsimit të Lartë

4. E tashmja dhe e ardhmja e turizmit në arsimin e lartë shqiptar

Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të XX-të dhe dekadat e para të shek XXI turizmi, lëvizja turistike dhe ekonomia me bazë turizmin është bërë kryefjala e ditës e cila ka mobilizuar politikbërës, ekonomist, specialist në fushën e turzmit, institucionet arsimore, kërkues shkencor etj në trajtimin, analizën dhe ndikimin e tij në jetesën e popullatës së gjerë sidomos në Europë e cila përbën një ndër polet e zhvillimit të turizmit. Turizmi, në ditët e sotme, përbën një ndër fenomenet më masive dhe një ndër aktivitetet ekonomike që po njohin rritje eksponenciale. Pavarësisht vështirësive të krijuara nga pandemia për vitin 2020, nëse do t'i referohemi të dhënave nga Organizata Botërore e Turizmit për vitin e 2019 vërehet se numri i turistëve në botë ishte 1,5 miliard . Në vitin 2018 sektori i turizmit siguroi 319 milion vende pune, duke përfaqësuar një në dhjetë vendet e punës në të gjithë botën, ndërsa në Shqipëri kontributi në punësimin direkt nga turizmi është më i vogël, rreth 7.7% ose 85500 të punësuar sipas statistikave të vitit 2016 . Megjithatë tendenca e numrit të punësuarve direkt apo indirekt në aktivitete ekonomike të lidhura me turizmin nga viti në vit po shkon drejt rritjes. Nevoja për të siguruar të punësuar me aftësi të larta profesionale në këtë sektor ka rritur paralelisht edhe rëndësinë e arsimit për të kontribuar në këtë sektor. Për shkak të rëndësisë në rritje që mori dega e turizmit në ekonominë shqiptare dhe prioritetit që iu dha asaj lëndët që kanë në fokus turizmin u futën gjerësisht në programe studimi që kanë lidhje direkte apo indirekte me të por edhe programe studimi që e kanë rikonceptuar objetivat e tyre në funksion të kësaj dege të re të ekonomisë por me premisa të qarta zhvillimi. Në ditët e sotme turizmi trajtohet jo vetëm si një lëndë kryesore në programe të ndryshme studimi, madje mund të themi se shumica e universiteve shqiptare kanë hapur programe të ndryshme studimi në ciklit, parë, dytë duke pasur parasysh tendencën e kohës për lidhur tregun e punës me arsimin universitar. Madje edhe shumë punime doktorale trajtonin turizmin, dhe aspektet e shumëanshme të tij në jetën tonë, ekonominë, kulturën, traditën, mjedisin etj.

Sot në shumë universite shqiptare si i Tiranës, Luigj Gurakuqi, Eqrem Çabej, F.S.Noli, Marin Barleti, Aleksandër Moisiu,Universiteti Bujqësor i Tiranës etj. jo vetëm janë hapur programe të reja studimi në fushën e turizmit, por janë krijuar edhe departamente që kanë në emërtesëm e turizmit të tilla si; Dep.Turizmit, Dep.Politikave Ekonomike dhe Turizmit, Dep.Marketing-Turizmit, Dep.Menaxhim i Hoteleri-Turizmit, Dep. i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit, etj Sipas të dhënave të nxjerra nga faqet zyrtare të internetit të universiteteve në vendin tonë deri në vitin 2020 janë 13 IAL (publike dhe private) në të cilat janë hapur 48 programe studimi me drejtim turizmin. Nëse do ti trajtojmë sipas cikleve të studimit rezulton; 26 programe studimi Bachelor, 12 programe Master Profesional, 4 Master shkencor, 6 Studime Profesionale. Në programet e studimit në fushën e turizmit ka një mori lëndësh të cilat trajtojnë aspekte të ndryshme që kanë lidhje turizmin. Madje lëndë të tilla si; Trashëgimi kulturore dhe natyrore, Turizmi shqiptar, E drejta e turizmit, Etika i turizmit, Turizëm rural, Strategji dhe Politikat e Turizmit, Turizëm arkeologjik, Marketingu për Turizëm, Evente dhe Mikpritje, IT në turizëm etj. synojnë që të krijojnë ura bashkëpunimi dhe ndërveprimi midis shkencave të ndryshme dhe turizmit. Në stadin aktual mund të themi se turizmi është bërë një shkencë më vete që ka një impakt të madh në shkencat e tjera simotra me të.

Nr	Universiteti	Fakulteti	Departamenti	Programi studimit	Cikli i studimit SP, B, MP, MSh	Nr lëndëve
1	Eqrem Çabej[17]	Ekonomik	Politikave Ekonomike dhe Turizmit	Turizëm	B	1
				Turizëm	MP	1
				Asistent menaxher në shërbimet turistike	SP	1

[17] http://uogj.edu.al/departamenti-politikave-ekonomike-dhe-turizmit/

		Edukimiit dhe Shkencave Shoqërore	Histori - Gjeografi	Histori - Gjeografi	B	1
					MP	1
				Udhërrëfyes Turistik	SP	1
2	Tiranës	Historisë dhe i Filologjisë [18]	Gjeografisë	Gjeografi	B	2
			Arkeologjise dhe Trashëgimisë Kulturore	Arkeologji	B	2
				Guidë Turistike	MP	2
				Trashëgimi kulturore	MP	7
		Ekonomisë	Menaxhimit	Menaxhim Turizëm	B	-
3	Ismail Qemali	Ekonomisë [19]	Biznesit	Mexhamin Turizmi	MP	-
				Sipermarrje në Turizëm	B	-
		Shkencave Humane	Edukimit	Histori-Gjeografi	B	1
4	Luigj Gurakuqi	Shkencave Shoqerore	Gjeografisë	Histori-Gjeografi me drejtim Gjeografi	MSh	1
				Studime Regjionale në Gjeografi	B	8
		Ekonomik [20]	Turizmit	Turizëm	MSh	9
				Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm	B	1
5	Fan. S.	Edukimit dhe	Histori-	Histori-	B	3

[18] https://www.fhf.edu.al/arkeologjia-dhe-trashegimia-kulturore/
[19] https://univlora.edu.al/fakulteti-i-ekonomise/
[20] https://unishk.edu.al/universiteti/fakultetet/fakulteti-ekonomik

	Noli	Filologjisë	Gjeografisë	Gjeografi		
		Ekonomisë [21]	Marketing-Turizmit	Administrim Biznesi në Turizëm	MP	4
				Biznes dhe Tregti	MP	3
				Turizëm	B	4
				Guidë Turistike	MSh	1
6	Aleksandër Xhuvani [22]	Ekonomik	Marketing Inxhinierisë	Ekonomi Turizem	SP	2
				Marketing	B	1
		Shkencave Humane	Gjuhës Angleze dhe Gjermane	Operator Turistik ne gjuhe Gjermane	B	1
			Histori-Gjeografisë	Gjeografi dhe Gjuhe Italiane	MSh	2
				Histori-Gjeografi	B	
				Trashegimi Kulturore	B	5
7	Aleksandër Moisiu	Biznesit[23]	Turizmit	Menaxhim Turizëm Kulturor	B	6
				Menaxhim Turizëm Arkeologjik	MP	4
				Menaxhim Hotel-Restorant	B	3
		Shkencave Politike	Administrim Publik	Turizmi	B	6

[21] https://www.unkorce.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomis%C3%AB
[22] https://uniel.ems.al/school/programlist.aspx
[23] https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/fakulteti-i-biznesit/

		Juridike				
		FASTIP	Menaxhim i Hoteleri-Turizmit,	Menaxhim Hoteleri - Turizëm	MP	6
8	Bujqësor I Tiranës	Fakulteti i konomisë dhe Agrobiznesit	Menaxhim Turizmi Rural[24]	Manaxhim i Turizmit Rural	B	7
				Manaxhim i Turizmit Rural	MP	-
9	Marin Barleti[25]	Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit	Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit	Menaxhim në Turizëm, Rekreacion dhe Evente	B	2
				Mikpritje dhe hotel	MP	1
10	Europian i Tiranës[26]	Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit	Menaxhimit dhe Marketingut	Turizëm	SP	3
				Turizëm	B	1
				Turizëm	B	1
11	Mesdhetar i Shqipërisë	Shkencave Ekonomike		Administrim Biznesi[27]	B	1
				Financë, Bankë dhe Kontabilitet	MP	1
				Biznes dhe Ligj	SP	1
				Menaxhim Turizmi	B	2
12	Metropolitan Tirana	Ekonomisë[28]	Shkencave të Administrimit	Menaxhim Turizem, Hoteleri dhe	SP	12

[24] https://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/departamenti-menaxhim-turizem-rural/
[25] http://fshsts.umb.edu.al/
[26] https://uet.edu.al/new/fakulteti-i-ekonomise-biznesit-dhe-zhvillimit-2/?lang=sq
[27] https://www.umsh.edu.al/media/5ee69cf6786cc.pdf
[28] https://umt.edu.al/fakultetet

				Evente		
13	Kolegji Logos	Ekonomisë [29]	Menaxhim Biznes	Menaxhim Biznes	B	1
			Menaxhim Turizmi	Menaxhim Turizëm	B	7
Shpjegues : Ciklet e studimit në tabelë janë përdorur me shkurtime : Studime Profesionale SP, Bachelor B, Master Profesional MP, Master Shkencor MSh						

Në vitin 2018 u hapën disa programe studimi të arsimit të lartë profesional 2 vjeçare për përgatitjen e kuadrove të rinj në një afat të shkurtër kohor, dhe për t'iu përgjigjur menjëherë kërkesave të industrisë turistike për kuadro të kualifikuar. Programe të tilla si Udhërrëfyes turistik, Operator turistik në gjuhën gjermane, Asistent menaxher në shërbimet turistike etj. duket që janë një histori suksesi për shkak të nivelit të lartë të punësimit të diplomuarve në këto profile studimi. Programe të tilla studimi si; Menaxhim Turizëm, Hoteleri dhe Evente, me 12 lëndë specifikisht në fushën e turizmit, Master Shkencor, Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm me 9 lëndë, Bachelor Turizëm me 8 lëndë Bachelor në Menaxhim në Turizëm, Rekreacion dhe Evente me 7 lëndë, Bachelor në Menaxhim Turizëm me 7 lëndë, Master Profesional me Manaxhim i Turizmit Rural me 6 lëndë në fushën e turizmit, (shih tabelën) tregon rëndësinë e madhe dhe zgjerimin e gamës së studimit dhe trajtimit të kësaj shkence në kurrikulat e arsimit të lartë. Në periudhën aktuale turizmi mban një peshë të madhe jo vetëm në ekonominë shqiptare, por edhe në arsimin e lartë. Ai po gjen aplikim të gjerë në të gjitha ciklet e studimeve të arsimit nga ai 9-vjeçar që mësohet si nocion deri tek ato universitare, pasuniversitare madje edhe punimet doktorale, kërkimet shkencore etj. E ardhmja për turizmin në kurrikulat e arsimit universitar pritet të jetë optimiste pse jo edhe në nivel organizativ dhe strukturor. Pritet të krijohen njësi kryesore (fakultete) pse jo edhe universitete të cilat do të jenë pararoja e kësaj degë tepër premtuese të ekonomisë. Njohja, evidentimi dhe përdorimi me racioanalitet i

[29] http://www.kulogos.edu.al/sq/fakulteti-ekonomik/

potencialeve turistike si dhe avantazheve dhe disavantazheve që vijnë nga ai do të orientoj stafet akademike drejt gjetjes së rrugëve, mënyrave, dhe strategjive të cilat jo vetëm do të synojnë një turizëm të qëndrueshëm dhe afatgjat, por edhe një turizëm që thyen barrierat politike, institucionale etj. Edhe universiteti "Eqerem Çabej" si një ndër më të vjetrit në vendin tonë që gjendet në një nga qytetet me traditë dhe kulturë të pasur i cilësuar edhe si pjesë e Trashëgimisë Botërore (UNESCO) ka dhënë një kontribut të madh në fushën e turizmit në të gjitha nivelet dhe hallkat e zhvillimit të tij. Qyteti ku gjendet ky universitet përbën një mjedis ideal për kërkim shkencor, aftësim teorik dhe praktik të studentëve duke qenë se ofron resurse të mëdha natyrore dhe kulturore të cilat janë asete të rëndësishmë të vendit tonë në fushën e turizmit. Përfshirja e këtij universiteti në rrjetin e universitete (FUUT[30]) që merren me trashëgiminë, turizmin në kuadër të UNESCO është një projekt ambicioz i cili do tu japë një stimul kërkimit shkencor, do të përfshijë studentët në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara nga universitetet vendase dhe të huaja të cilat janë përqëndruar në fushën e turizmit. Anëtarësimi në këtë rrjet universitetesh ku bëjnë pjesë 445 universitete nga 54 vende të botës[31] do të përafroj edhe standartet që aplikohen në fushën e kërkimit shkencor, aftësimit teorik dhe professional, mësimdhënie etj duke qenë një universitet i konkurueshëm me ata të vendeve të zhvilluara dhe me përvojë më të hershme se ato në vendin tonë.

Përfundime dhe rekomandime

- Turizmi në ditët e sotme është bërë temë e ditës në kurrikulat e arsimit të lartë shqiptar si një domosdoshmëri e tregut të punës që është i etur për kuadro të kualifikuar që do ta çojnë ekonominë turistike drejt një stadi të ri zhvillimi në të ardhmen.

[30] **F**orumi **U**NESCO **U**niversitet **T**rashëgimi

[31] Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qiriazi. P, Trashëgimia natyrore e Shqipërisë. fq 31, Tiranë 2018

- Arsimimi i kontigjentit të burimeve njerëzore do t'i hap rrugën profesionalizmit dhe racionalitetit në zhvillimin e industrisë së turizmit, gjithashtu do të përmirësojë cilësinë e shërbimeve.

- Profesionistët e dalë nga auditoret e universitetit me bagazh të mjaftueshën teorik dhe pjesëshëm në sensin praktik, me shumë mundësi do të orientohen më lehtë dhe do t'i përballojnë me më shumë profesionalizëm sfidat dhe problemet me të cilat përballet sipërmarrja e turizmit.

- Me gjithë arritjet që janë shënuar në arsimin e brezave të rinj në fushën e turizmit përsëri vihen re mangësi në koherencën e kuadrove që dalin nga bankat e arsimit të lartë në raport me tregun e punës. Kjo lidhet me faktin se akoma në vendin tonë shkalla e prakticitetit dhe praktika në biznesese dhe sipërmarrje publike apo private akoma nuk është në sinkron dhe më zhvillimet aktuale në ekonominë e turizmit.

- Nevojiten akoma më tepër orë mësimore në drejtim të praktikave profesionale, një bashkëpunim më i ngushtë IAL-biznes dhe pushtet lokal. Njëkohësisht studentët duhet të përfshihen në projekte, trajnime dhe aktivitite ekstrakurrikulare në mënyrë vullnetare, si pjesë e detyrimeve të lëndëve apo programeve të studimit, si dhe të punësohen me kohë të pjeshmë në ndërrmarjet e biznesit. Kështu zhvillimi i sezoni turistik në vendin tonë kryesisht gjatë stinës së verës korrespondon me periudhën e pushimeve për institucionet e arsimit të lartë. Kësisoj kjo është një periudhë e artë për punësim të studentëve gjatë sezonit të verës.

- Nevojitet një bashkëpunim dhe koordinim më i mirë në 3 hallkat; universitet–biznes- pushtet lokal në funksion përmirësimit të aftësive organizative, shmangien e burokracive, përballimin e sfidave të turizmit në të tashmen dhe në të ardhmen.

- Universitetet në Shqipëri në tërësi përbëjnë shembuj suksesi, pasi studentët ose të kualifikuarit janë integruar në industrinë e turizmit si të punësuar, sipërmarrës, ushërrëfyes, administrator

etj. në bizneset e turizmit lokal apo rajonal duke dhënë kontributin e tyre në avancimin e mëtejshëm të kësaj dege të ekonomisë. Në shumë nga kurrikulat që ofrojnë këto universitete janë përfshirë lëndë të tilla si turizmi kulturor, turizmi aventuror, rural, me bazë natyrën etj.

- Edhe punësimi i stafit akademik me origjinë nga biznesi është një aspekt tepër pozitiv në ndërthurjen e IAL-ve me biznesin.

- Studentët janë një kampion shumë i mirë për të testuar se çfarë turistët kërkojnë, çfarë mangësish ka ekonomia turistike dhe si mund të përmirësohet akoma më tej ecuria e saj. Edhe aktivitet praktike të tyre si realizimi i anketave, inervista etj sjellin informacionin e duhur për të bërë analiza dhe për të ndërtuar politika dhe strategji në funksion të tij.

BIBLOGRAFIA

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qiriazi. P, Trashëgimia natyrore e Shqipërisë Tiranë 2018

2. Doka.Dh, Draçi. B, Gjeografia e Turizmit, SHBLU, Tiranë 2009

3. Griffiths, Ralph; Griffiths, G.E. (1772). "Pennant's Tour in Scotland in 1769". The Monthly Review, Or, Literary Journal. 46: 150. Retrieved 23 December 2011.

4. Harper, Douglas. "tour (n.)". Online Etymology Dictionary. Retrieved 23 December 2011.

5. Meçaj. N, Gjeografi e Aplikuar, Toena, Tiranë 2004

6. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Strategjia Kombëtare për zhvillimin e qëndrushëm, Janar 2018

7. "Online Etymology Dictionary". etymonline.com. Retrieved 2 June 2016

8. https://www.unwto.org/international-tourism-growth-continues-to-outpace-the-economy#:~:text=1.5%20billion%20international%20tourist%20arrivals,in%20view%20of%20current%20uncertainties.
9. http://fshsts.umb.edu.al/
10. http://hoteleriturizemtr.vet.al/school/history
11. http://uogj.edu.al/departamenti-politikave-ekonomike-dhe-turizmit/
12. https://unishk.edu.al/universiteti/fakultetet/fakulteti-ekonomik
13. https://www.fhf.edu.al/arkeologjia-dhe-trashegimia-kulturore/
14. https://uniel.ems.al/school/programlist.aspx
15. https://univlora.edu.al/fakulteti-i-ekonomise/
16. https://uet.edu.al/new/fakulteti-i-ekonomise-biznesit-dhe-zhvillimit-2/?lang=sq
17. https://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomise-dhe-agrobiznesit/departamenti-menaxhim-turizem-rural/
18. https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/fakulteti-i-biznesit/
19. https://www.unkorce.edu.al/sq/fakulteti-i-ekonomis%C3%AB
20. https://umt.edu.al/fakultetet
21. http://www.kulogos.edu.al/sq/fakulteti-ekonomik/
22. https://www.umsh.edu.al/media/5ee69cf6786cc.pdf

THE IMPORTANCE OF COGNITIVE READING STRATEGIES IN COMPREHENDING LITERARY TEXTS

PhDc. Ardita Dylgjeri
University "Aleksandër Xhuvani", Faculty of Human Sciences, Elbasan, Albania
arditadylgjeri@live.com

Abstract

The process of reading has undergone several changes and developments in the recent years. Taking into consideration the most contemporary cognitive theories, it is becoming evident the importance of moving from the "writerly" dimension to the "readerly" dimension of reading texts, especially literary texts. The "readerly" dimension is about the cognitive or mental capacities a reader uses when trying to analyze a text. Thus, it aims towards models that make explicit the links between the human mind and the process of reading. In this respect, the reading strategies the students make use of when trying to comprehend literary texts, is an important aspect to be considered.

There is a list of main cognitive reading strategies the students generally make use of when trying to comprehend and analyze literary texts. However, naturally and normally, the students do not make use of all of them in any type of text assigned for analysis. Basically, this article aims to show, not only statistically, but also to describe which cognitive reading strategies are most widely used by students and why. As a lecturer of subjects as: Stylistics and English through literary genres, I will try to make evident the factors that contribute into the extensive use of some reading strategies instead of some others when comprehending literary texts. This short study will also be followed by a questionnaire completed by a target group of 40 students of the English Language branch in the University of Elbasan, "Aleksandër Xhuvani". The data gathered from the questionnaire would lead to the findings and discussion of the results in a qualitative and quantities approach.

Key words: cognitive, strategies, comprehend, literary texts, readers.

Introduction

The process of reading and comprehending a literary text does not merely mean decoding a text, semantically identifying words and phrases, but it is considered in a more contemporary approach as a process of interaction, involving a reader engaging with the information submitted by the author through the text. Through this process, the reader seeks to understand, evaluate, and utilize the information and ideas being presented. In reading comprehension, to understand the text, the reader needs to apply a comprehension strategy appropriate to the text they read. These strategies include selecting, predicting, confirming, and validating the results of the understanding. The use of these strategies has an effect on the reader's success in comprehending the content of the text (Cohen & Lotan, 1986, p. 133). This means that the use of the right strategy can optimize the results of comprehension while the use of inappropriate strategies can be a barrier to the success of comprehension. Especially, when reading a literary text in another language, other than your mother tongue may make the comprehension process encounter many more difficulties and obstacles. This would not only encompass finding out the meaning of certain words and phrases used in literary texts, but also being aware of the figurative and idiomatic language specifically used in such typology of texts.

According to (Hurd & Tim, 2008, p. 72) "Cognitive strategies are direct strategies used to orchestrate the mental processing of a target language". This can serve as a focal point of our study, since reading literature in English through literary genres (the subject taken into consideration) does not only mean reading short stories, poems and dramas as diverse literary genres, but also reading them in English which is not the students` native language. As a result, drawing maps between the target and source language, metaphorically speaking, but not only, would lead to both interesting and challenging phases to be followed by the students when reading and comprehending literary texts.

Moreover, the cognitive strategies that readers use to facilitate the process of reading and successful comprehension of literary texts make an important focus on the recent studies all over the world. The literature elements such as: themes, motifs, symbols, setting, tone and style, can certainly help the students to improve their reading strategies and better comprehend and critically analyze and evaluate literary texts. As a matter of fact, reading and comprehending literary texts does not only mean literally understanding and summarizing the main ideas and points made through the text, but it also encompasses finding out and analysing the metaphorical and figurative language, features and traits that these types of texts are typical of.

In addition, literary texts, from the linguistic point of view, may help the students to enrich their vocabulary in a fruitful way. It is widely known that literature serves as an unlimited source of new valuable vocabulary in different fields. Literature provides the readers with the bright opportunity to gain knowledge in a wide range of disciplines, since it includes in itself various contexts in which language is proficiently used.

Whereas, from the cultural point of view, literary texts offer the readers some sufficient information about different social, cultural and personal contexts in which the text is elaborated. This would affect and infect the readers at the same time. By digesting or absorbing colourful frames in which the happenings and events occur in a literary text, the students may get better involved in the stories.

Furthermore, the main aim of literature is to transmit to the readers the artistic feeling of beauty and of course to be enjoyed by them. Reading literature should first and foremost be a process of evaluating and enjoyment. As a result, if students really liked what they were reading, they would definitely comprehend it better by employing the necessary cognitive reading strategies.

I. Cognitive Strategies in reading.

The cognitive processes of reading comprehension roughly fall into two categories:

(1) lower level processes that involve translating the written code into meaningful language units and,
(2) higher level processes that involve combining these units into a meaningful and coherent mental representation.

With respect to lower level processes, there is general consensus that comprehension of text depends heavily on decoding (Perfetti, 1985), reading fluency (Fuchs, Douglas, Hosp, & Jenkins, 2001), and vocabulary knowledge (Nagy, Patricia, & Anderson., 1985). Whereas, higher level processes include drawing and mapping processes into more evolved mental representations of the objects, people, events and circumstances described in texts. Unfolding such elements into the readers eyes and mind would lead to better comprehension and analysis of texts, mainly the literary ones which due to the figurative and idiomatic language being used can become far more difficult, attractive and elaborated.

Lower level processes initiate to develop in somebody`s mental development since early childhood, even before children begin to read actively. On the other hand, higher level processes, being more elaborated and complicated require the readers to gain more effective tools and methods for analysis and understanding. However, it is observed that there are no clear cut boundaries between lower and higher level processes. Even inference, which is considered to be part of higher level comprehending processes, which is not only innate as the first one mostly is, can also be learned and acquired during the years.

The most normal question that arises in this situation is:

- How do we understand what we read? *Or*
